

MËSIMDHËNIA E HISTORISË MODERNE TË EUROPËS JUGLINDORE
Materiale Mësimore Plotësuese

Kombet dhe shtetet në Europën Juglindore

Mësimdhënia e Historisë Moderne të Europës Juglindore. Materiale mësimore plotësuese. Redaktor për botimin në gjuhën shqipe: Helian Demiri

Titulli në origjinal: Teaching Modern Southeast European History, Alternative Educational Materials, Nations and States in Southeast Europe (*Mësimdhënia e Historisë Moderne të Europës Juglindore, Materiale mësimore plotësuese, Kombet dhe shtetet në Europën Juglindore*), Selanik, 2009

Përkthyen nga anglishtja: Danjela Shkalla, Lumnis Çela, Sonila Danaj, Ymer Leksi

Redaktor gjuhësor: Prof. Dr. Tomor Plangarica

Recensentë për botimin në gjuhën shqipe: Prof. Dr. Xhevat Lloshi, Prof. Dr. Remzi Përnaska

Faqësja dhe botimi: Shtypshkronja „Obod” ad Cetinje

Numri i kopjeve: 700

Ky botim është financuar nga Bashkimi Europian



The European Union's Instrument for Pre-accession Assistance (IPA)

“The contents of this publication are the sole responsibility of the author and can in no way be taken to reflect the views of the European Union.”

Përmbajtja e këtyre librave është përgjegjësi vetëm e autorëve dhe nuk mund të thuhet se paraqet pikëpamjet e Bashkimit Europian

Raportues i CDRSEE-së në bordin drejtues të *Projekti i Historisë së Përbashkët*: Costa Carras

Drejtor ekzekutiv: Nenad Šebek

Drejtor i programeve: Corinna Noack-Aetopoulos

Koordinatorë të projektit: Antonis Hadjiyannakis, Zvezdana Kovač, Jenny Demetriou & Susan Nadeau Bustamante

Sponsorë për botimin në gjuhën shqipe:

THE PUBLICATIONS AND TEACHER TRAINING ACTIVITIES OF THE JOINT HISTORY PROJECT HAVE BEEN MADE POSSIBLE THROUGH THE KIND FINANCIAL BACKING OF THE FOLLOWING:



Copyright: Center for Democracy and Reconciliation in Southeast Europe (CDRSEE)

Krispou 9, Ano Poli, 54634 Thessaloniki, Greece

Tel.: +30 2310 960820-1; Fax: +30 2310 960822

e-mail: info@cdrsee.org, web: www.cdrsee.org

ISBN: 978-99956-726-9-0

MËSIMDHËNIA E HISTORISË MODERNE TË EUROPËS JUGLINDORE
M a t e r i a l e M ë s i m o r e P l o t ë s u e s e

LIBRI I PUNËS 2

Kombet dhe shtetet në Europën Juglindore

Redaktore: MIRELA-LUMINITA MURGESKU
Redaktore e përgjithshme e serisë: KRISTINA KOULOURI
Redaktor për botimin në gjuhën shqipe: HELIAN DEMIRI

Botimi i dytë



Cetinë 2012

Pasqyra e Lëndës

Hyrje	13
Kronologjia	17
<i>Harta 1: Krijimi i shteteve moderne në Ballkan</i>	25
KAPITULLI I: Formimi i shteteve kombëtare: synimet përkundrejt arritjeve	27
I-1. Marrëdhëniet ndërmjet Greqisë dhe Europës sipas Josip Mesidaksit (1761)	27
I-2. Bazat historike të kombit bullgar, sipas Paisi Hilendarskit (1762)	27
I-3. Evgenios Vulgarisi në mbrojtje të shtetit grek (rreth 1770)	28
I-4. Kërkesë e përfaqësuesve malazezë, dërguar perandoreshës austriake, Maria Terezës, me pretendimin që t'u njihet pavarësia (1779)	30
I-5. Dimitrios Katarcisi shpjegon se përse grekët përbëjnë një komb, ndonëse nuk kanë shtet (1783)	30
I-6. Peticion rumun për barazi kombëtare në Transilvani – <i>Supplex Libellus Valachorum</i> (1791)	31
I-7. Memorandum osman kundër Revolucionit Francez (1798)	32
I-8. Ndikimi i Revolucionit Francez tek intelektualët e Europës Juglindore – <i>Poemë kushtrimi</i> nga Adamantios Koraisi (1800)	32
I-9. Thirrje nga Aleksandër Ipsilanti : Luftoni për fe dhe për atdhe! (1821)	33
I-10. Kërkesa konservatore të parisë boshnjake (1826)	33
I-11. Hatisherifi i Gjylhanesë (1839)	33
I-12. Argumentim nga Jon Kodru-Dragushanu, në mbështetje të shtetit kombëtar (1844)	34
I-13. Projekti i Ilija Garashaninit për krijimin e një perandorie serbo-sllave (1844)	35
I-14. Kërkesat kombëtare në revolucionet e 1848-ës	36
A. Kërkesat e sllovenëve	36
B. <i>Kërkesat e popullit</i> , miratuar nga Asambleja Kombëtare Kroate në Zagreb	36
C. <i>Peticioni kombëtar</i> , miratuar nga Asambleja Kombëtare Rumune, në Blazh të Transilvanisë	36
I-15. Mitropoliti Petar II Petroviç Njegoshi mbështet jugosllavizmin (Cetinë, 12 mars 1850)	37
I-16. Pakënaqësia e të krishterëve boshnjakë ndaj sundimit osman, paraqitur nga murgu françeskan, Ivan Frano Jukiçi (1850)	38
I-17. Hati Humajuni Osman vendos barazinë ndërmjet nënshtetasve osmanë, pavarësisht nga besimi i tyre fetar (1856)	38
I-18. Opinionet kundërshtuese në lidhje me planin e krijimit të një shteti dualist bullgaro-osman (1867)	39
A. Promemorje e Komitetit Qendror të Fshehtë Bullgar, drejtuar sulltan Abdul Azizit	39
B. Reagimi i Fuad pashës, siç përshkruhet në kujtimet e Hristo Stambolskit	40
I-19. Projekti për bashkimin e bullgarëve dhe të serbëve në një mbretëri sllave të Jugut, nën sundimin e princit serb, Mihail Obrenoviçi (1867)	41

I-20.	Nga raporti i një diplomati rus, mbi planet për formimin e një shteti të përbashkët rumuno-bullgar (1867)	41
I-21.	Mbi marrëdhëniet ndërmjet lirisë politike dhe kombit – opinion i shprehur në editorialin e botuar nga Ljuben Karavelovi në gazetën “Svoboda” (nëntor 1869)	42
Fig. 1.	Sllovenia: Lëvizja tabore (1869)	42
I-22.	Fermani që bëri të mundur krijimin e Ekzarkatit bullgar (1870)	43
I-23.	Rezultatet e plebishitit për besnikërinë kishtarë në peshkopatat e Shkupit dhe të Ohrit (1874)	43
I-24.	Hristo Botevi mbi nevojën që bullgarët të luftojnë për çlirimin kombëtar (1875)	43
I-25.	Programi politik i Shoqërisë Bamirëse Qendrore Bullgare (Bukuresht, nëntor 1876)	44
I-26.	Memorandumi i Shqiptarëve kundër Paqes së Shën Stefanit (1878)	44
I-27a.	Poezi shqiptare e shkruar në kohën e Kongresit të Berlinit (1878)	45
I-27b.	Protestë e popullsisë së sanxhakut të Prishtinës drejtuar Kongresit të Berlinit duke raportuar mizoritë e kryera ndaj popullsisë vendase (25 qershor, 1878)	45
I-27c.	Notë proteste e popullsisë të Kosovës, Rrafshit të Dukagjinit, Dibrës, Shkupit, Manastirit, Tetovës, Novipazarit, Senicës, Tashlixhes, Gucisë drejtuar Kongresit të Berlinit duke i kërkuar mbrojtje (26 qershor, 1878)	46
I-28.	Traktati i Paqes i Berlinit (1878)	47
<i>Harta 2:</i>	Ballkani sipas Traktatit të Berlinit, korrik 1878	50
Fig. 2.	Greqia ndërmjet Turqisë dhe Europës. Karikaturë e marrë nga gazeta “Aristofanes” (1882)	51
I-29.	Kërkesat e Komitetit Qendror të Lidhjes së Prizrenit dërguar sulltanit (22 korrik, 1880)	51
I-30.	Argumentim shqiptar në mbështetje të një shteti të veçantë shqiptar (1886)	51
I-31.	Kujtimet e Ivan Haxhi-Nikolovit në lidhje me diskutimet më 1892-in, që çuan drejt krijimit të Organizatës së Brendshme Revolucionare Maqedonase (OBRM) (1893)	51
I-32.	Deklarata e Organizatës së Brendshme Revolucionare Maqedonase (OBRM), e cila u bën të ditur Fuqive të Mëdha vendimin e saj për fillimin e një kryengritjeje të armatosur (1903)	53
I-33.	Opinion i Kërste Misirkovit në lidhje me nevojën e gjetjes së zgjidhjeve politike për problemin maqedonas, brenda strukturës së Perandorisë Osmane (1903)	53
I-34.	Plani i Aurel C. Popovicit për ristrukturimin e Austro-Hungarisë në një shtet federal të quajtur “Shtetet e Bashkuara të Austrisë së Madhe” (1906)	54
I-35.	Përpjekjet e shqiptarëve për të siguruar shtetin e tyre kombëtar, sipas ambasadorit britanik në Perandorinë Osmane (1912)	55
Fig. 3.	<i>Shpallja e pavarësisë së Shqipërisë në Vlorë (1912)</i> – gravurë e kohës	55
I-36.	Fjalimi i Xhemal pashës në Damask, lidhur me marrëdhëniet ndërmjet turqve dhe arabëve (1913)	56
I-37.	Projekti i Dimitrij Çupovskit për formimin e një Republike Demokratike Federale Ballkanike (Shën Peterburg, 1917)	56
I-38.	Deklarata e Korfuzit (1917), lidhur me parimet që do të ndiqeshin për bashkimin e serbëve, kroatëve dhe sllovenëve	57
I-39.	Deklaratë e mbretit Nikolla të Malit të Zi, drejtuar jugosllavëve, 20 tetor 1918	58
I-40.	<i>Deklarata prej 14 pikash</i> e presidentit Uidro Uillson (1918) – klauzolat që lidheshin me Europën Juglindore	58
I-41.	Rezoluta e Asamblesë Kombëtare të Alba-Julias, ku shpallet vendimi për bashkimin e Transilvanisë me Rumaninë (1918)	59
I-42.	Fjala e Juliu Maniut në Asamblenë Kombëtare Rumune të Alba-Julias (1918)	60
<i>Harta 3:</i>	Europa Juglindore pas Versajës dhe Lozanës, 1923	61

I-43.	Propozim për organizimin e një shteti maqedonas me administrim kantonik, sipas modelit zviceran (1919)	62
I-44.	Marrëveshja e Zyrihut për Qipron ndërmjet Greqisë dhe Turqisë (1959)	62
I-45.	Franjo Tugjman argumenton të drejtën e çdo kombi për të patur shtetin e vet (1982)	63
I-46.	Deklarata e Pavarësisë së Kosovës	64
	<i>Harta 4: Europa pas Luftës I Botërore</i>	66

KAPITULLI II. Organizimi i shtetit kombëtar 67

Ila. Aspekte të përgjithshme të organizimit të shtetit 67

II-1.	Projekt i kushtetutës së hartuar nga Rigas Velestinlisi (1797)	67
II-2.	Fjalimi i Bozha Grujeviçit në sesionin e parë të Këshillit Serb (1805)	68
II-3.	Letra e Vuk Karaxhiçit, drejtuar princit Millosh Obrenoviç (1832)	69
II-4.	Kushtetuta serbe e vitit 1835 – struktura e pushtetit	70
II-5.	Kushtetuta rumune e vitit 1866 – dispozitat e përgjithshme	70
II-6.	Deklaratë e princit Nikolla, drejtuar popullit të Hercegovinës në qershor 1876	71
II-7.	Qëndrimet e osmanëve ndaj kushtetutës, sipas ambasadorit britanik në Stamboll (1876)	71
II-8.	Kushtetuta osmane e vitit 1876	71
II-9.	Parathënia e Kushtetutës së Malit të Zi (1905)	73
II-10.	Deklarata e xhonturqve (1908)	73
II-11a.	Kushtetuta e Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (1974)	74
II-11b.	Kushtetuta e Kosovës (1974)	75
II-12.	Kushtetuta e Serbisë 1990	76
Tab. 1:	<i>Kushtetutat e shteteve të Europës Juglindore</i>	77
Tab. 2:	<i>Vendosja e të drejtës së përgjithshme të votës në Europën Juglindore</i>	77
Fig. 4.	Sheshi i Kushtetutës në Athinë (1863)	78

Ilb. Nënshtetësia 78

II-13.	Përkufizimi i nënshtetësisë sipas <i>Kushtetutës Greke të Epidaurusit</i> (1822)	78
II-14.	Përkufizimi i nënshtetësisë sipas <i>Kushtetutës Greke të Troezenes</i> (1827)	79
II-15.	Përkufizimi i nënshtetësisë në <i>Kushtetutën Serbe të vitit 1835</i>	79
II-16.	Kodi ligjor i Danilos I të Malit të Zi dhe Bërdas (1855)	80
II-17.	Ripërkufizimi i nënshtetësisë sipas <i>Nenit 7</i> të Kushtetutës Rumune (1879)	80
II-18.	Traktati mbi pakicat kombëtare, i nënshkruar ndërmjet Forcave Aleate dhe Rumanisë (1919)	81
II-19.	Ripërkufizimi i nënshtetësisë sipas Kushtetutës Rumune të vitit 1923	82

Ilc. Kombet dhe Kishat 83

II-20.	Patriarkana Ortodokse e Kostandinopojës dënon zakonin e vënies fëmijëve, të emrave të lashtë grekë (1819)	83
II-21.	Opinione të ndryshme lidhur me vendosjen e autonomisë së Kishës Greke, kundrejt Patriarkanës Ortodokse të Kostandinopojës (1833)	83
	A. Teokletos Farmakidesi – ndërmbështetësit e zjarrtë	83
	B. Konstantinos Oekonomi – kundërshtar i autonomisë	84
II-22.	Dekreti për krijimin e autoritetit sinodik të Kishës Ortodokse në Rumani (1864)	84
II-23.	Komentet e gazetarit francez, Sharl Iriarte, mbi pikëpamjet e priftërinjve katolikë dhe ortodoksë për lidhjen ndërmjet fesë dhe kombësisë në Bosnjë (1875-1876)	84
II-24.	Kushtetuta Bullgare e 1879-ës, mbi pozitën e <i>Kishës Ortodokse Bullgare</i>	85

Il-25.	Pikëpamjet e Nikolla Pashiqit, mbi raportet ndërmjet kombit serb dhe Kishës Ortodokse (1890)	85
Il-26.	Besimi ortodoks shpallet besim zyrtar në Malin e Zi	86
	A. Kushtetuta e Sinodit të Shenjtë të Principatës së Malit të Zi, 20 dhjetor 1903	86
	B. Nenet e lidhura me besimin fetar në kushtetutën e Principatës së Malit të Zi, të vitit 1905	86
II d. Infrastruktura e shteteve kombëtare		86
Il-27.	Rëndësia e zhvillimit industrial për një komb të vogël – një argumentim grek (1841)	86
Fig. 5.	Kartëmonedhë në të cilën paraqiten marrëdhëniet ndërmjet elementeve ekonomike të një vendi dhe simboleve përfaqësuese kombëtare – kartëmonedha e parë me vlerë 500 dhrahmi, lëshuar nga Banka Kombëtare Greke (1841)	87
Il-28.	Roli i hekurudhave në forcimin e shtetit kombëtar – opinionin e një rumuni (1870)	87
Il-29.	Opinionin e princit bullgar, Aleksandër Batenberg (1879-1886), mbi rëndësinë e hekurudhave (1879-1881)	87
Il-30.	Përshkrimi i një hekurudhe bullgare gjatë fundit të shekullit të 19-të	88
Il-31.	Ligji bullgar për njësitë matëse (1889)	88
Fig. 6.	Teknologjitë e reja dhe simbolet kombëtare – afishe reklamuese e makinave qepëse (fundi i shekullit të 19-të, Greqi)	88
II e. Ndërtimi i kombit		89
Il-32.	Përdorimi i keq i gjuhës kroate kritikuar prej Ivan Kukuljeviçit (1843)	89
Il-33.	Rëndësia e gjuhës për identitetin kombëtar – opinionin e një sloveni (1861)	90
Il-34.	Rëndësia e gjuhës për identitetin rumun, sipas Titu Maioreskut (1866)	90
Il-35.	Peticioni i parlamentit kroat, drejtuar mbretit-perandor, Franc Jozefit, për miratimin e krijimit të Akademisë Jugosllave të Shkencës dhe Artit (1867)	91
Fig. 7.	Teatri Kombëtar në Bukuresht – kartolinë (vitet 1890)	91
Il-36.	Rëndësia e gjuhës dhe letërsisë në zhvillimin e kombit – pjesë nga dokumenti themeltar i “Shoqërisë së të Shtypurit Shkronja Shqip” (1879)	91
Il-37.	Memorandumi i studentëve maqedonas në Shën Peterburg, lidhur me gjuhën letrare maqedonase (1902)	91
Il-38.	Planet për zgjimin e ndjenjave kombëtare rumune në Transilvani – letra e dr. I. C.	92
Il-39.	Plani për organizimin e lëvizjes kombëtare shqiptare – letra e gazetarit Faik Konica, drejtuar baronit Goluhovski (Bruksel, 1897)	92
Il-40.	Udhëzime mbi mësimdhënien e historisë në Greqi (1881)	93
Fig. 8.	Fëmijë me veshje historike (Greqi, rreth 1875-ës)	93
Il-41.	Përpyekjet për vendosjen e sportit kombëtar në Rumani (1898)	94
Fig. 9.	Certifikatë e konkursit sportiv për djemtë e shkollave të mesme, organizuar nga “Gazeta Sporturilor” (në periudhën midis Luftërave në Rumani)	94
Il-42.	Mbreti shqiptar, Zogu I, mbi rëndësinë e shërbimit të detyrueshëm ushtarak në ndërtimin e kombit (1928)	94
Fig. 10.	Vetëpërcaktimi kombëtar nëpërmjet pamjeve – kartolinë slovene	95
Il-43.	Qëllimet e arsimit turk, të përkufizuara nga Zija Gokalpi (1914)	95
Il-44.	Pjesë e shkëputur nga një promemorie e Ministrisë së Arsimit dhe Çështjeve Fetare të Malit të Zi, 1908	96
Il-45.	Politika gjuhësore dhe e trajtimit të historisë e Ataturkut, e kritikuar nga një kundërshtar i tij (shënime ditari, 1932)	96
Il-46.	Besa dhe gjakmarrja sipas ligjit tradicional të Lekë Dukagjinit	97
Il-47.	Kujtimet e Mahmud Esad Bozkurtit, mbi thelbin nacionalist të “Revolucionit të Ataturkut”	97

KAPITULLI III: Ideologjitë kombëtare	98
IIIa. Ç'është kombi?	99
III-1. Të drejtat dhe detyrat e kombit rumun, përkufizuar nga poeti dhe politikani Dimitrie Bolintineanu (1869)	99
III-2. Tiparet themelore të kombeve, sipas një teksti shkollor serb (1870)	100
III-3. Përkufizimi i Zija Gokalpit për kombin (1923)	101
III-4. Ndryshimet në përkufizimin e Mustafa Qemal pashës mbi kombin	101
A. Theksimi i fesë gjatë luftës (1920)	101
B. Shtimi i kulturës (1922)	101
C. Theksimi i unitetit (1924)	101
D. Përgjithësimi dhe thjeshtëzimi (1929)	101
IIIb. Vetidentifikimi kombëtar	102
III-5. Të qenët bullgar – poema <i>Unë jam bullgar</i> nga Ivan Vazov (1917)	102
III-6. Të qenët shqiptar – mendimi i Pashko Vasës (1879)	102
Fig.11. Vetëpërcaktimi kombëtar nëpërmjet pamjeve – kartolinë sllovene (fillimi i shekullit të 20-të)	103
Fig.12. Vetëpërcaktimi kombëtar nëpërmjet pamjeve – kartolinë rumune	103
III-7. Të qenët turk – opinion i dr. Riza Nurit (1932)	103
III-8. Të qenët slloven – mbi karakterin e sllovenëve, nga Dimitri Rupel (1987)	103
III-9. Vetidentifikimi i fshatarësisë rumune, jo sipas përkatësisë kombëtare – nga kujtimet e George Jonesku-Gionit (1889)	104
III-10. Vetidentifikimi jo sipas përkatësisë kombëtare në Maqedoni – përvoja e H. N. Brailsfordit (1905)	104
Fig.13. Pavjoni për Bosnjë-Hercegovinën, në Ekspozitën Ndërkombëtare të Parisit (1900)	105
IIIc. Simbolet kombëtare	106
III-11. Si i përfytyronte Rigas Velestinlisi flamurin dhe simbolet e Republikës Greke (1797)	106
Fig.14. Flamuri i ishullit grek të Psaras, gjatë luftës për pavarësi, në të cilin paraqitet motoja “Liri a vdekje”, kryqi, si dhe simbolet e shoqërisë së fshehtë “Filiqi Eteria”	106
Fig.15. Flamuri rumun i Gardës Urbane të Bukureshtit, me mbishkrimin “Bashkimi bën fuqinë” (1867)	107
Fig.16. Flamuri dhe stema e Mbretërisë së Serbëve, Kroatëve dhe Sllovenëve / Mbretërisë së Jugosllavisë (që prej vitit 1929)	107
III-12. Domethënia e flamurit shqiptar, shprehur gjatë fjalimit të peshkopit Fan Stilian Noli, në varrimin e Faik Konicës (1942)	107
Fig.17. Flamurët e sotëm të shteteve të Europës Juglindore	108
III-13. Himnet kombëtare	108
A. Himni kombëtar grek (1823)	108
B. Himni kombëtar kroat (1835)	109
C. Himni kombëtar shqiptar (1912)	109
Fig. 18. Ndryshimet që ka pësuar stema bullgare (nga viti 1741 deri në ditët tona)	110
Fig. 19. Stema serbe, modeluar nga Pavao Riter Vitezoviçi (1701)	110
Fig. 20. Stema e Mbretërisë Serbe (vitet 1880-të)	110
Fig. 21. Stema e Mbretërisë të Malit të Zi, 1905	111
Fig. 22. <i>Monarkia dhe shteti</i> – kartolinë rumune në të cilën paraqitet mbreti Karol I (1866-1914).	111
III-14. Përpjekjet për krijimin e një veshjeje kombëtare në Greqi (1843)	111

Fig. 23.	Një vajzë fshatare serbe me veshjen kombëtare (1865)	111
	Tabela 3: Festat kombëtare kryesore në shtetet e sotme europiane juglindore	111
III d. Mitologjitë kombëtare		113
Fig. 24.	Paraqitja simbolike e kombit	113
	A. <i>Bullgaria e çliruar</i> – litografi e Georgi Dançovit (1879)	113
	B. Kartolina franceze të cilat paraqesin Serbinë dhe Malin e Zi (1917)	114
III-15.	Rrënjët historike të kombit maqedonas – Gjorgji Pulevski, <i>Për maqedonasit</i> (1879)	114
Fig. 25.	Heronjtë historikë si modele për të sotmen	115
	A. Leonidha, mbreti i Spartës së lashtë, u deklaroi persëve se ai nuk do të dorëzohet: “Μολων Λαβει” (Molon Lave - “Ejani ta merrni”) – figurë në një libër shkollor grek (1901)	115
	B. Vdekja e Vasa Çarapiçit gjatë pushtimit të Kalasë së Beogradit, 1806 – pikturë e Anastas Jovanoviçit (1817-1899)	115
III-16.	Kujtimet e dr. Riza Nurit, mbi ndikimin e tregimeve epike popullore	115
Fig. 26.	Pasqyrimi simbolik i ngjarjeve politike	116
	A. <i>Kryengritja e malazezve</i> – pikturë e Dura Jakshiçit (1832-1878)	116
	B. <i>Bullgaria e bashkuar</i> – pikturë e Nikolai Pavloviçit (1885)	116
III-17.	Ligji rumun për krenmtimet në kujtim të heroinës së luftës Ekaterina Teodoriu (1921)	117
Fig. 27.	Afische rumune për krenmtimin e 70-vjetorit të krijimit të shtetit modern (1929)	117
Fig. 28.	Pullë kroate në të cilën paraqitet basketbollisti i njohur Drazen Petroviç (1994)	118
III-18.	Origjina historike e stemës shqiptare, shpjeguar nga një historian bashkëkohor (2000)	118
KAPITULLI IV: Nacionalizmat në konflikt		119
IVa. Ideologjitë e përdorura për nxitjen e konfliktit		119
IV-1.	Paragjykimi kombëtar ndaj gjermanëve në Kroaci (1866)	119
IV-2.	Kujtimet e dr. Riza Nurit, për refuzimin e martesës me një vajzë të huaj (1910)	120
IV-3.	Mospajtme në lidhje me <i>Megali Idhenë</i> greke – diskutimi i profesorit Nikolaos Saripolos me mbretin George I (1877)	120
IV-4.	Përkufizimi i hapësirës kombëtare rumune, sipas historianit Aleksandër D. Ksenopoli (1888)	120
IV-5.	Ndarjet kombëtare në parlamentin osman (1908-1914)	121
IV-6.	Shpallje të luftës anticoloniale nga qipriotët grekë (1955)	121
IVb. Konfliktet konkrete		123
IV-7.	Stjepan Radiç, <i>Ne duam shtetin tonë kroat brenda Bashkimit Jugosllav</i> (1918)	123
IV-8.	Deklarata e serbëve, kroatëve dhe boshnjakëve (1943)	123
IV-8a.	Vendimet e Asamblesë së Madhe Kombëtare (Asamblesë së Podgoricës), 13 nëntor 1918	123
IV-8b.	Fjalimi i delegatit malazes, Anto Gvozdenoviç, në Këshillin e të Dhjetëve të Konferencës së Paqes në Paris, 5 Mars 1919	123
IV-9.	Deklarata e Asamblesë së Parë Antifashiste për Çlirimin e Popullit Maqedonas (1944)	124
IV-10.	Vështirësitë e luftës anticoloniale në Qipro (1955-1959), analizuar nga udhëheqësi i EOKA-s, George Grivasi (Digenis)	125
Fig. 29.	Thirrja e Qipros drejtuar Kombeve të Bashkuara (vitet 1950)	125
IV-11.	Këndvështrimi i Partisë Qipriote Greke, parti e krahut të majtë (AKEL), 1955	126

IV-12.	Qipriotët turq kundër EOKA-s, 1960	127
IV-13.	Qëllimet e “Pranverës kroate” në fillim të viteve 1970-të, sipas shkrimtarit Vlado Gutovac	128
IV-14.	Memorandumi i Akademisë Serbe të Artit dhe Shkencës (SANU) (1986)	128
IV-15.	Qëndrimi i një slloveni mbi çështjen e gjuhës në Jugosllavinë komuniste (1987)	130
IV-16.	Deklarata e majit e Shoqatës Demokratike Sllovene (1989)	131
IV-17.	Futbolli dhe nacionalizmi – një tifoz kroat kujton udhëtimin e tij për ndeshjen midis <i>Partizanit të Beogradit dhe Dinamos së Zagrebit</i> (1989)	131
IV-18.	Shkrimtarja Dubravka Ugresiçi shpreh keqardhje për ndarjet dhe luftërat e viteve 1990-të	132
IV-19.	Marrëdhëniet ndërmjet gjuhës kroate dhe asaj serbe – opinioni i gjuhëtarit kroat, Stjepan Babiç (2003)	133
IV-20.	Reagimet në Kroaci ndaj shfaqjes së një filmi serb me titra kroatë (1999)	133
IV-21.	Identiteti i dyfishtë i një gruaje të re në Kroaci	133
IVc. Kapërcimi i nacionalizmit?		134
IV-22.	Kuadri i përgjithshëm ligjor i <i>Marrëveshjes për Paqen</i> në Bosnjë-Hercegovinë (1995)	134
IV-23.	Traktati i <i>Mirëkuptimit, Bashkëpunimit dhe Fqinjësisë së Mirë</i> ndërmjet Republikës së Hungarisë dhe Rumanisë (1996)	136
IV-24.	Vlerësim, bazuar në përvojat vetjake, lidhur me marrëdhëniet ndërmjet Rumanisë dhe Hungarisë në zonat me popullsi të përziera (2001)	137
IV-25.	Pikat e Marrëveshjes së Ohrit, e cila i dha fund konfliktit të armatosur në Republikën e Maqedonisë (2001)	137
IV-26.	Sportet, si një mënyrë e kapërcimit të nacionalizmit. Qipriotët grekë, duke mbështetur skuadrën vendase qipriote turke të futbollit (2003)	138
Fig. 30.	Vija ndarëse (“Vija e gjelbër”), e cila ndante Nikozinë (2003)	138
IV-27.	Dy opinione, lidhur me heqjen e <i>Vijës së gjelbër</i> ndërmjet pjesës turke dhe asaj greke të Qipros (23 prill 2003)	139
	A. Vlerësim nga Nikos Anastasiu, publikuar në internet	139
	B. Një mësues turk nga Famagusta përshkruan vizitën e tij në një familje qipriote greke (2003)	139
Bibliografia		141

Kombet janë një prej elementeve përbërëse bazë të Europës moderne, ashtu siç janë edhe pjesë me rëndësi të botës joeuropiane. Që në shekullin e 19-të, forca e ideologjive nacionaliste ka përcaktuar veprimtarinë e grupeve të mëdha të njerëzve, si dhe funksionimin e shteteve. Nga kjo pikëpamje, Europa Juglindore nuk përbën përjashtim. Gjatë shekullit të 19-të, në këtë rajon u shfaqën pesë shtete kombëtare. Disa prej tyre ishin shtete krejtësisht të reja, të ngritura në ato territore që më parë kishin qenë nën sundimin e drejtpërdrejtë osman: Serbia (fillimi i luftës çlirimtare në vitin 1804, formimi i shkallëshkallshëm i shtetit gjatë periudhës 1815-

1830, zyrtarisht e pavarur që prej vitit 1878) ; Greqia (fillimi i luftës çlirimtare në vitin 1821, marrja e pavarësisë në vitin 1830); Bullgaria (kryengritja antiosmane në vitin 1876, formimi i shtetit në vitin 1878, pavarësia në vitin 1908). Dy shtetet e tjera u shfaqën prej shteteve të krishtera, vasale të Perandorisë Osmane, siç ishte Rumania (e krijuar nga bashkimi i Vllahisë me Moldavinë në vitin 1859, e pavarur që nga viti 1877/1878) dhe Mali i Zi (territori i pavarur, i sunduar prej princave peshkopë që nga shekulli i 18-të, shndërruar në një principatë të trashëgueshme në vitin 1852 dhe i pavarur që prej vitit 1878). Në fillim të shekullit të 20-të u shfaqën edhe dy shtete të tjera kombëtare: Shqipëria, në vitet 1912/1913, si rrjedhojë e Luftërave Ballkanike, dhe Turqia, në kontekstin e shpërbërjes së Perandorisë Osmane në fund të Luftës I Botërore (me qeveri kombëtare de facto që prej vitit 1919, dhe me shpalljen zyrtare të Republikës së Turqisë, në vitin 1923). Qiproja, koloni e Mbretërisë Britanike, u bë shtet i pavarur në vitin 1960; me shpërbërjen e Jugosllavisë në vitin 1991, u shfaqën disa shteteve të reja: Sllovenia, Kroacia, Republika e Maqedonisë*, dhe Bosnjë- Hercegovina, ndërkohë që Serbia dhe Mali i Zi krijuan një federatë, e cila u riorganizua në vitin 2002. Në vitin 2006 Serbia dhe Mali i zi u ndanë si dy shtete të veçanta.

Sigurisht që shtetet kombëtare nuk kanë qenë dhe nuk janë forma e vetme e qeverisjes në Europën Juglindore. Përveç tyre, kanë ekzistuar, gjithashtu, edhe forma të tjera, perandori shumëkombëshe dhe shtete shumetnike, ndërkohë që kombe të ndryshme kanë kaluar periudha të gjata, pa pasur shtetin e tyre. Pavarësisht nga kjo, marrëdhëniet e ndërlikuara ndërmjet kombeve dhe shteteve kanë përcaktuar historinë e këtij rajoni dhe shtetet-kombe u bënë një prej tipareve thelbësore të Europës Juglindore. Megjithëse këto shtete kombëtare janë relativisht të reja, në krahasim me disa shtete të tjera europiane si Franca, Spanja ose Britania (gjithsesi, duhet theksuar se Serbia dhe Greqia u shfaqën si shtete kombëtare përpara Italisë ose Gjermanisë), ekzistenca e rrezikuar e tyre dhe prania e një situatë në vijimësi drejt konflikteve kombëtare, gjykohen si të një rëndësie të veçantë për tërë zhvillimin historik të Europës Juglindore të dy shekujve të fundit.

Për shumicën e popujve të Europës Juglindore, shtetet-kombe të përcaktuara etnikisht janë bërë dhe modeli 'normal' i organizimit të shtetit. Njerëzit u mësuan që ta njëjtësonin vetveten me kombin 'e tyre', dhe që të luftonin për krijimin/mbrojtjen e shtetit të tyre kombëtar. Meqenëse shtetet kombëtare të Europës Juglindore janë shfaqur disi vonë, historianët dhe politikanët janë përpjekur që ta rrisin legjitimitetin e tyre përmes lidhjeve me shtetet antike dhe/ose ato mesjetare, duke përdorur kështu argumentin e 'hershmerisë' (pra që 'ne kemi qenë të parët...'), në garën ideologjike me kombet e tjera rivale. Në të tilla rrethana, historia e çdo populli është konsideruar shpeshherë si një betejë për idealet kombëtare, e cila ka paracaktuar krijimin e shteteve kombëtare; të gjitha momentet, aktorët dhe proceset historike janë vlerësuar në përputhje me kontributet e dhëna për përmbushjen e idealit kombëtar. Të tilla rrëfime historike që idealizonin të kaluarën, u përdorën për të arritur bashkimin kombëtar dhe për të mbështetur përpjekjet për modernizimin e shoqërisë. Dëshmia e këtyre përpjekjeve modernizuese ka çuar në ndërthurjen e sukseseve domethënëse me dështime

* Në kohën e botimit njihej nga të gjitha institucionet e BE dhe OKB me emrin e përkohshëm "Republika ish-Jugosllave e Maqedonisë"

të plota, dhe shtetet-kombe të Europës Juglindore duhet të mbajnë përgjegjësi për të gjitha çështjet e përfshira në këtë bilanc historik. Është plotësisht e qartë, megjithatë, se rrëfimet historike herë-herë janë keqpërdorur, për t'i mobilizuar njerëzit kundër armiqve të ndryshëm, të brendshëm dhe/ose të jashtëm, qofshin këta të vërtetë a imagjinarë. Sikundër u vërtetua edhe nga ngjarjet e fundit në ish-Jugosllavi, kjo mënyrë e keqpërdorimit të historisë shërbente si mjet për fillimin e luftërave dhe cikleve të urrejtjes midis kombeve dhe grupeve të ndryshme etnike.

Studimet që kanë të bëjnë me nacionalizmin kanë shënuar arritje të konsiderueshme kohët e fundit. Historianët dhe studiuesit e shkencave shoqërore kanë hulumtuar në lidhje me elementet strukturore të shteteve-kombe, ashtu si dhe për zhvillimin historik të tyre. Teoritë e formuluarat për natyrën e kombeve dhe të nacionalizmit kanë qenë të shumta; ato janë të ndryshme që nga etnocentrizmi i mirëfilltë, deri tek trajtimet konstruktiviste, që argumentojnë se kombet janë veçse krijime mendore, 'të shpikura' disi vonë në kohë. Megjithëse kjo ende vazhdon të jetë pjesë e një debati të fuqishëm, studiuesit po arrijnë një mirëkuptim gjithnjë e më të madh, se 'kombet' dhe identitetet kombëtare nuk janë 'njësi të përjetshme', por dukuri të zhvilluara historikisht, të cilat janë shfaqur në kontekste historike të caktuara dhe që, gjatë kohëve, pësojnë zhvillime, ndërprerje, episode të ndërtimit, të shpërbërjes dhe të rindërtimit. Shpeshherë, nacionalizmat modernë kanë përdorur ndjesi dhe simbole të hershme etnike, u kanë shtuar atyre kuptime të reja, i kanë ndërthurur me elemente të reja dhe i kanë vendosur brenda kornizave të reja mendore dhe ideologjike. Nga kjo pikëpamje, ashtu siç thotë edhe Benedict Andersoni, në të vërtetë, kombet moderne janë 'bashkësi të imagjinuara' (kujdes, 'të imagjinuara' nuk do të thotë 'të trilluara'). Ky model nuk është tipar i veçantë i Europës Juglindore. Ai është një tipar i përbashkët i botës moderne.

Përveç këtij mirëkuptimi themelor mbi 'krijimin' e kombeve moderne, historianët kanë përqasur idetë dhe kanë grumbulluar mjaft njohuri të reja mbi modelet e përgjithshme dhe karakteristikat e veçanta, të cilat kanë përcaktuar shtetet e ndryshme kombëtare. Përsa i përket Europës Juglindore, shtetet-kombe u shfaqën disi vonë, në krahasim me disa pjesë të tjera të Europës. Atje u desh që të zhvilloheshin beteja të gjata dhe të ndërlikuara ose kundër perandorive të mbetura shumëkombëshe, ose kundër shteteve kombëtare kundërshtarë. Kështu, format e nacionalizmit kanë ekzistuar përpara krijimit të shteteve kombëtare. Gjithsesi, këto tërësi të hershme vlerash kombëtare nuk mjaftuan për funksionimin e shteteve të reja dhe për rrjedhojë, elitat e reja politike dhe kulturore u përpoqën që t'i edukonin nënshtetasit e tyre sipas vlerave kombëtare. Një përpjekje e tillë shtetëtare për ndërtimin e kombit, gjithashtu nuk ishte një veçanti e Europës Juglindore. Përkundrazi, në disa pjesë të Europës Perëndimore, politika të tilla ishin ndërmarrë edhe më parë, madje edhe më të ashpra. Në librin e njohur të Eugen Veberit, *Nga fshatarë në francezë...*, tregohet se si, edhe në Francë, shumica e popullsisë fshatare filloi që ta përcaktonte vetveten me terma kombëtarë vetëm gjatë shekullit të 19-të, nën ndikimin e arsimit fillor, shërbimit të detyrueshëm ushtarak dhe komunikimit modern.

Marrëdhënia ndërmjet kombeve dhe besimeve ishte mjaft e ndërlikuar. Për shumë europianë juglindorë, përkatësia fetare ishte dhe mbeti tejet e rëndësishme, siç ishte ortodoksia për grekët dhe për serbët, apo katolicizmi për kroatët; për të tjerët, si për shembull, për shqiptarët, feja që më pak e rëndësishme, dhe kombi përfshinte njerëz të besimeve të ndryshme fetare, pa hasur vështirësi të mëdha. Në këtë Libër pune janë trajtuar shkurtimisht edhe probleme të tjera të veçanta, si marrëdhëniet midis kombeve dhe identiteteve gjuhësore.

Qëllimi kryesor i këtij Libri pune është pajisja e mësuesve dhe e nxënësve me dëshmi historike, të cilat do t'i ndihmojnë që ta kuptojnë më mirë ndërlikueshmërinë e marrëdhënieve ndërmjet kombeve dhe shteteve në Europën Juglindore. Për të qenë brenda caqeve të pranueshme dhe për të shërbyer si mjet i përdorshëm për mësuesit, nxënësit dhe studiuesit duhej që, në këtë Libër pune, të përcaktoheshin disa përparësi. Ndaj vendosëm të përqendroheshim kryesisht në krijimin e shteteve kombëtare, në çështjet e ndërtimit të kombit, në ideologjitë kombëtare dhe në disa prej konflikteve të ushqyera prej nacionalizmit. Këto çështje ndikuan edhe në përcaktimin e kufijve kronologjikë gjatë hulumtimit të burimeve përkatëse. Libri i punës u mendua që të përqendrohej kryesisht në shekullin e 19-të, por gjithsesi, vendosëm të përfshinim

në të edhe shumë burime historike të periudhës përpara Iluminizmit të 1800-ës, si dhe burime që kanë të bëjnë me jehonën e Revolucionit Francez në Europën Juglindore, të cilat shërbyen për ngritjen e lëvizjeve kombëtare në këtë rajon. Gjithashtu, këtu janë përfshirë edhe disa burime historike të shekullit të 20-të, që shërbejnë për dokumentimin e lindjes së shteteve të reja kombëtare, për zhvillimet e reja në marrëdhëniet ndërmjet kombeve dhe shteteve, për ndikimin e nacionalizmit në shfaqjen e konflikteve të shumta, si dhe për disa përbërës të një prirjeje për ta kapërcyer nacionalizmin. Në çdo rast jemi përpjekur që t'i shmangim dyzimet me Librat e tjerë të punës të përfshirë në këtë projekt, të cilët trajtojnë në thellësi dhe në mënyrë më të hollësishme Luftërat Ballkanike dhe Luftën e Dytë Botërore. Përsa i përket periudhës pas Luftës së Dytë Botërore, u përqendruam në problematikën që ka të bëjë me ish-Jugosllavinë dhe në konfliktet që çuan në krijimin e shteteve të reja kombëtare, ish-jugosllave, gjatë viteve '90. Ne jemi të vetëdijshëm se këtu mungojnë pjesërisht ose tërësisht disa aspekte të zhvillimit të nacionalizmit të shekullit të 20-të. Mungesat më të rëndësishme kanë të bëjnë me lulëzimin e ideologjive nacionaliste dhe diskriminimin që buron prej tyre në periudhën midis luftërave botërore; por, po ashtu, edhe me llojet e veçanta të nacionalizmit komunist jugosllav, shqiptar, rumun dhe bullgar. Meqenëse tërësia dhe ndërlikueshmëria e këtyre çështjeve do të kërkonte përfshirjen e mjaft burimeve shtesë, të cilat do ta mbingarkonin edhe më shumë këtë Libër pune, krahasuar me tre librat e tjerë të projektit, vendosëm që t'i linim këto çështje për një trajtim tjetër të veçantë.

Shpresojmë që grumbullimi i dëshmimeve nga të gjitha vendet europiane juglindore do të mbushë, gjithashtu, zbrazëtinë në njohuritë që popujt e rajonit kanë për njëri-tjetrin. Në të vërtetë, shumica e popujve të Europës Juglindore kanë mësuar më shumë për kombin e tyre dhe për kombet "kryesore" të botës (perëndimore), ndërkohë që kanë shpërfillur ose kanë marrë informacion të njëanshëm për fqinjët e tyre. Përmes materialeve të përfshira në këtë Libër pune, ne synojmë t'i nxitim mësuesit dhe nxënësit që ta krahasojnë historinë e vendit të tyre me atë të vendeve të tjera të Europës Juglindore, që të zbulojnë modele dhe elemente të përbashkëta, të cilat kanë qenë karakterizuese për disa vende ose periudha historike, dhe të kuptojnë kompleksitetin e ndryshimeve historike. Është e kuptueshme se nuk mund të përfshinim këtu materiale nga secili vend, për të gjitha aspektet e marrëdhënieve ndërmjet kombeve dhe shteteve gjatë dy shekujve të fundit. Na është dashur që të bëjmë përzgjedhje të kujdesshme, që kushtëzoheshin, në çdo rast, sidomos nga prania e burimeve të përshtatshme dhe nga përpjekjet për të ruajtur një baraspeshë, për të mundësuar përfaqësimin e të gjitha kombeve dhe shteteve europiane juglindore në këtë Libër pune. Pavarësisht nga përpjekjet tona, duhet pranuar se disa prej lexuesve të këtij Libri pune mund të mendojnë se ata vetë do të kishin përfshirë këtu edhe disa tekste të tjera. Nëse ndodh kështu, atëherë ky Libër pune do të përmbushë edhe një qëllim tjetër të tij, për të nxitur mësuesit, nxënësit dhe historianët profesionistë që t'i kushtojnë një vëmendje të re ndërlikueshmërisë së marrëdhënieve historike ndërmjet kombeve dhe shteteve të Europës Juglindore.

Jemi të bindur se një vështrim më i baraspeshuar dhe faktik i historisë së shteteve kombëtare në Europën Juglindore, do ta ndihmojë brezin e ri të jetë më tolerant ndaj kombeve dhe/ose grupeve të tjera etnike, si dhe më i hapur ndaj zhvillimeve të sotme. Varet nga ata – dhe nga ne – që të bëjmë zgjedhje të arsyeshme, e të mbështetura në informacion të dobishëm në mes alternativave të ndryshme dhe t'u përshtatemi sfidave të proceseve historike që po shfaqen, të cilat janë duke përvijuar marrëdhënie të reja ndërmjet individëve, bashkësive, shteteve kombëtare dhe organizatave e institucioneve mbikombëtare.

Kronologjia

1762	Paisi Hilendarski shkruan Historinë <i>sllavo-bullgare</i> , përmes së cilës bën thirrje për ndërgjegjësim kombëtar.
1768-1774	Lufta ruso-turke. Revolta greke mbështetet prej Ruisë (1770-74).
1796	Mahmut Pashë Bushatlliu i Shkodrës pushton Malin e Zi, por mundet në betejën e Martiniçit dhe Krusit prej ushtrisë malazeze të udhëhequr nga metropoliti Petar I Petroviçi; Perandoria Osmane heq dorë nga përpjekjet për të kontrolluar Malin e Zi, megjithëse vazhdon ta konsiderojë atë si pjesë përbërëse të territorit të saj.
1797	Hartimi i <i>Projektkushtetutës së Republikës Helenike</i> , prej Rigas Valestinlisit. Pushtimi francez i Venecies; sipas Traktatit të Kampo-Formios, bëhet ndarja e territoreve veneciane midis Francës dhe Habsburgëve: Habsburgësit pushtojnë Dalmacinë, ndërsa Franca fiton Ishujt Jonianë (sundimi francez zgjati deri më 1799-ën).
1800-1807	“Republika Joniane”, shtet vasal i Perandorisë Osmane. Ajo pushtohet nga britanikët në vitin 1807 dhe bëhet protektorat i tyre deri në vitin 1864.
1804-1813	Kryengritja e parë serbe, e udhëhequr nga Karagjorgji; u shtyp prej osmanëve.
1805-1813	Territore të mëdha të Dalmacisë, Kroacisë dhe Sllovenisë vendosen nën sundimin e Napoleonit (Provincat Iliriane); pas humbjes së Napoleonit, këto territore kthehen përsëri në provinca të Austrisë.
1806-1812	Lufta ruso-turke; nëpërmjet Traktatit të Paqes në Bukuresht, Moldavia Lindore (Besarabia) i aneksohet Ruisë.
1814	Krijimi në Odesë i shoqatës së fshehtë “Filiqi Eteria” [Shoqata e Miqve], që synonte çlirimin e Greqisë prej osmanëve.
1815	Kryengritja e dytë serbe, e udhëhequr nga Millosh Obrenoviçi; në dhjetor të vitit 1815, sulltani e njuh Milloshin si knjazin më të lartë të serbëve, në pashallëkun e Beogradit.
1821	Kryengritja e Vllahisë, e udhëhequr nga Tudor Vladimiresku; Revolucioni grek, i cili filloi me pushtimin e Moldavisë nga një ushtri e vogël greke, drejtuar prej Aleksandër Ipsilantit, u pasua me një kryengritje, e cila u përhap nga Peloponezi, drejt zonave të tjera.
1822	Në Epidarus, Asambleja Kombëtare Greke shpall Republikën Helene dhe voton për kushtetutën e parë greke.
1826	Sulltan Mahmuti i Dytë, shpërnda u mdhunë jeniçerët, duke u hapur rrugën reformave në Perandorinë Osmane.
1827	Britania, Franca dhe Rusia mbështesin hapur grekët; në Navarino, flota e aleatëve mund flotën osmano-egjiptiane.
1828-1829	Lufta ruso-turke. Rusët pushtojnë Moldavinë dhe Vllahinë.
1829	Traktati i Paqes në Adrianopojë (Edrene); Serbia njihet si principatë vasale, me Millosh Obrenoviçin si princ; Vllahia dhe Moldavia mbeten nën pushtetin osman, por vendosen, gjithashtu, edhe nën mbrojtjen ruse.
1830	Protokolli i Londrës – Greqia shpallet monarki e pavarur, nën dorëzaninë e përbashkët të Britanisë, Francës dhe Ruisë.

1831-1832	Nën mbikëqyrjen ruse, vendosen në Vllahi dhe Moldavi <i>Rregullat Organike</i> ; "modernizimi konservator" ruan pushtetin e princave dhe të bojarëve.
1832	Konventa e Londrës përcakton kufijtë e shtetit grek dhe vendos që Otoja, djali i dytë i Ludvigut të Parë të Bavarisë, të bëhet mbreti trashëgimtar i Greqisë.
1834	Athina zëvendëson Nafplionin, si kryeqytet i Greqisë.
1835	Kushtetuta Serbe (miratuar nga sulltani në vitin 1838); ajo kufizon pushtetin e princit, në dobi të një senati të zgjedhur.
1837	Krijimi i Universitetit të Athinës dhe i Shoqërisë Arkeologjike.
1839	Hatisherifi i Gjylhanesë; nisin zyrtarisht Reformat e Tanzimatit në Perandorinë Osmane.
1841	Krijimi i Bankës Kombëtare Greke.
1843-1844	Greqia bëhet monarki kushtetuese, duke vendosur të drejtën pothuaj-universale të votës për meshkujt.
1830-1848	Në Perandorinë Austriake, periudhë e ngarkuar me shumë lëvizje kombëtare, që synonin veçanërisht fitimin e statusit zyrtar për gjuhët kombëtare; po në këtë kuadër, Rilindja Kombëtare Kroate (Lëvizja Iliriane) lufton për gjuhën kroate, e cila bëhet gjuhë zyrtare në vitin 1847, dhe për një Kroaci autonome, brenda Perandorisë Austriake, ndërkohë që në Transilvani, rumunët përplasen me hungarezët për çështjen kombëtare.
1848-1849	Kryengritje në mbarë Europën, përfshirë këtu Perandorinë Austriake dhe Principatat Rumune; kryengritësit gërshetojnë kërkesat politike, shoqërore dhe kombëtare; ndarjet kombëtare shkaktajnë konflikte ndërmjet kryengritësve hungarezë, kroatë dhe rumunë; kryengritjet shtypen me dhunë nga osmanët dhe austriakët, me mbështetjen e Rusisë.
1850	Autoqefalia e Kishës Greke (e shpallur që në vitin 1833), miratohet nga Patriarkana Ekumenike e Kostandinopojës.
1852	Danilo i Parë Petroviçi (1851-1860) e shndërron Malin e Zi nga peshkopatë, në principatë laike dhe ndërmerr një program modernizues.
1853-1856	Lufta e Krimesë; Rusia mundet prej forcave të bashkuara të Perandorisë Osmane, Britanisë së Madhe, Francës dhe Sardenjës; përmes Traktatit të Paqes në Paris, Moldavia, Vllahia dhe Serbia vendosen nën mbrojtjen e përbashkët të Fuqive të Mëdha.
1858	Konventa e Parisit; Fuqitë e Mëdha riorganizojnë Moldavinë dhe Vllahinë si shtete të veçanta, por nën emërtimin e përbashkët "Principatat e Bashkuara".
1859	Aleksandër Joan Kuza zgjidhet princ i dyfishtë, i Moldavisë dhe Vllahisë; bashkimi i shkallëshkallshëm institucional i të dyja principatave deri më 1862; krijimi i shtetit modern rumun.
1860	Hapja e Universitetit të Jashit (i cili më 1864, u pasua edhe nga Universiteti i Bukureshtit).
1862	Një kryengritje e detyron Oton e Parë që të largohet nga Greqia.

1863	<p>Princi danez, George i Holstein-Sonderburg-Glucksburg-ut, zgjidhet përt'u bërë mbreti George i Parë (1863-1913) i Greqisë; Kushtetuta e re (1864) i bën njerëzit nënshtetas të kurorës mbretërore dhe të shtetit sovran; Ishujt Jonianë i jepen Greqisë nga Britania e Madhe.</p> <p>Laicizimi masiv i pronave të kishës në Rumani; konflikti me Patriarkanën e Kostandinopojës.</p>
1866	<p>Aleksandër Joan Kuza detyrohet që të japë dorëheqjen; princi gjerman, Karoli i Hohenzollern-Sigmaringen-it, bëhet princ i Rumanisë (1866-1914, mbret pas vitit 1881); Kushtetuta e 1866-ës vendos monarkinë kushtetuese dhe garanton të drejtat dhe liritë civile, por krijon një sistem të kufizuar votimi, nëpërmjet regjistrimit në bazë të pronësisë.</p>
1867	<p>Marrëveshje për krijimin e Austro-Hungarisë dualiste; Sllovenia dhe Bukovina mbeten pjesë të Austrisë, ndërsa Transilvania dhe Kroacia përfshihen brenda mbretërisë së Hungarisë; përmes një marrëveshjeje të posaçme (1868), Kroacia ruan një shkallë të caktuar autonomie brenda Hungarisë; pavarësisht nga kjo, politikat centralizuese dhe asimiluese të Hungarisë shkaktojnë rritjen e pakënaqësisë tek rumunët dhe kroatët.</p>
1866-1869, 1889	<p>Kryengritjet në Kretë kërkojnë respektimin e reformave osmane, por synimi përfundimtar është bashkimi me Greqinë.</p>
1869	<p>Në Rumani krijohet Komiteti Qendror Revolucionar Bullgar, nën drejtimin e Ljuben Karavelovit.</p>
1870	<p>Me anë të një dekreti osman, krijohet Ekzarkati Bullgar; bullgarët sigurojnë një organizim kishtar të ndarë prej Patriarkanës së Kostandinopojës, megjithëse ende nuk ishin një shtet i veçantë.</p>
1872	<p>Vendimi antikombëtar i Patriarkanave të vjetra ortodokse të Kostandinopojës, Aleksandrisë dhe Antiokisë, i cili dënon përcaktimin e juridiksionit kishtar sipas etnisë, si një veprim përçarës.</p>
1875	<p>Revolta antiosmane në Bosnjë dhe Hercegovinë; fillimi i Krizës Lindore të viteve 1875-1878.</p>
1876	<p>Osmanët shtypin me ashpërsi revoltën bullgare të prillit; Serbia dhe Mali i Zi i shpallin luftë Perandorisë Osmane, Serbia pëson humbje, ndërsa Mali i Zi arrin disa fitore; rritja e trysnisë ndërkombëtare dhe trazirat e brendshme i detyrojnë autoritetet osmane që të nxjerrin Kushtetutën e parë osmane, e cila u siguron të drejta të plota dhe të barabarta të gjithë nënshtetasve osmanë, por, në të njëjtën kohë, shpall se perandoria është "një tërësi e pandashme".</p>

1877	<p>Në Stamboll krijohet Komiteti Qendror për Mbrojtjen e të Drejtave të Popullit Shqiptar.</p> <p>Rusia i shpall luftë Perandorisë Osmane dhe pushton Bullgarinë; Rumania e shpall veten të pavarur dhe bashkohet me Rusinë; në Plevna, pas një qëndrese të madhe, ushtria osmane mundet.</p>
1878	<p>Traktati i Paqes i Shën Stefanit (3 mars); pas ndërhyrjes së Britanisë së Madhe dhe Austro-Hungarisë, Kongresi i Berlinit arrin një traktat të ri paqeje (1 korrik): Rumania, Serbia dhe Mali i Zi njihen si shtete të pavarura; Bullgaria ndahet në Principatën vasale të Bullgarisë dhe në Provincën Autonome të Rumelisë Lindore; Rumania përfiton Dobrukhën, në shkëmbim të Besarabisë Jugore, e cila iu dha Rusisë; Serbia dhe Mali i Zi përfitojnë, gjithashtu, zgjerim të territoreve të tyre; Bosnjë-Hercegovina vendoset nën administrimin austro-hungarez; nëpërmjet një konvente të veçantë osmano-britanike, Qiproja vendoset nën sundimin britanik, duke vazhduar të mbetet pjesë e Perandorisë Osmane (4 qershor 1878).</p> <p>Sulltan Abdulhamiti i Dytë (1876-1909) pezullon Kushtetutën e dhjetorit 1876, shpërndan parlamentin dhe sundon në mënyrë autokratike deri në vitin 1908.</p> <p>Lidhja Shqiptare e Prizrenit harton programin kombëtar.</p>
1879	Kushtetuta Bullgare e Tërnovës vendos monarkinë kushtetuese; princi i parë bëhet Aleksandri i Batenbergut (1879-1886).
1880	Krijimi i Bankës Kombëtare të Rumanisë.
1881	Në përputhje me Traktatin e Berlinit, osmanët i dorëzojnë Greqisë, Thesalinë dhe rajonin e Artës së Epirit.
1885	Bashkimi i Rumelisë Lindore me Principatën Bullgare; përpjekjet e Serbisë për kompensime dështojnë me Luftën serbo-bullgare (1885-1886).
1886	Kriza politike në Bullgari; princ Aleksandri i Batenbergut jep dorëheqjen; Rusia ndërpret marrëdhëniet diplomatike me Bullgarinë.
1887	Bullgarët zgjedhin si princ të tyre Ferdinandin e Saksa-Koburg-Gothas-it (1887-1918).
1893	Krijimi i OBRM-së (Organizata e Brendshme Revolucionare Maqedonase).
1896	Lojërat e para Olimpikë ndërkombëtare në Athinë.
1897	Lufta greko-turke; Greqia pëson humbje.
1898	Kreta bëhet shtet vasal, gjysëmautonom; princi grek, George, emërohet guvernator.
1903	<p>Grushti i shtetit në Serbi; vrasja e mbretit Aleksandri i Parë Obrenoviç dhe e familjes së tij; Petar i Parë Karagjorgjeviç bëhet mbret (1903-1921); rritet fryma nacionaliste në politikën serbe.</p> <p>Osmanët shtypin kryengritjen e Ilindenit në Maqedoni.</p>
1905	Mali i Zi miraton kushtetutën e tij të parë dhe vendi shpallet monarki kushtetuese.
1907	Kryengritje e rëndësishme e fshatarësisë në Rumani.

1907	Revolucioni xhonturk në Perandorinë Osmane; rivendosja e Kushtetutës së 1876-s dhe organizimi i zgjedhjeve për Parlamentin Osman; Bullgaria shpall pavarësinë e saj; Austro-Hungaria anekson Bosnjë-Hercegovinën ("Krizë boshnjake" me Serbinë dhe Rusinë).
1910	Mali i Zi shpallet mbretëri.
1911-1912	Lufta italo-turke; Italia pushton Ishujt Dodekanezë (si edhe Libinë).
1912	Kryengritja shqiptare; organizimi i revoltës së armatosur nga Ismail Qemali dhe Luigj Gurakuqi.
1912-1913	Luftërat Ballkanike; Perandoria Osmane humbet shumicën e territoreve europiane të saj, të cilat i kalojnë Bullgarisë, Serbisë, Greqisë dhe Malit të Zi; Shqipëria shpallet e pavarur (28 nëntor 1912); Maqedonia ndahet ndërmjet Bullgarisë, Serbisë dhe Greqisë; Dobruha Jugore e Bullgarisë i aneksohet Rumanisë.
1914	Princ Vilhem Vidi pranon fronin e dhënë prej Fuqive të Mëdha, për të qenë mbret i Shqipërisë.
1914-1918	Lufta e Parë Botërore; vrasja në Sarajevë e princ Franc Ferdinandit prej nacionalistëve serbë bëhet edhe shkaku i luftës; me përjashtim të Shqipërisë që, gjithsesi, ishte e pushtuar, të gjitha shtetet e Europës Juglindore morën pjesë në luftë: Austro-Hungaria, Perandoria Osmane (qysh prej vitit 1914) dhe Bullgaria (qysh prej vitit 1915) rreshtohen në krahun e Fuqive të Qendrës; Serbia, Mali i Zi (qysh prej vitit 1914), Rumania (qysh prej vitit 1916) dhe Greqia (qysh prej vitit 1917, pavarësisht nga kundërshtimet e mbretit Konstantin) rreshtohen në krahun e Antantës.
1915	Fillon internimi me forcë i të gjithë armenëve osmanë (prill). Më 6 tetor, Vincent Brys, duke folur në Dhomën e Lordëve, tha se gjatë këtij procesi llogariteshin të ishin masakruar "rreth 800 000" armenë. Që nga ajo kohë, çështja e gjenocidit ka qenë një temë polemikash, veçanërisht në Turqi.
1917	Qeveria serbe dhe Komiteti i Qeverisë Kroate të Londrës (kryesisht në mërgim), përmes Deklaratës së Korfuzit, bien në marrëveshje për formimin e një shteti të përbashkët jugosllav.
1917-1918	Në kontekstin e Revolucionit Rus, në Besarabi shpallet një republikë demokratike, dhe më pas Asambleja voton në favor të bashkimit të saj me Rumaninë (27 mars 1918).
1918	Thyerja e Fuqive të Qendrës; Bullgaria dhe Perandoria Osmane kapitullojnë; Austro-Hungaria shpërbëhet; në territoret jugore të ish Austro-Hungarisë shpallet Shteti i Sllovenëve, Kroatëve dhe Serbëve; Vojvodina dhe Sirmiumi bashkohen me Serbinë; Asambleja e Madhe Popullore (Asambleja e Podgoricës) voton "për bashkimin në një shtet të vetëm" me Serbinë; dështon <i>Kryengritja e Krishtlindjeve</i> , e nxitur prej mbretit Nikollë, kundër vendimeve të Asamblesë; Këshilli Kombëtar i Shtetit të Sllovenëve, Kroatëve dhe Serbëve vendos të bashkohet me Serbinë për të krijuar Mbretërinë e Serbëve, Kroatëve dhe Sllovenëve (e riemërtuar Jugosllavi pas vitit 1929); rumunët e Bukovinës dhe të Transilvanisë bashkohen me Rumaninë.
1919-1920	Konferenca e Paqes në Paris; vendosja e kufijve të rinj në Europën Juglindore përmes Traktatit të Shën-Germain-en-Laye (me Austrinë), Traktatit të Njëjës (me Bullgarinë) dhe Traktatit të Trianonit (me Hungarinë); ndarja e Banatit ndërmjet Rumanisë dhe Mbretërisë së Serbëve, Kroatëve dhe Sllovenëve; Bullgaria i dorëzon Greqisë, Trakinë Perëndimore; Greqia, Rumania, Jugosllavia, e më vonë Bullgaria dhe Turqia, duhet të nënshkruajnë traktate të veçanta për mbrojtjen e të drejtave të pakicave kombëtare brenda kufijve të tyre.

1919	Pushtimi i Azisë së Vogël Perëndimore (Smirna) nga Greqia, me autorizimin e Francës, Britanisë dhe SHBA-së, si kundërpeshë ndaj zgjerimit të Italisë në rajon; përpjekjet e kurdëve dhe të armenëve për krijimin e shteteve të tyre kombëtare; në Azinë e Vogël, fillimi i qëndresës kombëtare turke; udhëheqës është Mustafa Qemal pasha (që më vonë u quajt Ataturk).
1920	Traktati i Paqes i Sevrës; sulltan Mehmeti VI pranon shpërbërjen e Perandorisë Osmane (humbja e tokave arabe, e Armenisë dhe e Trakisë; mbajtja e referendumit në Smirna, pas një periudhe pesëvjeçare nën administrimin grek; mundësia e Kurdistanit për pavarësi; krijimi i zonave të ndikimit të Britanisë së Madhe, Francës dhe Italisë në Azinë e Vogël); nacionalistët turq nuk e pranojnë Traktatin dhe i shtypin armenët dhe kurdët.
1922	Fitorja e turqve ndaj ushtrisë greke; trupat turke marrin zotërimin e Smirnës/Izmirit, Kostandinopojës/Stambollit dhe Trakisë Lindore.
1923	Traktati i Paqes në Lozanë; shkëmbimi i detyrueshëm i popullsisë ndërmjet Greqisë dhe Turqisë. Rënia e Perandorisë Osmane dhe shpallja zyrtare e Republikës së Turqisë. Stambuliski dhe agrarët masakrohen në Bullgari.
1924	Heqja e monarkisë dhe krijimi i Republikës së parë greke.
1928	Vrasja e udhëheqësit politik kroat, Stjepan Radiçit, nga një deputet nacionalist serb nga Mali i Zi, gjatë një seance të parlamentit jugosllav në Beograd.
1929	Bie tregu i bursës së Nju Jorkut. Fillon rënia dhe kriza ekonomike botërore. Ekonomitë e Ballkanit mbështeten te burimet e tyre ekonomike dhe në një sistem ku ndërhyrja e shtetit ishte më e madhe.
1934	Aleksandri i Jugosllavisë vritet në Marsejë, së bashku me ministrin e Jashtëm francez, Lui Bartu nga një anëtar i Organizatës së Brendshme Revolucionare Maqedonase, i ndihmuar nga nacionalistët ustashtë kroatë.
1939	Shqipëria pushtohet nga Italia.
1939-1945	Lufta e Dytë Botërore; në vitin 1940, Rumanisë i merret Besarabia dhe Bukovina Veriore nga Bashkimi Sovjetik, Dobruxa Jugore nga Bullgaria, si dhe Transilvania Veriore nga Hungaria (kjo e fundit u riftua në vitin 1944); në vitin 1941, Jugosllavia dhe Greqia pushtohen nga fuqitë e Boshtit; krijimi i "Shtetit të Pavarur Kroat", si shtet fashist kukull, në territorin e Kroacisë, Bosnjës dhe Hercegovinës (deri në vitin 1945); lëvizjet partizane në Jugosllavi, Greqi dhe Shqipëri; Bullgaria dhe Rumania bëjnë aleancë me Fuqitë e Boshtit, kundër Kombeve të Bashkuara, dhe në vitin 1944 pushtohen nga ushtria sovjetike; në përfundim të luftës, Shqipëria, Bullgaria, Rumania dhe Jugosllavia vihen nën kontrollin komunist, ndryshe nga Greqia dhe Turqia.

1943-1946	Jugosllavia riorganizohet si federatë me 6 republika (Bosnjë-Hercegovina, Kroacia, Maqedonia, Mali i Zi, Serbia dhe Sllovenia) dhe me dy provinca autonome (Kosova dhe Vojvodina, që të dyja pjesë të Serbisë); sipas Kushtetutës së 1946-s, udhëheqja federale është shumë e fuqishme dhe përforcohet edhe më tej nëpërmjet rolit kyç e centralizues të Partisë Komuniste Jugosllave (prej vitit 1952, Lidhja Komuniste Jugosllave).
1946-1949	Lufta civile në Greqi.
1950	Referendumi jozyrtar i qipriotëve grekë, të cilët kërkojnë bashkimin me Greqinë; britanikët nuk pranojnë.
1955	Fillimi i përlëshjeve të armatosura kundër britanikëve në Qipro.
1958	Dhunë e ashpër ndëretnike në Qipro.
1959	Marrëveshjet ndërmjet Britanisë, Greqisë dhe Turqisë, lidhur me krijimin e shtetit të pavarur të Qipros, për qipriotët grekë dhe për ata turq, së bashku.
1960	Krijimi i Republikës së pavarur të Qipros.
1963	Kushtetuta e re federale në Jugosllavi; rritja e kompetencave të republikave, si dhe ndarja e posteve partiake nga ato shtetërore; liberalizimi dhe fuqizimi relativ i zyrtarëve të republikave ndihmon shpërthimin e nacionalizmit, veçanërisht në Kosovë dhe Kroaci (<i>Pranvera kroate</i>), që shtypet nga Titoja më 1972. Dhuna ndëretnike në Qipro detyron qipriotët turq të largohen nga qeveria.
1967	Në Greqi vendoset <i>Diktatura e kolonelëve</i> .
1974	Kushtetuta e re jugosllave; autonomi më e madhe për republikat jugosllave. Grusht shteti ushtarak grek në Qipro, që synonte bashkimin me Greqinë; pushtimi i Qipros Veriore prej trupave turke. Rivendosja e demokracisë në Greqi.
1980	Vdekja e Titos; shkatërrimi i ekonomisë; pavarësisht nga sistemi me rotacion, legjitimiteti i institucioneve federale në Jugosllavi zbehet shkallë-shkallë.
1981	Greqia bëhet anëtare e Komunitetit Europian.
1983	Shpallja e ' <i>Republikës Turke të Qipros së Veriut</i> ' njihet vetëm prej Turqisë dhe dënohet përmes Rezolutës së Këshillit të Sigurimit të OKB-së.
1987	Në Serbi vjen në pushtet Slobodan Millosheviçi.
1989	Rënia e komunizmit në Europën Juglindore; zëvendësimi paqësor i Teodor Zhivkovit në Bullgari, dhe revolucioni i dhunshëm në Rumani; vendosja e sistemit politik demokratik shumëpartiak dhe kalimi drejt ekonomisë së tregut.
1991-1992	Shpërbërja e Jugosllavisë; krijimi i shteteve të pavarura kombëtare: Sllovenisë, Kroacisë (më 1991), Bosnjë-Hercegovinës, Republikës së Maqedonisë, Republikës Federale të Jugosllavisë (Serbia dhe Mali i Zi) në vitin 1992.

1991	Kalimi në një sistem politik shumëpartiak në Shqipëri. Shpërbërja e Bashkimit Sovjetik; Besarabia bëhet e pavarur (Republika e Moldovisë).
1991-1995	Lufta midis serbëve dhe kroatëve në Kroaci, me përfshirjen e fuqishme të ushtrisë jugosllave.
1991	Riorganizimi i Komunitetit Europian, në Bashkimin Europian (Traktati i Mاستrihtit).
1992-1995	Lufta në Bosnjë-Hercegovinë, me përfshirjen e fuqishme të ushtrisë jugosllave, dhe më vonë të Serbisë.
1994-1999	Vendimi i Bashkimit Europian, për fillimin e negociatave të pranimit me vendet paskomuniste të Europës Lindore.
1995	Marrëveshjet e Dejtonit/Parisit për Bosnjë-Hercegovinën.
1996	Traktati rumuno-hungarez, për nxitjen e përmirësimit të marrëdhënieve ndërshtetërore dhe ndëretnike.
1998	Lufta në Kosovë, ndërmjet Ushtrisë Çlirimtare (shqiptare) të Kosovës dhe Ushtrisë Jugosllave.
1999	Lufta e NATO-s kundër Jugosllavisë; Presidenti Slllobodan Millosheviç detyrohet që të dorëzojë Kosovën, e cila vihet nën administrimin e Kombeve të Bashkuara.
2000	Kryengritje e suksesshme në Jugosllavi kundër regjimit të Slllobodan Millosheviçit; fillimi i kalimit drejt sistemit politik demokratik.
2000-2001	Konflikt i armatosur midis forcave të sigurisë së Republikës së Maqedonisë dhe UÇK-së (Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare). Me ndërmjetësim ndërkombëtar, arrihet në një marrëveshje për të ndaluar luftimet dhe për ndryshimin e kushtetutës, në mbrojtje të të drejtave të shqiptarëve dhe pakicave të tjera në Republikën e Maqedonisë.
2002	Marrëveshja e përkohshme ndërmjet Serbisë dhe Malit të Zi lejon vazhdimësinë e përkohshme të Federatës, me mundësinë e ndarjes së saj pas tre vjetësh.
2003	Komunikimi i parë i lirshëm, qysh prej vitit 1974, ndërmjet qipriotëve grekë dhe atyre turq në Qipro, si rezultat i hapjes së 'Vijës së gjelbër' që i ndante ata.
2004	Referendumi në Qipro, lidhur me Planin e Ananit për ribashkim; miratohet prej qipriotëve turq, por rrëzohet prej qipriotëve grekë. Slllovenia dhe Qiproja (duke përfshirë këtu vetëm zonat nën kontrollin e qipriotëve grekë) hyjnë në Bashkimin Europian; Bullgaria dhe Rumania planifikohen për vitin 2007; Kroacia hap negociatat për pranimit në BE.
2005	Kroacia dhe Turqia nisin negociatat e pranimit në BE.
2006	Mali i Zi shpallet shtet i pavarur. Republika e Maqedonisë bëhet vend kandidat për anëtarësimin në BE.
2007	Bullgaria dhe Rumania hyjnë në BE.
2008	Kosova shpallet shtet i pavarur; Kuvendi Popullor i Serbisë e anulon vendimin për pavarësi të Kuvendit të Kosovës.



KAPITULLI I: Formimi i shteteve kombëtare: synimet përkundrejt arritjeve

Shtetet-kombe nuk janë të përrjetshme. Ato janë shfaqur relativisht vonë, kryesisht gjatë dy shekujve të fundit. Në nivel europian, përgjithësisht është pranuar se shekulli i 19-të ishte shekulli i kombësive. Gjatë kësaj periudhe, në mbarë Europën u shfaq një lidhje e fortë midis përkatësisë kombëtare dhe proceseve politike. Gjithsesi, në shekullin e 19-të, shtetet-kombe nuk përbënin as formën e vetme dhe as mbizotëruese të strukturës politike. Perandoritë shumëkombëshe vazhdonin që të kontrollonin hapësira dhe popullsi të mëdha. Identifikimi poshtë nivelit të kombësisë, pra rajonal/lokal, ose ai shoqëror gjithashtu mbetej i rëndësishëm. Besimi fetar, ndonëse në rënie tek shtresa e të pasurve, vazhdonte që të ishte i rëndësishëm për shumicën e popullsisë. Në përgjithësi ekzistonte një mungesë mirëkuptimi në lidhje me identifikimin kombëtar, ose me idenë se çdo grupim kombëtar duhej që "normalisht" të kishte edhe shtetin e tij. Një shumëllojshmëri e tillë opinionesh dhe variantesh politike pati një ndikim shumë më të madh në historinë e shekullit të 19-të, sesa ai që zakonisht jemi mësuar të pranojmë. Gjithsesi, shkallë-shkallë nacionalizmi vazhdoi që të fitonte terren, perandoritë shumëkombëshe provuan se ishin të dobëta e për pasojë u shkatërruan, ndërkohë që numri i njësive politike të organizuara si shtete-kombe po shtoej gjithnjë e më shumë.

Nga ky model i përgjithshëm i historisë europiane, Europa Juglindore nuk përbën përjashtim. Ndërkohë që në fillim të viteve 1800, pjesa më e madhe e rajonit sundohej nga disa perandori shumëkombëshe, gjatë shekullit të 19-të kemi fillimin e shfaqjes së lëvizjeve kombëtare, ndërsa fundi i Luftës së Parë Botërore shënoi dhe mbizotërimin e shteteve kombëtare. Mesa duket, fitorja përfundimtare e shteteve-kombe ishte një lëvizje e pashmangshme historike. Gjithsesi, duhet theksuar se këto zhvillime historike ishin më të ndërlikuara sesa paraqiten zakonisht në tregimtarinë nacionaliste. Kështu, vetëm një pjesë e grupimeve kombëtare ia arritën që të formonin shtetet e tyre kombëtare, ndërkohë që shumë të tjera dështuan në këtë drejtim. Edhe ata që ia dolën mbanë, u lëkundën midis disa varianteve politike, rezultati përfundimtar i të cilave nuk u përcaktua vetëm nga veprimet e tyre, por edhe nga ndërhyrja e Fuqive të Mëdha, sikundër edhe nga ndikimi i proceseve historike botërore.

Në këtë kapitull do të trajtohen këto çështje: shkaqet e pakënaqësive ndaj regjimeve të ndryshme perandorake; përhapja e ideologjive nacionaliste; marrëdhëniet ndërkombëtare dhe ndërhyrja e Fuqive të Mëdha; pjesëmarrësit në luftën për çlirim kombëtar, motivimet e tyre, synimet/programet; format e përpjekjeve për ndërtimin e kombit; rezultati i këtyre përpjekjeve, duke u përqendruar, veçanërisht, në marrëveshjet e ndryshme që çuan drejt rezultateve konkrete. Meqenëse në realitet këto çështje janë të ndërthurura, sikundër paraqiten edhe në burimet historike të përzgjedhura për këtë Libër pune, materialet janë sistemuar në mënyrë kronologjike, duke mos ndjekur një model tematik. Gjithsesi, në përfundim të këtij kapitulli, ju sugjerojmë që të plotësoni një tabelë me të gjitha ato çështje që kanë lidhje me burime të veçanta.

Sigurisht që përzgjedhja e teksteve nuk mund të përfshinte të gjitha momentet dhe kontributet e dhëna gjatë procesit të formimit të shteteve kombëtare në Europën Juglindore. Por jemi të bindur se mësuesit dhe nxënësit do të jenë në gjendje që të hartojnë një listë edhe më të pasur kontributesh domethënëse për secilin shtet në veçanti në këtë proces, prandaj dhe i nxisim që t'i diskutojnë burimet e tyre, së bashku me ato tonat. Qëllimi kryesor i këtij kapitulli është paraqitja e shumëllojshmërisë së zgjidhjeve politike të konceptuara nga popujt në shekullin e 19-të dhe në fillim të shekullit të 20-të. Në të njëjtën kohë, ne jemi të bindur se kjo gjë do të ndihmojë edhe njerëzit e shekullit të 21-të që të përgatiten më mirë për zgjidhjet politike që do t'u duhet të bëjnë në të ardhmen.

I-1. Marrëdhëniet ndërmjet Greqisë dhe Europës sipas Josip Mesidaksit (1761)

Greqia¹ ka vërtet nevojë për Europën. Në ditët e sotme, kjo e fundit zotëron me tepriçë shumicën e burimeve të dijeve, që të parës i mungojnë. [...] Tashmë ka ardhur koha që Greqia t'i pranojë me dashamirësi dhuratat e Europës, meqenëse kjo e fundit ndien mirënjohje për të. Europa nuk e fsheh as shkëlqimin që mori, dhe as borxhin që i ka Greqisë. Ajo është e gatshme që t'i japë Greqisë të gjitha format e mundshme të dijes.

[...] Tërë Europa ndien keqardhje për Greqinë dhe e mëshiron atë, më shumë për mungesën e arsimit, sesa për skllavërimin e saj. A mund t'i lini pas dore vuajtjet e vendit tuaj, ju pasardhësit e sinqertë e të vërtetë të Greqisë, që shërbyet si model për mbarë botën? Ku shkoi nderi i paraardhësve tuaj? Ku gjendet mendjemprehtësia e stërgjyshërve tuaj, që arrinte të kalonte çdo pengesë? Ku ndodhet shpirti grek, shija e të cilit nuk mund të përzgjidhte asgjë tjetër veç së bukurës? Të gjitha kombet europiane, shumica e të cilave – për të mos thënë të gjitha – quheshin barbare nga grekët dhe romakët e lashtë, tashmë janë të ditura dhe të kulturuara.

[...] Por a ka kuptim që pikërisht ju, pasardhësit e atyre grekëve kryelartë, të cilët kanë qenë mësuesit e parë të dijes dhe të së bukurës, të shndërroheni në të vetmit që durojnë analfabetizmin, në të vetmit që vuajnë jo vetëm paditurinë, por dhe mjegullnajën që sjell mungesa e dijes?

Por jo, jo. Tashmë, Greqia duhet ta rizgjojë dëshirën e saj të zjarrtë, ta rigjejë përsosurinë e saj dhe të rikujtojë lashtësinë e lavdishme. Më e pakta që ajo duhet t'i tregojë sot botës mbarë, është se ende banohet nga grekë.

Moesiodax, "Filozofia e moralit" (1761),
te Kitromilides, f. 331, 338-340.



Josip Mesidaksi (rreth 1725-1800) ka qenë një prej intelektualëve më të shquar të shekullit të 18-të në Europën Juglindore. Në të vërtetë, fjala "Mesidaks" nuk tregon mbiemrin, por prejardhjen e tij etnike ("dak nga Mëzia"). Megjithëse vinte nga një familje vllahe dhe fliste rumanisht, Mesidaksi kreu arsimin grek, i cili gjatë shekullit të 18-të ishte sistem i përbashkët shkollimi për të gjithë popujt e krishterë ortodoksë të Ballkanit. Pas përfundimit të studimeve në Selanik dhe Smirnë, ai i vazhdoi ato edhe më tej, nën drejtimin e Evgenios Vulgarisit, pranë shkollës "Atonias", në Malin Athos (1754-1755). Mesidaksi njihet për hartimin e një teksti shkollor, *Teoria e gjeografisë* (1781), si dhe për *Apologjinë* (1780), vepër në të cilën u bëhej jehonë ideve të Xhon Lokut [John Locke] (1779). Gjithashtu, ai ka qenë edhe kujdestari i arsimit të djemve të Aleksandër Ipsilantit, sundimtarit të Vllahisë. Në veprën e tij *Filozofia e moralit*, Mesidaksi theksonte "përmasën ballkanike" të kulturës greke të shekullit të 18-të, parashtronte idetë humaniste kozmopolite të Iluminizmit; vepra e tij ndikoi në përhapjen e ideve perëndimore në Ballkan përmes arsimit grek; për më tepër, ai punoi për përhapjen e këtij arsimit edhe në popujt e tjerë të Ballkanit, duke e mbështetur emocionalisht dhe intelektualisht nocionin mbi "Greqinë" si një përcaktim të përbashkët. Në Europën Juglindore, vepra e tij solli kritikën shoqërore dhe skepticismin politik të Iluminizmit qysh përpara vitit 1780.



Sipas pikëpamjes së Mesidaksit, cila është marrëdhënia ndërmjet Europës dhe Greqisë? Përse Mesidaksi e lartëson aq shumë shkëlqimin e Greqisë së lashtë?

I-2. Bazat historike të kombit bullgar, sipas Paisi Hilendarskit (1762)

Dëgjoni me vëmendje lexues dhe dëgjues bullgarë, njerëz që e doni me gjithë zemër popullin dhe atdheun tuaj; ju që doni të mësoni dhe të dini atë çka është provuar mbi origjinën tuaj bullgare, mbi

¹ Termit që përdor Mesidaksi janë "Eladhë" dhe "Helenë", ndërkohë që autorë të tjerë të së njëjtës periudhë përdorin termit "Γραικοί" dhe "Γραικία" ose "Ρωμιοί". Në këtë përkthim përdoren termit "Greqi" dhe "greqë", duke nënkuptuar kombin e Greqisë moderne.

baballarët tuaj, mbi paraardhësit e carët, patriarkët dhe shenjtorët, se si e jetonin dhe e kalonin kohën e tyre. Është mjaft e rëndësishme, por dhe e dobishme për ju, që të dini atë që është vërtetuar për bëmat e etërve tuaj, po ashtu siç e njohin origjinën dhe gjuhën e tyre edhe fiset e tjera, të cilat kanë historinë e tyre dhe kushdo që mund ta lexojë, e njeh atë, e ritregon dhe ndihet krenar për origjinën dhe gjuhën e vet.

Kështu, unë kam shkruar për ju gjithçka që është provuar mbi origjinën dhe gjuhën tuaj, duke e paraqitur në rend kronologjik. Lexoni dhe mësoni, nëse nuk doni që t'ju tallin ose qortojnë fiset dhe popujt e tjerë. Kopjojeni vetë këtë libërth historie, ose paguani ata që dinë dhe që mund ta kopjojnë atë për ju, dhe ruajeni si sytë e ballit! Ka njerëz që e shpërfillin origjinën e tyre bullgare dhe përqafojnë një gjuhë dhe një kulturë të huaj. Kështu, ata mësojnë shkrim dhe këndim në greqisht dhe u vjen turp që ta quajnë veten bullgarë. Ah, ju fanatikë dritëshkurtër! Po përse vallë ju vjen turp që ta quani veten bullgarë? Përse nuk doni që të shkruani e të lexoni në gjuhën e nënës? Apo mendoni se bullgarët nuk kanë pasur as perandori dhe as vendin e tyre? Në të vërtetë, për shumë vjet, ata kanë mbretëruar dhe kanë qenë të famshëm e të lavdishëm në mbarë botën, e jo rrallëherë i kanë detyruar edhe romakët e fuqishëm ose grekët mendjemprehtë që t'u paguanin atyre taksa. Shumë carë dhe mbretër ua kanë dhënë vajzat e tyre për nuse carëve tanë, me qëllim që të jetonin në paqe me ta. Bullgarët kanë qenë fisi i parë sllav që patën carët e tyre, Patriarkun e tyre, që u kthyen në të krishterë dhe që pushtuan territore të shumta. Shenjtorët e parë sllavë kanë qenë bullgarë. Ata kanë qenë më të fuqishmit dhe më të respektuarit ndër fiset sllave; po kështu ka qenë dhe gjuha bullgare, gjëra të cilat unë i kam përmendur në rend kronologjik në këtë libër historie. Për bullgarët gjenden shumë fakte edhe në historitë e popujve të tjerë, dhe gjithçka e përmendur më lart, është e vërtetë.

Paisiy, f. 19-20.



Paisi Hilendarski (1722-1773) – ka qenë murg në manastirin e Hilendarit, në Malin Atos. Ai ishte autori i parë që shprehu idenë e rizgjimit kombëtar bullgar në librin *Historia sllavo-bullgare*, qysh në vitin 1762.



Përse e shkroi Paisi këtë libër? Si mund ta interpretojmë këtë tekst në ditët e sotme? Cili ka qenë roli i gjuhës greke në Europën Juglindore gjatë shekullit të 18-të? A konsiderohej gjuha apo besimi fetar si elementi më i rëndësishëm i identitetit kombëtar?

I-3. Evgenios Vulgarisi në mbrojtje të shtetit grek (rreth 1770)

Dobësia që ka pushtuar tashmë shtetin osman, nuk është pasojë vetëm e mungesës së përvojës së ushtrisë, por edhe e zemëratës që ekziston ndër shtetasit e tij. Nëse e para vjen si pasojë e mungesës së veprimit, kjo e fundit vjen prej një mërie të thellë. Është kjo mbretëri që i ushqen grekët brenda saj me mëri, ato turma të mëdha që janë dhunuar prej shumë e shumë kohësh, që kur shohin sesi shtypja dhe mjerimi arrijnë kulmin, ndiejnë veçse urrejtje kundër tiranëve të tyre.

[...] Por, nëse pushteti barbar e tiranik osman do të detyrohet me forcë që të lëshojë atje Tartarinë dhe Dakinë², ose Peloponezin a ndonjë pjesë tjetër të Greqisë së këtushme, si vende të lira strehimi për grekët e shtypur, atëherë mund të mëtojmë se baraspesha e pushteteve në Europë do të tronditet menjëherë! Për më tepër, çdo përpjekje kundër armiqve të të krishterëve, do të sillte dëmtim edhe për vetë botën e krishterë!

Voulgaris, f. 38, 41.

² Përkatesisht Krimea dhe Rumania.



Evgenios Vulgarisi lindi në Kërkyra në vitin 1716, dhe pas një periudhe të gjatë veprimtarie si dijetar udhëtar e më vonë si peshkop në Rusi, ai vdiq si murg në vitin 1806. Mbështetës i greqishtes së lashtë dhe një dijetar liberal, përktheu Volterin në greqisht, si dhe botoi një ese mbi tolerancën. Gjatë Lufës ruso-turke në vitet 1768-1774, Vulgarisi përkrahu idenë e çlirimit të Greqisë me ndihmën e Rusisë, dhe në vitin 1772 u ftua në Shën Peterburg nga perandoresha Katerina e Dytë.



Cili është opinioni i autorit për rolin e shtetit grek në Europë?

I-4. Kërkesë e përfaqësuesve³ malazezë, dërguar perandoreshës austriake, Maria Terezës, me pretendimin që t'u njihet pavarësia (1779)

Ka kaluar tashmë shumë kohë, Madhëria juaj e shenjtë, qysh kur malazezët me armë në dorë janë çliruar prej zgjedhës mizore osmane, e cila kishte nënshtruar lirinë dhe Greqinë [...] Por nuk ka rëndësi se sa e çmuar është kjo liri, madje as kur mendon vuajtjet e popullit nën zgjedhën turke, nëse në këtë shekull të iluminuar, kjo liri nuk shoqërohet nga një legjislacion i drejtë që rregullon çështjet civile dhe ekonomike [...] Për sa i përket luftës me Turqinë, ne kërkojmë prej gjykatës së lartë që ta bindë Portën, që ta njohë zyrtarisht lirinë dhe pavarësinë tonë në traktatin e paqes që mund të arrihet në fund të luftës.

Vladan Đorđević, f. 6-11.



Petari I Petroviç Njegoshi (1748-1830) ishte mitropolit dhe sundimtar malazez prej vitit 1784 deri në vitin 1830. Ai udhëhoqi ushtrinë malazeze në betejën e Martiniçit dhe Krusit në vitin 1796, në të cilën u mund Mahmut Pashë Bushatlliu i Shkodrës. Në vitin 1798, për herë të parë, ai themeloi institucionet moderne shtetërore, siç ishin: *Gjykata e Malit të Zi dhe Malësisë*, si dhe *Kodin ligjor të tyre*.

I-5. Dimitrios Katarcisi shpjegon se përse grekët përbëjnë një komb, ndonëse nuk kanë një shtet (1783)

Më duhet të pranoj, se sot nuk jemi një komb që ka shtetin e tij, përderisa varemi nga një komb tjetër më i fortë. Disa francezë, të cilët bazohen në përkufizimin e Aristotelit mbi qytetarin, na akuzojnë se nuk paskemi vendlindje, por një gjë e tillë nuk qëndron. Në të vërtetë, Aristoteli e përdor përkufizimin e tij, që t'i dallojë nënshtetasit nga njerëzit e skllavëruar, që ndryshe njihen si helotë ose periekë, dhe që kanë punuar si bujkrobër për banorët e Spartës dhe të Kretës. Por pavarësisht nga kjo, falë Zotit, ne nuk ndodhemi në këtë gjendje, dhe megjithëse nuk bëjmë pjesë në administratën e shtetit të zotërve tanë, përsëri nuk jemi të shkëputur prej tij. Ne jemi një komb që mbajmë lidhje me njëri-tjetrin, por edhe me qeverinë e lartë, përmes udhëheqësve tanë kishtarë, të cilët, në shumë mënyra, janë gjithashtu edhe drejtuesit tanë politikë.

[...] Të mos harrojmë së përmenduri edhe diçka: si është e mundur që një grek⁴, i cili mendon se e ka origjinën e vet nga Perikliu, Themistokliu e të tjerë si këta, ose nga familjet e Teodosit, Velisariosit, Narsesit, Vulgaroktonosit, Cimiskisit dhe të tjerë romakë të këtyre përmasave, ose që mendon se rrjedh nga ndonjë shenjtor ose familje shenjtori, si është e mundur që të mos i adhurojë pasardhësit e të tilla figurave? Si të mos pranojë vuajtjen brenda një shoqërie, e cila në gjirin e saj ka pasur të tillë emra? Si të mos e dojë tokën që mëkoi të tillë burra? Dhe teksa tërheq zgjedhën e skllavërisë, si është e mundur të mos e ujisë me lot tokën për të cilën ata derdhën gjak, dikush për lavdi e dikush për çlirim?

Katartzis, f. 44, 45.

³ *Guvernatori* Jovan Radonjiçi, *sirdari* Ivan Petroviçi dhe *arqimandriti* Petar Petroviçi. *Guvernatori* ishte titull që përmendet i dokumentuar për herë të parë në vitin 1717, në një marrëveshje të nënshkruar me Republikën e Venedikut. Që në fillim, guvernatorët shërbyen si ndërmjetës midis Malit të Zi dhe Republikës së Venedikut, dhe më pas u kthyen në figura politike më të pushtetshme në vend. Posti i *guvernatorit* u ndalua në vitin 1830. *Sirdar* ishte titulli më i lartë ushtarak në Malin e Zi.

⁴ Në tekstin origjinal grek përdoret fjala "Romios".



Dimitrios Katarcisi (1730-1807) ishte një studiues fanariot. Ai lindi në Kostandinopojë/Stamboll dhe jetoi në Bukuresht, ku punoi edhe si gjykatës i nivelit të lartë. I frymëzuar nga idetë iluministe, ai e përfytyronte botën greke në përputhje me konceptet perëndimore, sikundër paraqitej edhe në *Enciklopedinë* e Didëroit. Gjithashtu, hartoi edhe një program të gjerë reformimi për arsimin grek, duke u mbështetur në gjuhën popullore, e cila, sipas tij, ishte një “vepër kombëtare” mjaft domethënëse.



Cili është opinioni i autorit mbi lidhjen që ekziston ndërmjet kombit dhe shtetit? Përse u referohet figurave historike?

I-6. Peticion rumun për barazi kombëtare në Transilvani – *Supplex Libellus Valachorum* (1791)

I bekuari, Perandori August!

[...] Siç dihet nga të gjithë, kombi rumun është kombi më i lashtë që ekziston në Transilvaninë e sotme, çka vërtetohet nga dëshmitë historike dhe nga një traditë që nuk është ndërprerë kurrë, nga ngjashmëria ndërmjet gjuhëve, zakoneve dhe dokeve, se e ka prejardhjen nga kolonitë romake, të cilat perandori Trajan i sillte vazhdimisht këtu në Daki, në fillim të shekullit të 2-të, me një numër shumë të madh veteranësh për të mbrojtur provincën.

[...] Të përlulur përpara fronit të Madhërisë suaj, dhe të mbushur me nder dhe respekt, kombi rumun ju përgjërohet përsa vijon:

1. Të shfuqizohen, të hiqen dhe të ndalohen publikisht si të turpshme dhe të padrejta, të gjitha ato fjalë fyese dhe të urryeshme, si i toleruar, i pranuar, i pallogaritur mes shtresave e të tjera si këto, të cilat qëndrojnë si njolla të stampuara “në ballin e kombit rumun”, në mënyrë të padrejtë dhe të jashtëligjshme; kështu, falë mëshirës së Madhërisë suaj, kombi rumun i rilindur, do mund të gëzojë përsëri të gjitha të drejtat e tij qytetare. [...]

5. Të gjitha ato krahina, sede⁵, zona ose lagje të qyteteve në të cilat rumunët janë më të shumtë në numër sesa kombësitë e tjera, duhet që të mbajnë emra rumunë, ndërsa ato vende që në shumicën e tyre përbëhen nga kombësi të tjera, duhet që të mbajnë emrat e tyre ose një tjetër emër të përbashkët, si hungarezo-rumun a saksono-rumun; dhe në rast se nuk përdorin emrat që vijnë nga një komb ose një tjetër, atëherë le të mbajnë emrat e lumenjve ose kalave që janë përdorur deri më sot, si dhe të deklarohet se të gjithë banorët e asaj Principate, pavarësisht nga kombësia ose feja e tyre, duhet që të gëzojnë dhe të kenë të drejta, përfitime dhe detyrime të barabarta, në bazë të shtresës ose të gjendjes “së vetë secilit” dhe në përputhje me aftësitë e “gjithësecilit”.

Gjithçka e përmendur më lart provon se të gjitha këto kërkesa mbështeten në drejtësinë natyrore dhe në parimet e shoqërisë civile, si dhe në të gjitha marrëveshjet e bëra.

Prodan, f. 453-466.



Në shekullin e 18-të, Transilvania ishte principatë nën sundimin austriak. Sistemi i saj politik, i trashëguar qysh nga periudha e fundit e mesjetës, u kishte siguruar përfaqësim politik të tria kombeve politike (fisnikëve hungarezë, seklerëve dhe saksonëve), por përjashtonte rumunët më të shumtë në numër, të cilët vetëm ishin “toleruar”. Në vitin 1791, intelektualët kryesorë rumunë, në bashkëpunim me përfaqësuesit e Kishave Uniate dhe Ortodokse, dorëzuan një memorandum, i cili kërkonte nga perandori Leopold i Dytë të drejta të barabarta për rumunët e Transilvanisë. Për të shmangur ndonjë konflikt të mundshëm me shtresat politike, perandori e kaloi memorandumin për shqyrtim në Asamblenë e Transilvanisë. Por kjo e fundit e rrëzoi atë.



Cilat ishin argumentet e paraqitura nga rumunët e Transilvanisë? A shihni ndonjë ndikim të Revolucionit Francez në këtë tekst?

⁵ Sede = krahina të veçanta në zonat saksone dhe seklere të Transilvanisë.

I-7. Memorandum osman kundër Revolucionit Francez (1798)

Dihet botërisht se bazat themelore të rendit dhe të unitetit në çdo shtet, lidhen me mbështetjen që ka në rrënjët e ligjeve të shenjta, në besimin fetar dhe në doktrinë; se ruajtja e rendit dhe kontrolli i vendit dhe i nënshtetasve të tij nuk mund të sigurohet vetëm me mjete politike; se është e nevojshme që Zoti të kihet frikë [...]; se në kohë të lashta dhe të reja, çdo shtet dhe popull ka pasur besimin e tij fetar, qoftë ky i vërtetë ose jo. Por, pavarësisht nga kjo, prijësit e kryengritjeve dhe të pakënaqësive që po shfaqen sot në Francë si rrallëherë, me pikësynimin për të përmbushur qëllimet e tyre të mbrapshta dhe duke i shpërfillur pasojat e rënda që mund të vijnë, kanë arritur ta mposhtin frikën nga Zoti apo nga hakmarrjet e njerëzve të thjeshtë, dhe i kanë ligjëruar të gjitha aktet e shëmtuara, duke e fshirë plotësisht turpin dhe njerëzillëkun, e duke i hapur kështu rrugën shndërrimit të të gjithë francezëve në bagëti. Por ata nuk u ngopën me kaq dhe duke siguruar mbështetës kudo, për t'i mbajtur shtetet e tjera nën trysni që të ruajnë regjimet e tyre, e në këtë mënyrë të parandalonin sulmet e mundshme ndaj vendit të tyre, arritën të përkthejnë dhe botojnë në çdo gjuhë deklaratën kryengritëse të cilën e kanë quajtur *Të Drejtat e Njeriut*, si dhe u përpoqën që të nxisnin njerëzit e thjeshtë të çdo kombi ose besimi fetar që të rebeloheshin kundër mbretërve të tyre.

Lewis, f. 66-67



Memorandumi u hartua në pranverën e vitit 1798 nga Ahmet Atif efendiu, kryesekretari (reis-ul-kuttab - personi përgjegjës për marrëdhëniet me jashtë) i Këshillit Perandorak (divan). Vëmendja e osmanëve ndaj çështjeve të Francës u rrit për shkak të pushtimit që kjo e fundit u bëri Ishujve Jonianë nën sundimin e Venecies, në vitin 1797, si dhe për shkak të propagandës franceze në Greqi, të përgatitjeve për fushatën në Egjipt, që drejtohej nga gjenerali Napoleon Bonaparti, dhe të thirrjeve të Britanisë dhe Rusisë për t'u bashkuar në një koalicion antifrancëz.



Përse ishin të shqetësuara autoritetet osmane? A mendoni se idetë e Revolucionit Francez mund të ndiknin edhe tek nënshtetasit osmanë të Europës Juglindore? A ishte e mundur që ndikimi ideologjik të shmangej përmes dënimit zyrtar të Revolucionit nga ana e zyrtarëve osmanë?

I-8. Ndikimi i Revolucionit Francez tek intelektualët e Europës Juglindore – Poemë kushtrimi nga Adamantios Koraisi (1800)

(a)

Miqtë e mi bashkëpatriotë,
Edhe sa kohë do të qëndrojmë skllevër
Të myslimanëve të urryer,
Tiranëve të Greqisë?
Koha për hakmarrje
Është tani, o shokë;
Atdheu ynë vajton,
E na thërret mbytur në lot.
Fëmijtë e mi, grekë trima,
Nxitoni ju burra dhe rinia;
Si një grusht, të përbashkuar,
Me njëri-tjetrin përqaftuar,
Thërrisni fort njëzëri:
Mjaft më tirani!
Rrofsh liri!

(i)

Francezë të mrekullueshëm, trima,
Askush veç grekëve s'është si ju,
Trima e të paepur.
Gjersa në krah kemi francezët,
Që janë miqtë e lirisë
Dhe shpëtimit të Greqisë,
Përse na duhen të tjerët?
Francezë dhe grekë së bashku,
Lidhur fort në miqësi,
Nuk janë thjesht grekë e francezë,
Por një komb greko-francëz,
Që brohoret: skllavëria fatzezë
Le të zhduket nga kjo botë.
Rroftë liria!

Dimaras, f. 88-91.



Adamantios Koraisi (1748-1833), dijetar grek, i frymëzuar nga Revolucioni Francez, besonte se liria duhet fituar përmes arsimimit. Ai njihet si udhëheqës intelektual, i cili me veprën e tij i shërbeu luftës greke për pavarësi. Kështu, tek *Poemë kushtrimi*, ai i fton bashkëpatriotët e tij që të luftojnë kundër tiranisë (1800).



Cilat mendime që kanë lidhje me ideologjinë e Revolucionit Francez mund të gjejmë në këtë poemë? Ç'ndikim patën idetë e Revolucionit Francez në lëvizjet kombëtare të Europës Juglindore?

I-9. Thirrje nga Aleksandër Ipsilanti: *Luftoni për fe dhe për atdhe!* (1821)

Burra grekë! Koha tashmë ka ardhur. Popujt e Europës që kanë luftuar për të njëjtat të drejta dhe liri, kanë kohë që na kanë ftuar të veprojmë. Ndonëse ata vetë ishin të lirë, përsëri bënë të pamundurën që ta forconin këtë liri, e bashkë me të, edhe lumturinë e tyre.

Kudo - vëllezërit dhe miqtë tanë serbë, populli i Sulit dhe mbarë Epiri janë armatosur e po na presin; le t'u bashkohemi edhe ne plot entuziazëm! Atdheu po na thërret!

Tashmë Europa po na vështron dhe po çuditet me plogështinë tonë! E pra, le të gjëmojnë malet greke nga buçimat e trumbetave tona, dhe le të oshëtijnë luginat nga vringëllimat e armëve tona. Europa do na adhurojë për këtë trimëri, ndërsa shtypësit tanë do t'ia mbathin të zverdhur dhe të drithëruar nga frika.

Popujt mendjendritur të Europës po përpiqen që të rivendosin lumturinë e tyre; dhe me mirënjohje për vlerat e etërve tanë, dëshirojnë liri edhe për Greqinë. Duke dëshmuar se i meritojmë virtytet tona të lashta dhe të sotme, le të shpresojmë në mbështetjen dhe në ndihmën e tyre; shumë njerëz zemërgjerë ndër ta do të vijnë që të bashkohen në betejën tonë. Miq, mbahuni dhe do të shihni se një Fuqi e Madhe mbështet të drejtat tona! Madje do të shihni, se shumë prej armiqve tanë, të frymëzuar nga çështja

jonë e drejtë, do t'i kthejnë shpinën armikut dhe do të bashkohen me ne; dhe duke e njohur çiltërsinë e tyre, Atdheu ynë do t'i pranojë. [...]

Tashmë ka ardhur koha që ta shkundim zgjedhën e padurueshme, të çlirojmë Atdheun, të ulim Gjysmëhënën dhe të ngremë atë simbol që na sjell gjithmonë fitore, pra Kryqin; dhe kështu të hakmerremi për Atdheun dhe për Fenë tonë Ortodokse, me përbuzje ndaj të pafeve [...]

Pra, shokë, rrëmbeni armët, Atdheu po na thërret! Aleksandër Ipsilanti

24 shkurt 1821. Komanda e Përgjithshme e Jasionit [Jashi].

IEE vëll. 12, f. 23.



Thirrja u botua në Jashi nga Aleksandër Ipsilanti (1792-1828). Biri i një ish-princi të Vllahisë, oficer i lartë i ushtrisë ruse, si dhe anëtar i Organizatës së Fshehtë Revolucionare Greke "Filiqi Eteria", Aleksandër Ipsilanti mori drejtimin e luftës për çlirim kundër osmanëve në shkurt të vitit 1821, duke marshuar përmes Principatave Rumune, me një ushtri të vogël greke.



Kujt i drejtohet drejtpërsëdrejti kjo *Thirrje*? Analizoni me kujdes mjetet retorike që përdor autori për të nxitur dhe bindur bashkëpatriotët e tij që t'i bashkohen luftës. Si mendoni, përse e përmend autori Europën?

I-10. Kërkesa konservatore të parisë boshnjake (1826)

Kemi marrë urdhër [ferman] nga perandori, përmes Omer efendiut, sipas të cilit urdhërohet shfuqizimi i jeniçerëve, si dhe zbatimi i fermanit. Qysh nga koha e pushtimit [osman të Bosnjës], si gjyshërit tanë, ashtu dhe ne, u jemi bindur Ligjit të Shenjtë Osman [*Sheriatit*], si dhe Ligjit Perandorak Osman [*Kanunit*]. Ne gjithmonë u jemi bindur urdhrave dhe fermaneve të sulltanëve, kurrë nuk kemi shfaqur kundërshti a mosbindje ndaj tyre, e përsëri do të vazhdojmë kështu. Por kemi 40 vjet⁶ që luftojmë, duke sakrifikuar jetën dhe mallin tonë. Në luftërat

⁶ Këtu autorët i referohen fillimit të Luftës turko-austriake të viteve 1787-1791. Edhe pas përfundimit të saj, luftimet vazhduan për shkak të kryengritjeve të shumta në Perandorinë Osmane, veçanërisht të kryengritjes serbe, e cila filloi në vitin 1804.

e dikurshme me Serbinë, që zgjatën për 15 vjet, ne i shpenzuam të gjitha forcat tona, dhe deri në çlirimin e Kalasë së Beogradit, humbëm më shumë se 10 mijë veta, e mijëra të tjerë na u plagosën. Gjithmonë jemi lutur për shëndetin e sulltanit dhe gjithmonë kemi shpresuar në mëshirën e tij. Madje, edhe tani që po flasim për heqjen e jeniçerëve, ne përsëri kemi shpresë se sulltani do t'i hapë krahët e tij të mëshirshëm dhe do t'i ndërpresë e do t'i papësojë këto ndryshime, duke ruajtur rendin e mëparshëm në Bosnjë dhe të gjitha formacionet e hershme ushtarake, duke treguar kështu, rishtazi, mirësinë që ka ndaj nesh.

Aličić, f. 166-167.



Në vitin 1826, sulltan Mahmuti i Dytë (1808-1839) i shpërnda trupat jeniçere, duke eliminuar kështu grupin kryesor që kishte shfaqur kundërshti gjatë përpjekjeve të mëparshme për reformimin e Perandorisë Osmane. Ky veprim i jepte atij mundësinë që të vazhdonte procesin e vënies së provincave nën kontrollin e Stambollit, si dhe të përgatiste terrenin për reformat e periudhës së Tanzimatit.



Komentoni qëndrimin e parisë boshnjake në lidhje me marrëdhëniet me Perandorinë Osmane. Si mendoni, përse ata shqetësoheshin prej shfuqizimit të jeniçerëve dhe nga përpjekjet për reforma në Perandorinë Osmane?

I-11. Hatisherifi i Gjylhanesë (1839)

Të mbushur me besim, falë ndihmës së Lartmadhërisë dhe ndërhyrjes së Profetit tonë, gjykojmë si të drejtë që nëpërmjet institucioneve të reja, provincave në mbarë Perandorinë Osmane t'u sigurojmë përparësitë e një administrate të mirë.

Këto institucione duhet të udhëhiqen nga tri parime kryesore, të cilat janë: 1. Garantimi i sigurisë së plotë të jetës, nderit dhe pasurisë së nënshtetasve tanë. 2. Një sistem i drejtë për vlerësimin dhe mbledhjen e taksave. 3. Po ashtu, një sistem i drejtë për rekrutimin e trupave dhe për kohëzgjatjen e shërbimit të tyre ushtarak... Këtej e tutje, akuzat ndaj çdo të pandehuri do të gjykojnë publikisht, në përputhje me Ligjin tonë të Shenjtë, pas hetimit dhe shqyrtimit

të tyre. Për sa kohë që ende nuk është deklaruar një vendim i rregullt, askush nuk mund ta dënojë tjetrin, fshehurazi ose haptazi, me vdekje, me helmim ose çfarëdolloj mjete tjetër.

Askush nuk do të lejohet që të cenojë nderin e një personi tjetër, në çfarëdolloj rrethanash. Gjithkush do ta zotërojë pronën e tij të çfarëdo lloji, dhe do të veprojë me të në liri të plotë, pa u frenuar ose penguar nga askush [...]

Këto të mira perandorake do të shtrihen tek të gjithë qytetarët tanë, të cilitdo besimi ose sekt i fetar qofshin, si dhe do të gëzohen prej tyre pa kurrfarë përjashtimi. Kështu, ne u garantojmë banorëve të perandorisë sonë siguri të plotë të jetës, nderit dhe të pasurisë së tyre, sikundër paraqitet edhe në tekstin e Ligjit tonë të Shenjtë...

Meqenëse të gjithë nëpunësit publikë të Perandorisë marrin një pagesë të përshtatshme (dhe të gjitha ato detyra që deri më sot nuk janë shpërblyer siç duhet, do të përcaktohen), do të miratohet një Ligj i rreptë kundër të gjitha trafikëve, të emërimeve dhe të ryshfeteve, që sipas Ligjit të Shenjtë dënohen, e që në fakt, përbëjnë dhe shkakun kryesor të dobësimit të Perandorisë.

Vučinić, f. 160-161.



Urdhri perandorak, i lëshuar në rezidencën Gjylhane të Pallatit Perandorak në Stamboll, në emër të sulltanit të porsavënë, Abdulmexhidi i Parë (1839-1861), shënon zyrtarisht edhe fillimin e periudhës së reformave të brendshme modernizuese në Perandorinë Osmane.



Identifikoni problemet që *Hatisherifi* synonte të zgjidhte. Si mendoni, cilat ishin qëllimet e këtij veprimi? A ishte kjo një mënyrë për të modernizuar shtetin, apo thjesht një formë zbutjeje e pakënaqësive të nënshtetasve?

I-12. Argumentim nga Jon Kodru - Dragushanu, në mbështetje të shtetit kombëtar (1844)

Një komb mund të bëhet vetëm prej shtetit kombëtar. Atje ku nuk kemi një shtet kombëtar,

nuk mund të kemi as komb, dhe atje ku nuk kemi një qeveri të përkrahur nga populli, shteti mbetet veçse një ëndërr kombëtare, dhe kombi një përzierje individësh me tipare karakteristike të veçanta. Një komb i vërtetë mund të ekzistojë vetëm atje ku populli përfaqësohet drejtpërdrejt nga qeveria e tij. Ai mund të ekzistojë vetëm atje ku të gjitha ndjenjat, forcat dhe veprat kanë për qëllim të vetëm emrin dhe nderin, respektin dhe lavdinë për njerëzit e thjeshtë, si dhe mirëqenien e lumturinë për çdo klasë shoqërore dhe për çdo individ në shpirtin e tij...

Codru-Drăgușanu, f. 253-254.



Jon Kodru-Drăgușanu (1820-1884) lindi në Fagarash të Transilvanisë, në kohën e sundimit austriak të saj. Ai udhëtonte shpesh në vende të ndryshme të Europës, nga Anglia deri në Rusi, dhe ka qenë mjaft aktiv në jetën politike dhe kulturore.



Cili është komenti juaj mbi pohimin se “Një komb mund të bëhet vetëm prej shtetit kombëtar”? A ka lidhje ky pohim me faktin se gjatë asaj periudhe, në Transilvani, rumunët ishin të përjashtuar nga sistemi politik?

I-13. Projekti i Ilija Garashaninit për krijimin e një perandorie serbo-sllave (1844)

Tashmë sllavët kanë filluar të lëvizin e të gjallërohen [...] Nga ky fakt buron karakteri dhe themeli i politikës serbe: që Serbia të mos jetë e kufizuar në kufijtë e saj të tanishëm, por që të luftojë për përfshirjen e të gjithë popullsisë serbe brenda saj. [...]

Perandoria turke [duhet] të shpërbëhet dhe kjo gjë mund të arrihet vetëm përmes njëres nga këto dy mënyra: 1. Ose të copëtohet; 2. Ose të krijohet sërishmi nga banorët e saj të krishterë [...].

Shteti serb, i cili fatmirësisht tashmë ka filluar të ekzistojë, por që duhet të zgjerohet dhe të forcohet edhe më tej, i ka mbështetjen dhe bazat e tij të forta në Perandorinë Serbe të shekullit të 13-të dhe të 14-të, si dhe në historinë e pasur e të lavdishme

serbe. [Sipas kësaj historie dihet se] perandorët serbë filluan që t’ia dobësonin Perandorisë Greke pushtetin, dhe pothuajse e shkatërruan atë, me qëllim që në vend të Perandorisë së dështuar Romake të Lindjes, ata të ngrinin Perandorinë Serbosllave, si dhe ta zhvillonin atë. Ndërkohë, perandori Dushan Silni [car Dushani i Madh i Serbisë] e kishte marrë miratimin nga Perandoria Greke, por mbërritja e turqve e ndërpreu këtë erë ndryshimesh dhe e pengoi veprimtarinë e saj për një kohë të gjatë. Por, pas thyerjes dhe shkatërrimit të pushtetit turk, tashmë duhet vënë në lëvizje po ai shpirt, i cili përsëri do të kërkonte të drejtat e tij, si dhe do të rifillonte punën e ndërprerë.

[...] Nëse rilindja e re e perandorisë serbe do të shihet nga ky këndvështrim, atëherë sllavët e tjerë të jugut do ta kuptojnë lehtësisht këtë ide dhe do ta pranojnë atë me kënaqësi, sepse të tilla kujtime nga e kaluara historike, ndoshta nuk ekzistojnë në asnjë vend tjetër europian, ashtu si tek sllavët turq. [...] Ja pse një nismë e tillë ka gjasa që të pranohet me kënaqësi nga njerëzit, dhe nuk do të kërkohen dhjetëra vite punë që ata të kuptojnë përparësitë dhe përfitimet nga një qeveri e pavarur.

Serbët kanë qenë të parët ndër të gjithë sllavët e tjerë të Turqisë, që luftuan me forcat dhe mjetet e veta për liri. Për pasojë, ata kanë plotësisht të drejtë që ta ndjekin të parët këtë nismë. [...] Shteti i ri serb i Jugut do t’i ofrojë Europës të gjithë sigurinë, se do të jetë një shtet i shkëlqyer dhe funksional, i aftë që të mbijetojë midis Austrisë dhe Rusisë. Pozita gjeografike e këtij vendi, shtrirja e tij, burimet natyrore, shpirti luftarak i banorëve të tij, e për më tepër ndjenja fisnike dhe e zellshme kombëtare, origjina dhe gjuha e njëjtë – të gjitha së bashku, dëshmojnë për një të ardhme të lavdishme dhe të qëndrueshme. Në mënyrë që të përcaktohet se çfarë duhet bërë dhe si duhet bërë, qeveria duhet të informohet mbi gjendjen në të cilën ndodhen njerëzit në të gjitha provincat e ndryshme përreth Serbisë. [...] Për këtë qëllim, qeveria duhet mbi të gjitha të dërgojë njerëz mendjehollë [...] dhe të besuar, që të vëzhgojnë me kujdes gjendjen në të cilën ndodhen këta njerëz dhe këto krahi dhe të paraqesin raporte të sakta me shkrim kur të kthehen. Qeveria duhet të njoftohet veçanërisht

mbi gjendjen në Bosnjë dhe Hercegovinë, në Mal të Zi dhe në Shqipërinë e Veriut. Në të njëjtën kohë, është e nevojshme të dihet saktësisht gjendja në Slloveni, Kroaci dhe Dalmaci, pa përmendur këtu gjendjen e popullsisë në Srem, Banat dhe Baçka.
Ljušić 1993, f. 151-163.



Ilija Garashanini, (1812-1874) ishte njëri prej politikanëve më të spikatur serbë të shekullit të 19-të. Për shkak të ndikimeve të ndryshme, shumica e të cilave bazoheshin në këshillat e emigrantit politik çek, Frantisheh Zak (i cili mbante lidhje me emigrantët politikë polakë të Parisit), në vitin 1844, Garashanini shkroi *Naçertanijen* (Plani mbi të ardhmen e politikës së jashtme dhe asaj kombëtare serbe). Këtu, ai shpalosi se synimet kryesore të politikës afatgjatë të Serbisë në lidhje me Ballkanin, duhej të bazoheshin në bashkimin dhe çlirimin e atyre territoreve ku jetonin serbë, duke përfshirë këtu edhe vendet fqinje të Ballkanit që ende ndodheshin nën sundimin osman. Nga kombet fqinje *Naçertanija* konsiderohet një plan imperialist serb.



Cili është qëllimi i këtij teksti? Gjeni argumentet historike që autori përdor për të transmetuar idetë dhe bindjet e tij.

I-14. Kërkesat kombëtare në revolucionet e 1848-ës.

A. Kërkesat e sllovenëve

1. Të gjithë sllovenët të bashkohen në një komb të vetëm dhe të kenë një asamble të përbashkët sllovene [...]
2. Gjuha sllovene do të ketë të njëjtën pozitive brenda territorit slloven, ashtu siç e ka dhe gjuha gjermane brenda territorit gjerman, dhe ajo italiane brenda territorit italian [...]
3. Të mundësohet njohja e gjuhës sllovene në çdo zyrë brenda territorit slloven, nëse dhe sa herë që ne ta dëshirojmë një gjë të tillë [...]
4. Cilido zyrtar që do të punësohet brenda territorit slloven, duhet të zotërojë plotësisht gjuhën sllovene [...]

Prunk, f. 56.

B. Kërkesat e popullit, miratuar nga Asambleja Kombëtare Kroate në Zagreb

Duke marrë parasysh gjendjen e jashtëzakonshme në të cilën ndodhemi, është mjaft e rëndësishme për ne që të zgjedhim një udhëheqës të ligjshëm, i cili do të rivendosë ligjin në vendin tonë. Për këtë arsye, kemi vendosur njëzëri që baroni Josip Jelačić Buzhimski të jetë guvernatori ynë. Ai është njeriu që ka besimin e të gjithë popullit tonë, prandaj duhet t'i japim komandën e Trupave Ushtarake Kufitare, si dhe të drejtën për të thirrur parlamentin. Parlamenti ynë shtetëror duhet të mbledhet përpara datës 1 maj, në kryeqytetin tonë, Zagreb e të synojë: Ribashkimin e fuqishëm të Mbretërisë së Dalmacisë – që është e jona, në kuptimin ligjor dhe historik – me Mbretërinë e Kroacisë dhe Slloveninë, si dhe me Kufirin tonë Ushtarak... *Ministria* jonë të jetë e pavarur dhe përgjegjëse ndaj parlamentit tonë, anëtarët e të cilit duhet të miratohen nga populli dhe të frymëzohen nga shpirti i lirisë dhe i përparimit. Vendosjen e gjuhës sonë kombëtare në marrëdhëniet e brendshme dhe të jashtme të qeverisë sonë, si dhe në të gjitha nivelet e institucioneve arsimore. Krijimin e Universitetit të Zagrebit. Lirinë e shtypit, të besimit, të të mësuarit dhe të të shprehurit. Zgjedhjen e përfaqësuesve të popullit, mbështetur në parimin e barazisë, pavarësisht nga shtresa shoqërore. Sistemin e njëjtë të taksave për të gjithë njerëzit, pavarësisht nga klasa. Krijimin e një Banke Kombëtare. Të shfuqizohet kushti që priftërinjtë nuk duhet të martohen; në kishë të përdoret gjuha kombëtare, sipas ligjit të vjetër dhe traditave të Kroacisë.

Horvat, vëll. I, f. 107-108

C. Peticioni kombëtar, miratuar nga Asambleja Kombëtare Rumune, në Blazh të Transilvanisë

1. Kombi rumun, mbështetur në parimet e lirisë, barazisë dhe vëllazërisë, kërkon pavarësinë e tij kombëtare në fushën politike, që të gëzojë të drejtën e tij si komb rumun; të ketë përfaqësuesit

e tij në kuvend⁷, në përpjestim me popullsinë e tij; të ketë zyrtarët e tij në çdo degë të administratës, drejtësisë dhe të ushtrisë, po ashtu në përpjestim me popullsinë; të [ketë mundësi që të] përdorë gjuhën e tij në të gjitha çështjet në interes të tij, përfshirë këtu legjislacionin dhe administratën. Ai kërkon [të drejtën që të thërrasë] çdo vit një asamble të përgjithshme kombëtare. [...]

3. Kombi rumun, tashmë i vetëdijshëm për të drejtat e individit, kërkon heqjen e menjëhershme të bujkrobërisë, pa pagesën e asnjë dëmshpërblimi nga këta fshatarë. [...]

7. Kombi rumun kërkon të drejtën për të folur, shkruar dhe botuar, pa asnjë lloj censurimi. [...]

8. Kombi rumun kërkon garantimin e lirisë së individit; askush nuk duhet të arrestohet duke përdorur justifikim politik. Përveç kësaj, ai kërkon të drejtën për t'u tubuar, dhe që njerëzit të mos vuajnë asnjë pasojë, nëse mbledhen për të diskutuar dhe për t'u marrë vesh në qetësi. [...]

10. Kombi rumun kërkon armatosjen e popullsisë ose të rojes kombëtare, për të mbrojtur vendin nga brenda dhe nga jashtë. Milicia rumune duhet të ketë oficerët e saj rumunë.

13. Kombi rumun kërkon hapjen e shkollave rumune në çdo fshat dhe qytet, hapjen e gjimnazeve rumune, të instituteve teknike dhe ushtarake, të seminareve të priftërinjve, si dhe hapjen e një universiteti rumun me fondet e shtetit, në përpjesëtim me popullsinë taksapaguese, që të jetë plotësisht i lirë në zgjedhjen e drejtuesve dhe profesorëve të tij, si dhe në organizimin e programeve mësimore. [...]

14. Kombi rumun kërkon që shpenzimet publike të përballohen bashkërisht, në përputhje me pronën dhe pasurinë e gjithsecilit [individ], duke shmangur favorizimet.

15. Kombi rumun kërkon që për Transilvaninë të hartohet një Kushtetutë e re, nga një asamble kushtetuese [...]; kushtetutë, e cila duhet të mbështetet në parimet e drejtësisë, lirisë, barazisë dhe vëllazërisë, dhe në të cilën kodet e reja për të drejtën civile, penale dhe tregtare, të hartohen sipas po të njëjtave parime.

Murgescu, f. 191-192.



Në vitin 1848, revolucionet shpërthyen në shumë vende të Europës, përfshirë këtu Perandorinë Habsburgase dhe Principatat Rumune, por jo në Serbi, Greqi apo në Perandorinë Osmane. Në Perandorinë Habsburgase, pas rrëzimit të shpejtë të regjimit absolutist të Meternikut, secili komb filloi që të përcaktonte sa më konkretisht interesat e tij të veçanta. Kështu, gjatë periudhës mars-maj të vitit 1848, u mbajtën shumë asamble kombëtare, të cilat miratuan edhe programet e tyre politike kombëtare. Por megjithatë, beteja për të drejta politike dhe rend kushtetues u zbeh shumë shpejt, për shkak të konflikteve kombëtare, të cilat i përçanë revolucionarët, duke i dhënë kështu mundësinë Perandorisë Habsburgase që ta shtypte revolucionin në vitin 1849, me ndihmën e Rusisë.



Cilat ishin kërkesat kryesore të sllovenëve, kroatëve dhe rumunëve? Si e shpjegoni faktin se shumë prej kërkesave ishin të ngjashme? Përzgjidhni ato kërkesa që tashmë janë realizuar në vendin tuaj. Cilat prej tyre nuk janë përmbushur ende, dhe pse?

I-15. Mitropoliti Petar II Petroviç Njegoshi mbështet jugosllavizmin (Cetinë, 12 mars 1850)

I dashur Z. Fr. Mikloshiç,

Nuk jam në dijeni nëse gazeta juaj ka nisur tashmë të botohet. Nëse ka nisur, a kur të nisë të botohet, unë do të kisha kënaqësinë që të kontribuoja me shkrimet e mia në të. Gjithashtu, edhe Z. Milakoviç do t'ju dërgojë herë pas here shkrimet e tij. Ju jeni në një pozitë të tillë nga ku mund të jepni ndihmesë të madhe, pavarësisht nga padija dhe mosshikimit të jugosllavizmit.

Lamtumirë, i dashur Mikloshiç. Të uroj shëndet dhe lumturi. Këto urime të dërgohen nga admiruesi dhe shërbëtori yt, P.P. Njegoshi.

P.P. Njegoshi, *Letra të zgjedhura* f. 147.

⁷ Asambleja Përfaqësuese e Transilvanisë.



Në kohën e kryengritjeve të vitit 1848, u organizua një lëvizje e madhe për bashkimin dhe pavarësinë e sllavëve të jugut. Mitropoliti Petar II Petroviç Njegoshi (1813-1851) mbështeti idenë e jugosllavizmit, duke e konsideruar atë si një rrugë për të arritur çlirimim e vendit nga fuqitë e huaja, si dhe për emancipimin politik dhe kulturor të sllavëve të jugut. Njegoshi deshi të ndihmonte serbët dhe kroatët të luftonin kundër hungarezëve, të cilët i konsideronte armiqtë më të mëdhenj të të dy kombeve. Në qershor të vitit 1849, Njegoshi i ofroi gjeneralit rus, Orlovit, një njësi ushtarake të përbërë prej 4000-5000 malazezësh, për të luftuar kundër Hungarisë. Njegoshi u takua dhe shkëmbeu disa herë letra me mikun e tij, gjuhëtarin slloven, Franc Mikloshiçin (1813-1891). Mikloshiçi mbante titullin *doktor shkencash* në jurisprudencë dhe në studimet sllave; ai ishte profesor në Universitetin e Vjenës, anëtar i Bibliotekës Mbretërore të Vjenës dhe pasoi Jernej Kopitarin në postin e recensentit në këtë bibliotekë.

I-16. Pakënaqësia e të krishterëve boshnjakë ndaj sundimit osman, paraqitur nga murgu françeskan, Ivan Frano Jukiçi (1850)

Nëse një i krishterë boshnjak del në gjyq kundër një turku, ai thjesht nuk mund të ketë të drejtë, dhe kjo për shkak se nuk mund të dëshmojë asgjë kundër një turku, e sidomos kundër dikujt që e ka mjekrën të thinjur! Kadiu (gjykatësi) të drejtohet me këto fjalë: “Ej ti, vllah! Një turk di më shumë se njëqind vllah! Ky vend është i Turqisë, kurse ju jeni thjesht nënshtetas [raja]; kambana e kishës akoma nuk bie këtu, por praktikohet besimi turk, e të tjera si këto.” Në gjykatat e sulltanit, vendimet jepen pikërisht në këtë formë. Sot, të krishterët nuk mund të mbajnë vende pune shtetërore, vetëm turqit mund t’i kenë ato. Nëse të krishterët e Bosnjës duan që të ndërtojnë një kishë të re, ose të riparojnë një të vjetër, ata do të hasin në shumë pengesa – kështu që njerëzve fatkeqë u duhet që të qëndrojnë nën qiellin e hapur, dhe t’i dëgjojnë lutjet me kokën zbuluar!

Jukic, f. 307-308.



Cilat elemente të pakënaqësive thekson autori? A mendoni se autori është i paanshëm? Nëse mendoni se ai është tendencioz, a mund ta shfrytëzojmë këtë pasazh si dëshmi historike? Nëse po, deri në ç’masë?

I-17. Hati Humajuni⁸ Osman vendos barazinë ndërmjet nënshtetasve osmanë, pavarësisht nga besimi i tyre fetar (1856)

Të zbatohet, sikundër paraqitet më poshtë.

Po të drejtohem ty, Veziri im i Madh, Mehmet Amin Ali pasha, dekoruar me Urdhrin tim Perandorak *Mexhidije*, të Klasit të Parë dhe me Urdhrin për Merita Personale; të dhëntë Zoti sa më shumë madhësi e pushtet!... Mbështetur në dinjitetin e Perandorisë sime, si dhe [...] në bujarinë dhe ndihmën miqësore të Fuqive të Mëdha, aleatëve të mi fisnikë, tashmë kam dëshirë që t’i përtërij dhe t’i zgjeroj edhe më shumë institucionet e reja [...] Garancitë që ne kemi premtuar përmes *Hati Humajunit të Gjylhanesë*, dhe në përputhje me Tanzimatin [...], tashmë janë pranuar dhe konsoliduar, dhe për të arritur rezultate më të plota, do të merren masa edhe më të efektshme.

Të gjitha privilegjet dhe paprekshmëria shpirtërore që janë dhënë nga paraardhësit e mi *ab antiquo*, si dhe ato që u janë dhënë më vonë me mbështetjen time bashkësive të krishtera ose të tjera jomyslimane të kësaj Perandorie, do të konfirmohen dhe do të mbeten në fuqi.

Çdo i krishterë ose bashkësi tjetër jomyslimane ka për detyrë që brenda një periudhe të caktuar dhe në pajtim me një komision *ad hoc*, të përbërë nga anëtarë të po këtij grupi, me miratimin tim dhe nën vëzhgimin e Portës së Lartë, të vazhdojë procesin e shqyrtimit të Imunitetit dhe të Privilegjeve të tij të tanishme, si dhe të diskutojë e t’i paraqesi Portës së Lartë ato reforma që i kërkon koha dhe fryma qytetëruese. Pushteti që do t’u ngarkohet patriarkëve dhe peshkopëve të krishterë nga Sulltan Mehmeti II dhe nga pasuesit e tij, do të harmonizohet me gjendjen e re të cilën ua sigurojnë këtyre bashkësive

⁸ Dekreti perandorak osman.

qëllimet e mia bujare dhe dashamirëse [...]. Rregullat për emërimin e përhershëm të patriarkëve, pas rishikimit të rregullave të tanishme mbi mënyrën e zgjedhjes së tyre, do të zbatohen pikë për pikë dhe në përputhje me përmbajtjen e fermanëve të lëshuar.


Taksat fetare, të cilësdo natyre qofshin, do të hiqen dhe do të zëvendësohen nga të ardhurat e përcaktuara të patriarkëve dhe drejtuesve të komuniteteve [...]. Në ato qytete, bashki të vogla dhe fshatra, ku popullsia ka të njëjtin besim fetar, nuk do të ketë asnjë lloj pengese për riparimin e atyre ndërtimeve që janë përcaktuar për besimin fetar, për shkolla, për spitale dhe për varreza, në përputhje me projektin e tyre origjinal...

Çdo dallim i qytetarëve të Perandorisë sime, të cilësdo shtrese qofshin, që i përcakton ata si më ulët sesa një shtresë tjetër, për shkak të besimit fetar, gjuhës ose racës së tyre, do të fshihet njëherë e përgjithmonë nga Protokolli Administrativ. Gjithashtu do të vendosen ligje, të cilat ndalojnë përdorimin e termave me karakter fytes, si ndërmjet individëve privatë, ashtu dhe nga ana e autoriteteve. Meqenëse besimi fetar i çfarëdolloji është dhe do të vazhdojë të mbetet i lirë në të gjitha zotërimet e mia, asnjë nënshtetas i Perandorisë sime nuk do të pengohet të ushtrojë atë besim që ai deklaron [...]. Askush nuk do të detyrohet që ta ndryshojë besimin e tij [...] dhe [...] të gjithë nënshtetasit e Perandorisë sime, pa dallim kombësie, do të pranohen të punojnë në administratën publike. [...] Të gjithë nënshtetasit e Perandorisë sime, pa asnjë dallim, do të pranohen në shkollat civile dhe ushtarake të qeverisë... Për më tepër, çdo komunitet është i autorizuar që të hapë shkolla publike të shkencave, artit dhe profesionale [...]

Të gjitha paditë tregtare, civile dhe penale midis myslimanëve dhe të krishterëve ose nënshtetasve të tjerë jomyslimanë, ose midis të krishterëve dhe qytetarëve jomyslimanë të sekteve të ndryshme, do të shqyrtohen nga gjykata të përziera. Proceset në këto gjykata do të jenë të hapura: palët do të kenë mundësi që të ballafaqohen dhe të thërrasin dëshmitarët e tyre, dëshmitë e të cilëve do të

pranohen pa asnjë dallim, duke u betuar në përputhje me të drejtën fetare të secilit sekt [...] Taksat do të mbliidhen nën të njëjtën emërtesë, nga të gjithë qytetarët e Perandorisë sime, pa dallim shtrese ose besimi. Të gjitha mënyrat e përfolura për shmangien e shpërdorimeve gjatë mbledhjes së taksave, veçanërisht asaj të së dhjetës, do të rishikohen. Sistemi i mbledhjes së drejtpërdrejtë do të zëvendësohet shkallë- shkallë dhe sa më shpejt që të jetë e mundur, nga plani i bujqësisë, në të gjitha degët e të ardhurave shtetërore.

Vucinich, f. 161-163.

 Cilat ishin qëllimet e autoriteteve osmane kur lëshuan këtë dekret? Krahasoni vendimet konkrete të këtij dekreti, me ankesat e parashtruara në dokumentin I-16, të paraqitur më lart. A mendoni se Hati Humajuni ia arriti që ta forconte lidhjen e popujve jomyslimanë me shtetin osman?

I-18 Opinionet kundërshtuese në lidhje me planin e krijimit të një shteti dualist bullgaro-osman (1867)

A. Promemorje e Komitetit Qendror të Fshehtë Bullgar, drejtuar sulltan Abdul Azizit⁹

Memorandum,
drejtuar Madhërisë së Tij, Sulltanit Abdul Aziz Han,
Zotit dhe babait tonë të mëshirshëm, nga Komiteti
Qendror i Fshehtë Bullgar
Madhëria Juaj!

Fati i çdo individi dhe kombi është në duart e Zotit të Plotfuqishëm, i cili sundon tërë universin. Katër shekuj më parë, ky fat na shpuri ne bullgarëve, si dhe atdheun tonë të shtrenjtë, nën zotërimin e atyre pushtuesve të lavdishëm, të cilët themeluan Perandorinë Osmane në Europë. [...]

Ne tani ju lutemi, që të paraqesim përpara Madhërisë Suaj bazat mbi të cilat populli bullgar do të dëshironte dhe do të kërkonte me dashamirësi shpalljen e pavarësisë së tij. Pavarësia Politike.

⁹ Sulltan osman gjatë viteve 1861-1876.

Neni 1. Qeveri kushtetuese kombëtare.

Neni 2. Bullgaria, së bashku me të gjitha provincat e banuara nga bullgarët, të shpallet e pavarur dhe të quhet Mbretëria Bullgare.

Neni 3. Mbretëria Bullgare të jetë politikisht e varur nga Perandoria Osmane dhe të ketë si carin e saj, perandorin, madhërinë e Tij, sulltan Abdul Azizin dhe pasuesit e tij të mëvonshëm, të cilët do t'i shtojnë titullit të tyre të tanishëm "Sulltan Osman" edhe titullin "Car i Bullgarisë". [...]

Neni 6. Mëkëmbësi i carit do të jetë i dyti, pas madhërisë së Tij, në rolin e kryetarit të shtetit, qeverisë dhe pushtetit ekzekutiv, kryekomandant i ushtrisë bullgare, si dhe kryetar i gjykatës.

Neni 7. Mëkëmbësi i carit do të qeverisë me ndihmën e një këshilli, të përbërë vetëm nga bullgarë dhe të zgjedhur nga një asamble kombëtare. Anëtarët e këtij këshilli duhet ta ndajnë pushtetin ndërmjet tyre në mënyrë të tillë, që secili prej tyre të bëhet drejtuesi i një departamenti të veçantë. Ata duhet të kenë të drejtën që të nxjerrin projektligje dhe të hartojnë projektet e buxhetit të shtetit, të cilat do t'i paraqiten për miratim mëkëmbësit të carit, pasi të jenë miratuar edhe nga Asambleja Kombëtare. Anëtarët duhet të kenë përgjegjësi të përbashkët për veprimet e tyre dhe asnjë vendim i mëkëmbësit të carit nuk do të hyjë në fuqi, nëse nuk firmoset nga anëtarët e këshillit...

Neni 9. Krishterimi Ortodoks Lindor do të jetë besimi kryesor në vend.

Neni 10. Drejtësia do të zbatohet në përputhje me ligjet e veçanta bullgare, të cilat do të miratohen nga Asambleja Kombëtare. [...]

Neni 11. Mbretëria Bullgare do të ketë ushtrinë e saj të pavarur, të organizuar sipas sistemeve të reja dhe sipas një ligji të veçantë. [...]

Neni 13. Gjuha bullgare do të jetë gjuha zyrtare e mbretërisë.

Neni 14. Të garantohen të gjitha të drejtat civile dhe politike, për shembull, për shtypin e lirë, të drejtën për t'u shprehur lirshëm, mbajtjen e mbledhjeve dhe diskutimeve publike për probleme politike dhe shoqërore, etj., si dhe garantimi i lirisë vetjake, i të drejtës për të qenë zot në shtëpinë e vet, si dhe i tolerancës fetare.

Христоматия [Krestomaci], f. 400-409.



Ekzistojnë shumë tekste të cilat dokumentojnë përpjekjet për krijimin e shteteve kombëtare. Gjithsesi, shteti kombëtar nuk është përfytyruar si forma e vetme e organizimit politik. Për shkak të kushteve të veçanta politike, u hartuan edhe disa propozime të tjera, të cilat, në të vërtetë ishin alternativa të shtetit kombëtar.



Analizoni mënyrën që ishte menduar për organizimin e Bullgarisë në kuadrin e një shteti dualist osmano-bullgar. Cila ishte marrëdhënia e saj me shtetin osman? Përpiquni të kuptoni se përse anëtarët e Komitetit të Fshehtë shqyrtuan një propozim të tillë dhe jo një tjetër? A dini tjetër shembull të ndonjë shteti dualist në Europë?

B. Reagimi i Fuad pashës¹⁰, siç përshkruhet në kujtimet e Hristo Stambolskit

Vizitë tek Fuad pasha. – Pikërisht në të njëjtën ditë, më 2 prill të 1867-s, në ditën e dytë të pushimeve të Bajramit, Hristoja vajti tek Fuad pasha, sot ministër i Punëve të Jashtme, me pretekstin për ta uruar për pushimet, si dhe për t'u vetëprezantuar... Gjatë bashkëbisedimit, ministri foli për Memorandumin, duke deklaruar se qeveria 'a fait la sourde oreille' [e bëri veshin të shurdhët], dhe se askush prej ambasadorëve të tij nuk përmendi më gjësend lidhur me këtë çështje. Fuad pasha shtoi se bullgarët, nëse Memorandumin e kishin shkruar ata vetë, tregohen mjaft egoistë; nëse Perandoria Osmane do të ishte e populluar vetëm nga turqit dhe bullgarët, atëherë gjërat do të ishin shumë më ndryshe, por aty ka edhe grekë, armenë, shqiptarë, kurdë, arabë dhe shumë kombësi të tjera, dhe secilës prej tyre u janë dhënë të drejta dhe privilegje të barabarta politike dhe kombëtare... Nuk janë vetëm turqit, grekët ose bullgarët, siç thuhet në Memorandum, të cilët mund ta mbështesin veçmas shtetin turk, por të gjitha kombësitë njëloj; por, për të arritur një gjë të tillë, të gjitha kombet kanë nevojë për një arsye bindëse. Prandaj po ju them, me shqetësimin si ministër, se autorët e këtij Memorandumi duhet të jenë njerëz egoistë dhe të papjekur.'

Stambolski, f. 292-293.

¹⁰ Fuad-pasha (1815-1869) ishte një nga reformatoret osmanë më të spikatur të periudhës së Tanzimatit. Ai ka qenë pesë herë ministër i Jashtëm osman dhe dy herë vezir i madh.



Dr. Hristo T. Stambolski (1843, Kazanluk -1932, Sofje) ishte mjek dhe figurë publike. Ai ka punuar në Shkollën Mjekësore Perandorake të Stambollit, si profesor anatomie; pas vitit 1878, ai ka qenë njëri prej organizatorëve të Kujdesit Shëndetësor në Bullgari. Stambolski ka qenë mjaft aktiv edhe në lëvizjen për themelimin e kishës së ndarë bullgare, të pavarur nga Patriarkana Greke.



Jepni komentet tuaja mbi qëndrimin e Fuad pashës. Cilat ishin arsyt e tij për ta kritikuar propozimin? A mendoni se ai përfaqësonte edhe opinionin zyrtar të shtetit osman?

Zhvilloni një debat:

Ndahuni në dy grupe: njëri duhet të gjejë argumentet që e mbështesin propozimin për krijimin e një shteti dualist bullgaro-osman, kurse tjetri duhet ta diskutojë këtë çështje sipas pikëpamjes së Fuad pashës. Gjithashtu, ju mund të përpiqeni që të diskutoni një propozim të ngjashëm, porë nga këndvështrimi i grupit të cilit i përkisni, duke marrë parasysh edhe kushtet e veçanta historike.

I-19. Projekti për bashkimin e bullgarëve dhe të serbëve në një mbretëri sllave të Jugut, nën sundimin e princit serb, Mihail Obrenoviçit (1867)

Protokoll

Meqenëse rrethanat e tanishme kërkojnë ndërmarrjen e veprimeve çlirimtare nga të gjithë popujt e shtypur të Turqisë, në bullgarët që jetojnë në Bullgari, Traki dhe Maqedoni, jemi mbledhur që të shqyrtojmë dhe të gjejmë një mënyrë për çlirimin e atdheut tonë të dashur, për t'u bashkuar kështu në familjen e shteteve të lira, si dhe t'i tregojmë tërë botës se ne ekzistojmë.

Për të arritur suksese në këtë përpjekje kaq të dëshirueshme, na duhet të gjejmë edhe një popull fqinjë, me ndihmën e të cilit mund ta fitojmë lirinë në dobi të të dy palëve, dhe ne s'mund të përzgjedhim popull tjetër, përveç serbëve, me të cilët kemi lidhje kombësie, besimi fetar dhe pozite

gjeografike. Bashkimi vëllazëror duhet të bëhet ndërmjet serbëve dhe bullgarëve, duke u pagëzuar me emrin *Mbretëria Sllave e Jugut*.

Mbretëria Sllave e Jugut do të përbëhet nga serbët dhe bullgarët (tek bullgarët përfshihen territoret e Bullgarisë, Trakisë dhe Maqedonisë).

Kryetari i qeverisë së re do të jetë princi i tanishëm i Serbisë, Mihail Obrenoviçi, me të drejta të trashëgueshme.

Flamuri kombëtar i kësaj mbretërie duhet që të jetë një, dhe duhet të përfaqësojë simbolet e të dy popujve. E njëjta gjë duhet të vlejë edhe për monedhën e ardhshme.

Secili vend do ta ruajë gjuhën e vet si gjuhë zyrtare, dhe nëpunësit do të zgjidhen ndërmjet njerëzve që e flasin atë gjuhë.

Ligjet ekzistuese serbe do të pranohen edhe nga ne, dhe do të përkthehen në gjuhën bullgare. Të gjitha ligjet e *Mbretërisë Sllave të Jugut* do të botohen në të dyja gjuhët, pa asnjë përjashtim, pra serbisht dhe bullgarisht.

Документи [Dokumente], 1, f. 434-435.



Si mendoni, përse bullgarët zgjodhën modelin e bashkimit me Serbinë, në vend që të kërkonin shtetin e tyre kombëtar? Si e planifikonin ata ruajtjen e identitetit të tyre kombëtar?

I-20. Nga raporti i një diplomati rus, mbi planet për formimin e një shteti të përbashkët rumuno-bullgar (1867)

Në letrën nr. 1, të datës 15 prill, unë kam patur nderin që të njoftoj Shkëlqesinë tuaj, se i ashtuquajtura Komiteti i Fshehtë Bullgar përbëhet kryesisht nga të rinj dhe u krijua që të nxisë opinionin e favorshëm publik mbi bullgarët në Europë, dhe në të njëjtën kohë, t'i shtynte që të ngriheshin kundër sundimit turk. Sipas informacioneve të mëtejshme të grumbulluara nga ana ime, doli se ky Komitet u krijua si rezultat i një marrëveshjeje midis Partisë së të Kuqve [Liberalëve] të Rumanisë, dhe disa bullgarëve. Për më tepër, sipas kësaj marrëveshjeje, rumunët marrin përsipër të ndihmojnë bullgarët për çlirimin nga sundimi turk, me qëllim që ta shpallin shtetin e tyre të pavarur nga sulltani.

Nuk ka dyshim se rumunët, në marrëveshjen e tyre me bullgarët, kishin synime të fshehta për rikrijimin e shtetit vllah-bullgar, për përfitimet e veta, duke shfrytëzuar kështu problemet që do t'i krijoheshin qeverisë turke nga kryengritja e bullgarëve. Atëherë, do t'ia dilnin mbanë që të shpallnin një Rumani të pavarur, dhe përsa u përket bullgarëve – t'i braktisnin në punën e vet. Nga ana tjetër, bullgarët kishin në mendjet e tyre vetëm përfitimet që do të dilnin për bashkëkombësit përtej Danubit [...]

Документи [Dokumente], 1, f. 436.

? Sipas diplomatit rus, cilat ishin qëllimet e vërteta të bullgarëve dhe të rumunëve?

Bëni krahasimin midis teksteve I-18, I-19 dhe I-20. Cili projekt mendoni se ishte më i dobishëm për bullgarët?

Bëni krahasimin midis teksteve I-13, I-18, I-19, I-20 dhe I-43. Cilat janë modelet politike që parashtrihen në këto propozime?

I-21. Mbi marrëdhëniet ndërmjet lirisë politike dhe kombit – opinion i shprehur në editorialin e botuar nga Ljuben Karavelovi në gazetën "Svoboda" (nëntor 1869)

Ashtu si kafshët që kanë nevojë për ajër dhe peshqit që kanë nevojë për ujë, edhe njeriu, pikësëpari dhe mbi të gjitha, ka nevojë për liri. Pa liri, njeriu nuk mund ta quajë veten njeri, por gjysmënjeri; pa liri, njeriu nuk mund të jetë, ashtu si natyra e krijoj që të jetë, kështu pra, ai nuk mund të jetë as i lumtur. Gjithçka për të cilën ka nevojë një njeri, është e rëndësishme edhe për kombin mbarë. Vetëm një komb që ka jetën e vet historike dhe liri të brendshme e të jashtme, domethënë që ka pavarësinë e tij politike dhe intelektuale, mund të jetojë dhe të zhvillohet. Çdo komb që nuk ka liri politike, kurdoherë – edhe me qeverinë më liberale të mundshme – është i ekspozuar ndaj disa faktorëve të padukshëm centralizues dhe ndaj kombit sundues, kurse rrallëherë është e mundur që faktorë të tillë të ndikojnë për mirë në kombin e shtypur.

Karavelov, f. 165.



Ljuben Karavelovi (1834/1835-1879) ka qenë shkrimtar, gazetar, organizator dhe ideator i lëvizjes për çlirimin kombëtar të Bullgarisë.

Ai ishte themeluesi i organizatës më të madhe revolucionare të Bullgarisë dhe redaktori i gazetës së kësaj organizate. Karavelovi konsiderohet edhe si njëri prej themeluesve të letërsisë së re bullgare.



Analizoni thënien: "Gjithçka për të cilën ka nevojë një njeri, është e rëndësishme edhe për kombin mbarë". Shikoni dhe bëni krahasimin e kësaj pjese, me tekstin III-1, të shkruar nga Dimitri Bolintineanu. Çfarë përpiqen të na sugjerojnë autorët? Nëse mendoni se ata e theksojnë idenë e kombit, argumentoni qëndrimin tuaj?

► Fig. 1. Sllovenia: Lëvizja tabore (1869)



Slovenska, f. 232.



Sllovenët me bindje liberale, duke ndjekur shembullin çek, filluan lëvizjen e "taborëve", të tubimeve të hapura, për të mbështetur programin Sllovenia e Bashkuar. Për dy vjet me radhë, derisa Vjena i ndaloi këto veprimtari publike, sllovenët tuboheshin në vende të ndryshme për të dëgjuar opinione dhe për të miratuar vendime në lidhje me çështjet kombëtare.



Cili ishte qëllimi i kësaj fotografie? Ç'kuptim ka pamja në qendër të saj? Ç'lidhje ekziston midis peizazhit dhe vlerave kombëtare?

I-22. Fermani që bëri të mundur krijimin e Ekzarkatit bullgar (1870)

Të gjithë nënshtetasit dhe qytetarët e bindur të Perandorisë sonë, që gëzojnë liri të plotë besimi dhe të drejta të tjera, jetojnë mes një harmonie dhe miqësie të përbashkët, ashtu si dhe qytetarët e njerëzit e shkolluar... Por, për fat të keq, kemi hasur pakënaqësi dhe mosmarrëveshje, të cilat, pavarësisht nga qëllimi ynë i mirë, kanë shpërthyer ndërmjet bullgarëve të krishterë dhe Patriarkanës greke...

1. Tanimë po ngrihet një zonë e veçantë juridiksioni fetar, e quajtur *Ekzarkati bullgar*. Aty do të përfshihen ata peshkopë dhe ato peshkopata që përmenden më poshtë, si dhe disa territore të tjera. Ekzarkati do të jetë i autorizuar që të merret me të gjitha problemet kishtarë të këtij besimi.

2. Detyra më e lartë për peshkopët e përfshirë në këtë juridiksion do të mbajë titullin "Ekzarku" dhe ai do të jetë kryetari kanonik i Sinodit të Shenjtë Bullgar, selia qendrore e të cilit do ta shoqërojë atë gjithmonë. [...]

4. Sipas normave të kishës, ky ekzark, i caktuar me beratin (urdhrin) tonë, duhet që të përmendë emrin e patriarkut të Carigradit (Stambollit) në liturgji. Përpara zgjedhjes së një personi të denjë për t'u bërë ekzark, në përputhje me normat e kishës, do të kërkohet edhe mendimi dhe miratimi i qeverisë sime. [...]

[...]
Të gjithë ata të krishterë, ose të paktën dy të tretat e atyre që jetojnë jashtë zonave të lartpërmendura, të cilët duan të bëhen anëtarë të *Ekzarkatit bullgar*, do të lejohen që ta bëjnë një gjë të tillë, nëse ky vullnet ekziston vërtet.

Христоматия [Krestomaci], f. 268-271.



Ekzarkati bullgar ishte një formë organizimi e veçantë e Kishës ortodokse, që u krijua me anë të një fermi osman (dekreti të sulltanit), në shkurt të vitit 1870. Ai vazhdoi të ekzistonte deri në vitin 1953, kur u riorganizua si Patriarkana bullgare.



Si mendoni, përse autoritetet osmane pranuan krijimin e ekzarkatit autonom bullgar? Për çfarë arsyeje bullgarët ortodoksë dëshironin që të kishin organizimin e tyre të pavarur kishtar, të ndarë nga Patriarkana e Kostandinopojës?

I-23. Rezultatet e plebishitit për besnikërinë kishtarë në peshkopatat e Shkupit dhe të Ohrit (1874)

Pas plebishitit për caktimin e kryepeshkopëve bullgarë brenda eparkisë së Shkupit dhe të Ohrit, në përputhje me *Nenin 10* të fermanit mbi krijimin e *Ekzarkatit bullgar*, doli se nga 8 698 familje të krishtera në eparkinë e Shkupit, vetëm 567 prej tyre donin që të qëndronin në Patriarkanën greke, ndërsa 8 131 familjet e tjera votuan për të kaluar nën drejtimin e *Ekzarkatit bullgar*.

Sipas informacionit të dhënë nga vilajeti i Selanikut, më 21 muharem 1291 (27 shkurt 1874), rezultatet e plebishitit të mbajtur në qytetin e Ohrit dhe në rrethinat e tij, tregojnë se vetëm 139 burra votuan për të qëndruar ende me Patriarkanën, dhe 9 387 të tjerë votuan për të kaluar tek *Ekzarkati bullgar*.

Христоматия [Krestomaci], f. 280.



Si do t'i komentoni rezultatet e plebishitit? Ç'loj informacionesh të tjera na nevojiten për t'i kuptuar më mirë këto rezultate? A ishte diçka e pazakontë për shekullin e 19-të, që vetëm burrat kishin mundësi të votonin? A ishte e drejtë që në eparkinë e Shkupit, një familje përfaqësohej vetëm me një votë?

I-24. Hristo Botevi mbi nevojën që bullgarët të luftojnë për çlirimin kombëtar (1875)

Historia e popullit tonë ka qenë e zyrtë dhe e përvuajtur, ndërsa situata e tanishme është e vështirë dhe e hidhur.

Thënë ndryshe, bullgarët janë skllëvër të turqve, skllëvër të vetvetes, skllëvër të karakterit, madje

edhe skllëvër të shkollimit dhe të kulturës së tyre. Nëse i hidhni një sy punës së tyre të rëndë, do të shikoni se ata punojnë si dema. Duke i parë vuajtjet e tyre të pazakonta, madje edhe fytyrat e tyre, do të bindeni menjëherë për faktin se ata vërtet “punojnë si demat, mblidhen si bletët, e jetojnë si derrat”. Eshtë e vërtetë se shumë të huaj kanë shkruar dhe po vazhdojnë të shkruajnë shumë mbi zellin, talentin dhe zhvillimin tonë kulturor. Por, pothuajse që të gjithë këta autorë, kanë vërtetuar dhe vazhdojnë të vërtetojnë matematikisht se, që t’i zhvillojmë edhe më tej ato cilësi që ende ruajmë, e që të arrijmë të shndërrohemi në “gjermanët e Jugut” ose në “anglezët e Lindjes”, atëherë duhet që të flakim zgjedhën barbare turke, të çlirohemi nga kjo skllavëri çnjerëzore që po na thith të gjitha rezultatet e punës sonë, dhe në bulevardin e Bosforit të ndërtojmë Konfederatën e Lirë Sllavojugore.

Botev, f. 85-86.



Hristo Botevi (1847-1876) ishte poet, gazetar, revolucionar dhe hero kombëtar. Ai ka jetuar dhe punuar kryesisht në Rumani. Në periudhën 1874-1875, u bë udhëheqës i lëvizjes për çlirim kombëtar të Bullgarisë. Në maj të 1876-s, bashkë me një grup të vogël luftëtarësh, ai kapërceu Danubin dhe u vra në betejën kundër trupave turke. Botevi ka shkruar vetëm 20 poezi, por, megjithatë, ai ka mbetur poet klasik për letërsinë bullgare.



Cili ishte qëllimi i këtij artikulli? Në ç’mënyrë autori arrin të theksojë krenarinë e popullit bullgar? Përse autori këmbëngulte në idenë që bullgarët mund të shndërroheshin në “gjermanët e Jugut” apo në “anglezët e Lindjes”? Po në vendin tuaj, cilat kanë qenë pikat referuese europiane më të zakonshme?

I-25. Programi politik i Shoqërisë Bamirëse Qendrore Bullgare (Bukuresht, nëntor 1876)

Për të mundur vendosjen e paqes në Lindje, për të ndaluar mizoritë e vazhdueshme të turqve, të cilët nuk respektojnë asnjë të drejtë njerëzore, dhe për të përmbushur kërkesat e ligjshme të popullit bullgar, Europa është e detyruar që të japë ndihmesën e saj për zbatimin e programit të mëposhtëm:

1. Të rivendoset shteti bullgar, i përbërë nga Bullgaria, Maqedonia dhe Trakia, në të cilin bullgarët janë elementi mbizotërues.
2. Shteti bullgar do të ketë një qeveri të pavarur, dhe kushtetutën e tij, e cila do të miratohet nga një trupë legjislative, e zgjedhur nga populli.
3. Për të gjitha fushat do të ekzistojnë ligje të veçanta, të cilat do të hartohen në përputhje me kushtetutën dhe do të përmbushin nevojat e njerëzve.
4. Të gjitha pakicat kombëtare që jetojnë bashkë me bullgarët, do të gëzojnë të njëjtat të drejta politike dhe civile me ta.
5. Në shtetin bullgar do të ekzistojë liria e plotë e mendimit dhe besimit.
6. Shërbimi ushtarak dhe arsimit i përgjithshëm do të jenë të detyrueshëm për të gjithë banorët e Bullgarisë.

Христоматия [Krestomac], f. 609.



Pas shtypjes së kryengritjes bullgare të prillit nga ana e osmanëve, në gusht të vitit 1876, emigrantët bullgarë të Rumanisë themeluan Shoqërinë Bamirëse Qendrore Bullgare (ShBQB), e cila ishte një organizatë politike që hartoi një program me kërkesat kryesore politike për çlirimin kombëtar të bullgarëve.



Si i shpjegoni shprehjet e përdorura në tekst kundër turqve dhe kundër Perandorisë Osmane? A mendoni se ato i referoheshin në mënyrë të veçantë shtypjes që osmanët u bënë bullgarëve në kryengritjen e 1876-s, apo mendoni se ato ishin një argument retorik më i përgjithshëm? Në ç’mënyrë synonin që ta krijonin shtetin bullgar autorët? Si e përfytyronin ata organizimin e shtetit të ri?

I-26. Memorandumi i Shqiptarëve kundër Paqes së Shën Stefanit (1878)

Shqipëria – pjesa e Sipërme, e Mesme, dhe e Poshtme – ka qenë nga kohërat më të lashta e banuar nga i njëjti popull sikurse edhe sot. Numri i klaneve dhe i fiseve të ndryshme të cilat kanë banuar në kohën e Herodotit, të Strabonit dhe të Plinit, kanë mbetur të njëjtë, pos disa ndryshimeve të emërave.

Kjo shihet më mirë nëse do të bëhet krahasimi i trevave të Shqipërisë së sotme me përshkrimet e historianëve të vjetër të cilat na kanë mbetur në trashëgim.

[...]

Aneksimi i këtyre krahinave Malit të Zi, ose ndonjë shteti tjetër sllav, vende këto që janë të banuara ab antique (që nga kohërat e lashta) nga shqiptarët të cilët ndryshojnë qenësisht për nga gjuha, origjina, kostumet, traditat dhe religjionet, nuk do të ishte vetëm një padrejtësi pikëlluese, por më tepër një veprim i pavend, veprim ky që me doemos do të shkaktojë ankime, pakënaqësi, dhe konflikte gjakatare; shqiptarët, qoftë të besimit musliman ose të besimit katolik, nuk do t'i nënshtrohen sundimit të ndonjë shteti sllav (...)

Në qoftë se shqiptarët nuk do ta fitojnë autonominë, por kanë për të zgjedhur në mes të nënshtimit një shteti të vogël sllav, ose aneksimit nga një shtet i madh evropian, ata unanimisht nuk do të ngurrojnë për t'u deklaruar në të mirë të alternativës së dytë.

Zyra Kombëtare e Arkivave, Londër, F.O 78/2784,
Muzeu Britanik, Seksionet dhe Dokumentat (38),
1878. LXXXIII. (83, 298-301.)

I-27a. Poezi shqiptare e shkruar në kohën e Kongresit të Berlinit (1878)

Ju lutem, shikoni mirë, ju për Shqipëri.
Mos e bëni copa-copa, sikur s'ka njeri. S'jemi grekër, as bullgarë,
as prej Malit të Zi.
Jemi vetëm shqipëtarë
Dhe duam liri...

Brahimi, f. 62.



Shqiptarët, si të gjitha kombet e tjera të Ballkanit, nuk u përfaqësuan në Kongresin e paqes në Berlin, megjithatë udhëheqësit e tyre bënë përpjekje si për të caktuar qëllimet kombëtare, ashtu dhe për të vënë në lëvizje opinionin publik që t'i mbështeste ato qëllime.



Cili ishte synimi i kësaj poezie? Çfarë na transmetojnë autorët nëpërmjet renditjes së emrave të popujve që jetojnë në rajon?

I-27b. Protestë e popullsisë së sanxhakut të Prishtinës drejtuar Kongresit të Berlinit duke raportuar mizoritë e kryera ndaj popullsisë vendase (25 qershor, 1878)

"Rrethanat fatkeqe na detyrojnë t'ju lutemi që të ktheni vështrimin tuaj nga ne dhe të keni parasysht fatkeqësitë tona duke i shënuar në numrin e atyre që kanë qenë vendimtare për t'ju mbledhur në këtë kongres të nderuar... Bashkatdhetarët tanë, viktima të padrejtësive dhe të mizorive të kryera në vendet e pushtuara nga serbët, rusët, malazeztë dhe bullgarët... Për shkak të (...) tyre (...) sa e sa nëna e fëmijë kanë humbur jetën nëpër përrenj për t'i shpëtuar shpatës së armikut... Ata që kanë rënë në duart e mizorëve, qofshin pleq, qofshin gra, qofshin fëmijë, nuk kanë mundur të tërheqin me rënkimet e tyre, mëshirën e armikut, i cili i ka vrarë egërsisht (...) Pjesa më e madhe e banorëve të vendeve tona që janë (...) myslimanë (...), ortodoksë (...) dhe (...) katolikë flasin vetëm shqip; do të ndodhte kështu flijimi i kombit tonë dhe ky do të bëhej viktimitë e padrejtësive të lartpërmendura po qe se, siç po dëgjojmë, do të projektohej formimi i vendeve sllave midis qyteteve të pushtuara, po qe se do të vendosej pra të vdesim me nder gjer te njeriu i fundit që të mos jemi aspak viktima të këtij nënshtimi... Lutemi fort pra, në emër të të drejtave njerëzore dhe të qytetërimit të tregoni ndaj nesh mëshirën, dhembshurinë dhe mbrojtjen tuaj, që kështu të mos biem nën zgjedhën e rëndë të armiqve, qëllimi hakmarrës i të cilëve do të na shfaroste! Lutemi të merrni masa për mbrojtjen e kombit tonë..."

Prishtinë, më 13/25 qershor 1294/1878

Përfaqësuesit e popullsisë së kazave të Prishtinës, Gjilanit, Gjakovës, Vuçiternit, Pejës, Vranjës.

PAAA, Turqia 129, vëll. II; Aktet e Kongresit të Berlinit, 1878, dok. nr. 27. (telegram). Përkthyer nga origjinali frëngjisht¹¹.

¹¹ Akademia e Shkencave e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë (Instituti i Historisë), *Akte të Rilindjes Kombëtare Shqiptare (1878-1912)*, përgatitur nga Stefanaq Pollo dhe Selami Pulaha, Tiranë, 1978, fq. 52

I-27c. Notë proteste e popullsisë të Kosovës, Rrafshit të Dukagjinit, Dibrës, Shkupit, Manastirit, Tetovës, Novipazarit, Senicës, Tashlixhes, Gucisë drejtuar Kongresit të Berlinit duke i kërkuar mbrojtje (26 qershor, 1878)

"...Të gjithë bashkërisht (...) kemi pasur nderin t'i parashtrijmë drejtësisë së Fuqive të Mëdha (...) se pjesa më e madhe e banorëve të atdheut tonë janë (...) myslimanë dhe midis bashkatdhetarëve tanë të krishterë shumica janë (...) ortodoksë dhe (...) katolikë që flasin shqip dhe nuk kanë asnjë lidhje me sllavët. (...) Ky ndryshim i jashtëzakonshëm dhe në kundërshtim me drejtësinë (...) në (...) këtë shekull të qytetërimit (...) provohet (...) pas mizorive dhe çnderimeve të kryera nga rusët dhe bullgarët kundrejt banorëve të trevave të pushtuara. (...) Mijëra njerëz të pafajshëm e kanë larë tokën me gjakun e tyre. (...) Midis grave (...) e (...) vajzave janë djegur dhe kanë gjetur vdekjen (...) pasi kanë pësuar lloj-lloj çnderimesh (...) e (...) të gjitha vuajtjet (...).

Midis atyre që i janë dorëzuar armikut (...) iu plaçkitën pasuritë dhe bagëtia (...) dhe (...) qenë të detyruar të paguajnë haraçe (...) dhe atyre që nuk kanë qenë në gjendje të paguajnë, u kanë hequr edhe rrobat e trupit. (...) Ne jemi gati të bëjmë çdo lloj sakrifice (...) në qoftë se lutjet tona nuk do të arrijnë të ngjallin mëshirën e Evropës (...), në emër të të drejtave njerëzore dhe të qytetërimit...".

Prishtinë, më 14/26 qershor 1294/1878

Pasojnë nënshkrimet e përfaqësuesve myslimanë dhe katolikë të kazave të Dibrës së Sipërme, Dibra e Poshtme, Gjakova, Tetova, Shkupi, Prishtina, Peja, Manastiri, Vuçiterni, Gjilani, Mitrovica, Senica, Tashlixheja, Gucia, Luma, Prizreni.

PAAA, *Turqia 129, vëll. II, Aktet e Kongresit të Berlinit, II, 1878 dok. nr. 35. (telegram). Përkthyer nga origjinali frëngjisht.*¹²

I-28. Traktati i Paqes i Berlinit (1878)

Traktat ndërmjet Britanisë së Madhe, Austro-Hungarisë, Francës, Gjermanisë, Italisë, Rosisë dhe Turqisë (Berlin, 13 korrik 1878)

Neni I. Bullgaria përbën një principatë autonome tatimpaguese, në suzerenitetin e Madhërisë së Tij, Sulltanit. Ajo do të ketë një qeveri të krishterë dhe një milici kombëtare.

Neni XXIII. Porta e Lartë merr përsipër që të zbatojë me përpikëri në ishullin e Kretës, Ligjin Organik të vitit 1868, me disa ndryshime të pranueshme. Ligje të tjera të ngjashme, të përshtatura sipas kushteve vendore të veçanta, përveç çështjeve që kanë lidhje me përjashtimin nga taksat për Kretën, do të vendosen edhe në zonat e tjera të Turqisë në Europë, për të cilat në Traktatin e tanishëm nuk është përcaktuar ndonjë organizim i veçantë. Për përcaktimin e detajuar të ligjeve të reja në secilën provincë, Porta e Lartë do të përfaqësohet nëpërmjet komisioneve të posaçme, me përfshirjen e gjerë edhe të elementit vendës. Skemat e organizimit të përfutuara nga tërë kjo veprimtari, do t'i çohen për shqyrtim Portës së Lartë, e cila, përpara se ligjet të hyjnë në fuqi, do të këshillohet me Komisionin Europian, të krijuar për Rumelinë Lindore.

Neni XXV. Provincat e Bosnjës dhe Hercegovinës do të pushtohen dhe administrohen nga Austro-Hungaria. Meqenëse qeveria e Austro-Hungarisë nuk dëshiron të marrë përsipër administrimin e sanxhakut të Novi-Pazarit, i cili shtrihet midis Serbisë dhe Malit të Zi, në drejtimin juglindor, në anën tjetër të Mitrovicës, atëherë administrata osmane do të vazhdojë të ushtrojë atje funksionet e saj. Por, pavarësisht nga kjo, për garantimin e situatës së re politike, lirisë dhe sigurisë së komunikimit, Austro-Hungaria gëzon të drejtën e mbajtjes së garnizoneve dhe të rrugëve ushtarake e tregtare në të gjithë zonën e vilajetit¹³ të vjetër të Bosnjës. Për këtë qëllim, qeveria e Austro-Hungarisë dhe ajo e Turqisë do të arrijnë të mirëkuptohen lidhur me detajet përkatëse.

¹² Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë (Instituti i Historisë), *Akte të Rilindjes Kombëtare Shqiptare (1878-1912)*, përgatitur nga Stefanaq Pollo dhe Selami Pulaha, Tiranë, 1978, fq. 54.

¹³ Provincës

Neni XXVI. Pavarësia e Malit të Zi njihet prej Portës së Lartë dhe prej të gjitha Palëve të Larta Kontraktuese, të cilat deri më sot nuk e kishin pranuar një gjë të tillë.

Neni XXVII. Palët e larta nënshkruese bien dakord në lidhje me pikat e mëposhtme: në Malin e Zi, dallimet në besimin fetar ose anëtarësimi në grupime fetare të ndryshme nuk do të përdoret kundrejt asnjë personi si arsye për përjashtim ose paaftësi në çështje që lidhen me gëzimin e të drejtave civile dhe politike, punësim në poste, funksione dhe pozicione publike ose ushtrimin e profesioneve dhe zanateve të ndryshme në çfarëdo zone të vendit. Liria dhe praktikimi i të gjitha formave të lutjes do t'u sigurohet të gjithë banorëve të Malit të Zi, ashtu si edhe të huajve; dhe për më tepër, asnjë pengesë nuk do të krijohet për organizimin e institucioneve fetare dhe marrëdhëniet e tyre me udhëheqësit shpirtërorë.

Neni XXXIV. Palët e Larta Kontraktuese njohin pavarësinë e Principatës së Serbisë, në përputhje me kushtet e parashtruara në nenin vijues.

Neni XXXV. Në Serbi, pa kurrfarë dallimi, përkatësia e ndryshme fetare nuk do të merret si bazë për përjashtimin ose pamundësinë e personave për të ushtruar të drejtat e tyre civile dhe politike, punësimin nëpër institucione ose mbajtjen e funksioneve publike, ushtrimin e profesioneve ose bizneseve të ndryshme në të gjithë vendin. Liria dhe ushtrimi i hapur i çfarëdolloj forme besimi u garantohet të gjithë serbëve, ashtu si dhe të huajve; asnjëlloj pengesë nuk do të vendoset as në organizimin hierarkik të bashkësive të ndryshme fetare, dhe as në marrëdhëniet e tyre me udhëheqësit e vet shpirtërorë.

Neni XLIII. Palët e Larta Kontraktuese njohin pavarësinë e Rumanisë, në përputhje me kushtet e parashtruara në dy nenet vijuese.

Neni XLIV. Në Rumani, pa kurrfarë dallimi, përkatësia e ndryshme fetare nuk do të merret si bazë për përjashtimin ose pamundësinë e personave për të ushtruar të drejtat e tyre civile dhe politike, punësimin nëpër institucione ose mbajtjen e funksioneve publike, ushtrimin e profesioneve ose bizneseve të ndryshme në të gjithë vendin. Liria dhe ushtrimi i hapur i çfarëdolloj forme besimi u garantohet të

gjithë rumunëve, ashtu si dhe të huajve; asnjëlloj pengesë nuk do të vendoset as në organizimin hierarkik të bashkësive të ndryshme fetare, dhe as në marrëdhëniet e tyre me udhëheqësit e vet shpirtërorë. Në Rumani, nënshtetasit dhe qytetarët e të gjitha Fuqive, tregtarët, si dhe grupet e tjera, do të trajtohen pa kurrfarë dallimi përkatësie fetare, me një barazi të plotë.

Neni XLV. Principata e Rumanisë i rikthen Madhërisë së Tij, Perandorit të Ruisë, atë pjesë të territorit të Besarabisë që iu shkëput Ruisë prej Traktatit të Parisit më 1856-n. Nga perëndimi, ajo kufizohet me degën e mesit të [lumi] Pruthit, dhe nga jugu, me degën e mesit të Kilias dhe grykëderdhjen e Stari-Stamboulit [Moldova e sotme].

Neni LVIII. Porta e Lartë i jep Perandorisë Ruse në Azi territoret e Ardahanit, Karsit, dhe Batumit [Armenia dhe Gjeorgjia e sotme, si dhe një pjesë e Turqisë Verilindore], së bashku me portin e fundit.

Neni LIX. Madhëria e Tij, Perandori i Ruisë, deklaron se ka për qëllim krijimin e portit të lirë të Batumit, kryesisht për qëllime tregtare.

Neni LXII. Palët Kontraktuese mbajnë shënim deklaratën spontane të Portës së Lartë, e cila shprehu synimin për mbrojtjen e parimit të lirisë fetare, si dhe sigurimin e një hapësire sa më të madhe për të. Askund në Perandorisë Osmane, pa kurrfarë dallimi, përkatësia e ndryshme fetare nuk do të merret si bazë për përjashtimin ose pamundësinë e personave për ushtrimin e të drejtave të tyre civile dhe politike, punësimin nëpër institucione ose mbajtjen e funksioneve publike, ushtrimin e profesioneve ose bizneseve të ndryshme në të gjithë vendin. Liria dhe ushtrimi i hapur i çfarëdolloj forme besimi u garantohet të gjithëve, dhe asnjëlloj pengesë nuk do të vendoset as në organizimin hierarkik të bashkësive të ndryshme fetare, dhe as në marrëdhëniet e tyre me udhëheqësit e vet shpirtërorë.

Klerikët, pelegrinët dhe murgjit e cilësdo kombësie qofshin, të cilët udhëtojnë në Turqinë Europiane ose në Turqinë Aziatike, do të gëzojnë po të njëjtat të drejta, përparësi dhe privilegje.

E drejta për t'u mbrojtur zyrtarisht nga ana e përfaqësuesve diplomatikë dhe konsullorë të Fuqive në Turqi, u njihet jo vetëm personave të

lartpërmendur, por edhe institucioneve të tyre fetare, të bamirësisë ose të natyrave të tjera, në vendet e shenjta ose kudo qofshin ato. Të drejtat e zotëruara nga Franca janë posaçërisht të rezervuara, dhe është plotësisht e kuptueshme se në *status quo* - në e vendeve të shenjta nuk mund të bëhet asnjë ndryshim. Murgjit e Malit Atos, nga cilido vend qofshin ata, do të kenë të gjitha pasuritë dhe përparësitë e tyre të mëparshme, dhe do të gëzojnë, pa kurrfarë përjashtimi, barazi të plotë të të drejtave e të privilegjeve.

<http://www.fordham.edu/halsall/mod/1878berlin.html>



Vizatoni 3 harta: të parën, bazuar në gjendjen përpara vitit 1878, të dytën, sipas mëtimeve territoriale të secilit grup etnik, dhe të tretën, sipas neneve konkrete të Traktatit të Paqes të Berlinit. Çfarë vini re?

Lojë: të vihesh në vendin e dikujt tjetër

Shkruani një ese me 400 fjalë, duke paraqitur propozimet tuaja mbi situatën në Ballkan. Zgjidhni njërin prej identiteteve në vijim: diplomat rus, gjerman, francez, britanik, austro-hungarez; ose përfaqësues osman, shqiptar, bullgar, rumun, serb, kroat, malazias, slloven ose grek; përpikuni që të mos viheni në rolin e dikujt me të njëjtën përkatësi etnike si e juaja. Shpjegoni përzgjedhjen tuaj.



► **Fig. 2. Greqia ndërmjet Turqisë dhe Europës.**
 Karikaturë e marrë nga gazeta *Aristofanes* (1882)



Louvi, f. 230.

KEY **TURQIA:** “Më lini të shkoj, ndryshe hapni sytë, se do ta gllabëroj fëmijën.”

EUROPA: “Ndal, Zonja Turqi, se falë meje, je ende gjallë.”

? Përse paraqitet Greqia si një fëmijë i porsalindur? Bëni një përshkrim të shkurtër, duke u përqendruar në mënyrën se si janë paraqitur të tri personazhet. Si mendoni, çfarë përpiqet t’u sugjerojë autori lexuesve të gazetës?

I-29. Kërkesat e Komitetit Qendror të Lidhjes së Prizrenit dërguar sulltanit (22 korrik, 1880)

Sot në të gjitha anët ndër ne është bërë i njohur paralajmërimi i sulmit të padrejtë, të cilin armiqtë e huaj janë duke e përgatitur kundër nesh. Për këtë arsye, të gjithë na (shqiptarët) kemi vendosur të rrezikojmë me dëshirë e pamëshirë trupin dhe krejt pasurinë tonë për t' u mbrojtur nga armiqtë e huaj. Sipas mendimit tonë të përgjithshëm, duke e parë si obligim nevojën e mbrojtjes së atdheut (tonë) kemi vendosur njëzërit që qeverisja dhe administrimi i Arnautllukut duhet t' i ngarkohet patjetër një valiu të besueshëm, të aftë dhe të sigurtë. Me zemër të pikëlluar në përgjithësi kemi vendosur të përqëndrohemi kundër kësaj padrejtësie.

Qysh nga 500-600 vjet e këndej kemi jetuar nën sovranitetin e Lartmadhërisë së Tij Sulltanit, dhe qysh prej stërgjyshërve dhe gjyshërve tanë në mënyrë trashëgimtare kemi gëzuar të drejtën e ekzistimit, lirisë, nderit dhe fesë, kurse tani është e qartë se Lartmadhëria e Tij Sulltani nuk do ta lejojë shkatërrimin tonë brenda sekondës.

Lidhur me qëllimet dhe kërkesat tona ju kemi bërë qysh herët me dije dhe Ju kemi parashtruar peticione, kërkesa dhe telegrame, por deri më tani nuk kemi marrë përgjigje pozitive.

E njoftojmë Lartmadhërinë e Tij Sulltanin që me qëllim të vetëmbrojtjes duke dhënë jetën për tokë të atdheut tonë, për të cilin do ta derdhim pikën e fundit të gjakut, do ta vazhdojmë kontinuitetin e qëndrueshmërisë dhe ekzistencës tonë trashëguese – historike.

Sot në Prizren janë mbledhur paria nga të gjitha viset tona, çdo njëri ka ardhur sipas zakoneve të vjetra ku janë përmbushur fushat me njerëz të cilët kanë lidhur besën e bashkimit duke u zotuar që do t' i zbatojnë dëshirat e përgjithshme të popullit për t' i mbrojtur viset e Arnautllukut.

Prandaj kërkojmë prej Lartmadhërisë së Tij Sulltanit që të emërohet një person që të qeverisë në të gjitha (viset tona). Turbullirat, trazirat e ndryshme deri tani janë frenuar me premtime, por prej tashit nuk do të jemi në gjendje t' i qetësojmë.

Luteni edhe njëherë që përgjigjen definitive të na dërgoni po ose jo, të cilën e presim me padurim. Si

gjithmonë edhe në këtë pikëpamje urdhëri i takon Lartmadhërisë së Tij Sulltanit.

Të gjithë përfaqësuesit e Arnautllukut.

Më 22 korrik 1880.

Vula: KOMITETI QENDROR I LIDHJES SË PRIZRENIT
B. B. A. Yıldız No – A. K. Fondi L. P. Fot. Nr. 25 ARKIVI I
KOSOVËS, Prishtinë

I-30. Argumentim shqiptar në mbështetje të një shteti të veçantë shqiptar (1886)

Ne duam vetëm atë që do çdo komb: “Një shtet më vete dhe për vete, ku të mblidhen njerëzit e një gjaku, ashtu si në një shtëpi, ku mblidhen njerëzit e një familjeje”.

Kondo, f. 126.



Pjesë nga një artikull i Jeronim (Girolamo) de Radës (1814-1903), botuar në gazetën dygjuhëshe të përmuajshme, *Fiamuri i Arbrit – La Bandiera dell'Albania*. Autori ka qenë poet, por edhe botues i një tjetër gazete dygjuhëshe *L'Albanese d'Italia*. Jeronim de Rada ka jetuar në Itali.



Përse e përdor autori analogjinë midis kombit dhe familjes? Përpikuni të kuptoni sesi një pikëpamje e tillë ndikon në qëndrimin afatgjatë ndaj njerëzve të tjerë, që jetonin po në atë vend.

I-31. Kujtimet e Ivan Haxhi-Nikolovit¹⁴ në lidhje me diskutimet më 1892-in, që çuan drejt krijimit të Organizatës së Brendshme Revolucionare Maqedonase (OBRM) (1893)

Në korrik të vitit 1892 shkova në Sofje për të takuar Kosta Sahovin, botuesin e një gazete maqedonase, një maqedonas mjaft i respektuar, i cili do të shkonte në Selanik për t' u vënë në ballë të organizatës revolucionare për çlirimin e Maqedonisë.

Pasi më dëgjoi, Sahovi më tha: “E kuptoj se çfarë po kërkon, por njeriu e duhur nuk mund ta gjesh këtu. Të gjithë flasin dhe vetëm flasin, por kur vjen çasti për të bërë diçka, askush nuk ndodhet më aty pranë. Këtu është vetëm një njeri të cilit mund

¹⁴ Ivan Haxhi-Nikolovi (1861-1934), ishte njëri nga themeluesit e OBRM-së.

t'i drejtohesh për çështjen maqedonase. Ai është student i shkollës ushtarake, Goce Delcevi.”

Bashkë me Kosta Sahovin, ramë në një mendje që Goce Delcevi¹⁵ të njoftohej se unë kisha dëshirë që ta takoja dhe se takimin mund ta bënim të dielën, në orën 14.00, tek Sahovi. Në orën e caktuar mbërrita në zyrën e shtypit të Kosta Sahovit dhe atje, në një mjedis të qetë, i gjeta të dy duke më pritur që të diskutonim për atë çështje.

Plani për krijimin e organizatës:

1. Organizata të ngrihet në Maqedoni dhe jo në Sofje, sepse në të kundërt, serbët dhe grekët do ta konsideronin atë si krijim të qeverisë bullgare, do të ngrinin organizatat e tyre të ngjashme me të, dhe për pasojë, nga organizata jonë nuk do të kishim asnjë rezultat. Gjithashtu, ajo duhet të jetë e fshehtë.

2. Anëtarët e saj themelues duhet të jenë nga Maqedonia, në mënyrë që të jenë në kontakt të vazhdueshëm me popullsinë e Maqedonisë, që të hasin në të njëjtat rreze me të cilat do të përballen edhe pasuesit e tyre, çka do t'i ndihmojë të fitojnë më lehtë besimin e popullit.

3. Parulla duhet të jetë “Autonomi për Maqedoninë”. Që të shpresojmë për suksesin e synuar, kërkesat tona duhet të mbështeten në *Nenin 23* të Traktatit të Berlinit. Për të arritur autonominë e Maqedonisë, nuk do të thotë që ta shkëpusim atë përgjithmonë vetëm nga turqit, por edhe nga serbët dhe nga grekët. Pas përcaktimit të kufijve të Maqedonisë autonome, serbët dhe grekët nuk do të jenë më në gjendje të kërkojnë ndonjë pjesë të saj; ndërkohë, në rast se ne kërkojmë aneksim tek Bullgaria, atëherë serbët dhe grekët mund të kërkojnë edhe disa pjesë tonat. Detyra jonë është që ta ruajmë Maqedoninë si një të tërë, dhe kjo gjë mund të arrihet vetëm përmes një Maqedonie autonome.

4. Organizata duhet të jetë autonome dhe e pavarur, dhe nuk duhet të ketë asnjë lidhje ose angazhim me qeveritë e vendeve fqinje, me qëllim që të shmanget ndikimi i tyre i mundshëm. Për asnjërin nga këto qeveri, ajo nuk duhet të shndërrohet në një mjet që mund të nxisë kundërveprime nga qeveritë e tjera fqinje.

5. Nga maqedonasit në Bullgari, si dhe nga vetë bullgarët, ne do të kërkojmë vetëm mbështetje materiale dhe morale, pa lënë shteg për të ndërhyrë në veprimet tona.

Pas katër orë bisedimesh, Kosta Sahovi dhe Goce Delcevi e pranuan këtë plan. Vetë Goceja tha kështu: “Zoti Haxhi Nikolov, dëgjo: tashmë ka kaluar kaq shumë kohë, le të presim edhe një vit tjetër. Për një vit, unë e mbaroj shkollën ushtarake dhe shpallmë oficer. Më pas, nga e gjithë kjo do të heq dorë, do shkoj në Selanik, dhe atëherë le ta krijojmë organizatën revolucionare”.

Makedonium, f. 29-30.



Pas Traktatit të Paqes në Berlin, Maqedonia kishte mbetur territori më i rëndësishëm osman në Europë. Meqenëse kishte përbërje etnike të përzier, ajo shumë shpejt u shndërrua në mollë sherri midis nacionalistëve bullgarë, grekë dhe serbë. Organizata e Brendshme Revolucionare Maqedonase u krijua në vitin 1893. Në vitin 1903, ajo organizoi Kryengritjen e Ilindenit kundër sundimit osman, e cila u shtyp. Gjatë periudhës së Luftërave Ballkanike, Maqedonia u pushtua dhe më pas u copëtua ndërmjet Bullgarisë, Greqisë dhe Serbisë. Pas Luftës I Botërore, OBRM-ja u shndërrua shkallë-shkallë nga një lëvizje për çlirim kombëtar, në një organizatë fashiste, terroriste dhe shpërndarëse droge. Ajo ndërmori disa luftime guerile, veçanërisht kundër Serbisë (Jugosllavisë) dhe kontrollonte jozyrtarisht disa pjesë të Maqedonisë bullgare. Ajo pati një ndikim të madh edhe në jetën politike në Bullgari, deri në vitin 1934, kur dhe u detyrua nga qeveria bullgare që të shpërbëhej.



Lexoni tekstin dhe identifikoni ato probleme praktike që vështirësonin krijimin e një organizate politike në Europën Juglindore të fundshekullit të 19-të. Përse mendoni se ishte e rëndësishme që të bëhej një dallim midis autonomisë dhe pavarësisë?

¹⁵ Goce Delcevi (1872-1903) ka qenë një figurë e rëndësishme e luftës për çlirimin e Maqedonisë.

I-32. Deklarata e Organizatës së Brendshme Revolucionare Maqedonase (OBRM), e cila u bën të ditur Fuqive të Mëdha vendimin e saj për fillimin e një kryengritjeje të armatosur (1903)

Dhuna e pandëshkuar e muhamedanëve dhe trysnia e vazhdueshme e administratës i kanë detyruar të krishterët e Maqedonisë dhe të zonave të Adrianopojës që të nisin një luftë të përgjithshme të armatosur. Ata e pranuan këtë mënyrë zgjidhjeje të skajshme vetëm pas dështimit që pati ndikimi europian në ato marrëveshje ndërkombëtare, të cilat mendoheshin se do ta përmirësonin gjendjen e popullsisë. Kjo ndërhyrje nga jashtë vazhdon ende të mbetet mjeti i vetëm që mund ta largojë të keqen dhe të ndalojë gjakderdhjen.

Hapat jorezultativë që janë ndërmarrë deri më sot për ta përmirësuar regjimin turk përmes marrjes së masave qetësuese, por jo zgjidhëse, në të vërtetë veçse e kanë rritur nivelin e fanatizmit muhamedan, si dhe shtypjen shtetërore – kjo ndërhyrje mund të jetë e efektshme vetëm nëse vihen në zbatim këto masa të drejtpërdrejta:

1. Në pajtim me Fuqitë e Mëdha, emërimi i një kryegubernatori, i cili duhet të jetë një i krishterë që kurrë nuk ka qenë pjesë e administratës turke; dhe për të realizuar përbushjen e detyrave të tij, do të jetë i pavarur nga Porta e Lartë.

2. Krijimi i një grupi kontrolli të përhershëm dhe të përbashkët ndërkombëtar, me autoritet të gjerë për marrjen e sanksioneve.

Nëpërmjet këtij shpjegimi të arsyeve që çuan popullsinë kryengritëse drejt një akti të tillë dëshpërimi, si dhe masave që mund të parandalojnë pasojat që do të vijnë prej tij, Organizata e Brendshme e zhvesh veten e saj nga çdo lloj përgjegjësie dhe deklaroi se do ta udhëheqë këtë luftë deri në përbushjen e plotë të qëllimit të saj, duke u frymëzuar nga njohja dhe nga mbështetja që mbarë bota po tregon për të.

Odbrani, f. 484.



Ç'qëllim kishte ky tekst? Çfarë synonin që të arrinin autorët e tij? A paraqitet përballja me armë si qëllim në vetvete, apo si një mënyrë e detyruar për të arritur qëllime të tjera?

I-33. Opinioni i Kërste Misirkovit në lidhje me nevojën e gjetjes së zgjidhjeve politike për problemin maqedonas, brenda strukturës së Perandorisë Osmane (1903)

[...] Nëse propaganda fetare përpiket që ta pengojë integrimin e inteligjencies dhe të popullit maqedonas, atëherë gjëja e parë që duhet bërë është krijimi i një kishe të vetme apostolike në Maqedoni, pra Kryepeshkopata e Ohrit të jetë "Kryepeshkopata e të gjithë Maqedonisë".

Propaganda fetare mund të përmbajë elemente kundër integritetit të inteligjencies dhe të popullit maqedonas, për shkak të veçorive të tyre kombëtare. Nëse kjo është e vërtetë, atëherë është mjaft e natyrshme që, së bashku me kërkesën për reformën fetare, të bëhet edhe kërkesa për reformën arsimore, pra Kryepeshkopata të marrë nën kontroll çështjet e shkollave, si dhe t'i përshtatet kombësisë përkatëse nëpër famullitë e saj. Kështu, në peshkopatat greke, gjuha e shkollave dhe e kishave do të jetë ajo greke; në ato vllahe, do të jetë gjuha vllahe; kurse në peshkopatat sllave, do të jetë gjuha maqedonase. Në këtë mënyrë, e gjithë propaganda kombëtare dhe fetare, e cila deri më sot i ka përçarë njerëzit në grupe të ndryshme armiqësore ndaj njëri-tjetrit, tashmë do të hiqet dhe kështu do të kemi paqe për njerëzit, për Maqedoninë, për Turqinë dhe për Europën. [...]

Një rezultat i tillë është mjaft pozitiv edhe për vetë Turqinë. [...] Nëse nga ana tjetër pranohet zyrtarisht se në Maqedoni nuk ka shumë kombësi sllave, por vetëm një, dhe kjo as bullgare, dhe as serbe, dhe nëse Maqedonia arrin që ta shkëpusë kryepeshkopatën e saj autonome, atëherë Turqia do të shpëtojë menjëherë nga ndërhyrjet e të tria shteteve fqinje në çështjet e Maqedonisë.

Interesi ynë kombëtar ia dikton inteligjencies dhe popullit maqedonas ndihmën që ata duhet t'i japin Turqisë për të dalë nga pozita e vështirë ku ka rënë për shkak të propagandës kombëtare dhe fetare që qarkullonte në Maqedoni, si dhe për shkak të shteteve që kanë interesat e veta atje. Ne nuk kemi nevojë të bashkohemi me Bullgarinë, Serbinë ose Greqinë. Integriteti territorial i Turqisë është më i rëndësishëm për ne, sesa për Rusinë dhe Europën Perëndimore. Turqia është shteti me pozicionin më të favorshëm gjeografik. Nënshitetësia turke dhe

mbrojtja e integritetit të Turqisë na sigurojnë ne maqedonasve të drejtën për të gëzuar nënshtetësi të plotë në të gjithë Turqinë. Një e drejtë e tillë mund të na sigurojë dhe përfitime materiale. Kjo është arsyeja se përse inteligjencia maqedonase, nëse përqendrohet para së gjithash tek interesat e saj, duhet që të angazhojë të gjithë fuqinë e saj morale në mbrojtje të integritetit të Turqisë. Në këmbim, ne mund të shpresojmë dhe kemi të drejtë që të besojmë, se sundimtari ynë zemërgjerë do të na dhurojë autonomi të plotë në çështjet fetare dhe arsimore, barazi të plotë përpara ligjit dhe vetë-qeverisje vendore në Maqedoni. [...]

Një program i tillë kaq paqësor nga ana e popullit maqedonas do të gjejë mbështetjen dhe miratimin e Fuqive të Mëdha, të cilat janë të interesuara për integritetin e Turqisë.

Odbrani, f. 551-552.



Kërste Misirkovi, bashkë me Dimitrij Çupovskin, kanë qenë anëtarë të një grupi aktiv studentësh maqedonas në Shën Peterburg, gjatë dy dhjetëvjeçarëve të parë të shekullit të 20-të. Libri i Misirkovit, *Mbi çështjet e Maqedonisë*, botuar në Sofje në vitin 1903, njihet gjerësisht nga banorët e rajonit, si një gur themeli për zhvillimin e identitetit kombëtar maqedonas.



Përse Kërste Misirkovi ruajtjen e Perandorisë Osmane e quante zgjidhjen më të mirë për maqedonasit? Cili ishte roli i kishës në projektin e tij? A mund të mendojmë se autori po përpiquej ta paraqiste Perandorinë Osmane si një alternativë kundrejt shtetit- komb? Krahasoni tekstet I-25 dhe I-26, duke mbajtur parasysh edhe faktin se kryengritja maqedonase u shtyp në vitin 1903.

I-34. Plani i Aurel C. Popovicit për rishtrukturimin e Austro-Hungarisë në një shtet federal të quajtur “Shtetet e Bashkuara të Austrisë së Madhe” (1906)

Parimet bazë për një kushtetutë federale

I gjithë territori i panishëm i Perandorisë Austro-Hungareze, sipas komebeve që jetojnë brenda tij, përveç Bosnjës dhe Hercegovinës, ndahet në këto

njësi kombëtare dhe politike: Austria Gjermane, Bohemia Gjermane, Moravia (Silezia) Gjermane, Hungaria, Transilvania, Kroacia, Galicia Perëndimore, Galicia Lindore, Slovakia, Ukraina, Vojvodina, Seklerlandi, Tiroli, si dhe Triestja.

Së bashku, të 15-ta këto shtete kombëtare do të formojnë një shtet monarkik federal të quajtur “Shtetet e Bashkuara të Austrisë së Madhe”, nën kurorën e Madhërisë së Tij, perandorit Franz Jozef i Parë.

Të gjithë banorët e një shteti kombëtar do të jenë njëkohësisht, edhe banorë austriakë. Askush nuk lejohet që t’i ushtrojë të drejtat e tij politike në më shumë se një shtet kombëtar.

[...]

Qeveria perandorake ose federale përbëhet nga përfaqësuesit e shteteve kombëtare.

Kancelari, i cili zgjidhet nga perandori, është drejtuesi i qeverisë perandorake ose federale. Parlamenti i perandorisë përbëhet nga:

a) Dhoma e Deputetëve b) Senati

[...]

Qeveritë e shteteve kombëtare i dërgojnë përfaqësuesit e tyre të autorizuar në qeverinë perandorake, në përputhje me votat proporcionale të mëposhtme: Austria Gjermane 7, Hungaria 7, Bohemia 5, Transilvania 4, Kroacia 3, Galicia Perëndimore 3, Galicia Lindore 3, Bohemia Gjermane 1, Slovakia 2, Moravia Gjermane 2, Ukraina 1, Vojvodina 1, Tiroli 1, Triestja 1, dhe Seklerlandi 1, me një numër të përgjithshëm prej 42 votash. [...]

Secili shtet kombëtar ka një parlament, një qeveri të vetën dhe një pushtet gjyqësor. Perandori zgjedh një guvernator perandorak për të drejtuar qeverinë e çdo shteti kombëtar. Ai duhet që të jetë banor i shtetit kombëtar përkatës.

Perandori përzgjedh anëtarët e qeverisë, duke marrë parasysh sugjerimet e guvernatorit.

Secili shtet kombëtar ka kushtetutën e vet. Që të hyjë në fuqi, ajo duhet të miratohet nga pushteti perandorak. Deri në atë çast, qeveria e shtetit kombëtar mund të ushtrojë në mënyrë të pavarur të gjitha të drejtat autonome të vendit. Perandoria është dorëzënë për integritetin territorial të shteteve kombëtare, ashtu si dhe për autonominë e tyre, me kusht që ajo të mos kufizohet nga klauzolat e kushtetutës perandorake, si dhe nga kushtetutat e tyre të veçanta. [...]

Secili shtet kombëtar mund të vendosë vetë se cila do të jetë gjuha zyrtare e tij.

Gjuha e komunikimit ndërkombëtar të perandorisë do të jetë gjermanishtja.

Pavarësisht nga kjo, në parlamentin perandorak, secili anëtar mund të përdorë gjuhën e vet. [...] Të gjitha ligjet, dekretet dhe botimet e autoriteteve perandorake duhet të hartohen dhe të botohen vetëm në gjuhën zyrtare të shtetit përkatës.

Të gjitha mbishkrimet e autoriteteve perandorake, përfshirë dhe ato ushtarake, duhet të bëhen vetëm në gjuhët zyrtare përkatëse.

Tek monedhat dhe kartëmonedhat do të përdoren, gjithashtu, të gjitha gjuhët zyrtare të shteteve përbërëse.

[...]

Vjena është kryeqyteti dhe qyteti rezidencial i perandorisë.

Popovici, f. 288-297.



Aurel C. Popovici (1863-1917) ishte publicist rumun nga Transilvania. Ai studioi për mjekësi dhe shkencë politike në Vjenë dhe në Grac, ka qenë anëtar i Komitetit Kombëtar Rumun në Transilvani, si dhe ka luftuar për të drejtat e rumunëve në Perandorinë Austro-Hungareze. Plani i tij për ta zgjeruar dualizmin austro-hungarez në një sistem të vërtetë federal, u hartua në kuadrin e përpjekjeve të një grupi intelektualësh pranë princit Franz Ferdinand, trashëgimtarit të fronit, për gjetjen e zgjidhjeve që të forcohej monarkia, e cila rrezikohej nga zhvillimi i nacionalizmave të ndryshëm.



Si i mendonte Aurel C. Popovici marrëdhëniet ndërmjet nivelit kombëtar dhe atij federal? Përpiquni të kuptoni se përse ai parapëlqente modelin federativ, në vend të krijimit të shteteve kombëtare të veçanta.

I-35. Përpjekjet e shqiptarëve për të siguruar shtetin e tyre kombëtar, sipas ambasadorit britanik në Perandorinë Osmane (1912)

Lordi Goshen, atëherë ambasador i Madhërisë së Tij në Kostandinopojë, në raportin e tij mbi këtë temë, e përmbledhi lëvizjen e shqiptarëve shkurtimisht me

këto fjalë: “Nuk mund të mohohet se lëvizja shqiptare është krejt e natyrshme. Një popull aq i vjetër dhe i veçantë, sa cilido prej atyre që e rrethojnë, ata kanë vështruar se si e kanë fituar kombësinë, nën mbrojtjen e Fuqive të Mëdha, popujt fqinjë me ta, dhe se si janë shpërblyer dëshirat e tyre për një jetë më të pavarur [...] Ndërkohë që nga ana tjetër, shqiptarët nuk janë trajtuar njëjloj. Kombësia e tyre është injoruar, [...] janë hedhur dhe propozime për shkëmbime terriroresh, e janë shfaqur edhe të tjera vështirësi, por si gjithmonë në kurrizin e Shqipërisë, dhe kështu shqiptarët iu lanë sllavëve dhe grekëve, duke mos i marrë parasysh mëtimet e tyre kombëtare”.

Durham, f. 72.

► Fig. 3. Shpallja e pavarësisë së Shqipërisë në Vlorë (1912) – gravurë e kohës.



Hudhri, f. 44.



Figura në anë të flamurit paraqet Skënderbeun.



Cili është elementi kryesor i paraqitur në këtë figurë? Si mendoni, përse paraqitja e shpalljes së Pavarësisë është e lidhur me simbolet kombëtare? Cili është roli i Skënderbeut në këtë figurë?

I-36. Fjalimi i Xhemal pashës në Damask, lidhur me marrëdhëniet ndërmjet turqve dhe arabëve (1913)

[...] Kam dëshirë që t'ju them këtë gjë: Lëvizja turkiste që ju sot shihni në Stamboll dhe në vende të tjera islamike të banuara nga turqit, nuk është aspak në mospërputhje me mendimin arabist. Ju e dini mirë, se deri më sot kanë ekzistuar lëvizjet greke, bullgare dhe armene në Perandorinë Osmane. Këtyre tashmë iu shtua dhe lëvizja arabe. Turqit e kishin harruar fare veten e tyre. Madje, atyre u vinte turp që të përmendnin edhe kombësinë e tyre. Një rënie e tillë e nacionalizmit mund të na çojë drejt një fundi të sigurt. Duke iu druajtur kësaj gjëje, rinia turke u mobilizua në një lëvizje mjaft të çmuar. Ajo shpalli luftën e shenjtë kombëtare [millixhihad], për t'u thënë turqve se ata ishin turq dhe se kishin virtyte të pafundme... Unë ju siguroj, se lëvizja turkiste nuk është aspak armike e lëvizjes arabiste. Ato janë që të dyja të pandashme dhe vëllazërore me njëra-tjetrën. Rinia turke dëshiron me gjithë zemër që të shohë përparimin e arabëve, si dhe ushtrimin prej tyre të çdo të drejte kombëtare. Përpjekjet e sotme të rinisë turke janë përqendruar në të tilla aspekte të rëndësishme, si: arsimimi i turqve fill pas ndërgjegjësimit kombëtar, rritja e dëshirës për punë, çlirimi nga robëria, kujdesi për shëndetin, rritja e numrit të popullsisë, si dhe rritja e mirëqenies së turqve; pra, e thënë përmbledhurazi, paraqitja e turqve në sytë e botës, si një element i respektuar dhe i bekuar, që e meriton plotësisht të drejtën për të jetuar përkrah kombeve të shekullit të 20-të... Edhe ju, përfaqësuesit e ajkës së rinisë arabe, përpiquini të përmbushni të tilla ideale..."

Cemal, f. 220



Xhemal pasha ka qenë oficer karriere, si dhe një nga udhëheqësit e xhonturqve. Pas grushtit të shtetit në janarin e 1913-s, ai u bë guvernatori ushtarak i Stambollit, më pas ministër i Çështjeve Detare, dhe gjatë Luftës I Botërore u bë komandant ushtrie në Siri. Atje, Xhemal pasha u përpoq që t'u bënte ballë britanikëve, si dhe të ruante besnikërinë e popullsisë arabe ndaj Perandorisë Osmane.



Cili ishte qëllimi i këtij fjalimi?

I-37. Projekti i Dimitrij Çupovskit për formimin e një Republike Demokratike Federale Ballkanike (Shën Peterburg, 1917)

Ballkani për popujt e Ballkanit, Vetëvendosje e plotë për çdo komb.

Lufta botërore që po zhvillohet, do të sjellë liri dhe vetëvendosje për shumë popuj të shtypur. Për shekuj me radhë, Maqedonia ka luftuar dhe e ka derdhur gjakun lumë për këtë liri e pavarësi, por u copëtua tradhtisht nga shovinizmi kriminal dhe nga lakmia e dinastive gjakatare përreth saj. Pasojat e një grabitjeje të tillë të pazakontë kanë shkaktuar jo vetëm shfarosjen e ndërsjelltë të popujve të Ballkanit, por edhe këtë luftë botërore të paparë ndonjëherë. Tani, kur një pjesë e madhe e Gadishullit Ballkanik ndodhet nën gjermadha, dhe ku ata që ende kanë mbetur të gjallë, gjenden nën zgjedhën austro-hungareze, ne maqedonasit që po vuajmë më shumë nga të gjithë, u bëjmë thirrje të gjithë popujve të Ballkanit, që t'i harrojnë grindjet e vjetra dhe t'i bashkohen programit tonë revolucionar mbarëballkanik, për një luftë të përbashkët dhe për krijimin e një Republike Demokratike Federale Ballkanike.

Programi i Komitetit tonë Revolucionar përmban pikat e mëposhtme:

Të gjithë popujt e Ballkanit janë të detyruar që t'i rrëzojnë dinastitë ekzistuese dhe të krijojnë qeveri republikane.

Secila republikë e Ballkanit duhet të jetë plotësisht autonome në veprimtarinë e saj të brendshme.

Të gjitha republikat e Ballkanit të formojnë një Republike Demokratike Federale Ballkanike. Republika Demokratike Federale Ballkanike të përbëhet nga republikat e mëposhtme: Maqedoni, Shqipëri, Mali i Zi, Greqi, Serbi, Bullgari, Kroaci, Bosnjë-Hercegovinë, Slloveni dhe Traki.

Si republika të pavarura, njihen jo vetëm shtetet me një etni, por edhe ato zona me popullsi të përzier, interesat jetike të të cilave janë të lidhura ngushtë me kushtet e tyre gjeografike, historike, politike, ekonomike dhe kulturore.

Në republikat me popullsi të përzier mund të krijohen rajone dhe bashki autonome, në të cilat çdo kombësi do të gëzojë liri të plotë të gjuhës amë, besimit dhe të traditave.

Gjuha zyrtare në secilën nga këto republika është ajo e shumicës.

Secila republikë dërgon përfaqësues të autorizuar në Parlamentin e Përgjithshëm Federal të Republikës Demokratike Federale Ballkanike. Nga grupi i përfaqësuesve të autorizuar, do të formohet një qeveri federale dhe një këshill, i cili do të zëvendësojë presidentin e Republikës Federale.

Qeveria Federale dhe Këshilli do të përbëhen nga një numër i barabartë përfaqësuesish nga secila republikë federative.

Qeveria Federale dhe Këshilli bashkërendojnë të gjitha çështjet e brendshme të përbashkëta, si dhe çështjet e jashtme ndërkombëtare të Republikës Ballkanike.”

Makedonium, f. 75-76.



Dimitrij Çupovski (1878-1940) ka qenë një anëtar drejtues i Shoqatës Maqedonase të Shën Peterburgut. Shpërthimi i Luftës I Botërore dhe Revolucioni Rus i vitit 1917, e nxitën atë që të hartonte plane të guximshme mbi riorganizimin e Europës Juglindore pas mbarimit të luftës.



Lexojeni me kujdes paragrafin e parë dhe krahasojeni atë me tekstet I-32 dhe I-33. Përpikuni të kuptoni se përse Çupovski parapëlqente një republikë federale, në vend të një shteti kombëtar maqedonas.

I-38. Deklarata e Korfuzit (1917), lidhur me parimet që do të ndiqeshin për bashkimin e serbëve, kroatëve dhe sllovenëve

Komiteti i mëparshëm i koalicionit dhe kabineti i tanishëm i Mbretërisë së Serbisë, së bashku me përfaqësuesit e Komitetit Jugosllav të Londrës, i cili deri më sot ka funksionuar si i pavarur, si dhe në praninë dhe me ndihmën e kryetarit të parlamentit (serb), mbajtën një konferencë në të cilën shkëmbyen mendimet dhe idetë e tyre lidhur me të ardhmen e serbëve, kroatëve dhe sllovenëve brenda të njëjtit shtet.

(...) Pikësëpari, përfaqësuesit e serbëve, kroatëve dhe sllovenëve theksojnë si më të rëndësishëm faktin se kombi ynë ka të njëjtin gjak, flet dhe shkruan të njëjtën gjuhë, ka të njëjtën ndjenjë

uniteti, për shkak të vazhdimësisë dhe tërësisë së tij territoriale, dhe ka të njëjtat synime lidhur me ekzistencën kombëtare, si dhe me zhvillimin moral e material të tij.

Ky komb me tre emra, që ka vuajtur aq shumë nga pushteti i ashpër, nga padrejtësia, si dhe nga dëshira e tij për vetëvendosje, tashmë i ka përqaftuar me dëshirë të plotë këto parime të larta, si qëllimin kryesor të kësaj lufte të tmerrshme, që është pasojë e mospërfilljes së të drejtës së tij për vetëvendosje. Gjithashtu, përfaqësuesit e autorizuar të serbëve, kroatëve dhe sllovenëve, në mbështetje të kërkesës së panegociueshme të popullit tonë për lirinë e vetëvendosjes, për çlirimin e plotë nga pushtimi i huaj, si dhe për bashkimin në një shtet kombëtar të lirë, të veçantë, dhe të pavarur, janë marrë vesh që shteti i tyre i përbashkët të ngrihet mbi bazën e këtyre parimeve moderne dhe demokratike (pjesa 1). Populli ynë nuk kërkon asgjë që u përket të tjerëve; populli ynë kërkon vetëm atë që i takon atij vetë, dhe dëshiron që të çlirohet plotësisht e të bashkohet. Kjo është arsyeja përse populli ynë, me ndërgjegje dhe vendosmëri të plotë, nuk pranon asnjë lloj zgjidhjeje të pjesshme, lidhur me çështjen e çlirimit të tij kombëtar dhe atë të bashkimit. Ai e paraqet çështjen e çlirimit nga Perandoria Austro-Hungareze dhe bashkimin e tij me Serbinë dhe Malin e Zi, si një të tërë të pandashme.

Petranović, Zečević, f. 66-68.



Ngjarjet dramatike të 1917-s (veçanërisht lëvizja revolucionare në Rusi dhe përfshirja e Amerikës në luftë) e nxitën qeverinë serbe, si dhe Komitetin Jugosllav – të krijuar prej politikanëve të dëbuar nga territoret austro-hungareze sllave të Jugut – që t’i kapërcenin mosmarrëveshjet e tyre dhe t’i drejtoheshin botës me anë të një programi politik të përbashkët. Deklarata u diskutua në qershor të vitit 1917, në ishullin e Korfuzit, ku qeveria serbe ishte vendosur qysh prej largimit të saj të detyruar nga vendi, në vitin 1915. Në këtë deklaratë përfshiheshin 13 dispozita kryesore, mes të cilave: ajo mbi emrin e shtetit të ardhshëm (Mbretëria e Serbëve, Kroatëve dhe Sllovenëve), si një monarki kushtetuese parlamentare, me sundimtarë nga dinastia Karagjeorgjeviç; mbi stemën, flamurin dhe barazinë e simboleve kombëtare ekzistuese; mbi barazinë e të tre emrave kombëtarë, alfabetëve, emërtesave fetare, territorit dhe barazinë e qytetarëve përpara ligjit dhe shtetit etj. Ky dokument pati një ndikim mjaft domethënës në qëndrimet e politikanëve jugosllavë në emigrim, ashtu si dhe tek popullsia që jetonte në provincat sllavojugore të Austro-Hungarisë.



Cili ishte propozimi kryesor i serbëve, lidhur me të ardhmen e serbëve, kroatëve dhe sllovenëve? Cilat ishin argumentet për mbështetjen e këtij propozimi? Përse mendoni se u propozua një shtet i përbashkët, në vend të 3 shteteve të veçanta? Nëse do t'ju pyesnin tani, çfarë këshille do të jepnit lidhur me të ardhmen e serbëve, kroatëve dhe sllovenëve të vitit 1918?

I-39. Deklaratë e mbretit Nikolla të Malit të Zi, drejtuar jugosllavëve, 20 tetor 1918

Vëllezërit e mi, sot me gëzim të parrëfyer, i mbushur me emocion dhe lumturi, po ju shpreh dëshirën time – dhe jam i bindur që kjo është edhe dëshira e popullit besnik malazes – që Mali i Zi, vendi ynë i dashur, të jetë pjesë përbërëse e Jugosllavisë, dhe që ky popull t'i bashkohet me nder komunitetit jugosllav, ashtu siç ka luftuar dhe vuajtur për të deri në fund. Dua të shpreh dëshirën time që të biem në një mendje dhe të organizohemi si vëllezër në konfederatën jugosllave, në të cilën gjithësecili do të ketë të drejtat e tij, të mbajë besimin e tij dhe të ruajë zakonet dhe rregullat e veta.

Branko Petranoviç, Momçilo Zeçeviç, f. 75.



Nikolla I Petroviç Njegoshi (1841-1921), ishte princ i Malit të Zi në vitet 1860-1910 dhe mbret në vitet 1910-1921. Nën sundimin e tij, Mali i Zi zgjeroi ndjeshëm territoret e tij dhe iu njoh pavarësia në Kongresin e Berlinit të vitit 1878. Ai modernizoi administratën shtetërore, zbatoi rregulla ligjore, miratoi kushtetutën e parë, rregulloi mbarëvajtjen e institucioneve fetare (Mali i Zi ishte i pari vend me shumicë ortodokse që nënshkroi një marrëveshje me Vatikanin). Ai përmirësoi sistemin arsimor, ekonominë e vendit, si dhe infrastrukturën rrugore. Ai u kurorëzua mbret në 50-vjetorin e sundimit të tij. Pavarësisht nga reformat që ndërmori, Nikolla mbetet sundimtar absolutist. Pas pushtimit austro-hungarez të Malit të Zi, në janar 1916, ai emigroi në Francë, ku edhe vdiq.

I-40. Deklarata prej 14 pikash e presidentit Udro Uillson (1918) – klauzolat që lidheshin me Europën Juglindore

Ne u përfshimë në këtë luftë, për shkak të dhunimit të të drejtave, çka na preku thellë dhe që do ta bënte të pamundur jetën e popullit tonë, në rast se kjo nuk do të korrigohej dhe bota nuk do të shpëtonte njëherë e përgjithmonë nga përsëritja e saj.

Ajo që kërkojmë nga kjo luftë, nuk është diçka posaçërisht për ne. Në të vërtetë, ne duam që bota të bëhet e përshtatshme dhe e sigurtë për të jetuar; që ajo të bëhet e sigurtë veçanërisht për çdo komb paqedashës si i yni, i cili dëshiron që të jetojë jetën e vet, të vendosë për institucionet e veta, të ketë drejtësi të garantuar, si dhe marrëdhënie të ndershme me popujt e tjerë të botës, kundër përdorimit të forcës dhe të sulmeve lakmitare. Në të vërtetë, të gjithë popujt e botës kanë një interes të përbashkët dhe ne e kemi të qartë se, nëse të tjerëve nuk u jepet e drejta e tyre, atëherë ajo nuk do të na jepet as neve. Për këtë arsye, programi ynë është programi për paqen e botës; dhe ky program, i vetmi i mundshëm sipas pikëpamjes sonë, është ky: [...]

X. Popujve të Austro-Hungarisë, vendin e të cilëve duam që ta shikojmë të ruajtur dhe të siguruar midis kombeve të tjera, u duhet dhënë një mundësi e pakufizuar për zhvillimin e tyre autonom.

XI. Nga Rumania, Serbia dhe Mali i Zi duhen larguar trupat e huaja; territoret e pushtuara t'u rikthehen përsëri; Serbisë t'i garantohet një dalje e lirë dhe e sigurtë në det; lidhjet e shteteve të shumta të Ballkanit me njëri-tjetrin të vendosen në marrëveshje miqësore duke iu përmbajtur linjave historike të përvijuara sipas përkatësive dhe kombësive; duhet që të zbatohen garancitë ndërkombëtare mbi pavarësitë politike dhe ekonomike, si dhe integriteti territorial i të gjitha shteteve të Ballkanit.

XII. Territoreve turke në Perandorinë Osmane të sotme, u duhet garantuar sovraniteti i plotë, por kombësive të tjera, që tashmë ndodhen nën sundimin turk, u duhet garantuar siguria e jetës, si dhe mundësia absolute e zhvillimit autonom; gjithashtu, nën garancinë ndërkombëtare, Dardanelet duhet

të hapen në mënyrë të përhershme, për të lejuar kalimin e lirë të anijeve dhe tregtinë e çdo kombi. **XIV.** Sipas marrëveshjeve të posaçme, duhet të krijohet një organizatë e përgjithshme e kombeve, me qëllim që të japë garanci të ndërsjellta për pavarësinë politike dhe integritetin territorial si të shteteve të mëdha, ashtu edhe atyre të vogla [...] <http://www.forham.edu/halsall/mod/1918wilson.html>



Presidenti i SHBA-së, Udro Uillson, e paraqiti propozimin e tij të 14 pikave për përfundimin e luftës gjatë mbajtjes së një fjalimi më 8 janar të vitit 1918. Aty ai hodhi bazat e një traktati për paqe, si dhe krijimin e Lidhjes së Kombeve.



Cilat ishin qëllimet e Udro Uillsonit në lidhje me Ballkanin? Si do t'i cilësoni ato?

Si mendoni, a do ta kishin përmirësuar situatën afatgjatë në Ballkan këto zgjidhje?

I-41. Rezoluta e Asamblesë Kombëtare të Alba-Julias, ku shpallet vendimi për bashkimin e Transilvanisë me Rumaninë (1918)

I. Asambleja Kombëtare e të gjithë rumunëve të Transilvanisë, të Banatit dhe të Hungarisë, mbajtur prej përfaqësuesve të saj të ligjshëm në Alba-Julia, nga data 18 nëntor deri më 1 dhjetor, dekreton bashkimin e këtyre rumunëve, si dhe të territoreve të banuara prej tyre, me Rumaninë. Mbi çdo gjë, Asambleja Kombëtare shpall të drejtën e patjetërsueshme që ka kombi rumun mbi të gjithë Banatin, të kufizuar nga lumenjtë Mures, Tisa dhe Danub.

II. Asambleja Kombëtare u jep territoreve të lartpërmendura autonominë e përkohshme, deri në miratimin e kushtetutës nëpërmjet votimit të përgjithshëm.

III. Lidhur me këtë çështje, për themelimin e shtetit të ri rumun, Asambleja Kombëtare shpall parimet themelore të mëposhtme:

1. Liri të plotë kombëtare për të gjitha etnitë e tjera që banojnë në të njëjtin territor. Çdo popull do të arsimohet dhe do të përdorë gjuhën e vet në çështjet juridike, me individë të së njëjtës etni; gjithashtu, çdo popull do ketë të drejtën për t'u përfaqësuar në institucionet ligjore dhe të qeverisë,

në përputhje me numrin e tij të popullsisë.

2. Të drejta të barabarta dhe liri të plotë autonomie fetare për të gjitha besimet fetare në këtë shtet.

3. Sistem të plotë demokratik në të gjitha fushat e jetës publike. Garantimi i votës së drejtpërdrejtë, të barabartë dhe të fshehtë në çdo komunë, në mënyrë përpjesëtimore, për të dyja gjinitë, si dhe përfaqësim mbi moshën 21 vjeç në komuna, rrethe apo në parlament.

4. Liri të plotë për shtypin, shoqatat dhe tubimet, propagandë të lirë për çdo opinion të njerëzve.

5. Reformë agrare rrënjësore. Të gjitha llojet e pasurive, sidomos ato të mëdhatë, do të regjistrohen. Do të ndalohen testamentet nëpërmjet të cilave trashëgimtari ia jep tokën një pale të tretë; ndërkohë, në bazë të së drejtës për ndarjen e çifligjeve, fshatari do të mundet që të ketë pronën e vet (tokë të punëshme, kullotë, pyll), të paktën sa për të punuar ai vetë dhe familja e tij. Parimi në të cilin bazohet kjo politikë agrare, është nxitja e barazisë shoqërore, nga njëra anë, dhe shtimi i forcave të prodhimtarisë, nga ana tjetër.

6. Punëtorëve të industrisë do t'u garantohen të drejta dhe privilegje të njëjta me ato që janë sot në fuqi në shtetet më të zhvilluara industriale të perëndimit.

IV. Asambleja Kombëtare dëshiron që Kongresi i Paqes të krijojë komunitetin e kombeve të lira, me qëllim që drejtësia dhe liria të sigurohet njëlloj për të gjitha kombet e mëdha ose të vogla, dhe që në të ardhmen, të shmanget lufta si mjet për kontrollin e marrëdhënieve ndërkombëtare.

V. Rumunët e mbledhur në këtë Asamble Kombëtare përshëndesin vëllezërit e tyre në Bukovinë, të cilët u shkëputën nga zgjedha e Perandorisë Austro-Hungareze dhe u bashkuan me atdheun e tyre, Rumaninë.

VI. Asambleja Kombëtare përshëndet plot entuziazëm çlirimin e të gjitha kombeve që deri më sot kanë qenë të nënshtruara nga Perandoria Austro-Hungareze, e konkretisht: çekoslovakët, austro-gjermanët, jugosllavët, polakët dhe rusët e Karpateve; gjithashtu, ajo vendosi që kjo përshëndetje t'u dërgohet edhe të gjitha kombeve të tjera.

VII. Asambleja Kombëtare i bën jehonë edhe kujtimin të atyre rumunëve trima, të cilët derdhen gjakun e tyre, në luftë për përmbushjen e ëndrrës sonë, pra,

për çlirimin dhe bashkimin e kombit rumun.

VIII. Asambleja Kombëtare shpreh mirënjohjen dhe përkrahjen e saj ndaj të gjitha Fuqive Aleate, të cilat, përmes betejave të shkëlqyera ndaj një armiku të stërvitur prej dhjetëvjeçarësh me radhë për luftë, arritën që ta shpëtonin qytetërimin nga terrori i barbarëve.

IX. Për vazhdimin e trajtimit të çështjeve të kombit rumun në Transilvani, Banat dhe Hungari, Asambleja Kombëtare vendos që të krijojë Konventën e Madhe Kombëtare Rumune, e cila do të ketë të gjitha të drejtat për të përfaqësuar kombin rumun kurdoherë dhe në çdo vend, në marrëdhëniet me të gjitha kombet e tjera të botës, si dhe të marrë çdo lloj vendimi të rëndësishëm që është në interes të kombit.

http://www.cimec.ro/Istorie/Unire/rezo_eng.htm



Cilat janë propozimet që kanë të bëjnë me pakicat kombëtare në shtetin rumun?

Si mendoni, përse rumunët i përfshinë këto pohime në deklaratën e tyre të bashkimit të Rumanisë?

I-42. Fjala e Juliu Maniut në Asamblenë Kombëtare Rumune të Alba-Julias (1918)

Për heqjen e çdo dyshimi të mundshëm që të huajt mund të kenë krijuar, lidhur me synimet tona pas bashkimit dhe çlirimit kombëtar, Këshilli i Madh Kombëtar Rumun deklaroi se ai nuk dëshiron që të krijojë ndonjë perandori shtypëse. Ne nuk duam që nga të shtypur, të shndërrohemi në shtypës. Ne duam të garantojmë liri për të gjithë, si dhe zhvillim për çdo popull me të cilin jetojmë së bashku. Këshilli i Madh Kombëtar Rumun këmbëngul për zbatimin e thënies sonë të vjetër: "Mos u shkakto të tjerëve atë që nuk dëshiron as për veten tënde." Ne dëshirojmë që në trojet e Rumanisë së Madhe, liria kombëtare të mbizotërojë për të gjithë. Ne dëshirojmë që çdo komb të lëvrojë gjuhën e vet, t'i lutet Zotit sipas

besimit të vet, dhe të kërkojë drejtësi në gjuhën e vet.

Ne që kemi derdhur lot, tek shihnim sesi gjuha jonë hiqej prej shkollave, kishave ose sistemit të drejtësisë, nuk do t'ua heqim atë të tjerëve. Ne nuk dëshirojmë që të jetojmë me djersën e të tjerëve, sepse mund të jetojmë nëpërmjet punës sonë dhe me forcat tona. [duartrokitje] Vetëm përmes rendit demokratik ne mund ta fuqizojmë atdheun tonë rumun, duke pasur parasysh nevojat që ka një shtet modern. Vetëm duke garantuar një sistem të drejtash dhe lirish brenda vendit, atëherë do të mund t'i japim vlerë çështjes sonë në mbarë botën.

Murgescu, f. 284.



Juliu Maniu (1873-1953) gjatë periudhës së sundimit austro-hungarez ka qenë një nga udhëheqësit kryesorë të lëvizjes kombëtare rumune në Transilvani. Ai mbështeti bashkimin me Rumaninë dhe u bë president i Këshillit të Madh Kombëtar, që e administroi Transilvaninë deri në përfshirjen e saj të plotë brenda Rumanisë së Madhe. Gjatë periudhës ndërmjet dy luftërave, Maniu u bë kryetar i Partisë Kombëtare të Fshatarëve, si dhe kryeministër (1928-1930, 1932-1933). Ai ishte mbrojtës i vlerave demokratike, kundër diktaturave të ndryshme që u vendosën në Rumania pas vitit 1938; vdiq në njërin prej burgjeve komuniste.

Në diskutimin e Maniut pasqyrohen ndjenjat e entuziazmit dhe të bujarisë së lëvizjes për krijimin e një shteti kombëtar të vërtetë, në fund të Luftës I Botërore. Por pavarësisht nga kjo, fryma e fjalimit të tij, megjithëse u përfshi në rezolutën e Asamblesë së Madhe Kombëtare, nuk gjeti mbështetje tek të gjithë politikanët rumunë. Fatkeqësisht, politikat konkrete ndaj pakicave kombëtare në Rumaninë e periudhës midis dy luftërave, ishin shumë larg standardeve që Maniu u përpoq të vendoste në vitin 1918.



Bëni krahasimin midis dokumenteve I-41 dhe I-42. Cilat janë ndryshimet ndërmjet një fjalimi dhe një vendimi zyrtar?



I-43. Propozim për organizimin e një shteti maqedonas me administrim kantonik, sipas modelit zviceran (1919)

[...] Çdo ndërgjegje e pastër dhe çdo shpirt i trazuar për të ardhmen e njerëzimit kërkon respektimin e të drejtës për vetëvendosje të çdo populli. Ne, maqedonasit, kërkojmë që ky rregull të respektohet edhe për Maqedoninë. Populli ynë zotëron të gjitha aftësitë e nevojshme për vetëqeverisje, sepse ai nuk përbëhet as nga një masë pa formë, dhe as nga ndonjë komunitet i pandërgjegjësuar, sikundër u intereson disa autorëve të na paraqesin. Përkundrazi, prapa kësaj pamjeje kaosi qëndron një unitet shpirtëror, i cili mbështetet në disa lidhje të forta psikologjike, siç janë kryengritjet masive dhe të vazhdueshme, ose vuajtjet dhe dhembjet e përbashkëta nën të njëjtën zgjedhë. Petku përbashkues i këtij uniteti shpirtëror është pikërisht përpjekja eprorë e mbarë popullit për pavarësinë e Maqedonisë, duke krijuar gjithmonë heronj, apostuj dhe dëshmorë.

Ne e shpallim hapur të drejtën tonë për të jetuar, duke e theksuar për të fundit herë vullnetin e shumicës dërrmuese të maqedonasve si vijon: Maqedoni e pavarur, me administrim kantonik sipas modelit të Zvicrës demokratike dhe nën protektoratin e njëjës prej fuqive pa lidhje interesash, Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Për cilindo që e njeh Maqedoninë dhe oreksin e shteteve ballkanike, nuk do të jetë e vështirë që të kuptojë se nëpërmjet kësaj, ne synojmë që të arrijmë katër objektiva:

Njohja e Maqedonisë si shtet i pavarur do ta shuajë njëherë e përgjithmonë konfliktin ndërmjet shteteve ballkanike, pasi populli maqedonas do të pushojë së qeni objekt shkëmbimi për fqinjët e tij.

Administrimi kantonik sipas modelit të demokracisë zvicerane që ne propozojmë të zbatojmë në vendin tonë, do të sigurojë për të gjitha pakicat kombëtare një barazi të përkryer të zhvillimit të tyre ekonomik dhe shpirtëror, pavarësisht nga ndryshimet në gjuhë ose në besimin fetar. Sigurimi i protektoratit të Maqedonisë përmes njëjës prej Fuqive të Mëdha, është mjaft i nevojshëm, për të ndalur në të ardhmen intrigat nga diplomacitë e korruptuara të shteteve ballkanike.

Pas shpalljes së lirë dhe të pavarur, në rradhë të parë falë pozicionit të saj të shkëlqyer gjeografik, Maqedonia do të luajë një rol përbashkues midis shteteve të Ballkanit, do t'u mundësojë që të takohen pa mbajtur armë në duar, si dhe do të ndihmojë për krijimin e një konfederate ballkanike. Lozanë, qershor 1919
Këshilli i Përgjithshëm i Shoqatave Maqedonase në Zvicër

Odbrani, f. 900-901.



Gjeni argumentet e përdorura nga autorët për mbështetjen e idesë së një shteti të pavarur maqedonas. Komentoni argumentet për zbatimin e modelit zviceran në shtetin maqedonas. A mendoni se këto ishin të përshtatshme për situatën historike në fund të Luftës I Botërore? Nëse do të ishit anëtar i Shoqatës Maqedonase, ju vetë, çfarë zgjidhje do të kishit sugjeruar?

I-44. Marrëveshja e Zyrihut për Qipron ndërmjet Greqisë dhe Turqisë (1959)

1. Shteti i Qipros do të jetë republikë presidenciale, ku presidenti do të jetë grek, ndërsa zëvendës-presidenti turk, dhe ku secili do të zgjidhet me votim në komunitetin përkatës të ishullit, pra në atë grek dhe turk.

2. Gjuhët zyrtare të Republikës së Qipros do të jenë greqishtja dhe turqishtja. Të gjitha dokumentet dhe instrumentet legjislative dhe administrative do të hartohen dhe shpallen në të dyja gjuhët.

3. Republika e Qipros do të ketë flamurin e saj, me një model dhe ngjyrë asnjëse, të zgjedhur bashkërisht nga presidenti dhe zëvendës-presidenti i Republikës.

Autoritetet dhe komunitetet do të kenë të drejtë që të valëvisin flamurët grekë dhe turq gjatë ditëve festive, bashkë me flamurin qipriot.

Komunitetet greke dhe turke do të kenë të drejtë që të festojnë festat kombëtare greke dhe turke. [...]

5. Autoriteti ekzekutiv do të ushtrohet nga presidenti dhe zëvendës-presidenti. Për këtë qëllim, ata do të kenë ndihmën e një këshilli ministrash, i cili do të përbëhet nga shtatë ministra grekë dhe nga tre ministra turq [...]

6. Autoriteti legjislativ do të ushtrohet nga parlamenti, i cili do të zgjidhet për një periudhë 5-vjeçare nga secili komunitet veçan, ku grekët do të kenë 70 për qind të tij, ndërsa turqit 30 për qind. Një ndarje e tillë e përpjeshtme është e përcaktuar pavarësisht nga të dhënat statistikore [...]

11. Shërbimi Civil do të përbëhet 70 për qind nga grekët dhe 30 për qind nga turqit.

Një ndarje e tillë sasiore do të zbatohet për sa është e mundshme, në të gjitha nivelet e Shërbimit Civil. Në ato zona ose lokalitete ku njëri prej këtyre dy komuniteteve përbën një shumicë afër njëqindpërqindshit, organet e administratës vendore do të përbëhen vetëm nga zyrtarë të atij komuniteti [...]

18. Presidenti dhe zëvendës-presidenti i Republikës do të ushtrojnë të drejtën e posaçme të faljes për individët që janë dënuar me vdekje, gjithsecili për komunitetin e tij përkatës. Në ato raste kur pala paditëse dhe personat e dënuar janë nga komunitete të ndryshme, e drejta e faljes do të ushtrohet vetëm nëse arrihet një marrëveshje midis presidentit dhe zëvendës-presidentit. Në rastin e mosmarrëveshjeve, ai që do të mbizotërojë, do të jetë vendimi i mëshirës. Pas dhënies së mëshirës, dënimi me vdekje do të ndryshohet në burgim të përjetshëm.

19. Në rastin e reformës agrare, tokat do t'u rishpërndahen vetëm personave që janë nga i njëjti komunitet me pronarët e shpronësuar. [...]

21. Midis Republikës së Qipros, Greqisë, Mbretërisë së Bashkuar dhe Turqisë do të nënshkruhet një marrëveshje e cila garanton pavarësinë, integritetin territorial dhe kushtetutën e shtetit të ri të Qipros. Gjithashtu, midis Republikës së Qipros, Greqisë dhe Turqisë do të nënshkruhet edhe një traktat aleance ushtarake. Të dyja këto instrumente do të kenë fuqi kushtetuese. (Paragrafi i fundit do të përfshihet në kushtetutë si një nen themelor.)

22. Pranohet se përjashtohet mundësia e bashkimit tërësor ose të pjesshëm të Qipros me ndonjë shtet tjetër, ose pavarësia e ndarë e Qipros (pra ndarja e Qipros në dy shtete të pavarura). [...]

24. Qeveria greke dhe ajo turke kanë të drejtë që të financojnë institucionet e arsimit, kulturës, atletikës dhe të bamirësisë, të cilat u përkasin komuniteteve të tyre respektive.

Në rastet kur secili komunitet mendon se nuk ka numrin e nevojshëm të mësuesve të shkollave, profesorëve ose priftërinjve për të siguruar mbarëvajtjen e institucioneve të tij, atëherë qeveria greke dhe ajo turke mund të ofrojnë vetëm numrin e domosdoshëm për plotësimin e nevojave përkatëse. [...]

26. Shteti i ri që do të marrë jetë me firmosjen e traktateve, do të ngrihet sa më shpejt të jetë e mundur dhe brenda një periudhe jo më vonë se 3-mujore pas firmosjes së traktateve.

27. Të gjitha pikat e lartpërmendura do të shqyrtohen për t'u bërë nene bazë për Kushtetutën e Qipros.

<http://www.kibris.gen.tr/english/photos/documents/zurich02.html>



Në vitet 1950, qipriotët grekë e përforcuan lëvizjen çlirimtare kundër sundimit britanik, i cili ishte vendosur që në vitin 1878. Veprimtaria guerile, e filluar nga EOKA¹⁶ (e mbështetur jozyrtarisht nga Greqia), arriti që ta minonte sundimin britanik. Por pavarësisht nga kjo, qipriotët turq (të mbështetur nga Turqia) e kundërshtuan idenë e bashkimit me Greqinë dhe kërkuan ndarjen e Qipros. Në përfundim, kryeministri grek, Kostantin Karamanlis dhe ai turk, Adnan Menderes, arritën që të bënin një marrëveshje kompromisi në Zyrih, më 11 shkurt të 1959-s, në të cilën u vendosën parimet se si do të funksiononte shteti i pavarur i Qipros. Më vonë, miratimi i kushtetutës dhe i disa traktateve të tjera, të cilat siguruan disa baza ushtarake për Britaninë, si dhe të drejtën e ndërhyrjes për Greqinë dhe Turqinë (Traktati i Krijimit & Traktati i Garantimit) i dhanë Qipros mundësinë që të shpallej si shtet i pavarur më 19 gusht të vitit 1960.



Ç'mendoni për nenet e veçanta që lidhen me përfaqësimin politik të të dy komuniteteve? A dini ndonjë shembull tjetër historik me një sistem politik të ngjashëm?

I-45. Franjo Tugjman argumenton të drejtën e çdo kombi për të patur shtetin e vet (1982)

Asnjë komb nuk mund të heqë dorë nga interesat dhe synimet e tij, sepse kjo do të thotë që të heqësh dorë nga vetë jeta. Për më tepër, kombet nuk lejohen që të bëjnë vetëvrasje, dhe as vrasja e tyre fshehurazi

¹⁶ Ethniki Organosis Kyprion Agoniston (Organizata Kombëtare e Luftëtarëve Qipriotë). Shih pjesët IV-6 dhe IV-11.

nuk është e mundur: xhelati ose ekzekutuesi i krimit, gjithmonë njihet mirë në histori. Kombet janë qeliza të pazëvendësueshme për bashkësinë njerëzore ose për ekzistencën e vetë botës. Një fakt i tillë nuk mund të vihet në pikëpyetje. Kjo është arsyeja përse lufta për mbijetesë kombëtare, për vetëvendosje dhe për lirinë e kombit – nuk është dhe nuk mund të quhet krim. [...] Çdo komb, pavarësisht sa i madh ose sa i vogël është, ka të drejtën natyrore dhe historike të ketë vendin dhe sovranitetin e tij në bashkësinë njerëzore, po ashtu siç ka edhe njeriu vendin e tij në shoqëri [...]

Za Hrvatsku, f. 218.



Franjo Tugjman (1922-1999) ishte historian dhe politikan, anëtar i lëvizjes komuniste për rezistencë gjatë Luftës II Botërore, dhe më vonë një administrator komunist që u akuzua nga Titoja për shfaqje të nacionalizmit kroat. Tugjman kaloi shumë vite në burg dhe në fund u zgjodh president i Republikës Kroate (1990-1999).



Si e argumenton Tugjmani të drejtën dhe nevojën e çdo kombi për të patur “lirinë e tij kombëtare”? Sipas tij, a është e mundur që njerëzimi të ekzistojë pa kombet? Cili është mendimi juaj për këtë çështje? Bëni krahasimin e këtij teksti me pjesët I-5, I-6, I-7, I-16 dhe I-23. Gjeni argumentet e përbashkëta që janë përdorur në secilin prej tyre.

I-46. Deklarata e Pavarësisë së Kosovës

A. Vendim i Kuvendit të Kosovës

Kuvendi i Kosovës
Miraton

DEKLARATA E PAVARËSISË SË KOSOVËS

1. Ne, udhëheqësit e popullit tonë, të zgjedhur në mënyrë demokratike, nëpërmjet kësaj *Deklarate* shpallim Kosovën shtet të pavarur dhe sovran. Kjo shpallje pasqyron vullnetin e popullit tonë dhe është në pajtueshmëri të plotë me rekomandimet e të *Dërguarit Special të Kombeve të Bashkuara, Martti Ahtisaari, dhe Propozimin e tij Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës.*

2. Ne shpallim Kosovën republikë demokratike, laike dhe multietnike, të udhëhequr nga parimet e jodiskriminimit dhe mbrojtjes së barabartë sipas ligjit. Ne do të mbrojmë dhe promovojmë të drejtat e të gjitha komuniteteve në Kosovë dhe do të krijojmë kushtet e nevojshme për pjesëmarrjen e tyre efektive në proceset politike dhe vendimmarrëse.
10. Kosova shpall zotimin e saj ndaj paqes dhe stabilitetit në rajonin tonë të Europës Juglindore. Pavarësia jonë e sjell në fund procesin e shpërbërjes së dhunshme të Jugosllavisë. Gjersa ky proces ka qenë i dhëmbshëm, ne do të punojmë pa pushim për t'i kontribuar një pajtimi që do të lejonte Europën Juglindore të shkojë përtej konflikteve të së kaluarës dhe të farkojë lidhje të reja rajonale të bashkëpunimit. Për këtë arsye, do të punojmë së bashku me fqinjët tanë për të avancuar të ardhmen tonë të përbashkët europiane.
11. Ne shprehim, në veçanti, dëshirën tonë për të vendosur marrëdhënie të mira me të gjithë fqinjët tanë, përfshirë Republikën e Serbisë, me të cilën kemi marrëdhënie historike, tregtare dhe shoqërore, të cilat synojmë t'i zhvillojmë më tej në të ardhmen e afërt. Ne do të vazhdojmë përpjekjet tona për t'i kontribuar marrëdhënieve të fqinjësisë dhe bashkëpunimit me Republikën e Serbisë duke promovuar pajtimin ndërmjet popujve.

D- 001

Prishtinë, 17 shkurt 2008
Kryetari i Kuvendit të Kosovës
Jakup KRASNIQI

<http://www.assembly-kosova.org/?krye=news&newsid=1635&lang=en> – aksesuar 10.10.2008

B. Vendim i Kuvendit të Serbisë

Në seancën e parë të Sesionit të Parë të Jashtëzakonshëm, më 18 shkurt 2008, Kuvendi Kombëtar i Republikës së Serbisë miratoi një Vendim që konfirmon Vendimin e Qeverisë së Republikës së Serbisë mbi “anullimin e akteve të jashtëligjshme të institucioneve vetëqeverisëse provizore të Kosovës dhe Metohisë, lidhur me deklaratën e tyre të pavarësisë së njëanshme”.

1. Vendimet dhe veprimet e Institucioneve Vetëqeverisëse Provizore të Kosovës dhe Metohisë për shpalljen e njëanshme të pavarësisë anulohen, sepse ato shkelin sovranitetin dhe integritetin terriotorial të Republikës së Serbisë që garantohet nga Kushtetuta e Republikës së Serbisë, nga Karta e Kombeve të Bashkuara, Rezoluta e Këshillit të Sigurimit të OKB-së 1244 (1999), rezoluta të tjera që lidhen me të, si dhe nga ligji ndërkombëtar përkatës. Këto akte dhe veprime përbëjnë një ndarje me forcë dhe të njëanshme të një territori të Republikës së Serbisë dhe si rrjedhojë do të konsiderohen si jo ligjore dhe të pavlefshme. Këto vendime nuk do të kenë ndonjë efekt ligjor në Republikën e Serbisë ose në rendin ndërkombëtar ligjor. Ndarja e njëanshme e një territori të një shteti sovran përbën shkelje ligjore ndaj Republikës së Serbisë dhe shkelje të ligjit ndërkombëtar.
2. Qeveria e Republikës së Serbisë ri-konfirmon *Vendimin* që Provinca Autonome e Kosovës dhe Metohisë është një pjesë e pandashme e një shteti të vetëm dhe të pandashëm të Republikës së Serbisë, bazuar në Kushtetutën e Republikës së Serbisë dhe Kartës së Kombeve të Bashkuara. [...]

PC Nr. 1

Beograd, 18 shkurt 2008

KUVENDI KOMBËTAR I REPUBLIKËS SË SERBISË

www.parlament.sr.gov.rs/content/akta/akta/detalji
– aksesuar me 5 Dhjetor 2008.




Në fund të Luftës së Kosovës, më 1999, Rezoluta 1244 e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara e vuri Kosovën nën administrimin provizor të OKB-së dhe vendosi që një proces politik i ndërmjetësuar nga OKB-ja do të përcaktonte statusin e ardhshëm të Kosovës, pra, nëse ajo do të bëhej e pavarur ose do të mbetej pjesë e Serbisë. Pas shumë negociatash, i Dërguari Special i Kombeve të Bashkuara, Martti Ahtisaari, në prill të 2007-ës paraqiti në Këshillin e Sigurimit të OKB-së një paketë me propozime, në të cilën përfshiheshin masa për mbrojtjen e minoriteteve dhe një rekomandim të qartë që Kosova duhej të ishte e pavarur, dhe, për një kohë të caktuar, nën vëzhgimin ndërkombëtar. Ky propozim u pranua nga përfaqësuesit shqiptarë të Kosovës, u refuzua nga Serbia, dhe nuk u pranua të zbatohet si Rezolutë e Këshillit të Sigurimit të OKB-së, pas kundërshtimit dhe vënies së vetos të Ruisë. Një raund tjetër negociatash, i kërkuar nga Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së dhe i kryesuar nga SHBA/BE/Troika e negociatorëve ruse, u mbyll në 10 dhjetor 2007, pa arritur ndërmjet palëve një marrëveshje mbi statusin e Kosovës. Në 17 dhjetor 2008, Kuvendi i Kosovës, të cilin 11 deputetë serbë e bojkotuan, miratoi në unanimitet, me 109 deputetë pjesëmarrës deklaratën e njëanshme të pavarësisë së Kosovës. Qeveria serbe kishte lëshuar tashmë në 14 shkurt 2008, një vendim për anulimin e deklaratës së pritshme të pavarësisë së Kosovës, dhe ky vendim u konfirmua nga parlamenti serb në 18 shkurt 2008. Situata akoma nuk është përfundimisht e zgjidhur, pasi shtete të ndryshme kanë opinione të ndryshme nëse duhet ta përkrahin pavarësinë e Kosovës ose jo. Shtetet e Bashkuara, pjesa më e madhe e vendeve të Bashkimit Europian dhe disa shtete të tjera e kanë njohur pavarësinë e Kosovës, por ka shtete të tjera që e kanë refuzuar njohjen e tij. Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara ka miratuar në tetor 2008 kërkesën serbe për një opinion këshillues nga ana e Gjykatës Ndërkombëtare, nëse shpallja e njëanshme e pavarësisë së Kosovës është në përputhje me ligjin ndërkombëtar.



Përpiquni të jepni tri argumente në favor të pavarësisë së Kosovës, dhe tri argumente në favor të idesë që Kosova të mbetet pjesë e Serbisë.

Cili ka qenë pozicioni i vendit tuaj në lidhje me pavarësinë e Kosovës? Cilat ishin arsyet për këtë? Cili ishte pozicioni i Bashkimit Europian në lidhje me pavarësinë e Kosovës? Çfarë dini ju rreth *Përfaqësuesit Ndërkombëtarë Civile për Kosovën*?

REZULTATET E LUFTËS I BOTËRORE, 1918-1929



KAPITULLI II: Organizimi i shtetit kombëtar

Shtetet e reja kombëtare në Europën Juglindore janë përballur me probleme mjaft serioze, të cilat kanë qenë të përbashkëta për shumicën e tyre. Sigurisht që i pari ndër to ka qenë përcaktimi i strukturave dhe i mekanizmave të reja të këtyre shteteve. Shpeshherë, kushtetutat kanë luajtur rol thelbësor në këtë proces, por përveç kuadrit ligjor, mjaft e ndërlikuar është shfaqur edhe çështja për ngritjen konkrete të institucioneve. Elitat e reja politike, bënë përpjekje për të gërshetuar në praktikë modelet perëndimore me traditat dhe interesat vendore/kombëtare. Pavarësisht nga përpjekjet e republikanëve gjatë gjithë shekullit të 19-të, të gjitha shtetet e reja të Europës Juglindore u bënë monarki, disa prej të cilave sundoheshin nga princa të vendit (Mali i Zi dhe Serbia), ndërsa të tjerat nga princa me origjinë perëndimore (Greqia, Rumania, Bullgaria dhe Shqipëria). Vetëm pas Luftës I Botërore, ky model arriti të ndryshohej dhe shtetet e reja kombëtare, së bashku me disa shtete të tjera të vjetra, zgjodhën (ose u detyruan që të zgjidhnin) formën republikane të qeverisjes. Vendosja e një sistemi politik kushtetues, shumëpartiak dhe kryesisht demokratik, në të vërtetë doli se ishte një proces mjaft i vështirë dhe shpeshherë i ndërlikuar, i cili frenohej nga ngurtësia shoqërore, nga prapambetja ekonomike dhe kulturore, si dhe nga traditat dhe zakonet autoritariste.

Çështja e përcaktimit të nënshtetësisë ka qenë ajo më e ndjeshmja. Shtetet-kombe të reja nuk kishin një përbërje homogjene as në aspektin etnik, dhe as në atë fetar. Përveç kësaj, bota moderne prodhonte një lëvizje të konsiderueshme të njerëzve përmes kufijve, duke e shtuar kështu larminë e popullsisë. Paragjykimet dhe interesat e ndryshme krijonin mekanizma përfshirës/përrjashtues, të cilët shkonin që nga përcaktimi i kufijve zyrtarë, e deri në mënyrat praktike të diskriminimit. Në një mjedis të tillë, padyshim që zhvillimet ishin mjaft të ndërlikuara; kështu, procesi i dhënies së të drejtave të plota pakicave fetare dhe etnike, shpeshherë me detyrimin e fuqive të mëdha, shoqërohej me shfaqje ndjenjash ksenofobie, me përplasje të dhunshme, si dhe me vuajtje, sidomos gjatë çasteve të krizave.

Shtetet e reja kombëtare kanë qenë mjaft të brishta dhe të cënueshme. Me qëllim që të mbijetonin, atyre iu desh të ngrinin institucione funksionale, si dhe t'i modernizonin ato. Kjo përfshinte ngritjen e një administrate të efektshme dhe të një sistemi ushtarak të besueshëm, njësimin e ligjeve dhe të masave të tjera, ristrukturimin e kishës mbi baza kombëtare, si dhe ndërtimin e hekurudhave. Ndërtimi i kombit nuk ishte i kufizuar vetëm tek institucionet dhe infrastruktura. Ai nënkuptonte edhe zhvillimin kulturor. Arsimiti i përgjithshëm, institucionet diturore dhe mjetet e tjera të komunikimit kulturor e ndryshuan mendësinë e njerëzve, i legjitimuan sistemet e reja politike dhe i bënë individët dhe grupet shoqërore ta identifikonin veten me shtetet e reja kombëtare.

Ila. Aspekte të përgjithshme të organizimit të shtetit

II-1. Projekt i kushtetutës së hartuar nga Rigas Veletinlisi (1797)

Mbi Republikën

Neni 1. REPUBLIKA HELENIKE¹⁷ është një e tërë e bashkuar, që përfshin raca dhe besime fetare

të ndryshme; ajo nuk i shikon dallimet ndërmjet besimeve fetare me sy armiqësor; ajo është e pandashme, sepse të gjithë lumenjtë dhe të gjitha detet që veçojnë rajonet e saj nga njëri-tjetri janë të lidhur ngushtë, porsì një trup i vetëm.

¹⁷ Fjalën "helenike" po e përdorim në vend të fjalës "greke", sepse sipas Rigasit, ky term nuk i referohet shtetit të grekëve, por një shteti të frymëzuar nga idealet politike klasike. Përveç kësaj, në shkrimet e tij Rigasi ka përdorur termat "helen" dhe "Eladhë", por jo termat "grek" dhe "Greqi" ose "Romioi", siç kanë bërë dijetarët e tjerë të po asaj periudhe (shih p.sh. tekstet I-4 dhe I-7).

Mbi ndarjen e popullsisë

Neni 2. POPULLI HELEN, pra të gjithë banorët e këtij shteti, pavarësisht nga gjuha dhe besimi fetar, për ushtrimin e pushtetit ndahen në asamble të veçanta për secilin autoritet vendor; kjo do të thotë se ata mblidhen në çdo krahinë, për të shprehur mendimet e tyre për çdo problem. [...]

Mbi nënshtetësinë

Neni 4. Çdo person mbi moshën 21 vjeç, i cili ka lindur dhe jeton nën këtë sovranitet, konsiderohet nënshtetas.

- Çdo i huaj mbi moshën 21 vjeç, që ka jetuar në këtë shtet prej një viti dhe që jeton me punën e vet, është nënshtetas. [...]

- Cilido që zotëron gjuhën e folur, ose atë [të vjetër] helene dhe që mbështet Eladhën, edhe nëse jeton në anën tjetër të botës (meqë fara helene është shpërndarë në të dyja anët e botës), është helen dhe nënshtetas.

- Cilido që është i krishterë dhe nuk zotëron gjuhën e folur, ose atë [të vjetër] helene, por vetëm mbështet Eladhën, është nënshtetas.

- Së fundi, çdo i huaj për të cilin administrata beson se do të jetë një banor i vlefshëm i atdheut, për shembull një zanatçi i aftë, një mësues i zellshëm, ose një patriot i merituar, është i mirëpritur në atdhe dhe gëzon të drejta të barabarta si gjithë nënshtetasit e tjerë.

Rigas f. 45-47.



Këto janë pjesë të shkëputura nga Kushtetuta e hartuar në vitin 1797 nga Rigas Velestinli (1757-1798), njëri prej përfaqësuesve më të shquar të Iluminizmit grek. I ndikuar nga Kushtetuta revolucionare franceze e vitit 1793, ai i përcaktoi si nënshtetas grekë të gjithë ata që jetojnë në republikë, pavarësisht nga besimi ose gjuha e tyre, dhe që mblidhen për të vendosur mbi çështjet e përbashkëta. Rigasi u arrestua nga policia austriake, u akuzua për "komplot" dhe më pas u dorëzua tek autoritetet turke, të cilat e ekzekutuan në Beograd, në qershor të vitit 1798.



Cilët persona duhet të ishin nënshtetas të Republikës Helenike, sipas autorit?

Cila është lidhja midis nënshtetësisë së grekëve që jetojnë në Greqi, dhe atyre që jetojnë jashtë shtetit? Çfarë të drejtash dhe detyrimesh janë përcaktuar për të huajt? Diskutoni për marrëdhënien ndërmjet nënshtetësisë dhe fesë, sikundër paraqitet në projektin e kushtetutës. Cilat elemente e kanë marrë frymëzimin nga Revolucioni Francez? Bëni krahasimin e këtij teksti me zhvillimet e mëvonshme, të paraqitura tek II-13 dhe II-14.

II-2. Fjalimi i Bozha Grujeviçit në sesionin e parë të Këshillit Serb (1805)

[...] Ne duhet të vendosim dhe të ngulitim mirë në Serbi këto dy parime: arsyen dhe drejtësinë, si dhe t'i konsolidojmë ato me të gjitha forcat tona, në mënyrë që çdo forcë dhe pushtet të udhëhiqet prej tyre. Ky ligj i mençur dhe i drejtë duhet të bëhet udhëheqësi dhe sundimtari ynë. Ai duhet që të prijë udhëheqësit, vojevodët¹⁸, këshillin, klerikët, peshkopët dhe cilindo tjetër, i madh apo i vogël qoftë. Është pikërisht ai që do të na mbrojë dhe do të na sigurojë lirinë.

Atje ku kushtetuta është e mirë, pra atje ku ligjet kanë një mbështetje të fortë dhe ku qeveria është ndërtuar mbi bazën e ligjit, ka edhe liri, ndërsa atje ku një ose disa persona drejtojnë në mënyrë arbitrare, nuk zbatojnë ligjin dhe bëjnë çfarë të duan, atje shteti vdes, dhe nuk ka as liri, as siguri, e as mirëqenie, por mbizotëron paligjshmëria dhe banditizmi, ndonëse me një tjetër emër. [...]

Gjithsecili, madje edhe një foshnje ende e palindur, duhet që të kërkojë nga sundimtari, së pari, sigurinë e jetës, së dyti, të pronës, dhe së treti, të nderit; dhe nëse sundimtari nuk dëshiron ose nuk mundet që t'u garantojë atyre jetën, pasurinë dhe nderin, atëherë ai nuk meriton që të jetë sundimtar.

Detyrimi i dytë i sundimtarit është t'i çlirojë ata që ende nuk janë të lirë, si dhe të jetë dorëzanë për lirinë e vendit, sepse jeta është dyfish më e dashur

¹⁸ Drejtues ushtarak, i cili ka ushtruar edhe detyra të pushtetit vendor gjatë periudhës së kryengritjes serbe.

dhe më e ëmbël në liri. Liria është ajo që na dallon nga kafshët, dhe një skllav jeton më keq se kafsha, sepse privohet nga ajo që e bën të ndihet njeri. Më mirë të mos rrosh, sesa të jesh nën skllavëri. Liria... është ajo që na bën njerëz; ushtarëve ua jep forcën liria, ndërsa vojvodëve dhe guvernatorëve u jep zgjuarsë dhe gjykim të drejtë... Në një vend të lirë, të mbjellat janë më të bollshme, gjëja e gjallë rritet më e shëndetshme, buka është më e shijshme, dhe vera më e mirë. Me një fjalë, atje ku s'ka liri, nuk ka as jetë."

Memoari, f. 295-297.



Bozha Grujeviçi (Teodor Filipoviçi) ishte serb nga Hungaria, i cili ishte vendosur në Rusi, ku punoi edhe si profesor universiteti në Harkov. Në vjeshtën e vitit 1804, ai u bashkua me delegacionin e serbëve kryengritës, të cilët shkuan në Shën Peterburg për të kërkuar ndihmë dhe mbështetje nga Rusia. Në mars 1805, ai mbërriti në Serbi, ku mori pjesë në formimin e qeverisë dhe në krijimin e institucioneve të para të shtetit të ri, duke u bërë edhe anëtar i Këshillit (qeverisë së parë).



Çfarë synonte që të përçonte autori përmes fjalimit të tij? Cili është mendimi juaj për shprehjen e fundit?

II-3. Letra e Vuk Karaxhiçit, drejtuar princit Millosh Obrenoviç (1832)

Zemun, 24 prill 1832
I nderuar,
Zoti ynë i dashur! [...]

Është e vërtetë që të parët tanë dikur thoshin se askush s'mund të jetë i mirë me të gjithë; por me sjelljen e deritanishme të Madhërisë Suaj, mund të thuhet se askush nuk ka mbetur i kënaqur. Një analizë e mëtejshme nxjerr si më të pakënaqur ata nëpunës civilë të cilët ndodhen më pranë Jush, ndërkohë që më të kënaqurit janë ata që Lartmadhëria Juaj nuk i ka takuar asnjëherë. [...] Arsyet e kësaj pakënaqësie mund të grupohen

praktikisht në dy kategori kryesore. Njerëzit janë të pakënaqur: ose ngaqë nuk jetojnë dot sipas dëshirës dhe mundësive të tyre dhe askush nuk është i sigurtë për jetën dhe nderin e tij, duke mos u ndjerë as zot i pronës që e ka fituar me drejtësi dhe me përpjekje; ose ngaqë ende nuk është bërë aq sa duhet për mirëqenien e përgjithshme, të paktën jo në mënyrën që duhet dhe që mund të ishte bërë (ky është mendimi i tyre). [...]

Fillimisht dua të përmend atë rregull, sipas së cilit mund të gjykohet për çdo gjë tjetër, *se përfitim i vërtetë për çdo sundimtar quhet vetëm ajo çka është e dobishme për popullin e tij; ndërsa gjithçka që është e dëmshme për popullin e tij, nuk mund të jetë ndonjë përfitim i vërtetë për të. [...]*

1) E para gjë që duhet bërë, është t'u jepet njerëzve drejtësia, ose siç njihet tashmë në Europë, *Kushtetuta*. Këtu nuk e kam fjalën as për Kushtetutën franceze, as angleze dhe as Kushtetutën e re greke; por që ajo të përcaktojë një formë qeverisjeje, dhe që qeveria të jetë e emëruar [...] që jeta, pasuria dhe nderi t'i garantohen gjithsecilit; që secili të bëjë punën e vet sipas dëshirës, në rast se ajo nuk dëmton dikë tjetër, si dhe të jetojë ashtu siç dëshiron vetë; se çdo njeri e di atë që duhet të bëjë dhe se nuk duhet t'ju druhet as juve dhe as ndokujt tjetër [...]. Mendoj se sundimtari i cili mban njerëz, ushtarë dhe roje që ta ruajnë nga populli i tij, është një sundimtar i keq. Mbrojtja më e mirë për një sundimtar në vendin e tij duhet të jetë dashuria e popullit. Populli duhet të jetë i kënaqur nga sundimi dhe i bindur se nëse sundimtari vdes për popullin do të jetë më keq dhe në asnjë mënyrë më mirë. [...]

a) Në Serbi, sot nuk ekziston një qeveri me kuptimin e plotë të fjalës, por qeveria jeni vetë Ju: kur ju ndodheni në Kragujevac, qeveria është në Kragujevac; kur ju ndodheni në Pozharevac, qeveria është në Pozharevac; kur ju ndodheni në Topçider, ajo është në Topçider; kur ju ndodheni larg, edhe ajo është larg; dhe nëse Ju, larg qoftë, një ditë do të vdisni (gjë që do të ndodhë njëherë), gjithashtu do të vdesë dhe qeveria, e më pas pushtetin do ta marrë më i forti [...]

b) Nëse qeveria do të formohet në Serbi, atëherë Serbia do të fitojë respektin e duhur midis shteteve dhe njerëzve të thjeshtë, sepse qeveria, së pari, do ta mendojë mirë atë që do të pretojë ose do të bëjë, dhe sapo të pretojë ose të bëjë diçka, ajo do t'i qëndrojë asaj pa e ndryshuar, ashtu siç thuhet edhe

në përrallën ku “fjala e Perandorit nuk bëhet dysh” [...]

c) Edhe sundimtari më i zgjuar, madje sikur ta kishte kaluar tërë rininë e tij duke mësuar se si të qeverisë, nuk mundet dhe nuk duhet që ta udhëheqë vendin i vetëm, së pari, sepse është e vështirë që një njeri i vetëm t’i drejtojë punët siç duhet, qofshin edhe ato të një fshati të vogël, e jo më të një populli ose një shteti të tërë; së dyti, sepse “katër sy shohin më mirë sesa dy”; dhe së treti, sepse edhe sundimtari më i mençur dhe më i ditur, përsëri vazhdon të mbetet njeri, i ndjeshëm ndaj pasioneve dhe dobësive njerëzore, e për pasojë, mund t’i bëjë dikujt diçka të keqe, për shkak të zemërimit ose ndonjë emocioni tjetër të fortë [...]

3) Është e domosdoshme ngritja e *shkollave*. Sipas mendimit tim, mungesa më e madhe dhe nevoja më e ngutshme që ka Serbia sot është përgatitja e njerëzve të aftë për shërbimin publik [...].

Karadžić, f. 652-666.



Në vitet 1830, një numër i madh intelektualësh dhe politikanësh serbë nuk ishin dakord me regjimin despotik të Millosh Obrenoviçit (1780-1860, princ gjatë periudhave 1815-1839 dhe 1858-1860). Një prej mendimeve më autoritare të kohës u dha nga Vuk Karaxhiçi (1787-1864), i cili ishte figura qendrore e kulturës kombëtare serbe në shekullin e 19-të. Duke qenë gjuhëtar, etnolog dhe historian tepër aktiv, ai botoi Fjalorin dhe Gramatikën e parë të gjuhës së sotme serbe, mblodhi dhe botoi poezi folklorike, epike dhe lirike, si dhe përktheu Dhiatën e Re nga sllavishtja e vjetër, në gjuhën serbe. Gjatë shkruarit të këtij dokumenti, Vuk Karaxhiçi ishte edhe kryetari i parë në Gjykatën e Rrethit të Beogradit.



Përse Vuk Karaxhiçi ia dërgoi këtë letër sundimtarit të vendit? Cilat janë problemet kryesore të politikës së shtetit dhe të qeverisë, që nënvizohen nga autori?

II-4. Kushtetuta serbe e vitit 1835 – struktura e pushtetit

Neni 29. Princi serb [knjazi] duhet të jetë serb i lindur ose i natyralizuar, i besimit ortodoks lindor. Princesha [knjagina], si dhe bashkëshortet e anëtarëve të tjerë të familjes së princit duhet t’i përkasin të njëjtit besim fetar.

Neni 45. Këshilli Shtetëror Serb është pushteti më i lartë pas Princit. [...]

Neni 79. Pushteti gjyqësor në të gjithë Serbinë do të udhëhiqet në mënyrë të barabartë dhe në përputhje me kodin e ligjeve serbe, i cili do të dekretohet publikisht në një kohë sa më të shkurtër, dhe më pas do t’u ngarkohet gjykatave për t’u përdorur, si në çështjet civile, ashtu edhe në ato penale.

Neni 80. Në Serbi, në dhënien e gjykimit të tij, gjykatësi nuk varet nga askush, përveçse nga kodi i ligjeve. Asnjë autoritet tjetër, më i ulët ose më i lartë, [...] nuk ka të drejtë që ta shmangë gjykatësin nga kjo detyrë, ose ta urdhërojë atë që të japë një gjykim tjetër. [...]

Neni 82. Asambleja Kombëtare do të përbëhet nga njëqind deputetët më të ndershëm dhe më të zgjuar, të përzgjedhur me kujdes nga të gjitha krahinat e Principatës Serbe.

Jovičić, f. 48-64.

II-5. Kushtetuta rumune e vitit 1866 – dispozitat e përgjithshme

Neni 1. Mbretëria e Rumanisë, me të gjitha rajonet e saj në të djathtë të Danubit, është një shtet i tërë dhe i pandashëm.

Neni 2. Territori i Rumanisë nuk mund të tjetërsohet. Kufijtë e shtetit nuk mund të ndryshohen ose modifikohen, përveçse me anë të ligjit.

Neni 3. Territori i Rumanisë nuk mund të kolonizohet me njerëz të origjinave të huaja [...].

Neni 5. Rumunët gëzojnë lirinë e mendimit, lirinë e arsimimit, lirinë e shtypit dhe lirinë e tubimeve.

Neni 10. Në këtë shtet nuk ekziston diferencimi klasor. Të gjithë rumunët janë të barabartë përpara ligjit, duhet të paguajnë të njëjtën sasi taksash dhe të ushtrojnë të njëjtat detyra publike.

Vetëm ata mund të punojnë në poste të ndryshme publike, civile dhe ushtarake. [...] Të huajt nuk mund të punojnë në poste publike, përveçse në ato raste që janë të përcaktuara me ligj [...]

Neni 12. Në shtetin rumun, qysh sot e tutje ndalohen përfundimisht të gjitha llojet e privilegjeve, përrjashtimeve dhe monopoleve klasore.

Neni 13. Liria individuale është e garantuar [...].

Neni 21. Liria e mendimit është absolute [...].

Neni 23. Arsimimi është falas.

Neni 31. Të gjitha pushtetet shtetërore ushtrohen nga i gjithë kombi, i cili e bën këtë, veçse duke i deleguar dhe në përputhje me parimet e rregullat e përcaktuara në këtë kushtetutë.

Neni 32. Pushteti legjislativ ushtrohet bashkërisht nga mbreti dhe nga Asambleja Kombëtare e Përfaqësuesve.

Asambleja Kombëtare e Përfaqësuesve është e ndarë në dy dhoma:

Senati dhe Asambleja e deputetëve.

Çdo ligj duhet të miratohet nga të tria ndarjet përkatëse të pushtetit legjislativ.

Neni 35. Pushteti ekzekutiv ushtrohet nga mbreti, i cili e bën këtë në bazë të kushtetutës.

Neni 36. Pushteti gjyqësor ushtrohet vetëm në gjykata. Vendimet dhe dënimet e tyre jepen në përputhje me ligjin dhe zbatohen në emër të mbretit.

Neni 38. Anëtarët e të dyja asambleve përfaqësojnë të gjithë kombin, dhe jo vetëm zonën ose qytetin tek i cili janë votuar. [...]

Neni 92. Figura e mbretit është e paprekshme. Përgjegjësia bie mbi ministrat.

Asnjë dekret i mbretit nuk është i vlefshëm, në qoftë se nuk është firmosur edhe nga një ministër, i cili mban edhe përgjegjësinë për dekretin në fjalë.

Constituçioni, f. 33-41.

? Ç'vend zë kombi në organizimin e shtetit rumun?

Si u zbatua ndarja dhe baraspeshimi i pushteteve në kushtetutë?

II-6. Deklaratë e princit Nikolla, drejtuar popullit të Hercegovinës në qershor 1876

MUHAMEDANË! Ju do të jetoni të lirë në Hercegovinën e çliruar. Ligjet e saj do të zbatohen me drejtësi dhe për të gjithë njësoj. Askush nuk do të shkelë mbi të drejtën tuaj të besimit. Ju garantoj për këtë me ndershmërinë dhe dashurinë time për ju. Këto mund t'i dëshmojnë me qindra vetë të të njëjtit besim me ju, të cilët gjithmonë janë mirëpritur, janë ndihmuar dhe nderuar si vëllezër prej meje dhe vendit tim. Për këtë arsye, ju bëj thirrje juve, Muhamedanë, që të mos ngriheni me armë kundër vëllezërve tuaj të krishterë.

Princi Nikolla

Fjalime dhe deklarata të mbretit Nikolla, f.31.

II-7. Qëndrimet e osmanëve ndaj kushtetutës, sipas ambasadorit britanik në Stamboll (1876)

Fjala “kushtetutë” shqiptohej ngado, dhe softët [nxënësit e shkollave fetare myslimane], që përfaqësonin opinionin publik përparimtar të kryeqytetit, e dinin mirë se kishin edhe mbështetjen e të gjithë kombit. Si të krishterët, ashtu dhe myslimanët, nuk do t'i ndërprisnin aspak përpjekjet e tyre, derisa ta merrnin atë, dhe nëse Sulltani nuk do të pranonte që t'ua jepte, atëherë përpjekjet për rrëzimin e tij ishin të pashmangshme. Tekste të shkëputura nga Kurani që qarkullonin ngado, u provonin besimtarëve se forma e qeverisjes që sanksionohej në to ishte pikërisht demokratike, dhe se autoriteti absolutist i ushtruar nga sulltani përbënte dhunim për të drejtat e njerëzve, dhe nuk gjente mbështetje tek Ligjet e Shenjta. Si këto dy tekste, ashtu edhe të mëparshmit, synonin të tregonin se nuk i duhej bindur një Sovrani, i cili nuk i përfillte interesat e Shtetit [...]

Eliot, f. 231-232.

? Nga myslimanët e Perandorisë Osmane, a perceptohej ideja e kushtetutës si një importim nga Europa e krishterë? Përse mbështetësit e kushtetutës donin që të provonin se ajo ishte në përputhje me Ligjin e Shenjtë mysliman?

II-8. Kushtetuta osmane e vitit 1876

Perandoria osmane

Neni 1. Perandoria osmane përfshin territoret dhe zotërimet e tanishme, si dhe provincat gjysmë të varura. Ajo është një e tërë, e pandarë, nga e cila asnjë pjesë nuk mund të shkëputet, cilado qoftë arsyeja.

Neni 4. Madhëria e tij, Sulltani, i cili mban titullin “Kalifi i Lartë”, është mbrojtësi i besimit mysliman. Ai është sovrani dhe padishahu [perandori] i gjithë osmanëve.

Neni 5. Madhëria e tij, Sulltani, është i përgjegjshëm nga çdo lloj përgjegjësie; personi i tij është i shenjtë. Neni 7. Ndër të drejtat sovraane që zotëron Madhëria e Tij, Sulltani, përfshihen edhe prerogativat e mëposhtme: - Ai përcakton dhe shfuqizon emërimin e ministrave; ai jep gradat, funksionet dhe dekoratat

e urdhëruara po prej tij, si dhe miraton krerët e provincave me privilegje sipas formave që janë përcaktuar nga privilegjet e dhëna; ai pret monedhat, emri i tij shqiptohet në xhami gjatë lutjeve publike; ai lidh traktatet me fuqitë e tjera; ai shpall luftën dhe vendos paqen; ai komandon forcat tokësore dhe ato detare; ai drejton lëvizjet ushtarake; ai zbaton pikat e Sheriatit (Ligjit të Shenjtë), ashtu si dhe ato të ligjeve të tjera; ai merret me administrimin e masave publike; ai pezullon ose ndryshon dënimet e dhëna prej gjykatave penale; ai mbledh ose shtyn punimet e Asamblesë së Përgjithshme; ai shpërndan, nëse e gjykon të arsyeshme, Dhomën e Deputetëve, me kusht që ai të drejtojë edhe zgjedhjen e anëtarëve të rinj.

Liritë vetjake

Neni 8. Të gjithë nënshtetasit e perandorisë quhen osmanë, pa kurrfarë dallimi, pavarësisht nga besimi i tyre fetar; statusi i një osmani fitohet dhe humbet në përputhje me kushtet e përcaktuara në ligj.

Neni 9. Çdo osman gëzon lirinë e tij vetjake, me kusht që ajo të mos cenohet lirinë e të tjerëve. Neni 10. Liria vetjake është e paprekshme. Askush nuk mund të ndëshkohet, cilado qoftë arsyeja, përveçse në rastet e përcaktuara me ligj, si dhe në përputhje me mënyrat e përcaktuara nga ai.

Feja

Neni 11. Islami është fe shtetërore. Por, ndërkohë që zbaton këtë parim, shteti do të mbrojë edhe ushtrimin e lirë të çdo feje tjetër në perandori, si dhe do të njohë privilegjet fetare që u janë dhënë organizmave të ndryshme, me kusht që ato të mos dëmtojnë rendin publik, si dhe të mos shkelin moralitetin.

Barazia përpara ligjit, postet publike

Neni 17. Të gjithë osmanët janë të barabartë përpara ligjit. Ata kanë të drejta të barabarta, si dhe detyrime të njëjta kundrejt vendit të tyre, pavarësisht nga feja.

Neni 18. Pranimi në poste publike kushtëzohet nga njohja e gjuhës turke, e cila është dhe gjuha zyrtare e shtetit.

Neni 19. Çdo osman mund të punojë në poste publike, në përputhje me përshtatshmërinë, meritat dhe aftësitë e tij.

Prona

Neni 21. Pasuria e patundshme dhe vetjake e vënë në rrugë të ligjshme është e garantuar. Shpronësimet janë të ndaluara, përveçse në rastet e paraqitjes së një arsyeje të fortë publike, përkundrejt pagesës

paraprake, në përputhje me ligjin mbi vlerën e pronës në fjalë [...].

Asambleja e Përgjithshme

Neni 42. Asambleja e Përgjithshme përbëhet nga dy dhoma: Dhoma e Fisnikëve ose Senati, dhe Dhoma e Deputetëve.

Neni 43. Të dyja Dhomat mblidhen më 1 nëntor të çdo viti; hapja bëhet me dekret perandorak (irade), dhe mbyllja, e përcaktuar më 1 mars të vitit pasues, bëhet, gjithashtu, me dekret perandorak. Asnjëra nga të dyja Dhomat nuk mund të mblidhet pa praninë e dhomës tjetër.

Neni 47. Anëtarët e Asamblesë së Përgjithshme janë të lirë që të shprehin mendimin e tyre, si dhe të votojnë ashtu siç dëshirojnë.

Ata nuk mund të kufizohen me kushte ose premtime, dhe as të ndikohen nga kërcënimet. Ata nuk mund të ndëshkohen për opinionet ose votat e dhëna gjatë kohës së debatit, në rast se nuk janë shkelur rregullat në fuqi të Dhomës, dhe atëherë veprimet e tyre u nënshtrohen dispozitave të rregullores në fuqi.

Administrimi i provincave

Neni 108. Administrimi i provincave mbështetet në parimin e decentralizimit.

Klauzola të ndryshme

Neni 115. Asnjë nen i kushtetutës nuk mund të shfuqizohet ose të mos merret parasysht, cilado qoftë arsyeja.

www.ata.boun.edu.tr/Department%20Webapages/ATA_517/Constitution%20of%20the%20Ottoman%20Empire%201876.doc



Kushtetuta Osmane u miratua në dhjetor të vitit 1876, në kontekstin e përgjithshëm të Krizës Lindore të viteve 1875-1878. Qëllimi i saj ishte që të parandalonte ndërhyrjen e Fuqive të Mëdha, në dobi të nënshtetasve jomyslimanë të Perandorisë Osmane, duke argumentuar se kushtetuta e re moderne u siguronte atyre tashmë të drejta të plota, duke mbrojtur njëkohësisht edhe integritetin e Perandorisë Osmane. Nga ky këndvështrim, kushtetuta nuk qe e efektshme, sepse ajo nuk mundi ta pengonte Rusinë të shpallte luftën në vitin 1877. Pas humbjes, në vitin 1878, zbatimi i Kushtetutës u pezullua, për t'u rivendosur përsëri vetëm në vitin 1908; në fund të Luftës I Botërore, në kontekstin e rënies së Perandorisë Osmane, ajo pushoi së funksionuar përfundimisht.



Në ç'këndvështrim Kushtetuta Osmane e 1876-s ka ngjashmëri me kushtetutat e shteteve të ndryshme kombëtare të Europës Juglindore? Çfarë elementesh sigurie u përfshinë në tekstin e asaj Kushtetute, për të shmangur rikthimin te qeverisja autokratike? Përpiquni të kuptoni përse Kushtetuta e 1876-ës i dha islamit një rol të privilegjuar në Perandorinë Osmane. Cilat ishin nenet që kishin për qëllim ta ruanin Perandorinë Osmane nga shpërbërja e brendshme? Sa realiste ishin këto nene në kontekstin e vitit 1876?

II-9. Fjalimi i princ Nikollës, me rastin e shpalljes së Kushtetutës së Malit të Zi (1905)

Zotërinj deputetë!

Modeli i deritanishëm i qeverisjes së lartë shtetërore të këtij vendi ka qenë një lloj autokracie [*samoderzhavje*]. Si sundimtari i shtatë që Dera ime ka nxjerrë me ndihmën e Zotit, unë kam trashëguar pushtetin dhe drejtimin e asaj qeverie. Ndryshe prej monarkëve të tjerë, as paraardhësit e mi të lavdishëm, dhe as unë, nuk kemi qenë të papërgjegjshëm dhe nuk kemi menduar asnjëherë se vullneti ynë është ligj.

Në kohë paqeje, ne kemi qenë vëllezërit e vërtetë të malazezve, ne kemi marrë pjesë në të njëjtat beteja me ta, ne jemi vrarë në të njëjtin vend me ta, ne kemi duruar dhe kemi shkaktuar plagë bashkë me ta – gjatë gjithë kohëve, që nga Carev Lazi, deri tek Vuçi Do¹⁹ [...]

Qeveria jonë e nisi punën nga hiçi, mbi fusha të zhveshura dhe nën qiellin e hapur, nën vështrimin e armiqve tanë. Ajo ishte legjitime, sepse u votua nga populli dhe u drejtua me zemër, dashuri dhe energji. [...]

Në fund të shekullit të 17-të, Dera ime e gjeti atdheun tonë në kushte të mjerueshme, dhe pothuajse të përpirë nga një besim tjetër, ndërkohë që besimi ynë i shkëlqyer ortodoks gjendej në rrezik të madh. [...] Sot, kufijtë e atdheut tonë janë zgjeruar dhe janë përcaktuar ndërkombëtarisht, që nga grykëderdhja e Bunës në detin Adriatik, e deri në bashkimin e Taras dhe Pivas, që formojnë lumin Drin, dhe që nga Bijela

¹⁹ Fushëbetejat e luftërave kundër osmanëve.

Gora, e deri në Çakor, përmbi Pejë dhe Deçan. [...] Sot, Atdheu ynë po bëhet monarki kushtetuese, dhe ne fillojmë plot gëzim një jetë të re politike. Duke u ndarë nga ajo e mëparshmeja, gjatë kësaj pike kthese, unë nuk mund të mos shpreh mirënjohjen time më të thellë për paraardhësit e mi dhe tuaj, të cilët na falën lirinë dhe solidaritetin e tyre të shenjtë. [...] Vendimi im për shpalljen e kushtetutës do të mirëpritet nga të dyja palët. Ju, dhe në përgjithësi të gjithë patriotët e tjerë serbë, do ta pranojnë atë me besimin që u është ngjallur, me besimin se ajo do të sjellë mbarësi dhe suksese të mëtëjshme për zhvillimin e atdheut. [...]

Crnogorski, IV, f. 34-46.



Nikolla I Petroviçi (1841-1921) e udhëhoqi Malin e Zi gjatë periudhës 1860-1918, fillimisht si princ dhe më pas, që nga viti 1910, si mbret. Gjatë mbretërimit të tij, Mali i Zi fitoi pavarësinë (1878), si dhe i zgjeroi territoret e tij në kurriz të Perandorisë Osmane. Meqenëse ai kishte bërë dy vjet shkollë të mesme në Paris, mbështeti përmirësimin e arsimit, si dhe modernizimin e institucioneve. Për shkak të strukturave shoqërore tradicionale, shumica e këtyre reformave u desh që të ndërmerreshin nga lart-poshtë, dhe për pasojë, qenë disi të vonuara, në krahasim me shtetet e tjera kombëtare të Europës Juglindore.



Si e legjitimoi veten monarkia? Përse mbreti vendosi që të miratonte kushtetutën?

II-10. Deklarata e xhonturqve (1908)

1. Baza e kushtetutës do të jetë respektimi i vullnetit kombëtar. Një nga rrjedhojat e këtij parimi do të jetë mbajtja e përgjegjësisë së ministrit përpara Dhomës, dhe ai do të konsiderohet si i dorëhequr, nëse nuk arrin të marrë shumicën e votave të Dhomës.

2. Me kusht që numri i senatorëve të mos e kalojë një të tretën e numrit të deputetëve, senati do të zgjidhet si vijon: një e treta nga Sulltani dhe dy të tretat nga populli; ndërsa mandati i senatorëve do të jetë për një periudhë të kufizuar.

3. Kërkohet që të gjithë nënshtetasit osmanë, të cilët kanë mbushur moshën 20 vjeç, pavarësisht

nga pasuria apo prona që zotërojnë, të gëzojnë të drejtën për të votuar. Ata që i kanë humbur të drejtat e tyre qytetare, natyrisht që nuk do ta gëzojnë këtë të drejtë.

4. Kërkohej që e drejta e lirisë së krijimit të grupeve politike të përcaktohet saktësisht në kartën kushtetuese, me qëllim që të respektohet Neni 1 i Kushtetutës së vitit 1293 A.H. [Viti i Hixhrit].

7. Gjuha turke do të mbetet gjuha zyrtare shtetërore. Letërkëmbimi dhe bisedat zyrtare do të bëhen në turqisht.

9. Çdo nënshtetas do të gëzojë liri dhe barazi të plotë, pavarësisht nga kombësia ose besimi i tij, si dhe do t'u nënshtrohet të njëjtave detyrime. Të gjithë osmanët, të cilët janë të barabartë përpara ligjit, përsa u përket të drejtave dhe detyrimeve të tyre ndaj shtetit, mund të mbajnë poste qeveritare, në përputhje me kapacitetin dhe arsimin e tyre individual. Popullsia jomyslimane do të mbajë përgjegjësi të njëjta përpara ligjit ushtarak.

10. Privilegjet fetare që u janë dhënë kombësive të ndryshme për ushtrimin e lirë të besimit, do të mbeten të paprekura.

14. Me kushtin që të drejtat e pronarëve mbi tokën të mos shkelen (meqenëse sipas ligjit, këto të drejta duhet të respektohen dhe të mos cenohen), do të propozohet që fshatarëve t'u jepet e drejta e zotërimit të tokës, si dhe t'u krijohet mundësia për të marrë para borxh me tarifa të pranueshme. [...]

16. Arsimi do të jetë pa pagesë. Çdo nënshtetas osman mund të drejtojë një shkollë private, në përputhje me ligjet e veçanta dhe brenda kufizimeve që parashikohen në kushtetutë.

17. Të gjitha shkollat do ta ushtrojnë veprimtarinë e tyre nën mbikëqyrjen e shtetit. Për arritjen e një arsimit sa më të njëjësuar dhe të njëllojtë, për nënshtetasit osmanë do të hapen shkolla shtetërore, në të cilat mësimi do jetë pa pagesë dhe ku do të lejohen të arsimohen të gjitha kombësitë. Në shkollat publike, zhvillimi i mësimin në turqisht do të jetë i detyrueshëm. Në shkollat shtetërore, mësimdhënia publike do të jetë pa pagesë. Arsimi i mesëm dhe i lartë do të ofrohet në shkollat publike të përmendura më lart; ai do të zhvillohet në gjuhën turke. Do të hapen shkolla tregtare, bujqësore dhe industriale për të zhvilluar burimet e vendit.

18. Gjithashtu do të ndërmerren hapa për ndërtimin e rrugëve, hekurudhave dhe kanaleve ujore, për lehtësimin e komunikimit dhe për shtimin e burimeve të pasurisë së vendit. Do të ndalohet gjithçka që mund të pengojë zhvillimin e tregtisë ose bujqësisë.

<http://www.fordham.edu/halsall/mod/1908youngturk.html>



Pas humbjes së pësuar në luftën e 1877-1878-s, sulltan Abdulhamiti II (1876-1908) e pezulloi zbatimin e Kushtetutës së 1876-s dhe sundoi në mënyrë autokratike. Xhonturqit, organizatë opozitare, e përbërë kryesisht nga oficerë dhe intelektualë, kërkuan rivendosjen e kushtetutës dhe reforma modernizuese për forcimin e Perandorisë. Përfundimisht, në vitin 1908, ata udhëhoqën një revolucion të suksesshëm, duke marrë dhe pushtetin, të cilin e mbajtën deri në vitin 1918.



Kërkesa politike bazë e xhonturqve gjatë opozitës së tyre ndaj Abdulhamitit II ishte rivendosja e Kushtetutës së 1876-s. Pavarësisht nga kjo, ata e pranuan përfshirjen e disa ndryshimeve në këtë Kushtetutë; renditini këto ndryshime dhe shpjegoni se përse xhonturqit i propozuan ato.

Krahasoni nenin 17, me tekstet e paraqitura në kapitullin II-E. Ç'rol luan shkolla në procesin e ndërtimit të kombit?

Analizoni nenin 18 dhe krahasojeni atë me tekstet e paraqitura në kapitullin II-D. Ç'rol i japin udhëheqësit politikë zhvillimit ekonomik?

II-11a. Kushtetuta e Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (1974)

PJESA E PARË

Neni 1

Republika Socialiste Federative e Jugosllavisë është shtet federativ si bashkësi shtetërore e kombeve të bashkuara vullneratisht dhe e republikave të tyre socialiste, si dhe e krahinave socialiste autonome të Vojvodinës e të Kosovës që janë në kuadrin e Republikës Socialiste të Serbisë, e bazuar në

pushtetin dhe vetëqeverisjen e klasës punëtore dhe të të gjithë njerëzve punues, dhe bashkësi socialiste vetëqeverisëse demokratike e njerëzve punues e qytetarëve dhe e kombeve e kombësive të barabarta.

Neni 2

Republikën Socialiste Federative të Jugosllavisë e përbëjnë: Republika Socialiste e Bosnjës e Hercegovinës, Republika Socialiste e Sllovenisë, Republika Socialiste e Serbisë, si dhe Krahinat Socialiste Autonome e Vojvodinës dhe Krahinat Socialiste Autonome e Kosovës që janë në kuadrin e Republikës Socialiste të Serbisë, Republika Socialiste e Kroacisë dhe Republika Socialiste e Malit të Zi.

Neni 3

Republika socialiste është shtet i bazuar në sovranitetin e popullit dhe në pushtetin e vetëqeverisjen e klasës punëtore dhe të të gjithë njerëzve punues, dhe bashkësi socialiste vetëqeverisëse demokratike e njerëzve punues e qytetarëve dhe e kombeve e kombësive të barabarta.

Neni 4

Krahina socialiste autonome është bashkësi autonome socialiste shoqërore – politike vetëqeverisëse demokratike e bazuar në pushtetin dhe vetëqeverisjen e klasës punëtore dhe të të gjithë njerëzve punues, në të cilën njerëzit punues e qytetarët, kombet e kombësitë realizojnë të drejtat e veta sovraane, e kur kjo është në interes të përbashkët të njerëzve punues e të qytetarëve, të kombeve e të kombësive të Republikës si tërësi e përcaktuar me Kushtetutën e Republikës Socialiste të Serbisë – edhe në Republikë.

Neni 5

Territori i Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë është unik dhe përbëhet nga territoret e republikave socialiste.

Territori i republikës nuk mund të ndryshohet pa pëlqimin e republikës, e territori i krahinës autonome – as pa pëlqimin e krahinës autonome. Kufiri i Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë nuk mund të ndryshohet pa pëlqimin e të gjitha republikave dhe të krahinave autonome. Kufiri në mes të republikave mund të ndryshohet vetëm në bazë të marrëveshjes së tyre, e nëse është

fjala për kufirin e krahinës autonome – edhe në bazë të pëlqimit të saj.

II-11b. Kushtetuta e Kosovës (1974)

PJESA E PARË

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME 1974

Neni 1

Krahina Socialiste Autonome e Kosovës është bashkësi autonome socialiste shoqërore – politike demokratike dhe vetëqeverisëse e njerëzve punues dhe qytetarëve, e malazezëve, muslimanëve, serbëve, shqiptarëve, turqëve dhe pjesëtarëve të kombeve e të kombësive të tjera dhe të grupeve etnike të barabarta, e bazuar në pushtetin dhe vetëqeverisjen e klasës punëtore dhe të të gjithë njerëzve punues.

Krahina Socialiste Autonome e Kosovës është në kuadër të Republikës Socialiste të Serbisë dhe të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë.

[...]

Neni 4

Në Krahinën Socialiste Autonome të Kosovës kombet e kombësitë janë të barabarta dhe kanë të drejta e detyra të njehta.

Për realizimin e barazisë së kombeve e të kombësive garantohet e drejta e zhvillimit të lirë të tyre dhe e të shprehurit të lirë të veçorive kombëtare, të gjuhës, të kulturës, të historisë dhe të simboleve të tjera.

Neni 5

Në Krahinën Socialiste Autonome të Kosovës sigurohet barazia e gjuhës shqipe, serbokroate e turke dhe e shkrimeve të tyre.

Me këtë Kushtetutë dhe me ligjin krahinor rregullohet dhe sigurohet aplikimi i këtij parimi.

Neni 6

Në Krahinën Socialiste Autonome të Kosovës është e drejtë e pjesëtarëve të të gjitha kombeve e kombësive që të përdorin flamurin e vet kombëtar. Kushtet dhe mënyra e përdorimit të flamurit kombëtar rregullohen me ligj.

Neni 7

Kryeqyteti i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës është Prishtina.

<http://plisi.al/skedat/bp-1036281933-sp.pdf>

II-12. Kushtetuta e Serbisë 1990

Neni 6

Republika e Serbisë do të përfshijë Krahinën Autonome të Vojvodinës dhe Krahinën Autonome të Kosovës dhe Metohisë si forma të autonomisë territoriale.

VI - ORGANIZIMI I TERRITORIT

Krahina Autonome e Vojvodinës dhe Krahina Autonome e Kosovës dhe Metohisë

Neni 108

Krahinat autonome janë themeluar në përputhje me karakteristikat specifike kombëtare, historike dhe kulturore të zonave të tyre.

Qytetarët në një krahinë autonome do të ushtrojnë të drejtat e tyre dhe do të përmbushin detyrimet e përcaktuara në Kushtetutë dhe në ligj.

Territori i një krahinë autonome do të përcaktohet me ligj.

Neni 109

Një krahinë autonome duhet që përmes autoriteteve të saj të:

- 1) Miratojë programin e zhvillimit ekonomik, shkencor, teknologjik, demografik, rajonal dhe social, zhvillimin e bujqësisë dhe zonave rurale, në përputhje me planin zhvillimor të Republikës së Serbisë, dhe të përcaktojë masat për zbatimin e tij;
- 6) Kryejë çështje të tjera të parashikuara në Kushtetutë dhe në ligj, si dhe në statutin e krahinës autonome.

Republika e Serbisë mund ti besojë drejtimin e çështjeve të veçanta nën juridiksionin e saj një krahinë autonome me ligj dhe t'i transferojë asaj fondet e nevojshme.

Një krahinë autonome do të mbledhë të ardhurat e parashikuara me ligj.

Neni 110

Statuti do të jetë akti ligjor më i lartë i një krahinë autonome i cili do të përcaktojë kompetencat e krahinës autonome, zgjedhjen, organizimin dhe punën e autoriteteve të saj si dhe çështjeve të tjera me interes për krahinën autonome, në pajtim me Kushtetutën.

Statuti i një krahinë autonome do të miratohet nga kuvendi i saj, me miratimin paraprak të Asamblesë Kombëtare.

Neni 111

Një krahinë autonome do të ketë autoritetet e saj si vijon: Asamblenë, Këshillin Ekzekutiv dhe autoritetet administrative.

Asambleja e një krahinë autonome do të përbëhet nga deputetë të zgjedhur në zgjedhje të drejtëpërdrejta me votë të fshehtë.

Neni 112

Në rastet kur një autoritet i një krahinë autonome dështon në zbatimin e një vendimi ose akti të përgjithshëm të krahinës autonome pavarësisht nga paralajmërimi nga një autoritet përkatës i Republikës, autoriteti i Republikës ka të drejtë të sigurojë zbatimin e tij të menjëhershëm.

Tabela 1: Kushtetutat e shteteve të Europës Juglindore

Shteti	Kushtetuta e parë moderne	Ndryshimet kryesore			Kushtetuta e tanishme
		Përpara Luftës I Botërore	Periodha ndërmjet luftërave	Pas Luftës II Botërore	
Shqipëria ²⁰	1920		1925; 1928; 1939	14.03.1946; 1976	21.10.1998
Bosnjë-Hercegovina					24.02.1993; 14.12.1995
Bullgaria	1879 (Kushtetuta e Tërnovës)			04.12.1947; 1971	12.07.1991
Qiproja	1959 (1960)				
Kroacia					22.12.1990
Republika e Maqedonisë					17.11.1991
Greqia ²¹	1844	1864; 1911	1927	1952	07.06.1975
Mali i Zi	1905				19.10.2007
Perandoria Osmane	1876				
Rumania ²²	1866		1923; 1938	13.04.1948; 1952; 1965	08.12.1991
Serbia	1835	1838; 1869; 1888; 1901			28.09.1990
Sllovenia					23.12.1991
Turqia	1924			1961	07.11.1982
Jugosllavia			1921 (Kushtetuta e Vidovdanit); 1931	31.01.1946; 1963; 1974	27.04.1992

Tabela 2: Vendosja e të drejtës së përgjithshme të votës në Europën Juglindore

	E drejta e përgjithshme e votës për meshkujt	E drejta e votës për femrat
Shqipëria	1920	E kufizuar – 1920, E përgjithshme – 1946
Bosnjë-Hercegovina	1920 (Jugosllavia)	1945 (Jugosllavia)
Bullgaria	1879	Gratë e martuara – 1938, E përgjithshme – 1945
Kroacia	1920 (Jugosllavia)	1945
Qiproja	1960	1960
Republika e Maqedonisë	1913 (Serbia)	1945 (Jugosllavia)
Greqia	1864	E kufizuar – 1930, E përgjithshme – 1952
Mali i Zi	1905	1945 (Jugosllavia)
Rumania	1918	E kufizuar – 1929, E përgjithshme – 1946
Serbia	1869	1945 (Jugosllavia)
Sllovenia	1907 (Austria)	1945 (Jugosllavia)
Turqia	1924	1930
Jugosllavia	1945	1945

²⁰ Rregullat gjysmëkushtetuese: Statusi i Komisionit Ndërkombëtar për Shqipërinë (1914).

²¹ Kushtetutat e para greke u votuan nga asambljetë revolucionare, në periudhën e luftës greke për pavarësi, përpara themelimit të shtetit: 1822 (Epidaurus), 1823 (Astros), 1827 (Troezene).

²² Rregullat gjysmëkushtetuese: Rregullore organike (1831/1832) në Vllahi dhe në Moldavi; Konventa e Parisit (1858) për Principatat e Bashkuara të Vllahisë dhe Moldavisë (Rumanisë, pas 1859-ës).

► **Fig. 4. Sheshi i Kushtetutës në Athinë (1863)**



Markenzis, f. 312-313.

? Shpjegoni emrin që i është vënë këtij sheshi. A ka ndonjë shesh në kryeqytetin e vendit tuaj ose në qytetin tuaj me emrin “Sheshi i Kushtetutës”? A keni apo a keni pasur ndonjëherë një shesh të quajtur “Kombi apo ... kombëtar”?



Në Bukuresht, emri *Bulevardi Mbretëresha Elisabetë*, i përdorur në periudhën midis dy luftërave, u ndryshua gjatë regjimit komunist, fillimisht me emrin *Bulevardi 6 Marsi* (data e vendosjes së qeverisë së parë të mbizotëruar prej komunistëve), dhe më pas me emrin *Bulevardi George Georgiu – Dezh* (duke mbajtur emrin e udhëheqësit komunist të Rumanisë gjatë viteve 1945-1965). Pas vitit 1989, ai u quajt *Bulevardi Mihail Kogalniceanu* (emri i një politikani, historiani dhe shkrimtari të shquar të shekullit të 19-të), ndërkohë që disa vite më vonë, një pjesë e tij mori përsëri emrin e vjetër (*Bulevardi Mbretëresha Elisabetë*). Ky është një shembull mjaft i thjeshtë për të kuptuar mënyrën e shfrytëzimit të emrave të rrugëve prej regjimeve politike, për legjitimimin e kujtimeve të veçanta historike ideologjike. A mund të gjeni shembuj të shumtë të ngjashëm me këtë? Cili është mendimi juaj mbi ndryshimin e këtyre emrave?



Ju mund të zhvilloni të njëjtën lojë edhe për bustet.

? **Lojë: Emrat e rrugëve të qytetit, në orët e mësimin të historisë**

Ndahuni në katër grupe. Gjeni harta turistike nga qyteti juaj, që u përkasin katër periudhave historike gjatë shekujve të 19-të dhe 20-të. Analizoni emrat e rrugëve e të shesheve dhe përpiquni që të gjeni se sa prej tyre u referohen ngjarjeve ose figurave historike, heronjve ose ngjarjeve kombëtare dhe vendore. Analizoni qëllimin e vendosjes së emrit dhe ndryshimet e tij në kohë.

IIb. Nënshetësia

II-13. Përkufizimi i nënshetësisë sipas *Kushtetutës Greke të Epidaurusit (1822)*

NË EMËR TË TRINISË SË SHENJTË E TË PANDASHME Kombi grek, duke mos e duruar dot më barrën e rëndë të tiranisë së sundimit osman, dhe pasi e hodhi poshtë atë me shumë sakrificë, deklaroi sot në Asambleshën Kombëtare, përmes mbrojtësve të tij të ligjshëm, përpara Zotit dhe popullit, “pavarësinë dhe ekzistencën e tij politike”.

Epidaurus, më 1 janar 1822, Viti I i Pavarësisë.

ASAMBLEJA E PËRKOHSHME E GREQISË TITULLI A

SEKSIONI A

Mbi Fenë

Şa – Feja mbizotëruese në territorin grek është ajo e Kishës së krishterë ortodokse të Lindjes; pavarësisht nga kjo gjë, administrata e Greqisë do t’i tolerojë të gjitha fetë e tjera; ritet dhe ceremonitë e shenjta të tyre nuk do të pengohen.

SEKSIONI B

Mbi të drejtat e përgjithshme të banorëve në territorin grek

Şb – Në territorin grek, të gjithë banorët vendas, të cilët besojnë tek Krishti, janë grekë dhe gëzojnë çdo të drejtë politike, pa kurrfarë diskriminimi.

Sc – Të gjithë grekët janë të barabartë përpara ligjit, pavarësisht nga ofiqet, shtresa shoqërore ose posti i tyre.

Şd – Të gjithë ata persona që vijnë nga jashtë për të zënë vend ose për të banuar në territorin grek, janë të barabartë përpara ligjit, njëlloj si dhe popullsia vendase.

Vakalopoulos, f. 390.



Gjatë Revolucionit Grek, "parlamenti" i parë u mbledh në Epidaurus dhe votoi për Kushtetutën e parë, duke u ndikuar prej dokumenteve të ngjashme të Revolucionit Francez. Pavarësisht ndryshimeve që ajo pësoi gjatë revolucionit, Kushtetuta e Epidaurusit mbeti referencë kryesore në kulturën politike greke, si simbol i idealeve të luftës për pavarësi kombëtare.



Sipas kushtetutës së Epidaurusit, cilët persona quheshin grekë? Cila është lidhja ndërmjet identitetit fetar dhe atij kombëtar? A përbën gjuha një kusht të domosdoshëm për identitetin kombëtar? Cilat parime të Revolucionit Francez mund të gjeni në këtë kushtetutë?

II-14. Përkufizimi i nënshtetësisë sipas Kushtetutës Greke të Troezenes (1827)

6. Quhen grekë:

- Të gjithë ata vendas që banojnë në territorin grek dhe që besojnë në Krisht;
- Të gjithë ata që ndodhen nën sundimin osman, të cilët besojnë në Krisht dhe që kanë ardhur, ose do vijnë në territorin grek për të marrë pjesë në luftë ose për të jetuar aty;
- Të gjithë ata që jetojnë në territore të huaja, por që kanë lindur nga baballarë grekë;
- Të gjithë ata vendas ose jovendas dhe pasardhësit e tyre që u bënë nënshtetas të shteteve të tjera, përpara publikimit të kushtetutës së tanishme, të cilët do të kthehen në territorin grek dhe do të bëjnë betimin grek;
- Të gjithë ata të huaj që vijnë dhe marrin nënshtetësinë.

OEAB, f.107.



Krahasoni tekstat II-13 dhe II-14, që trajtojnë konceptin e nënshtetësisë. Çfarë vëreni në to?

II-15. Përkufizimi i nënshtetësisë në Kushtetutën Serbe të vitit 1835

Neni 108. Konsiderohen si serbë dhe u jepet nënshtetësia serbe: çdo fëmije të lindur në Serbi ose jashtë saj, por nga prindër serbë; çdo nëpunësi ose shërbyesi të besimit të krishterë, i cili ka patur një punësim serb, brenda ose jashtë Serbisë, në kohën e shpalljes së Kushtetutës së sotme; kushdo që vazhdon të jetojë në Serbi prej më shumë se dhjetë vjetësh, ose që zotëron pasuri të paluajtshme atje.

Neni 109. Tregtarët e huaj, pronarët e fabrikave, zejtarët dhe fermerët e besimit të krishterë, mund të fitojnë të drejtat e nënshtetasve serbë, vetëm pasi të kenë jetuar aty prej shtatë vjetësh dhe të jenë sjellë hijshëm, ose në rast se Princi do t'u japë atyre ndonjë pozitë; nënshtetësinë mund ta fitojnë edhe ata të huaj të denjë për Serbinë, të cilët marrin letër nga Princi, si serbë të natyralizuar.

Mënyra sesi do të ushtrohet e drejta për nënshtetësinë serbe, përcaktohet me ligj të veçantë.

Neni 111. Çdo serb është i barabartë përpara ligjeve serbe, pa kurrfarë diskriminimi, gjatë mbrojtjes dhe gjatë dënimit të tij në të gjitha gjykatat, nga më e ulta e deri tek më e larta. [...]

Neni 116. Çdo nënshtetas serb ka mundësi të barabarta për çfarëdolloj posti, me kushtin që të jetë i aftë dhe ta meritojë atë. Në rastet e shfaqjes së aftësive të njëjta, serbët kanë përparësi ndaj të huajve.

Neni 118. Çdo skllav që shkel në tokën serbe, bëhet mënjëherë i lirë, pavarësisht nga fakti se ai mbërriti aty vetë ose e kanë sjellë të tjerë. Një serb është i lirë që të blejë një skllav, por jo që ta shesë atë.

Jovičić, f. 48-64.



Krahasoni këtë tekst me tekstin II-17; analizoni lidhjen ndërmjet fesë dhe nënshtetësisë, ashtu siç del edhe nga ato pjesë të Kushtetutës që janë paraqitur më lart. Shikoni kushtetutat e mëparshme të vendit tuaj dhe gjeni nëse ka ndonjë nen, i cili e lidh nënshtetësinë me besimin fetar. A mendoni se nënshtetësia duhet që të varet nga feja? Mos u përgjigjini vetëm me po ose jo, por përpikuni që të argumentoni idenë tuaj me shembuj që bazohen në përvojën e vendit tuaj. Pyeteni veten: përse e kemi (apo nuk e kemi) këtë lloj neni? A përbën besimi fetar një kusht të domosdoshëm për identitetin kombëtar?

II-16. Kodi ligjor i Danilos I të Malit të Zi dhe Bërdas (1855)

Deri më sot, Mali i Zi dhe Bërda²³ kanë qenë vërtet të lirë, por ato nuk kanë patur një kod ligjor publik, i cili do të përforconte dhe do të mbronte lirinë e malazezeve dhe të banorëve të Bërdas, drejtësia dhe fati i të cilëve vareshin vetëm nga goja e sundimtarit. [...]

Së pari,

Çdo malazez dhe banor i Bërdas është i barabartë përpara gjykatës.

Së dyti,

Nderi, prona, jeta dhe liria e trashëguar dhe e ruajtur deri më sot, do të vazhdojnë t'u sigurohen edhe në të ardhmen çdo malazez ose banori të Bërdas. Asnjë malazez ose banor i Bërdas, po ashtu asnjë gjykatë nuk mund të ndërhyjë mbi të drejtat e shenjta të vëllezërve malazez ose banorëve të Bërdas. [...]

Së nëntëdhjetëjti,

Çdo i mërguar që mbërrin në territorin tonë të lirë, sipas betimit të Shën Peterit, udhëheqësit të mëparshëm malazez, është i sigurtë dhe nëse ai sillet me ndershmëri dhe në përputhje me kodin ligjor të shtetit tonë, askush nuk mund t'i bëjë keq. Atij do t'i sigurohet drejtësi, njëlloj si të gjithë vëllezërve tanë malazez dhe banorëve të Bërdas [...]

Së nëntëdhjetëdyti,

Pavarësisht se në këtë shtet nuk ka ndonjë komb tjetër, përveçse atij serb dhe as ndonjë fe tjetër, përveçse asaj ortodokse lindore, anëtarët e çfarëdolloj fisi ose feje tjetër qofshin, mund të jetojnë lirshëm dhe të gëzojnë të njëjtën liri dhe drejtësi, ashtu si edhe malazeztë ose banorët e Bërdas.

Crnogorski, I, f. 167-184.



Danilo I Petroviç Njegoshi (1826-1860) pasoi xhaxhain e tij, Petar II Petrovic Njegosh, si udhëheqës i Malit të Zi, në vitin 1851. Duke mos pranuar pozicionin e peshkopit [*vladika*], ai përfitoi titullin si princ (*knjaz*) dhe e riorganizoi Malin e Zi si principatë laike të trashëgueshme. I arsimuar dhe mjaft energjik, Daniloja luftoi me sukses kundër osmanëve: ushtria malazeze mundi trupat osmane në Grahovac, në vitin 1858. Pas ndërhyrjes së Francës dhe Austrisë, kufiri midis Perandorisë Osmane dhe Malit të Zi u caktua përfundimisht. Danilo ndërmori një proces centralizimi e modernizimi të detyruar dhe miratoi *Ligjin mbi Tokën* në vitin 1855. Ai u vra nga një anëtar i opozitës, në Kotorr, në vitin 1860.



Si përcaktoheshin malazeztë sipas kodit të Danilos I? A ishte ai i hapur edhe për të sapoardhurit?

II-17. Ripërkufizimi i nënshtetësisë sipas Nenit 7 të Kushtetutës Rumune (1879)

Neni 7. Në Rumani, besimet dhe sektet e ndryshme fetare nuk përbëjnë pengesë për zotërimin dhe ushtrimin e të drejtave qytetare dhe politike.

§ I. Të huajt, pavarësisht nga besimi i tyre fetar, qofshin ose jo nën mbrojtje të huaj, mund të fitojnë të drejtën për t'u vendosur këtu sipas kushteve të mëposhtme:

a) Të dorëzojnë në qeveri kërkesën e tyre për t'u natyralizuar, në të cilën të tregohet kapitali në zotërim, profesioni ose tregtia përkatëse, si dhe vullneti për t'u vendosur në Rumani.

b) Pas dorëzimit të kërkesës, të interesuarit duhet të jetojnë dhjetë vjet në këtë shtet dhe të tregojnë se janë të dobishëm për të.

§ II. Nga ky proces janë të përjashtuar personat e poshtëshënuar:

a) Ata që kanë sjellë në këtë vend industri, shpikje të dobishme ose talente të spikatura, ose ata që kanë ngritur këtu firma të mëdha tregtare ose industriale.

b) Ata që kanë lindur dhe janë rritur në Rumani nga prindër të vendosur aty dhe që kurrë nuk kanë gëzuar mbrojtjen e të huajve.

c) Ata që i kanë shërbyer këtij vendi gjatë Luftës për Pavarësi dhe që do të natyralizohen bashkërisht,

²³ Bërda është emri i vjetër që përdorej për një pjesë të territorit gjeografik të Malit të Zi të sotëm. Në të përfshiheshin viset e banuara nga këto shtatë fise: Bjelopavliçët, Piperët, Rovčanët, Moračanët, Bratonoziçët, Kuçat dhe Vasojeviçët. Komuna dhe qarku i Bërdskas njiheshin si ndarje administrative në Principatën dhe më vonë në Mbretërinë e Malit të Zi.

me një dekret të vetëm dhe pa formalitete të mëtejshme, sipas propozimit të qeverisë.

§ III. Natyralizimi i personave mund të bëhet vetëm përmes ligjit dhe në mënyrë individuale.

§ IV. Do të ketë një ligj të vetëm, i cili do të përcaktojë mënyrën se si personat e huaj do të mund të vendosen në territorin rumun.

§ V. Vetëm rumunët dhe ata që natyralizohen si të tillë, mund të zotërojnë prona të patundshme rurale në Rumani.

Të gjitha të drejtat që shtetasit kanë përfituar deri më sot, do të respektohen.

Të gjitha konventat ndërkombëtare ekzistuese mbeten në fuqi, me të gjitha dispozitat dhe klauzolat e tyre përkatëse.

Constituționale, f. 34-35.



Kushtetuta rumune e vitit 1866 e kufizoi nënshtetësinë vetëm për të krishterët (*Neni 7*), duke i përjashtuar kështu hebrenjtë dhe myslimanët. Në Traktatin e Paqes të Berlinit (1878), Fuqitë e Mëdha e kushtëzuan njohjen e pavarësisë së Rumanisë, me ndryshimin e *Nenit 7*, në dobi të jo të krishterëve. Elita politike rumune u zemërua nga një kërkesë e tillë, por nuk mund ta kundërshtonte atë pafundësisht, kështu që hartoi një version tjetër të *Nenit 7*, me ndryshime të pranueshme.



A mendoni se ndryshimi i *Nenit 7*, e ndaloi me të vërtetë diskriminimin fetar, për marrjen e nënshtetësisë rumune? Çfarë kushtesh duhet të plotësonte një i huaj që të kërkonte nënshtetësinë rumune? Si do ta kishit konceptuar ju mënyrën e marrjes së nënshtetësisë?

II-18. Traktati mbi pakicat kombëtare, i nënshkruar ndërmjet Forcave Aleate dhe Rumanisë (1919)

Neni 1

Rumania angazhohet që dispozitat e parashtruara në *Nenin 2* dhe 8 të këtij kapitulli, të njihen si ligje themeltare, dhe asnjë ligj, rregull ose akt zyrtar nuk do të ketë përplasje ose ndërhyrje në këto dispozita, dhe se asnjë ligj, rregull ose akt zyrtar nuk do të jetë mbi to.

Neni 2

Rumania angazhohet të garantojë mbrojtjen e plotë të jetës dhe të lirisë për të gjithë banorët e Rumanisë,

pa dallim vendlindjeje, kombësie, gjuhe, race ose besimi fetar.

Të gjithë banorëve të Rumanisë u jepet e drejta e ushtrimit të lirë të çdo lloji bindjeje, feje ose besimi publik ose privat, zbatimi i të cilave nuk bie në kundërshtim me rendin dhe me moralin publik.

Neni 3

Në përputhje me kushtet e veçanta të traktateve të mëposhtme, Rumania, pa kurrfarë formaliteti, i pranon dhe i deklaron si shtetas rumunë të gjithë ata persona që janë banorë të territorit rumun, në datën kur ky traktat hyn në fuqi. Këtu përfshihen edhe ato kohëzgjatje të afatit që janë parashikuar në Traktatet e Paqes me Austrinë dhe me Hungarinë, si dhe ato kohëzgjatje të tjera që mund të bëhen më vonë, nëse brenda kësaj date këta persona nuk janë shtetas të një vendi tjetër të huaj, me përjashtim të Austrisë dhe Hungarisë.

Pavarësisht nga kjo gjë, shtetasit austriakë dhe hungarezë mbi moshën tetëmbëdhjetë vjeçare, kanë të drejtën që të zgjedhin çdo lloj nënshtetësie që mund t'u lejohet, brenda kushteve të parashikuara në traktatet në fjalë. Kjo mundësi u jepet edhe grave, për shkak të bashkëshortëve të tyre, si dhe fëmijëve nën moshën tetëmbëdhjetë vjeçare, për shkak të prindërve të tyre.

Personat që e kanë ushtruar të drejtën e lartpërmendur të përzgjedhjes së nënshtetësisë, duhet që të transferohen në shtetin përkatës, brenda dymbëdhjetëmujorit në vazhdim. Atyre u jepet e drejta për t'i mbajtur pronat e patundshme në territorin rumun, ndërkohë që ata mund të marrin me vete çfarëdolloj prona të tundshme tjetër. Këta persona nuk do t'i nënshtrohen asnjëlloj detyrimi për largimin e kësaj pronësie. [...]

Neni 5

Rumania angazhohet se nuk do të krijojë asnjë pengesë gjatë ushtrimit të së drejtës së personave të interesuar për të përfituar ose jo nënshtetësinë rumune, në përputhje me traktatet e arritura, ose që do të arrihen në të ardhmen ndërmjet Forcave Aleate dhe Austrisë ose Hungarisë.

Neni 6

Të gjithë personat e lindur në territorin rumun, të cilët nuk janë shtetas të një vendi tjetër, bëhen *ipso facto* shtetas rumunë.

Neni 7

Rumania angazhohet të njohë si shtetas rumunë *ipso facto* dhe pa kurrfarë formaliteti, të gjithë ata hebrenj të cilët banojnë në territorin rumun dhe që nuk mbajnë ndonjë nënshtetësi tjetër.

Neni 8

Të gjithë shtetasit rumunë janë të barabartë përpara ligjit dhe gëzojnë të njëjtat të drejta qytetare dhe politike, pavarësisht nga raca, gjuha ose besimi i tyre fetar.

Dallimet fetare, bindjet ose sektet e tyre nuk do të shërbejnë për t'i paragjykuar shtetasit rumunë për ato çështje që lidhen me ushtrimin e të drejtave qytetare dhe politike, si për shembull, punësimi në vende dhe funksione të ndryshme publike ose ushtrimi i profesionit dhe punësimi në industri [...]

Neni 9

Shtetasit rumunë që u përkasin pakicave raciale, fetare ose gjuhësore, gëzojnë të njëjtin trajtim dhe siguri ligjore, ligjërish dhe faktikisht po ashtu si edhe shtetasit e tjerë rumunë. Ata kanë të drejta të barabarta për të krijuar, administruar dhe kontrolluar, me shpenzimet e tyre, institucione bamirësie, fetare dhe shoqërore, shkolla dhe mjedise të tjera edukative, me të drejtën e përdorimit të gjuhës së tyre, si dhe ushtrimin e lirshëm të besimit të tyre fetar në to.

Neni 10

Në të gjitha ato qytete dhe rajone që banohen nga një numër i konsiderueshëm shtetasish rumunë të një gjuhe tjetër, Rumania për sistemin arsimor publik jep mjetet e përshtatshme, që t'u sigurohet fëmijëve të shkollave fillore mësimdhënia në gjuhën e tyre. Kjo dispozitë nuk e pengon qeverinë rumune ta bëjë të detyrueshëm mësimin e gjuhës rumune në këto shkolla.

[...]

Neni 12

Meqenëse dispozitat e neneve të lartpërmendura përbëjnë detyrime me interes ndërkombëtar, pasi ndikimi i tyre shtrihet tek pakicat raciale, fetare ose gjuhësore, atëherë Rumania pranon që vendosja e tyre të garantohet nga Lidhja e Kombeve. [...]

<http://www.austlii.edu.au/au/other/dfat/treaties/1920/13.html>



Në përfundim të Luftës I Botërore, perandoritë Ruse, Austro-Hungareze dhe Osmane u shpërbënë, çka solli shfaqjen e shumë shteteve të reja kombëtare, ndërkohë që disa shtete të tjera ekzistuese përfituan territore të reja, bashkë me një numër të konsiderueshëm pakicash. Për të shmangur tensionet e mundshme, gjatë Konferencës së Paqes në Paris (1919-1920), këtyre pakicave iu sigurova një mbrojtje e veçantë përmes traktateve ndërkombëtare të nënshkruara veç e veç me shtetet kombëtare të Europës Lindore dhe Juglindore.



Shpeshherë, traktatet mbi pakicat perceptoheshin si ndërhyrje të Fuqive të Mëdha në çështjet e brendshme të shteteve kombëtare sovraane. Cili është mendimi juaj sot? A ishin të ligjshme këto traktate? A ishin të efektshme ato?

II-19. Ripërkufizimi i nënshtetësisë sipas Kushtetutës Rumune të vitit 1923

Neni 1. Mbretëria e Rumanisë është një shtet i tërë dhe i pandashëm kombëtar.

Neni 5. Rumunët, pavarësisht nga origjina e tyre etnike, gjuha që flasin ose besimi fetar, gëzojnë lirinë e mendimit, të arsimimit, të shtypit, të tubimit, të shoqatave, si dhe të gjitha liritë dhe të drejtat e tjera të përcaktuara me ligj.


Neni 6. Kjo kushtetutë dhe të gjitha ligjet e tjera që lidhen me të drejtat politike, përveç të qenit rumun, konsiderohen si kushte të domosdoshme për ushtrimin e këtyre të drejtave.

Ligje të posaçme, të votuara nga një shumicë prej dy të tretash, përcaktojnë kushtet sipas së cilave gratë mund të ushtrojnë të drejta politike.

Të drejtat civile të grave përcaktohen në bazë të barazisë së plotë ndërmjet të dyja gjinive.

Neni 7. Në Rumani, besimet dhe sektet e ndryshme fetare, etnia, si dhe gjuha, nuk përbëjnë asnjë pengesë për zotërimin dhe ushtrimin e të drejtave qytetare dhe politike. Përsa i përket ushtrimit të të drejtave politike, vetëm natyralizimi mund t'u sigurojë të huajve të njëjtat të drejta me rumunët. Natyralizimi jepet në mënyrë individuale nga Këshilli i Ministrave, me vendim të një komisioni të përbërë nga kryetari, si dhe nga anëtarët e tjerë të Gjykatës së Lartë të kryeqytetit, të cilët e miratojnë nëse personi i përmbush kriteret ligjore.

Constituțiile, f. 71-72.


 A ishin nenet e Kushtetutës së 1923-it më të përparuara, në krahasim me rregullat e mëparshme për nënshtetësinë?
Cilat janë nenet që lidhen me votat e grave? Kërkoni në kushtetutat e shekullit të 19-të dhe 20-të të vendit tuaj dhe përpikuni të gjeni ato nene që lidhen me të drejtën e grave për të votuar. Cilat janë pasojat politike që sjell përjashtimi nga e drejta e votës?

IIc. Kombet dhe Kishat

II-20. Patriarkana Ortodokse e Kostandinopojës dënon zakonet e vënies fëmijëve, të emrave të lashtë grekë, në vend të atyre të krishterë (1819)

“Zakoni i ri, sipas së cilit foshnjave të pagëzuara u vihen emra të lashtë grekë [...], si një mënyrë shpërfilljeje ndaj emrave të krishterë, është tërësisht i pavend; në këto rrethana, është e domosdoshme që ju të vendosni rregulla më të forta [...].”

Dimaras, f. 364.

 Si mendoni, përse njerëzit filluan t’u vinin fëmijëve të tyre emra të lashtë grekë? Ç’mendim keni për qëndrimin e Patriarkanës? A është e drejtë që autoritetet fetare të ndërhyjnë në përzgjedhjet e prindërve për emrat e fëmijëve të tyre? Po ndërhyrja e autoriteteve politike në këtë çështje, a do të ishte më e ligjshme? Cilët emra kanë mbizotëruar në vendin tuaj gjatë shekullit të 19-të? Po sot? A mendoni se emrat janë përdorur për të treguar identitetin fetar, rajonal apo kombëtar? Nga kush merret vendimi për të përcaktuar identitetin?

Pyetje të përgjithshme:

Diskutoni mbi lidhjen ndërmjet shtetësisë, identitetit kombëtar dhe atij fetar, gjinisë dhe racës. Kërkoni në kushtetutën e tanishme të vendit tuaj dhe gjeni kushtet për të marrë shtetësinë. Krahasoni dhe diskutoni situatën aktuale me atë që është paraqitur këtu ose atë që gjendet në historinë e vendit tuaj. Si mund të shpjegohen kushtet për mosdhënien e nënshtetësisë?

II-21. Opinione të ndryshme lidhur me vendosjen e autonomisë së Kishës Greke, kundrejt Patriarkanës Ortodokse të Kostandinopojës (1833)

A. Teokletos Farmakidesi – ndër mbështetësit e zjarrtë

Në qershor të vitit 1833, Kisha e Mbretërisë së Greqisë shpalli autonominë dhe pavarësinë e saj. [...] Kombi grek, pasi e kishte shpallur pavarësinë e tij politike përpara Zotit dhe njerëzve qysh në fillim të revolucionit të tij të lavdishëm [...], gjithashtu e shpalli si të pavarur dhe autonome edhe Kishën e tij; **meqenëse qëllimi i asaj lufte të shenjtë ishte pavarësia fetare, ashtu si dhe ajo politike** [...], nuk kërkohet asnjëlloj leje ose miratimi [sepse], sipas besimit të Kishës Ortodokse Lindore [...], autonomia politike shkon krah për krah me autonominë fetare, pa nevojën e akteve ose marrëveshjeve të veçanta; kjo, sepse Kisha dhe vendi janë e njëjta gjë [...]

Matalas, f. 49.



Pas fitores së pavarësisë, shteti grek duhej të zgjidhte gjithashtu edhe problemin fetar. Shumica e grekëve ishin ortodoksë, por drejtuesi i Kishës Ortodokse, patriarku i Kostandinopojës, ishte nën kontrollin osman. Për të shmangur varësinë e mëtejshme fetare nga Perandoria Osmane, Kisha Ortodokse në Greqi i ashpërsoi marrëdhëniet e saj institucionale me Patriarkanën në Kostandinopojë. Diskutimet e ashpra mbi këtë çështje janë ilustruar përmes teksteve të Teokletos Farmakidesit (1784-1860) dhe të Konstantinos Oekonomit (1780-1857).

B. Konstantinos Oekonomi – kundërshtar i autonomisë

Çfarë vuajtjesh kanë kaluar për hir të lirisë së Greqisë ata vëllezër që janë lënë jashtë saj? E ju përsëri kërkoni që ata të mos quhen as grekë, dhe as vëllezër, por banorë të Turqisë dhe vartës të asaj që ju e quani kishë të robëruar! Kështu, ju e ndani (aq sa mundeni) Greqinë nga Greqia, dhe grekët nga njëri-tjetri, duke copëtuar kombin dhe duke nxitur përçarje fetare, të cilat shpiten drejt lëngatave të brendshme, si dhe luftërave të kobshme ndërmjet vëllezërve. E kështu, në përfundim, ju e rrudhni shtetin grek brenda disa kufijve mjaft të ngushtë dhe e frenoni zhvillimin e mbretërisë së bekuar greke, duke i shuar (përsëri aq sa mundeni) shpresat dhe dëshirat shekullore të gjithë këtij kombi, ashtu si dhe ato të kombeve të tjera të krishtera filohelenike! O njerëz, si mund të silleni në këtë mënyrë?

Oikonomos, f. 336-337.



Bëni krahasimin e këtyre dy teksteve. Cilat janë argumentet e përdorura nga të dy autorët? Si mendoni, përse për shtetin grek ishte mjaft e rëndësishme që ai të kishte një kishë autonome?

II-22. Dekreti për krijimin e autoritetit sinodik të Kishës Ortodokse në Rumani (1864)

Neni 1. Kisha Ortodokse Rumune është dhe do të mbetet e pavarur prej cilitdo autoriteti fetar të huaj, në aspektin organizativ dhe disiplinor të saj.

Neni 2. Kisha Rumune, uniteti i së cilës përfaqësohet nga Sinodi i Përgjithshëm, vazhdon të administrohet nga kryepeshkopët dhe nga peshkopët, me ndihmën e sinodeve peshkopale.

Neni 3. Sinodi i Përgjithshëm i Kishës Rumune do ta ruajë unitetin dogmatik të besimit të shenjtë ortodoks me kishën e madhe të Lindjes, përmes konsultimeve me Kishën Ekumenike të Kostandinopojës.

Neni 4. Sinodi i Përgjithshëm i Kishës Rumune përbëhet nga:

- Kryepeshkopët
- Peshkopët
- Kryehierarkët rumunë

Tre përfaqësues të zgjedhur prej besimtarëve në secilën peshkopatë, nga radhët e famullitarëve ose

personave laikë me njohuri fetare; Dekanët e fakulteteve teologjike të Jashit dhe të Bukureshtit [...]

Neni 16. Sinodi i Përgjithshëm i Kishës Rumune, pavarësisht nga shkaku, nuk mund të ndryshojë ose të pengojë:

Lirinë e ndërgjegjes dhe tolerancën fetare. Ligjet për tolerancën fetare janë kompetencë e plotë e asambleve legjislative të zakonshme.

Gjuha e kultit ortodoks, e përdorur në kishat e vendit, do të jetë përgjithmonë rumanishtja.

Murgescu, f. 255-256.



Ky dekret u lëshua nga princi Aleksandër Joan Kuza (1859-1866) gjatë periudhës së konfliktit me Patriarkanën e Kostandinopojës, për shkak të shpronësimit të pronave të paluajtshme të kishës (1863). Ky qe dhe hapi i parë drejt organizimit të kishës ortodokse kombëtare, i cili përfundoi me shpalljen zyrtare të autoqefalisë fetare (1885) dhe me organizimin e Kishës Ortodokse Rumune si patriarkanë e veçantë (1925).



Përse për shtetin rumun, organizimi i kishës në mënyrë të ndarë dhe të pavarur qe aq i rëndësishëm? Si e siguronte shteti kontrollin e tij mbi kishën? Në ç'aspekt e ruajti kisha rumune lidhjen e saj me Patriarkanën e Kostandinopojës? Krahasojeni këtë me tekstet I-17 dhe I-27a.

II-23. Komentet e gazetarit francez, Sharl Iriarte, mbi pikëpamjet e priftërinjve katolikë dhe ortodoksë për lidhjen ndërmjet fesë dhe kombësisë në Bosnjë (1875-1876)

Prifti ortodoks jeton pranë njerëzve të besimit të tij dhe nuk është e çuditshme se përse udhëheqësit e lëvizjes [Kryengritjes së 1875-s në Bosnjë] qenë kryesisht priftërinj të ortodoksisë greke, të cilët nuk dhanë vetëm sinjalin për fillimin e kryengritjes, por rrokën vetë armët dhe e udhëhoqën popullin në betejë. Për të tillë njerëz, koncepti i besimit dhe ai i racës ose kombit janë aq të ngjashme, saqë fjala "serb" është kthyer në sinonim të fjalës "ortodoks". Ndërkohë, katolikët kanë një tjetër pikëpamje:

për priftërinjtë katolikë boshnjakë, koncepti i fesë është më i rëndësishëm sesa koncepti i kombit, dhe ne sot mund të shohim sesi priftërinjtë katolikë, të cilët i marrin urdhrat nga Roma, i kanë shmangur besimtarët katolikë prej kryengritjes. Më përparimtarët ndër ta janë kufizuar vetëm me publikimin e disa deklaratave në gjuhën e tyre latine, mbi nevojën për ndërhyrjen e fuqisë katolike fqinje [Austro-Hungarisë] për ndalimin e shtypjes që ndodh në vend. Ne nuk duhet të habitemi për mbizotërimin e të tilla mosmarrëveshjeve, të cilat i ndajnë të dyja fetë [ortodokse dhe katolike]. Qëllimisht, shteti osman nuk kujdeset për arsimimin e të krishterëve, dhe ia ka lënë këtë rol kishës, çka nënkupton se gjatë mesimdhënies, prifti duhet t'i konsiderojë mosmarrëveshjet ndërmjet feve si bazën e gjithçkaje. Pasojat e një sistemi të tillë janë të qarta dhe fatale: Fëmijët e ortodoksëve grekë nga *igumeni* [abati ortodoks], fëmijët katolikë nga *françeskani* dhe fëmijët myslimanë nga *ulema*, do të mësojnë sesi ta urrejnë njëri-tjetrin dhe, në thelb, kjo përbën gjënë e vetme në të cilën ata do të arrijnë suksese kur të rriten.

Yriarte

Analizoni mënyrën sesi e përshkruan autori lidhjen ndërmjet identitetit fetar dhe atij kombëtar, sipas pikëpamjes së kishës/fesë katolike dhe asaj ortodokse në Bosnjë. A pajtoheni me mendimin e autorit, se arsimimi vetëm në institucionet e tyre fetare, do t'i mësonte fëmijët që ta urrenin njëri-tjetrin? Si mund të shmangej kjo lloj situatë? Ç'rol luajti feja gjatë lëvizjes kombëtare në vendin tuaj?

II-24. Kushtetuta Bullgare e 1879-ës, mbi pozitën e Kishës Ortodokse Bullgare

Neni 37. Feja shtetërore e Principatës së Bullgarisë është besimi ortodoks lindor.

Neni 38. Princi bullgar dhe pasardhësit e tij kufizohen në praktikimin vetëm të besimit fetar ortodoks, përveç princit të parë të zgjedhur bullgar, i cili mund të praktikojë fenë e prejardhjes së tij.

Neni 39. Principata bullgare, e cila nga pikëpamja kishtarë përbën një pjesë të pandashme të

juridiksionit të Kishës bullgare, është vartëse e Sinodit të Shenjtë, i cili është dhe autoriteti më i lartë shpirtëror i Kishës Bullgare, kudo qoftë ajo. Përmes po të njëjtit autoritet, principata do të vazhdojë të mbetet e bashkuar me Kishën Lindore Ekumenike, përsa u përket çështjeve të dogmës dhe të besimit.

Конституция, f. 6.

❓ Përse u vendosën në kushtetutë çështjet kishtarë? A ekziston ndonjë dispozitë lidhur me kishën dhe fenë në kushtetutën e tanishme të vendit tuaj?

II-25. Pikëpamjet e Nikolla Pashiqit, mbi raportet ndërmjet kombit serb dhe Kishës Ortodokse (1890)

Për Kishën Ortodokse

Është mjaft e qartë përse Kisha Ortodokse është kisha e popullit. Kjo, për shkak se ajo është më e lidhur dhe më e bashkuar me shpirtin e njerëzve që e praktikojnë, sesa Kisha Katolike. [...] Kjo është arsyeja pse ato (quhen) kisha serbe, kisha bullgare, kisha greke dhe kisha ruse. [...]

Si një e tërë, Kisha Ortodokse Sllave, e lidhur qysh në fillim me popujt sllavë, të cilët i mbetën asaj besnikë, mishëroi tek ata cilësitë, tiparet dhe natyrën sllave, duke u dhënë atyre aftësinë për të pranuar rezultatet e zhvillimeve të sotme [...]

Sovraniteti kombëtar

[...] Populli serb e krijoi i vetëm shtetin serb: e krijoi atë me gjakun, përpjekjet dhe aftësinë e tij, dhe ky shtet mban vulën e krijuesit të tij, si një shtet tërësisht demokratik. [...] Në vetëdijen e njerëzve, se ata vetë e kanë ndërtuar shtetin e tyre, mbështetet sovraniteti kombëtar, pushteti i plotë i popullit [...], si pushteti më i lartë, mbi çdo pushtet tjetër; garancia se nuk mund të ketë shmangie thelbësore nga mënyra demokratike e jetesës, se regjimet jodemokratike, ndonëse mund të jenë të papritura, kurrsesi nuk mund të lëshojnë rrënjë dhe as të qëndrojnë për një kohë të gjatë.

Pašić, f. 128-129, 137, 139.



Nikolla Pashiqi (1845-1926) ka qenë një prej pushtetarëve më të spikatur serbë, që nga fundi i shekullit të 19-të, e deri më 1920-n. Pas mbarimit të studimeve për inxhinieri, ai iu përkushtua politikës, duke themeluar edhe Partinë Radikale në vitin 1881. Ai ka qenë disa herë kryeministër i vendit.



Cili ishte roli i Kishës sipas pikëpamjes së autorit? Si e justifikon ai marrëdhënien ndërmjet njerëzve dhe shtetit? Sipash jush, përse e ndjeu autori të nevojshme botimin e mendimeve të tilla?

II-26. Besimi ortodoks shpallet besim zyrtar në Malin e Zi

A. Kushtetuta e Sinodit të Shenjtë të Principatës së Malit të Zi, 20 dhjetor 1903

Neni 1. *Kisha autoqefale ortodokse mitropolitike e Principatës së Malit të Zi, si pjesë e së vetmes Kishë*

të Shenjtë Katolike dhe Apostolike, e cila ruhet dhe drejtohet nga Zoti ynë, Jezu Krishti, do të ruajë dhe mbrojtë unitetin e dogmave dhe institucioneve kanonike me të gjitha kishat e tjera autoqefale ortodokse dhe do ta ruajë këtë unitet përgjithmonë. Neni 22. Vendimet e *Sinodit të Shenjtë* në lidhje me çështjet e jashtme do të kërkojnë miratimin suprem të Princit, përpara se të zbatohen dhe të jenë të detyrueshme për të gjithë.

Zhivko Adrijasheviç, f. 363, 370.

B. Nenet e lidhura me besimin fetar në kushtetutën e Principatës së Malit të Zi, të vitit 1905

Neni 40. *Besimi i krishterë lindor* do të jetë besimi zyrtar në Malin e Zi. Kisha malazeze do të jetë autoqefale [...] Të gjitha besimet e tjera mund të praktikohen lirshëm në Malin e Zi.

Neni 128. Të gjitha besimet fetare të njohura do të kenë të drejtë të ndjekin ritet e tyre fetare-ligjore lirshëm dhe në publik.

Neni 136. Çdo veprim i drejtuar kundër *Kishës Ortodokse të Lindjes* në Malin e Zi ndalohet me ligj.

Zhivko Adrijasheviç, f. 431-432.

IId. Infrastruktura e shteteve kombëtare

II-27. Rëndësia e zhvillimit industrial për një komb të vogël – një argumentim grek (1841)

Nuk ka dyshim që llojet e ndryshme të industrive sjellin lumturinë për një komb. Pa industri, një komb nuk mund ta rrisë dhe ta shtojë më tej fuqinë e tij tokësore dhe detare; pa krijimin e industrive të ndryshme, kombi mbetet i kufizuar vetëm tek burimet e tij natyrore dhe nuk mund të rritet më fizikisht ose moralisht [...] Me fjalë të tjera, kombet pa industri do të mbeten gjithmonë të varfra, duke qëndruar brenda komunitetit politik si njësi pasive dhe të parëndësishme, nën tekat e njërit ose tjetrit komb më të fortë, të cilat nuk u bënë të tilla për shkak të bukurisë së tyre natyrore dhe klimës së favorshme, dhe as prej pjellorisë së tokës, madhësisë së saj

ose pasurisë së prodhimeve, por vetëm për shkak të nxitjes, zgjerimit dhe përmirësimit të industrive të ndryshme dhe tregtisë së tyre. Në këtë mënyrë, kombet e fuqishme të së djeshmes dhe të së sotmes u radhitën të parat ndërmjet Fuqive europiane, duke arritur kulmin e lavdisë, shkëlqimit dhe madhësisë së tyre, përmes pasurisë së përfituar nga industritë e ndryshme dhe nga tregtia e jashtme.

S.B., "Αὐτοβιογραφία" [Industritë],
E përditshmja Αὐτὼν [Shekulli],
26.2.1841, nr. 238, te Psalidopoulos, f. 55.



Çfarë argumentesh kombëtare ka përdorur autori për t'i bindur njerëzit në lidhje me nevojën e zhvillimit industrial të shteteve të vogla? Si mendoni, përse argumentet ekonomike janë ndërthurur me ato kombëtare?

► **Fig. 5. Kartëmonedhë në të cilën paraqiten marrëdhëniet ndërmjet elementeve ekonomike të një vendi dhe simboleve përfaqësuese kombëtare – kartëmonedha e parë me vlerë 500 dhrahmi, lëshuar nga Banka Kombëtare Greke (1841)**



Καθημερινή, f. 4.

❓ Çfarë elementesh pamore janë paraqitur në kartëmonedhë? Cili është kuptimi i tyre? Përse ishte e nevojshme që një shtet të kishte paratë e veta? Çfarë pamjesh dhe simbolesh paraqiten në kartëmonedhat e vendit tuaj? A mendoni se monedhat dhe kartëmonedhat shërbejnë për edukimin dhe përfaqësimin kombëtar? Nëse po, në çfarë mënyre?

II-28. Roli i hekurudhave në forcimin e shtetit kombëtar – opinioni i një rumuni (1870)

Edhe sot e kësaj dite, kur ndikimi i hekurudhave në traditat, në marrëdhëniet ndërmjet provincave dhe në zhvillimin e pasurive është kaq i madh, shumë njerëz ende vazhdojnë ta pyesin veten nëse uniteti i çmuar kombëtar do të prishet për shkak të tyre, ose nëse ai do mund të arrihet përsëri. Duke dëshiruar një turbullirë të tillë, por pa pasur ndershmërinë ta shfaqin atë haptazi, disa prej partive janë të gatshme të sakrifkohen edhe të ardhmen e vendit, duke u përballur me përbuzjen e Europës së pakënaqur. Askush nuk e anashkalon dot faktin se në të dyja anët e Milcovit, përveç disa partive të ndershme, mike të kombit rumun, të cilat fatmirësisht përbëjnë edhe shumicën, ka disa të tjera, të cilave u vjen keq për bashkimin moldavo-rumun, por dhe disa parti, të cilat i fshehin kërcënimet e tyre të errëta nën petkun e pavarësisë dhe të liberalizmit, duke u përpjekur që

t'i realizojnë projektet e tyre përmes shfrytëzimit të pasioneve popullore. Pavarësisht nga kjo, ne jemi në gjendje të pohojmë se aty ku largësia ndërmjet të gjithë anëtarëve të familjes së madhe rumune do të zvogëlohet; ku qarkullimi i prodhimeve dhe i njerëzve do të lehtësohet nëpërmjet vendosjes me kujdes të tarifave hekurudhore, do të shndërrohen në një prej armëve më të fuqishme për shtypjen e prirjeve të mbrapshta, si dhe do të shërbejnë për përmbushjen e dëshirës së madhe të kombit rumun, që të arrihet bashkimi i të gjitha pjesëve të Dakisë së lashtë.

Brătianu, f. 51-52.



Konstantin I. Brătianu (1844-1910) ishte topograf ushtarak, oficer në Shtabin e Përgjithshëm, dhe më vonë gjeneral dhe anëtar i Akademisë Rumune.



Përveçse sillnin modernizimin e ekonomisë, hekurudhat ishin edhe një mjet i rëndësishëm për ndërtimin e kombit. Cili element spikat në diskutimin e Brătianusit? Përse? Si do ta kishit argumentuar ju nevojën për ndërtimin e hekurudhave?

II-29. Opinioni i princit bullgar, Aleksandër Batenberg (1879-1886), mbi rëndësinë e hekurudhave (1879-1881)

Princi mbretëror tha: "Shkollat dhe ligjet nuk janë aq të rëndësishme sa hekurudhat." U vendos që Sofja të bëhej kryeqytet, për shkak se arteria botërore Beograd – Stamboll kalon përmes saj. Lidhja përmes Maleve Ballkan, pranë Berkovicës, mund të bllokohet plotësisht gjatë dimrit. Princi përmendi edhe shqetësimin e tepruar se austriakët mund ta shtinin në dorë tregtinë bullgare nëpërmjet kësaj hekurudhe. Ai shtoi: "Për ne nuk ka rëndësi se kush do t'i ndërtojë hekurudhat. Ajo që ka rëndësi është që t'i kemi ato sa më shpejt që të jetë e mundur."

Jireček, f. 27.



Krahasoni të dyja tekstet. Përse ishte aq e rëndësishme për shtetet e reja që të zhvillonin rrjetin e tyre hekurudhor? A përbënte ndonjë rrezik ndërtimi i hekurudhave?

II-30. Përshkrimi i një hekurudhe bullgare gjatë fundit të shekullit të 19-të

Hekurudha në atë kohë quhej Hekurudha e Baron Hirshit [sipas emrit të milionerit hebre austriak që e zotëronte atë] dhe ishte ndërtuar gjatë sundimit turk që të lidhte Jambolin me Odrinin dhe Stambollin. Vagonat ishin të vegjël dhe të ndarë në kabina; kabinat kishin dyer nga të dy krahët, ku gjendeshin edhe shkallët e gjata prej druri, që përdoreshin prej kontrolluesve të biletave. Këta të fundit shfaqeshin gjithmonë papritmas te xhamat e dyerve dhe gjatë mbrëmjeve, varnin në qafë fenerët ndriçues me gaz. Zyrtarët e hekurudhave mbanin uniforma të huaja. Shumica e tyre ishin armenë ose levantinë dhe nuk flisnin bullgarisht. Tabelat e stacioneve hekurudhore ishin në gjuhën frënge dhe treni nisej vetëm pasi kambana të binte tri herë... Sa herë që dikush duhej të udhëtonte drejt Kremenlit, kjo kthehej në një ngjarje të gëzueshme, të mbushur plot me emocione dhe gjëra të reja interesante: stacione hekurudhore, trena, njerëz të panjohur dhe gjuhë të huaja. Një udhëtim i tillë ishte një fluturim drejt botës së panjohur, si dhe një prekje afatshkurtër e mbretërisë së ëndrrave. Ndërsa udhëtimi drejt Sofjes ishte një aventurë e vërtetë, që kërkonte disa ditë përgatitje...

Константинов, f. 19-20.

? Gjeni disa pamje stacionesh hekurudhore dhe shikoni arkitekturën e tyre.

II-31. Ligji bullgar për njësitë matëse (1889)

Neni 1. Që sot e në vazhdim, njësia bazë e matjeve që do të përdoret në Principatën Bullgare, do të jetë metri [...]

Neni 6. Njësia bazë për matjen e vëllimeve do të jetë litri [...]

Neni 7. Njësia bazë e përdorur për peshat do të jetë grammi, ose pesha që ka 1cm³ ujë i distiluar në vakuum, në temperaturën 4 gradë Celcius [...]

Barasvlerësimi i njësive të vjetra të masës me të reja

A. Njësia e gjatësisë

I. Nga e vjetra tek e reja

Neni 9. Një arshin arkitektonik (ndërtuesish) përmban 758mm (0, 758m).

Një arshin rrobaqepësish përmban 680mm (0, 680m). Një kut përmban 650mm (0, 650m). [...]

Dispozita të përgjithshme

Neni 13. Ky ligj, për njësitë matëse ushqimore, hyn në fuqi në datën 1 qershor 1889, kurse për njësitë e tjera matëse, në datën 1 janar 1892 [...]

Neni 16. Përdorimi i njësive matëse të reja në institucionet shtetërore është i detyrueshëm që nga data 1 janar 1889.

Të gjithë nëpunësit civilë janë të detyruar që të përdorin njësitë e reja matëse në dokumentet zyrtare. Shtetasit që bëjnë veprime me institucionet shtetërore, janë të detyruar që t'ia paraqesin përlllogaritjet dhe raportet e tyre institucioneve sipas njësive të reja matëse [...]


Държавен вестник, нг. 7, 19 janar 1889

? Në një tabelë, shkruani arsyet se përse njëri prej akteve të para të shteteve të reja kombëtare lidhej me përdorimin e detyrueshëm të njësive të reja matëse. Përpiquni që të gjeni arsyet ekonomike, shoqërore dhe kulturore. A mendoni se kjo përbënte edhe një mjet të kontrollit shtetëror?

► Fig. 6. Teknologjitë e reja dhe simbolet kombëtare – afishe reklamuese e makinave qepëse (fondi i shekullit të 19-të, Greqi)



Koleksioni i Bibliotekës Helenike dhe Arkivit Historik, Athinë, tek Fotopoulos, f. 480.


 Kartolinë reklamuese e kompanisë së makinave qepëse Singer. Makinat qepëse reklamoheshin në shtypin grek qysh nga viti 1874. Përdorimi i tyre filloi që të përhapej nëpër fshatrat greke rreth viteve 1900. Pikërisht gjatë kësaj periudhe, ato morën edhe emrin “Olga”, për nder të mbretëreshës që ua shpërndau ato vajzave dhe nuseve të reja të varfra, që t’i kishin për pajën e tyre.

Ile. Ndërtimi i kombit


II-32. Përdorimi i keq i gjuhës kroate kritikohet prej Ivan Kukuljeviçit (1843)


Unë jam i vetëdijsëm për faktin se ne që jemi mbledhur këtu, nuk e flasim mirë gjuhën tonë, dhe përsa i përket vendit në përgjithësi, mund të gjesh lehtësisht vetëm pak njerëz të të dy gjinive të cilët lexojnë, shkruajnë dhe flasin mirë në gjuhën e tyre amtare. Kjo vjen ngaqë ne nuk e përdorim në jetën publike e në biznes dhe argëtohemi me të, ashtu si zotëria i pispillosur argëtohet me shërbëtorin e vet. Shumica e njerëzve tanë, ende nuk e njohin kënaqësinë e të folurit në gjuhën e nënës. Të tilla ndjenja mund të provohen vetëm prej atyre të cilëve u është dashur që të jetojnë për një kohë të gjatë jashtë vendit, mes të huajve në dhe të huaj. Ne vazhdojmë ta ruajmë gjuhën tonë vetëm për miqtë dhe për bujkrobërit tanë.

Wein, f. 541.

 Komentoni shkurtimisht figurën. Analizoni personazhet që janë paraqitur aty, mënyrën e veshjes së tyre dhe atë çfarë janë duke bërë. Përse janë përdorur simbolet kombëtare në këtë afishe komerciale?

Në ç’mënyrë mund të shërbejë reklama në forcimin e vetidentifikimit kombëtar? A është e mundur që reklamimi komercial të shërbejë për përhapjen e klisheve edhe për grupimet e tjera etnike apo fetare? A e përforcon kjo gjë edhe më tepër dallimin ndërmjet ‘nesh’ dhe ‘të tjerëve’? A paraqiten personazhe historike ose karakteristika të veçanta të identifikimit kombëtar në reklamat e sotme në televizione apo radio në vendin tuaj? A paraqiten “të tjerët” në kuptimin kombëtar, etnik ose fetar si shembuj ose si pika krahasimi?

 Deri në vitet 1830, kur nisi të zhvillohet lëvizja kombëtare, gjuha zyrtare në Kroaci (ashtu si dhe në Transilvani) ishte latinishtja. Qeveria hungareze u përpoq që nëpër shkolla dhe zyra, ta zëvendësonte latinishten me hungarishten. Në atë kohë, edhe përdorimi i gjermanishtes ishte gjithashtu mjaft i përhapur. Por pavarësisht nga kjo, reformatorët kroatë mbështetën vendosjen e gjuhës kroate si gjuhë zyrtare dhe ia arritën që ta realizojnë këtë gjë në vitin 1847. Në kuadrin e këtyre përpjekjeve, shkrimtari, historiani dhe politikani Ivan Kukuljeviç (1816-1889) – njëri prej reformatorëve më të spikatur kroatë – në vitin 1843, si anëtar i Parlamentit kroat, iu drejtua këtij parlamenti për herë të parë në gjuhën kroate.

 Si e mbështet Kukuljeviçi përdorimin gjithnjë e më të gjerë të gjuhës kroate? Kukuljeviçi vinte nga shtesa e fisnikërisë; a kuptohet kjo gjë në tekstin në fjalë? Përse Kukuljeviçi thotë se vetëm një numër i vogël njerëzish flisnin në gjuhën e tyre të nënës, në një kohë kur ajo flitej nga të gjithë bujkrobërit (të cilët nuk ishin të paktë në numër)?

II-33. Rëndësia e gjuhës për identitetin kombëtar – opinion i një slloveni (1861)

Duke shëtitur përreth kështjellës, djali ynë pa dy njerëz me veshje të ngjashme, të cilët po bërtisnin në mënyrë të frikshme, duke shtyrë njëri-tjetrin. Ai nuk e kuptonte njërin prej tyre, por tjetri fliste në gjuhën që djali e njihnte dhe fytyra e tij ishte disi e njohur për të. Djali u fut për ta ndihmuar këtë njeri, sepse ai ishte bashkëatdhetari i tij dhe ata flisnin që të dy të njëjtën gjuhë. Vetëm nëpërmjet gjuhës, djali arriti që ta njihnte bashkëatdhetarin dhe bashkëkombësin e tij. Ai do ta kish njohur atë edhe sikur të kishin qenë njëqind burra bashkë, të veshur njëloj ose ndryshe. Gjuha është shenja më e mirë, me anë të së cilës ne mund të kuptojmë se cilit komb i përket dikush. Ai që e ka folur gjuhën tënde kombëtare qysh në fëmijëri, i përket kombit tënd. Po çfarë është kombi sipas të gjithë kësaj ngjarjeje? Pas asaj që djali mësoi gjatë shëtitjes, atij i pëlqejnë që të gjithë njerëzit. Për të, të gjithë njerëzit janë të dashur dhe ai ka dëshirë që t'i afrohet kujtdo që vjen prej atdheut të tij; kujtdo që ka zakone dhe tradita të njëjta me ato të shtëpisë së tij. Por edhe nëse njerëzit i ndryshojnë veshjet, ai arrin që t'i dallojë prej të folurit, prej gjuhës së tyre. Të gjithë ata njerëz që ai i kupton, fjalët e të cilëve sjellin ngrohtësi në kraharorin e tij, janë bashkëatdhetarët e tij. Ata janë të gjithë të ëmbël dhe të dashur për të; ata i përkasin të njëjtit komb me të.



Artikullin me titullin *Çfarë është kombi? Dhe çfarë është veçanërisht kombi slloven?*, e shkroi mësuesi dhe historiani Ivan Macuni, në formën e një tregimi, që përshkruan përvojat e një djali, i cili udhëton nëpër vendin e vet dhe përpiqet që të njohë bashkëatdhetarët e tij. U botua në vitin 1861 në gazetën Novice [Lajmet], e cila dilte në Lubjanë.



Përse e thekson autori rolin që luan gjuha në identitetin kombëtar? A mund t'i përkasin të njëjtit komb njerëzit që flasin gjuhë të ndryshme? Jepni shembuj.

II-34. Rëndësia e gjuhës për identitetin rumun, sipas Titu Maioreskut (1866)

Për popujt modernë kërkohet që ata të kenë një shtet kombëtar, por veçanërisht një letërsi dhe një gjuhë kombëtare.

[...] Çdo rumun e di se është i tillë dhe gjithçka që do të bëjë më tej, do mundohet që ta lidhë sa më mirë të jetë e mundur me traditën latine, nga e cila ai ka marrë edhe vlerat e tij intelektuale.

Deri më sot, me të drejtë, kjo e vërtetë ndikoi vetëm në gjuhën dhe në shkrimet tona. Për rumunët, gjuha është thesari më i çmuar që ka mbetur prej paraardhësve të tyre latinë. Sot ajo u kujton atyre një tjetër lashtësi, e cila ka qenë busulla e tyre e vetme dhe e besueshme që i ka udhëhequr në drejtimin e duhur, duke i ruajtur prej shmangieve ose zhytjes nën dallgët e emigrantëve që vërshuan në Dakinë e Trajanit.

Maiorescu, I, f. 277.



Titu Maioresku (1840-1917) ishte kritik letrar, estet, profesor në universitet, politikan (deputet, ministër, kryeministër), si dhe anëtar i rëndësishëm i shoqërisë "Junimea". Ai mori titullin e Doktorit të Filozofisë në Giessen, si dhe u diplomua për jurisprudencë në Paris. Duke qenë kryeministër, Maioresku drejtoi Konferencën e Paqes të mbajtur në Bukuresht (1913).



Si e shpjegon autori lidhjen ndërmjet gjuhës dhe identitetit? Cili është mendimi juaj mbi këtë çështje?

II-35. Peticioni i parlamentit kroat, drejtuar mbretit-perandor, Franc Jozefit, për miratimin e krijimit të Akademisë Jugosllave të Shkencës dhe Artit (1867)


Madhëria juaj Apostolike, mbreti dhe sundimtari ynë i shtrenjtë! Popujt e Mbretërisë tripalëshe të Dalmacisë, Kroacisë dhe Sllovenisë [...], kurrë nuk kanë qenë të prapambetur në dije për fajin e tyre. Historia e tyre njih shumë heronj të shpatës dhe

të penës, në çdo fushë të mendjes dhe të zemrës. Por kjo histori na dëshmon plot keqardhje edhe arsytet përse sot populli ynë nuk mund të konkurrojë bashkë me kombet e tjera, që janë më fatlume në fushën e shkencës, e cila sot – më shumë se kurrë – përbën dhe shtyllën kryesore të çdo vendi. Ky parlament është plotësisht i bindur se, përse i përket zhvillimit të shkencës dhe të letërsisë, [...] populli ynë ka mbërritur në atë pikë, ku na shtrohet si detyrë që të ndihmojmë në krijimin e një oborri të lartë letrar dhe shkencor: dhe kjo është Akademia, pa të cilën shkenca nuk mundet që të zhvillohet dhe të jetë e suksesshme.

Laszowsky, f. 127.

? Si e argumenton parlamenti nevojën për krijimin e akademisë? Cila duhet të jetë detyra e akademisë sipas letrës së lartpërmendur? A shihen më akademitë e sotme si “oborre letrare dhe shkencore”, apo krahasuar me shekullin e 19-të, reputacioni i tyre është në rënie?

► **Fig. 7. Teatri Kombëtar në Bukuresht – kartolinë (vitet 1890)**



? Si e shpjegoni faktin që institucionet kryesore të shtetit konsideroheshin “kombëtare”? Sa institucione të tjera që mbajnë etiketimin “kombëtare” njihni?

II-36. Rëndësia e gjuhës dhe letërsisë në zhvillimin e kombit – pjesë nga dokumenti themeltar i “Shoqërisë së të Shtypurit Shkronja Shqip” (1879)

“Të gjitha kombet e arsimit kanë qenë qytetëruar me shkrime në gjuhën e tyre. Çdo komb që nuk shkruan gjuhën e vet dhe nuk ka vepra në gjuhën e tij është në errësi dhe barbari.”

Myzyri, f. 40

? Përse autorët e konsideronin kaq të rëndësishme që kombet të kenë gjuhën dhe letërsinë e tyre?

II-37. Memorandumi i studentëve maqedonas në Shën Peterburg, lidhur me gjuhën letrare maqedonase (1902)

Tashmë lind pyetja: a është i nevojshëm krijimi i një gjuhe letrare të veçantë maqedonase, në një kohë kur kemi gjuhën letrare serbe dhe atë bullgare? Ekzistojnë dy arsye për krijimin e gjuhës letrare maqedonase: së pari, gjatë krijimit të gjuhës letrare serbe – në fillim të shekullit të 19-të – gjuhëve që fliteshin në Serbinë Lindore, në Bullgarinë Perëndimore dhe në Maqedoni, nuk iu kushtua vëmendja e duhur, kështu që, me njohjen e gjuhës së folur hercegovinase si gjuhë letrare, nevojat e Serbisë Lindore, Bullgarisë Perëndimore dhe Maqedonisë, nuk u plotësuan. Edhe gjatë krijimit të gjuhës letrare bullgare, duke marrë si bazë për një gjuhë letrare të përgjithshme dialektin bullgarolindor, përsëri dialekteve serbolindore, bullgaroperëndimore dhe atyre maqedonase nuk iu kushtua vëmendja e duhur. Njëanshmëria e treguar gjatë procesit të krijimit të gjuhës letrare bullgare dhe asaj serbe, ndikoi në ndarjen e sllavëve të Ballkanit në dy kampe armiqësore, të cilat filluan të grindeshin me njëri-tjetrin pikërisht për atë truall, i cili i bashkon tiparet e serbishtes dhe të bullgarishtes. Nga ana tjetër, nëse gjatë procesit të krijimit të njëjës apo të tjetrës gjuhë letrare, njëra prej gjuhëve ballkanike qendore do të ishte ngritur në nivelin e gjuhës letrare, atëherë armiqësia ndërmjet sllavëve të ndyshëm të Gadishullit Ballkanik do të

ishite shmangur, dhe ata mund të bashkoheshin në një njësi të vetme nacional-kulturore. Ne mendojmë se dialektet maqedonase, të cilat prej bullgarëve njihen si bullgare, dhe prej serbëve si serbe, në të vërtetë qëndrojnë midis gjuhëve ku tashmë shtrihet Bullgaria dhe Serbia, dhe si të tilla, do të shërbenin si urë lidhëse për zbutjen e armiqësisë bullgaro-serbe. Arsyja e dytë për ngritjen e njërit prej dialekteve maqedonase në nivelin e gjuhës letrare, ka të bëjë me nevojën për shmangien e mëtimeve serbe dhe bullgare kundrejt Maqedonisë, për ta mënjanuar propagandën kombëtare shkurajuese për popullin maqedonas, si dhe për bashkimin e elementit sllav në Maqedoni, që të ruhet rëndësia e tij e madhe për të ardhmen politike të Maqedonisë [...]

Makedonium, f. 56.

? Cili është qëllimi i këtij teksti? Cili është mendimi i autorit për nevojën e një gjuhe letrare maqedonase? Sipas jush, ç'do të thotë krijimi i një gjuhe letrare?

II-38. Planet për zgjimin e ndjenjave kombëtare rumune në Transilvani – letra e dr. I. C. Drageskut, drejtuar Emilia Raciusë (1874)

[...] Pozicioni i lypësit nuk është i përshtatshëm për një popull si populli rumun. Paraardhësit tanë e kishin zakon që të jepnin dhe të merrnin: *ne nuk mund të lypim!*

Ju duhet të mendoni më tepër për *fshatarët* dhe për *gratë*.

Rilindja nis pikërisht këtu. Shndërrojini gratë në nëna, bashkëshorte dhe rumune të denja; transformojini fshatarët në njerëz të vetëdijshëm për dinjitetin, për të drejtat dhe për detyrimet e tyre. Vetëm atëherë ju do të keni hedhur hapin më të vështirë dhe më të rëndësishëm drejt përparimit dhe shpëtimit të kombit.

Me këto dy elemente, ju do të jeni në gjendje që të arrini gjithçka. Shkollat, shkrimet dhe konferencat janë dhe mënyrat e duhura. [...]

Lungu, f. 141-142.

? Cilat ishin mjetet e parashikuara nga autori për përforcimin e ndjenjave kombëtare rumune në Transilvani? Përse mendoni se theksi u vendos pikërisht tek fshatarësia dhe tek gratë? Cili ishte roli që u ishte ngarkuar grave?

II-39. Plani për organizimin e lëvizjes kombëtare shqiptare – letra e gazetarit Faik Konica, drejtuar baronit Goluhovski (Bruksel, 1897)

A. Së pari. Qëllimi që duhet patur dhe duhet arritur është:

1. Zhvillimi i një ndjenje kombëtare shqiptare, për t'i bërë ata të vetëdijshëm për dallimin thelbësor që ata kanë me turqit. [...]

[...]

3. Të punohet që të gjithë shqiptarët, brenda hapësirës që i lejon ligji dhe duke respektuar autoritetet qeverisëse, të kuptojnë në ç'drejtim duhen kanalizuar aspiratat e tyre për zhvillimin ekonomik dhe intelektual, nëse rrethana të paparashikuara do të përshpejtonin shpërbërjen e Çështjes Lindore.

B. Së dyti. Mjetet që do të përdoren:

a. Gazeta, e cila do të botohet në toskërisht, gegërisht²⁴ dhe frëngjisht, duhet të publikojë këngë popullore, kronika historike, poezi patriotike, çështje ekonomike, si dhe komente politike në formën e lajmeve, të cilat nuk duhet as që të ngjallin mosbesimin e Portës së Lartë me anë të komenteve të tyre armiqësore, por as që t'i shtyjnë shqiptarët nëpërmjet komentarëve mbështetës, që ata të mbajnë një qëndrim favorizues ndaj Portës së Lartë...

b. Botimi, dy apo tre herë në vit, i broshurave të thjeshta, prej mijëra kopjesh dhe në të dyja dialektet, të cilat do ta zhvillojnë ndjenjën kombëtare përmes pyetjeve dhe përgjigjeve që do t'i shmangen përfshirjes së drejtpërdrejtë në politikë [...].

f. Shkollat: ato duhet të kenë interesin tonë sa më të madh, meqenëse shqiptarët e dëshirojnë me gjithë

²⁴ Toskërishtja dhe gegërishtja janë dialektet kryesore të gjuhës shqipe.

zemër hapjen e tyre; gjithsesi, nga njëra anë kemi mungesë iniciativash, ndërsa nga ana tjetër kemi mungesë mësuesish. Prandaj do ishte e nevojshme që qeverisë osmane t'i dërgoheshin peticione prej anakënd ku ekziston nevoja për shkolla.

g. Fetë: midis të gjithë klerikëve, veçanërisht *bektashijve* [urdhër fetar mysliman], ndikimi i të cilëve tani mund të jetë i dobishëm, duhet të vendosen marrëdhënie miqësore; në përputhje me rrethanat që mund të shfaqen në të ardhmen, tendencat duhet të shkojnë tërësisht drejt autonomisë fetare.

C. Në përfundim, më lejoni të ritheksoj se e gjithë veprimtaria dhe përpjekjet tona duhet të përshkohen nga këto dy ide: asnjë parti nuk duhet të krijohet, por që të gjithë duhet të mbledhen rreth të njëjtit qëllim; gazeta (revista), shoqata, shkollat, dhe propaganda – që të gjitha duhet të mbartin vulën e një lëvizjeje spontane, ku aleancat, miqësitë apo simpatitë nuk duhet të ndikojnë në përkrahjen tonë.

Konica, 2000 f. 40.



Faik Konica (1875-1942) ka qenë një prej figurave më të spikatura të kulturës shqiptare, gjatë gjysmës së parë të shekullit të 20-të. Pas kryerjes së studimeve në Dijon dhe në Paris, në vitin 1897 ai u vendos në Bruksel, ku nisi botimin e gazetës shqiptare "Albania". Për mundësimin e saj, Konica i kërkoi mbështetje ministrit të jashtëm austro-hungarez të kohës, kontit Agenor Goluhovskit, dhe më në fund ia arriti që të siguronte mbështetjen financiare austro-hungareze për gazetën e tij.



Analizoni mjetet e propozuara për forcimin e identitetit kombëtar shqiptar.

II-40. Udhëzime mbi mësimdhënien e historisë në Greqi (1881)

Qëllimi i lëndës së Historisë Greke në shkollat fillore nuk ka të bëjë me mësimin përmendësh të ngjarjeve historike, të datave dhe të emrave të figurave historike, ose me marrjen kryesisht të njohurive historike; nga njëra anë, për edukimin moral të fëmijëve është mjaft e rëndësishme ngulitja e ndërgjegjes kombëtare, me qëllim formimin e anëtarëve të denjë për këtë komb të lavdishëm, dhe nga ana tjetër, sistemimi i njohurive historike

të marra prej lëndëve të tjera të shkollës, si dhe thellimi i përvetësimit të tyre. Nëpërmjet njohjes së madhështisë dhe lavdisë së paraardhësve të tyre – të cilët u bënë njerëz të mëdhenj përmes ligjshmërisë, papërtueshmërisë, trimërisë dhe çiltërsisë së mendjes, duke siguruar të mira materiale dhe duke e mposhtur vdekjen në dobi të lirisë dhe të detyrës – shpirtrat e fëmijëve grekë do të mbushen me adhurim dhe me dëshirën për ta ndjekur shembullin e tyre dhe për ta çuar edhe më tej çështjen e lavdishme kombëtare.

Koulouri, f. 263.



Analizoni tekstin dhe shpjegoni se cilat ishin qëllimet e mësimdhënies së historisë. Cili është mendimi juaj në lidhje me qëllimet e mësimdhënies së historisë në kohën e sotme?

► Fig. 8. Fëmijë me veshje historike (Greqi, rreth 1875-ës)



Fotopoulos, f. 259.

? Festimet e organizuara në shkolla përdoren vetëm për qëllime argëtimi, apo edhe si një mënyrë për mësimin dhe forcimin e identitetit kombëtar?

II-41 Përpjekjet për vendosjen e sportit kombëtar në Rumani (1898)

Për përhapjen e dëshirës për praktikimin e ushtrimeve fizike në vendin tonë, ministri i Arsimit, zoti Haret²⁵, ka marrë nismën për organizimin e një konkursi ndërmjet shkollave të mesme të Bukureshtit, me rastin e ditës së 10 Majit. Ky konkurs do të zhvillohet në lojën e Oinas²⁶; për grupin fitues do të jepet një çmim nderi, i cili do të mbahet nga shkolla e grupit fitues për një vit; më pas, shkollat do të konkurrojnë përsëri për të njëjtin çmim, me rastin e po së njëjtës ditë. Gatishmëria e zotit ministër për të mbështetur përhapjen e fizikut në vendin tonë, nëpërmjet konkurrimit me sportet e hershme, është plotësisht e mirëpritur: a) sepse në këtë mënyrë, një pjesë e madhe e lojërave tona, që deri më sot kanë qenë të kërcënuara për t'u zhdukur, tashmë do të praktikohen dhe do të luhen nga të rinjtë, dhe b) sepse këto, së bashku me zbatimin e një sistemi të mirë gjimnastikor, do të na sigurojnë një edukim të vërtetë kombëtar dhe patriotik, i cili është mjaft i nevojshëm për një vend që dëshiron të jetë i fortë dhe i respektuar prej bijve të vet.

Ionescu, f. 1106.

? A ka pasur apo vazhdon të ketë vendi juaj ndonjë sport që mbahet si sport kombëtar? Si mendoni, përse në fund të shekullit të 19-të, kishte njerëz që ndienin nevojën për një "sport kombëtar"? Cili ishte qëllimi i tyre?

► Fig. 9. Certifikatë e konkursit sportiv për djemtë e shkollave të mesme, organizuar nga "Gazeta Sporturilor" (në periudhën midis Luftërave në Rumani)



ACIME, 37/2000.

🔑 Fëmijët fitues i kurorëzon një figurë femëre, e cila me kostumin e saj popullor, përfaqëson Rumaninë.

? Në ç'mënyrë është përfaqësuar Rumania aty? Diskutoni lidhjen e saj simbolike dhe pamore, me djelmoshat që marshojnë. Çfarë skicash apo simbolesh paraqiten në certifikatat e sotme të vendit tuaj? Po gjatë periudhës midis Luftërave?

II-42. Mbreti shqiptar, Zogu I, mbi rëndësinë e shërbimit të detyrueshëm ushtarak në ndërtimin e kombit (1928)

Unë e shoh ushtrinë si faktorin me vlerat më të larta edukative. Nevoja më e ngutshme që ka vendi, është arsimit; dhe ata burra që janë thirrur si ushtarë, do të kthehen në shtëpi me ide shumë më të mëdha. Duhet ta kuptoni se shqiptari i zakonshëm nuk di asgjë mbi kombësinë. Ai gjithmonë i ka drejtuar

²⁵ Spiru C. Hareti (1851-1912) mbrojti doktoraturën për matematikë, në Paris. Pas kthimit në Rumani, punoi si profesor universiteti, si zyrtar i lartë për arsimin, dhe tri herë si ministër i Edukimit Publik dhe Fetar. Ai konsiderohet si simboli i përpjekjeve për modernizimin e arsimit rumun, rreth viteve 1900.

²⁶ Oina mbahet si loja kombëtare tipike rumune. Ajo është e ngjashme me bejsbollin dhe luhet ndërmjet dy skuadrave me nga 12 veta secila, në një fushë 80/50m. Topi ka një diametër prej 6-9 cm, kurse shkopi nuk është më shumë se 95 cm i gjatë. Ndonëse quhet lojë kombëtare, ata që e luajnë dhe që i njohin rregullat e saj, janë shumë të paktë.

sytë tek i pari i fisit, ose tek beu, si autoritetet më të larta. Atij iu desh që të mësohej gradualisht, që besnikërinë e tij, të admirueshme në vetvete, ta kalonte nga krerët lokalë, drejt qeverisë qendrore. Ai duhet ta mësojë se duke qenë anëtar i një fisi të caktuar, ai gjithashtu është njëherazi edhe nënshtetas i shtetit.

Fischer, f. 23.

? Ahmet Zogu (1895-1961) ka qenë udhëheqësi i shtetit shqiptar në periudhën midis dy luftërave botërore. Ai ishte presidenti i Shqipërisë gjatë viteve 1925-1928 dhe mbreti i saj gjatë viteve 1928-1939, duke mbajtur emrin Zogu I.

? Sipas pikëpamjes së Zogut, çfarë kishte më shumë rëndësi: roli që luante shërbimi i detyrueshëm ushtarak për rritjen e aftësive mbrojtëse të vendit, apo roli që ai luante për formimin e identitetit kombëtar tek të rinjtë shqiptarë? Po ju si mendoni: a ishte shërbimi ushtarak një mjet i përshtatshëm për arritjen e këtyre qëllimeve? Cili është qëndrimi i shoqërisë suaj ndaj shërbimit të detyrueshëm ushtarak?

► **Fig. 10. Fëmijë rumun i veshur si ushtar i vogël (1916)**



? Si e shpjegoni prirjen për t'i veshur fëmijët e vegjël me uniforma ushtarake? A mendoni se kjo prirje ishte thjesht një modë, apo mbarte edhe një kuptim shoqëror dhe pedagogjik?

II-43. Qëllimet e arsimit turk, të përkufizuara nga Zija Gokalpi (1914)

Nëse studiojmë programin e një shkolle [turke], do të vërejmë se fëmijët mësohen sipas tri kategorive të mësimnxënies: (1) Atyre u mësohet gjuha, letërsia dhe historia, të cilat janë ato turke; (2) Ata njihen me Kuranin, me texhvitin [leximin e Kuranit me ritmin dhe intonacionin e duhur], me katekizmin, dhe me historinë e Islamit dhe të gjuhëve islamike [arabishtes dhe persishtes]; (3) Ata ushtrohen gjithashtu në matematikë, në shkencat e sakta dhe në gjuhët e huaja [europiane], të cilat do t'i ndihmojnë gjatë studimeve të mëtejshme në këto shkenca, ashtu sikundër ushtrohen edhe në zanate dhe në gjimnastikë.

Kjo tregon se synimet që ndjekim në arsimin tonë janë tri: turkizmi, islamizmi dhe modernizmi. Asnjë baba turk nuk mund të pranojë që fëmija i tij të mos arsimohet në gjuhën turke, ose të mbetet i paditur në lidhje me historinë turke. Gjithashtu, nuk mund të pranojë që fëmija i tij të mos njohë besimin dhe ritet islame, ose të mos njihet me historinë e Islamit. Nga ana tjetër, ai gjithashtu dëshiron që fëmija i tij të përgatitet si njeri modern, përveç edukimit të tij si turk dhe si mysliman. Ndaj duhet që arsimit ynë i plotë të përfshijë këto tri fusha: edukimin turk, edukimin islamik dhe edukimin modern. [...] Të tria këto elemente të arsimit duhet që të ndihmojnë dhe të plotësojnë njëra-tjetrën. Por nëse nuk arrijmë që të përcaktojmë funksionet dhe të ndajmë fushën e secilit në mënyrë të arsyeshme, pa e vënë theksin më tepër se duhet tek njëri prej tyre, atëherë ato mund të kundërshtojnë, e madje dhe të armiqësohen me njëra-tjetrën.

Vucinich, f. 157-159.

? Zija Gokalpi (1876-1924) ishte një prej figurave udhëheqëse të lëvizjes xhonturke, si dhe ideologu kryesor i nacionalizmit turk.

❓ Ç'mendoni për qëllimin e autorit që të vendosej baraspesha ndërmjet të tria llojeve të arsimit? A ishte diçka praktike që në shkollat fillore të përfshiheshin të tria llojet? Si ishte gjendja në vendin tuaj gjatë fillimit të shekullit të 20-të? Po sot?

II-44. Pjesë e shkëputur nga një promemorie e Ministrisë së Arsimit dhe Çështjeve Fetare të Malit të Zi, 1908

Qëllimi kryesor në rritjen e fëmijës është forcimi i karakterit të moralshëm dhe formimi i këtij karakteri nënkupton arsim shumëplanësh. Pra, shkollat kanë detyrë që t'u japin nxënësve arsim shumëplanësh. Kjo nënkupton që nxënësve t'u futen në zemër elemente të caktuara kombëtare, t'u paraqiten njohuri të cilat përçojnë ide të ngjashme, në mënyrë që të mos mbeten të ndarë, të izoluar dhe të përhumbur në shpirtin e tyre. Kjo është e nevojshme për të arritur integritetin e ndërgjegjes dhe shpirtit.

Paviçević, Raspopoviç, Volumi IV, f. 650.

II-45. Politika gjuhësore dhe e trajtimit të historisë e Ataturkut, e kritikuar nga një kundërshtar i tij (shënime ditari, 1932)

17 korrik 1932

Mustafa Qemali mblodhi një kongres historik në Ankara [...] Ata po flasin shumë budallallëqe, duke e shndërruar tërë botën në Turqi [...] Për tetë vjet rresht, Mustafa Qemali u paraqit si një gjeni i mendimit ushtarak, gjeni i politikës, gjeni i bujqësisë etj. Tani këtij burri iu tek që të bëhet edhe një historian i madh [...] Qëllimi dhe synimi i kongresit është ky: Mustafa Qemali zbulon gjëra të reja në histori, ai ngre teorira mbi historinë, dhe na bëhet një historian i madh, një gjeni i historisë. Kujt nuk do t'i vinte turp të synonte për të tilla gjëra qesharake. [...] Në librin që ka botuar, na i tregon

me shigjeta vendet e pushtuara prej turqve. Nuk ka asnjë vend ku ata të mos kenë shkuar. Ai na i bën grekët turq, për shkak të fjalës "Ege", dhe irlandezët turq, për shkak të rrokjes [Ir]. Çfarë marrëzie, çfarë paditurie, sa qesharake! Por ai na harroi Iranin e shkretët [...] Nëse kombet na u kthehan në turq prej rrokjes [ir], atëherë çfarë problemi ka Irani? Ai gjithashtu fillon me [Ir]. Si është e mundur kjo marrëzi [...]

Kështu gaziu i pohon Junuz Nadiut, se në fjalorin "Çagatai" të Shejh Sulejmanit, gjendet fjala "kilturmak", së cilës po t'i heqësh prapashtesën "mak", atëherë mbetet pjesa "kiltur", e cila është edhe forma origjinale e termit frëng, kulturë. Ata e morën këtë prej nesh. O zot, më ndihmo! A duhet të qaj, të qesh, apo të vdes? Kur lexoj shpikjet e këtij njeriu, unë që ndodhem në Paris, turpërohem. Fjala "kilturmak" nuk është gjë tjetër, veçse fjala "getirmek" [sjell]. Ku është kultura këtu?

[...]

8 shtator 1932

Sipas *Millijetit*²⁷, e cila mbërriti sot, Mustafa Qemali thërriti këtë muaj një kongres gjuhësor në Pallatin e Dolmabahçesë. O Zot, ki mëshirë për gjuhën tonë [...] Kush e di se çfarë do të na nxjerrë tani ky njeri? Çështja e gjuhës do të jetë edhe më e ndërlikuar. Do jetë edhe më e vështirë për të bërë një spastrim të ri. Sa mirë do të ishte sikur ai të mos e kishte bërë fare këtë gjë. Nuk e di se si vepron ky njeri. Vetëm për dy vjet, na u bë historian. Botoi një libër të historisë turke, të mbushur me sajimet e veta, dhe e ka futur me detyrim nëpër shkolla. Mëshirë për kohën dhe për mendjet e fëmijëve turq! Dhe tani, na u bë përnjëherësh edhe filolog.

Nur, III, f. 547.

❓ Për nxitjen e nacionalizmit turk, gjuha dhe historia kanë zënë pjesën kryesore të politikës së Ataturkut. Ç'mendim keni për veprimet e ekzagjuara, të kritikuar në shënimet e ditarit të një intelektual kundërshtar? A do të kishte qenë e efektshme kjo lloj kritike, sikur ajo të ishte shprehur publikisht? A dini veprime të ngjashme të ekzagjuara në vendin tuaj?

²⁷ Gazetë.

II-46. Besa dhe gjakmarrja sipas ligjit tradicional të Lekë Dukagjinit

NYE I NJIQINDENJIZETEDYTË BESA

§.854. Besa është një vade lirije e sigurimi, qi shpija e të vramit i ep dorërasit e shpijarve të tij, tuj mos i ndjekë per gjak perkohsisht e një në vade të caktueme.

§.855. Me çue gjind për besë është kanû, me dhânë besë është detyrë e burrni.

§.856. Shpija e të vramit, po i dha besë dorërasit, ky edhëpse e vrau, do të shkojë në mort e në gjâmë me percjellë të vramin deri në vorrim e me ndëjë per drekë. -Kio besë ngjatë 24 orë.

§.857. Po s'shkoi dorërasit ne gjâmë e ne drekë permbas besës së dhânun, nuk i xêhet per shburrim shpis së të vramit, edhë në mos i dhashtë besë, tuj kênë së dorërasit i a shtoi dhunën mbi dhûnë.

§.858. Permbasi të hijë i vrami në dhé, katundi kà tagër, mbas kanûnit, me i a xjerrë besen dorërasit e shpijarve të tij.

§.859. Besa e katundit është tridhetë ditshem.

§.860. Po ngurroi shpija e të vramit e s'u gjej me i dhânë besë katundit, dorërasit me gjithë shpijarë e kushrini të dame zjarmit do të rrijë mshilë.

§.861. Kurrkush tjetër nuk mûnd të bije me ia xjerrë besën dorërasit e shpija e të vramit nuk mûnd t'i apë kuej besë, për pà ndreqë katundin e vet.

NYE I NJIQINDENJIZETESHTATË.

"Gjaku për faj nuk jet".

909. Çdo faj, qi t'i bajë Shqyptari Shqyptarit, tagër kà me e mundue me pleq e me pëgje, porsë nuk mûnd t'a vrasë, 'së "Gjaku për faj nuk jet".

910. Po më shau kush, e un e vrava, ia kam gjakun.

911. Po erdh kush me m'i dhânë zjarrë shpis, a ksollës, a tbanit, un e prita edhë e vrava, i karn gjakun.

912. Po erdh kush me të vjedhë, edhë e shef tuj t'a zhbërthye derën, e vrave, i ké gjakun.

913. Erdh kush met'a dliirë vathin, e sheftujt'a vû tufën e gjasë përpara, rrane me xjerrë gjânë tande e atij s'i lodhet mendja me t'a lshue, po e vrave, bjen në gjak.

914. T'u mbat kush a të rà, ti e vrave, bjen në gjak.

915. Të hypi kush në qafé, edhë pse janë dy duer për një krye, po e vrave, i ké gjakun.

<http://ebookbrowse.com/kanuni-i-lek-dukagjinit-pdf-d238875778>



Kanuni i Lekë Dukagjinit është një paketë e ligjeve tradicionale shqiptare, të cilat kanë ekzistuar vetëm në formë gojore, deri në fillim të shekullit të 19-të. Mendohet që *Kanuni* të jetë kodifikuar për herë të parë nga Lekë Dukagjini (1410 – 1481), i cili ishte një princ shqiptar dhe një bashkëkohës i Skënderbeut. Në periudha dhe rajone të ndryshme kanë evoluar gjashtë variante të ndryshme të *Kanunit*. Në fillim të shekullit të 20-të, Shtjefën Gjeçovi (1874 – 1929), një murg katolik françeskan, filloi të shkruante *Kanunin* por nuk e publikoi atë. Pas vdekjes, vëllezërit e tij françeskanë, përpiluan një version të *Kanunit*, duke përdorur materialet e mbledhura nga Gjeçovi por duke marrë pjesë edhe nga Bibla, duke përdorur përkufizime të ligjeve etj. Libri, i cili mbante emrin e Gjeçovit, u publikua për herë të parë në Shkodër në vitin 1933. Disa pjesë të *Kanunit* ishin botuar në mënyrë sporadike në periodikë Shqiptarë, por nuk ka pasur asnjë botim para vitit 1913 (botimi i I, në analizën *Hylli i Dritës*). *Kanuni* i vitit 1933 përfshin 1262 nene dhe 12 libra: Kisha, Familja, Martesa, Shtëpia, Bagëtia dhe Prona, Puna, Transferimi i Pronës, Fjala e dhënë, Nderi, Dëmet, Ligji i Krimeve, Ligji gjyqësor, *Kanuni* për të moshuarit, Të veçanta dhe përjashtime.

II-47. Kujtimet e Mahmud Esad Bozkurtit, mbi thelbin nacionalist të "Revolucionit të Ataturkut"

Në Republikën e re turke, në krye të punëve shtetërore do të ketë vetëm turq. Ne nuk kemi besim tek ata njerëz që nuk janë turq. Aspekti më i veçantë i revolucionit të Ataturkut, ka të bëjë me nacionalizmin dhe me të qenit turk. Një parim i tillë e ka spastruar të kaluarën, duke sjellë modernizmin. I gjithë revolucioni turk, me të gjithë veprimtarinë e vet, bazohet në këtë parim. Zhvendosja më e vogël prej tij do të na çonte veçse mbrapa dhe do të thotë vdekje.

Bozkurt, f. 354-355.



Mahmud Esad Bozkurti shërbeu si ministër i Brendshëm gjatë periudhës së Ataturkut. Ai ishte njëri prej ideologëve të parë që e ktheu qemalizmin në doktrinë.



Pyetje të përgjithshme:

Krahasojini tekstat II-38, II-39, II-40, II-41, II-42 dhe II-43, ashtu si dhe figurat 8, 9 dhe 10. Cilat ishin mënyrat e ndërtimit të kombit, si dhe ato të nxitjes së një identiteti të përbashkët, që u përdorën në shtetet e reja kombëtare të Europës Juglindore?

KAPITULLI III: Ideologjitë kombëtare

Kultura ka luajtur rol thelbësor në ngritjen dhe konsolidimin e kombeve. Elitat e shteteve kombëtare europiane juglindore e kuptuan këtë gjë dhe bënë përpjekje të mëdha për krijimin e një modeli kombëtar për të gjithë prodhimtarinë kulturore. Kombëtarizimi i kulturës përfshinte jo vetëm përsiatje të vazhdueshme për kombin dhe perceptimin e karakteristikave kombëtare të veçanta, por edhe përdorimin e një game të gjerë simbolesh kombëtare. Në këtë kapitull janë paraqitur vetëm një pjesë e vogël e tyre. Flamurët, emblemat dhe himnet u shndërruan në simbolet e shtetit dhe popujt u edukuan që ta identifikonin vetveten me to. Shkallë-shkallë, secili shtet përcaktoi një ose disa festa kombëtare, të cilat përkujtonin ngjarjet heroike të kombit. Historia shërbeu si një burim i pashtershëm simbolesh dhe heronjsh. Intelektualët dhe politikanët përzgjedhën figura dhe ngjarje të ndryshme historike dhe i shfrytëzuan për ndërtimin e një të kaluarë që u përshtatej ideve dhe interesave të tyre të kohës. Shumica e heronjve kombëtarë e kishin zanafillën në të kaluarën e largët. Të tjerët u përzgjedhën nga ditët e sotme. Ata u përdorën për nxitjen e krenarisë në kohë paqeje, si dhe për forcimin e unitetit dhe të përkushtimit kombëtar në kohë lufte. Që nga fundi i shekullit të 19-të e në vazhdim, çdo komb europian duhej që të kishte të paktën një poet kombëtar, një piktor ose skulptor kombëtar, si dhe një kulturë popullore kombëtare, përfshirë këtu krijimtarinë popullore, si dhe veshjet kombëtare. Për forcimin e identitetit dhe të krenarisë kombëtare u përdorën edhe kuzhina ose sportet karakteristike. Marrëdhëniet ndërmjet kombeve nuk u kufizuan vetëm në garën e simboleve. Në të vërtetë, konfliktet politike në Europën moderne kanë qenë të shpeshta dhe Europa Juglindore me shtetet e saj të brishta dhe me mëtimet e shumta territoriale, nuk përbënte ndonjë përjashtim. Përgatitja e kombit për luftë ka qenë synimi kryesor i ideologjive kombëtare. Panteonet kombëtare u mbushën me udhëheqës politikë dhe me heronj lufte. Përveç burrave, një vëmendje e veçantë iu kushtua edhe grave e fëmijëve, të cilët u shquan në luftën për kombin. Në përgjithësi, gratë dhe fëmijët perceptoheshin si të pafajshëm e zemërgjerë, dhe përfshirja e tyre në luftën për qëllimet kombëtare u konsiderua si dëshmia e fundit për të vërtetuar se këto qëllime dhe e tërë lufta kombëtare ishin të justifikuar dhe ia vlenin. Gratë, si nëna dhe edukatore të fëmijëve të tyre, dhe fëmijët, si nënshtetas dhe ushtarë të së ardhmes, luajtën një rol të rëndësishëm për krijimin e besimit se e ardhmja e kombit ishte e ndritshme dhe e sigurtë.

IIIa. Ç'është kombi?

III-1. Të drejtat dhe detyrat e kombit rumun, përkufizuar nga poeti dhe politikani Dimitrie Bolintineanu (1869)

Rumunët janë një komb; kombi është populli dhe të gjitha shtresat që e përbëjnë atë, të cilat jetojnë së bashku në tokën e paracaktuar për ta, nën të njëjtat ligje, me të njëjtën gjuhë e me të njëjtat zakone. Çdo komb ka karakterin e vet, që e bën atë të ndryshëm nga të tjerët. Ashtu si dhe njeriu që ka të drejtat dhe detyrat e tij ndaj shoqërisë,

edhe kombi ka të drejta dhe detyra të njëjta ndaj vetvetes dhe ndaj kombeve të tjera; të drejtat janë gjithashtu edhe detyra. E drejta më e çmuar e një kombi është ajo e vetëqeverisjes sipas dëshirës së tij, ndërsa e drejta e dytë është të mos shuhet; kombi ka gjithmonë të drejtë që me forcën e vet, të flakë çdo lloj agresioni të huaj të padrejtë; e drejta e tretë e kombit është të zhvillojë plotësisht dhe lirshëm gjithë aftësitë e veta, për aq kohë sa ushtrimi i tyre nuk dëmton interesat e kombeve të tjera. Detyra e parë e kombeve, e një kombi ndaj të tjerëve, e cila

përfshin dhe të gjitha detyrat e tjera, është ajo që kërkon prej tyre ta duan dhe ta ndihmojnë njëri-tjetrin...

Bolintineanu, II, f. 501.



Dimitrie Bolintineanu (1819-1872) ka qenë poet, shkrimtar dhe politikan rumun. Lindi në një familje vllahe me origjinë maqedonase, mori pjesë në lëvizjen revolucionare në Vllahi në vitet 1840, veçanërisht më 1848-n, kur qe edhe anëtar i Qeverisë së Përkohshme, dhe themeloi gazetën *Poporul Suveran* [Populli sovran]. Në vitet 1863 dhe 1864, ai u bë disa herë ministër i Punëve të Jashtme, si dhe ministër i Arsimit Publik dhe Fetar.



Sipas autorit, cilat janë elementet që përcaktojnë një komb? Gjeni përkufizimin e “kombit” në fjalor dhe bëni krahasimin e tyre. Sipas autorit, cilat janë të drejtat më të rëndësishme të kombit?

III-2. Tiparet themelore të kombeve, sipas një teksti shkollor serb (1870)

Fjala “komb” mund të lexohet shpeshherë nëpër gazeta ose libra, si dhe mund të dëgjohet çdo ditë gjatë bisedave, kështu që ia vlen t’i kujtojmë vetvetes se ne gjithashtu jemi komb dhe se ai quhet “kombi serb”. Njëherë, kur në shtëpinë e Radosavit u përmendën fjalët “kombi serb”, djali i tij kërkoi që të dinte se ç’ishte kombi dhe se cilët ishin serbët. Më tej, biseda vazhdoi në këtë mënyrë:

Babai: A mund të më thuash, biri im, se çfarë është familja?

Djali: Po baba. Familja janë fëmijët me babanë dhe nënën e tyre.

Babai: Po kur babai ka vëllezër dhe nëna ka motra, e që të gjithë këta kanë fëmijët e tyre – a nuk është kjo sërish një familje?

Djali: Po baba, është. E tërë kjo, së bashku, është një familje. [...].

Babai: Kjo është ajo që doja të të thoja për kombin. Mijëra e mijëra familje, siç e dimë, janë të shpërndara nëpër kodra e lugina, buzë lumenjve ose detit, në toka të varfra a pjellore, në të gjithë botën anembanë. Ky numër i stërmadh njerëzish nuk flet të njëjtën gjuhë për t’u marrë vesh. Kjo është arsyeja përse njerëzit e botës janë të ndarë në grupe më

të vogla, anëtarët e të cilave komunikojnë sipas mënyrës së tyre, me gjuhën e vet. Prandaj, çdo grup që flet në një mënyrë të atillë të pakuptueshme prej të tjerëve, quhet komb. [...].

Babai: Kombet dallohen nga gjuha. Mijëra familje që flasin të njëjtën gjuhë dhe që e kuptojnë njëri-tjetrin, formojnë një komb. Nëse ti, për shembull, largohesh prej këtej, atëherë do ta kuptosh lehtësisht se deri ku shtrihet kombi ynë. Kudo që të shkosh, në veri, në jug, në lindje ose në perëndim, kudo që dëgjon njerëz që flasin si ne ose në një mënyrë lehtësisht të kuptueshme prej nesh, ai është i tëri një komb. Por ka edhe diçka tjetër karakteristike të kombit. Nëse ti, për shembull, do të shkosh shumë larg prej këtej, atëherë do të shikosh njerëz të cilët jo vetëm nuk flasin gjuhën tonë, por edhe nuk krenohen me Millosh Obiliçin, që nuk kanë poema për princin Marko, që nuk festojnë slavan tonë, që nuk shkojnë nëpër ceremonitë kishtarë, e që nuk mbajnë zi për Kosovën tonë. Shpeshherë ata nuk dinë asgjë për të. Kështu pra, njerëzit të cilët flasin të njëjtën gjuhë, që besojnë tek e njëjta lavdi kombëtare e që e kujtojnë njëri-tjetrin kudo që të jenë, por që kanë edhe zakone të njëjta, quhen një komb.

Djali: Kombe të tilla ka shumë nëpër botë, apo jo, baba?

Babai: Shumë, biri im! Dhe secili prej tyre ka emrin e vet. Aty ku ka një komb – ka dhe një gjuhë; kur ka një gjuhë – ka dhe një emër! Ata që flasin gjuhën tonë, janë serbë, ndërkohë që kombet e tjera janë të panumërta. Pranë nesh gjenden: bullgarët, rumunët ose vllehtë, hungarezët, sllovenët, italianët, gjermanët, kështu pra, në botë gjenden shumë kombe.

Djali: Kjo, baba, do të thotë se çdo komb ka emrin e tij, ashtu si edhe çdo njeri ka emrin e vet. [...].

Më tej, kur disa kombe janë të lidhura nga gjuha ose nga zakonet, sikundër jemi ne me bullgarët, sllovenët, çekët, polakët, rusët, si dhe me dy-tre të tjerë, atëherë ata konsiderohen një familje, një fis i madh. Ky fis dhe kjo marrëdhënie në të cilën ndodhemi ne, quhet “fisi sllav”. Dhe prej këtij fisi, ne (serbët dhe kroatët), bullgarët dhe sllovenët quhemi “Sllavët e Jugut” ose “Jugosllavët”, meqenëse jetojmë në jug, ndërsa sllavët e tjerë jetojnë në veri ose në lindjen tonë.

Srpska, I, f. 9-17.

? Sipas shpjegimit të dhënë në këtë tekst, cilat janë tiparet kryesore të kombit? Cilat janë elementet e veçanta të identitetit kombëtar serb që paraqiten aty? Cilat ishin qëllimet edukative të këtij teksti? Cili është mendimi juaj për shpjegimin e dhënë? Krahasojeni atë me përkufizimet bashkëkohore për kombin, që gjenden në tekstet tuaja të edukatës qytetare.

III-3. Përkufizimi i Zija Gokalpit për kombin (1923)

Atëherë, çfarë është kombi? Cila është marrëdhënia tjetër mes nesh, që mbizotëron përmbi forcën racore, etnike, gjeografike, politike apo të vullnetshme? Shkenca e sociologjisë dëshmon se kjo marrëdhënie është partneriteti a bashkëpunimi i arsimimit me edukimin dhe me kulturën – pra, një partneritet i ndjenjave [...] Nga këto pohime del qartë se kombi nuk është një bashkim racor, etnik, gjeografik, politik ose i vullnetshëm. Ai është një grup, i përbërë nga burra dhe gra, të cilët kanë patur të njëjtin edukim dhe kanë marrë të njëjtat njohuri për gjuhën, fenë, moralin dhe estetikën [...] Prandaj, kërkimet gjenealogjike mbi kombësinë janë të kota. Ato duhen përqendruar vetëm tek arsimi, edukimi dhe tek idealet kombëtare.

Gökalp, f. 11-15.

? Krahasojeni këtë tekst me II-43: Cili është elementi kryesor që thekson autori si karakteristikë të një grupi kombëtar? Ç'rol i jep ai edukimit?

III-4. Ndryshimet në përkufizimin e Mustafa Qemal pashës mbi kombin

A. Theksimi i fesë gjatë luftës (1920)

Parimi i përgjithshëm është ky: ata elementë të ndryshëm islamikë, të cilët jetojnë brenda atyre zonave që ne i kemi përcaktuar si kufij kombëtarë, janë vëllezër të vërtetë, të cilët respektojnë të drejtat etnike, rajonale dhe etike të njëri-tjetrit. Për këtë arsye, ne nuk duam që të bëjmë ndonjë

gjë kundër dëshirës së këtyre njerëzve. Ajo për çka jemi plotësisht të sigurtë, është se brenda kufijve kombëtarë, të gjithë elementët islamikë kurdë, turq, lazë, çerkezë etj. kanë interesa të përbashkëta dhe kanë vendosur që të punojnë së bashku. Ne nuk kemi ndonjë pikëpamje tjetër. Ne kemi një dëshirë të përzemërt dhe një unitet vëllazëror dhe fetar. Prandaj nuk është për t'u vënë fare në dyshim [...] që lazi ose kurdi do ta japë votën e tij, kur ajo t'i kërkohet [...]

Ozturk, f. 196-197.

B. Shtimi i kulturës (1922)

Populli i Turqisë, i cili gëzon një unitet racor ose fetar dhe që në aspektin e tij kulturor është i mbushur me respekt të ndërsjellë dhe vetësakrificë ndaj njëri-tjetrit, përbën një trup shoqëror, i cili ka interesa të përbashkëta dhe një të ardhme të përbashkët.

Atatürk'un, f. 52.

C. Theksimi i unitetit (1924)

Dukuritë natyrore dhe historike, të cilat kanë luajtur rol në krijimin e kombit turk, janë:

- 1- Uniteti në organizimin politik
- 2- Uniteti në gjuhë
- 3- Uniteti gjeografik
- 4- Uniteti në racë dhe origjinë
- 5- Lidhja historike
- 6- Përafria morale dhe etike

Prania e rrethanave të tilla gjatë formimit të kombit turk nuk haset plotësisht edhe nëpër kombet e tjera. Për të mbërritur në një përkufizim më të përgjithshëm, mund të themi se një bashkësi quhet "komb", nëse këto rrethana ekzistojnë pjesërisht ose plotësisht në të njëjtën kohë.

Atatürk'un, f. 70.

D. Përgjithësimi dhe thjeshtëzimi (1929)

Le të japim një përkufizim që do t'i përshtatet, aq sa të jetë e mundur, çdo kombi. Ata popuj që kanë: trashëgimi të pasur kujtimesh, dëshirë dhe pëlqim të sinqertë për të jetuar së bashku, vullnet të barabartë për të mbrojtur kujtimet e përbashkëta, formojnë

një bashkësi të quajtur “komb”. Sipas kësaj, nëse themi se “kombi” është bashkësia e krijuar prej njerëzve që i përkasin të njëjtës kulturë, atëherë kemi dhënë edhe përkufizimin më të shkurtër të “kombit”.

Ataturk'un, f. 46.

IIIb. Vetidentifikimi kombëtar

III-5. Të qenët bullgar – poezia *Unë jam bullgar nga Ivan Vazov (1917)*

Unë jam bullgar dhe i fortë,
i lindur nga nëna bullgare.
Kaq shumë bukuri dhe mirësi
të dashur e bëjnë për mua tokën amë.

Unë jam bullgar dhe i dua,
malet tona të gjelbëruara.
Të quhem bullgar
është kënaqësi e madhe për mua

Unë jam bullgar i lirë
dhe jetoj në vendin e lirisë.
Çdo gjë bullgare
e dua, e shikoj dhe e adhuroj.

Unë jam bullgar dhe po rritem
në këto ditë të mëdha,
në këto kohë të lavdishme.
Jam bir i kësaj toke të mrekullueshme,
jam bir i këtij fisi trimash.

Вазов, f. 7.



Ivan Vazov (1850-1921) ishte poet dhe politikan bullgar, i njohur si “patriarku i letërsisë bullgare”. Ai lindi në Sopot, në Luginën e Trëndafilave, në Bullgari. Emigroi në Rumani dhe Rusi dhe u përfshi në lëvizjen bullgare për çlirim. Poezia e tij e parë ishte “Lufta”, gjatë luftës së viteve 1877-1878 botoi librin “Shpëtimi”, dhe pas krijimit të shtetit bullgar bëri një sintezë të sundimit osman në romanin e parë dhe të famshëm bullgar, “Nën Zgjedhë”. Gjatë Luftërave Ballkanike dhe Luftës I Botërore botoi një sërë poezish nacionaliste (shih. Librin e punës 3, Luftërat Ballkanike, tekstet II-5 dhe V-17). Poezia “Unë jam Bullgar” mësohet në të gjithë shkollat fillore në Bullgari.



Përse mendoni se kemi kaq shumë përkufizime apo mundësi përkufizimesh për kombin? A mund t’i lidhni përkufizimet e ndryshme të Ataturkut me rrethanat e veçanta historike që mund të kenë ndikuar në perceptimet e tij për kombin? A mund të jepni edhe ju një përkufizim tuajin?

III-6. Të qenët shqiptar – mendimi i Pashko Vasës (1879)

Sipas mendimit tonë, qofshin myslimanë, ortodoksë ose katolikë, populli shqiptar është dhe mbetet ashtu siç ka qenë edhe 30 shekuj më parë, populli më i lashtë i Europës, raca që është përzier më pak nga të gjitha racat e tjera të njohura - në mënyrë të mahnitshme dhe të pashpjegueshme i ka rezistuar kohës, e cila shkatërron dhe ndryshon, ka qenë i zoti të ruajë gjuhën e tij, pa patur letërsi ose qytetërim të përparuar dhe, për më tepër, ka arritur t’ia dalë mbanë në ruajtjen e tipit origjinal dhe karakteristik, duke mos u shfaqur i pashoqërueshëm dhe duke mos refuzuar besimet dhe ritet e feve të cilat ai i ka përqafuar, ndërkohë që ato shfaqeshin fitimtare me kalimin e shekujve.

Vasa, f. 22.



Pashko Vasa (1825-1892), shkrimtar dhe personalitet i shquar i shekullit të 19-të, lindi në qytetin e Shkodrës. Pas një rinie plot peripeci (pjesëmarrës në Revolucionin Italian të 1848-s), ai kreu disa detyra në shtetin osman dhe më pas u bë guvernator i përgjithshëm i Libanit. Gjatë periudhës si nëpunës civil, besnik i Perandorisë Osmane, ai organizoi disa shoqëri kulturore shqiptare, si dhe bëri shumë botime për gjuhën, historinë dhe politikën shqiptare. Projektet e tij politike nuk synonin krijimin e një Shqipërie të pavarur, por bashkimin e të gjitha territoreve osmane shqipfolëse në një njësi të vetme administrative (vilajet), me një nivel të caktuar autonomie vendore.

► **Fig. 11. Vetëpërcaktimi kombëtar nëpërmjet pamjeve – kartolinë slovene (fillimi i shekullit të 20-të)**



► **Fig. 12. Vetëpërcaktimi kombëtar nëpërmjet pamjeve – kartolinë rumune (fillimi i shekullit të 20-të)**



România, f. 55.



Kjo kartolinë është pjesë e një serie që pasqyron figura rumune, të veshura me kostume popullore apo duke u marrë me veprimtari tradicionale.



Krahasoni dy kartolinat. A mund të ndikojë në forcimin e identitetit kombëtar një kartolinë? Nëse po, në ç'mënyrë?

III-7. Të qenët turk – opinion i dr. Riza Nurit (1932)

Kombi turk është kombi më i përkrahur prej Zotit. Inteligjenca, heroizmi, aftësitë shkencore dhe ato artistike iu dhanë atij, shumë më tepër se kombeve të tjera. Ne jemi ata që, përpara dhe pas Krishtit, kemi krijuar shumë qytetërime në zonën që nga Deti i Kinës, e deri në Ballkan, Egjipt edhe Marok. E gjitha kjo është rezultat i vlerës së çmuar të aftësive që gjenden brenda gjakut turk [...]

Nur. f. 523.

III-8. Të qenët slloven – mbi karakterin e sllovenëve, nga Dimitri Rupel (1987)

Në të kaluarën, konvertimi [i fesë] duket se ishte mjeti kryesor për çlirimin slloven. Konvertimi nënkupton zëvendësimin e zotave, të shenjtoreve, të moralit shpirtëror dhe të kulturave. Ai përbën një ndryshim shoqëror rrënjësor, i cili përmbys vlerat, idetë, rregullat dhe ligjet. Konvertimi nga një fe në një tjetër ka qenë një veçori e kombit slloven, që prej fillimeve të tij. [...]

Asnjë nga kovertimet kryesore nuk shënoi kthim mbrapa për sllovenët. Përkundrazi, ato mundësuan mbijetesën dhe zhvillimin. Nga ana tjetër, bashkëjetesa me konvertimet çon në zhvillimin e një mendësie të veçantë ose të një shpirti kombëtar. Përkohësisht, një mendësi e tillë mund të cilësohet si një shpirt pajtueshmërie, kompromisi dhe vetësakrifikimi, ose si një qëndrim i arsyeshem dhe pranues. Në fushën e politikës, shpeshherë sllovenët ndoqën rrugën e hapave të vegjël, të aleancave të pasigurta dhe të tolerancës, për të cilat disa herë i kritikuan rëndë e moralisht. Një mendësi e tillë i

çoi ata drejt vetëdorëzimit, çka u shpreh përmes emigrimit dhe shkallës së lartë të vetëvrasjeve.

Stokes, f. 281-282.



Dimitri Rupeli është intelektual dhe politikan slloven. Ai lindi në 1946-n, studioi për letërsi dhe sociologji dhe më vonë u bë profesor i asociuar në Universitetin e Lubjanës. Gjatë viteve 80-të, drejtoi gazetatat me karakter kritik *Problemi* dhe *Nova Revija*, që nismëtar i idesë për pavarësinë e Sllovenisë, dhe në janar të vitit 1989 u bë kryetar i Bashkimit Demokratik Slloven. Bashkimi Demokratik Slloven u bë pjesë e koalicionit opozitar DEMOS, i cili fitoi zgjedhjet e para pluraliste në Slloveni, në prill të 1990-s. Pas kësaj, ka qenë njëri prej politikanëve kryesorë të Sllovenisë, dhe është zgjedhur dy herë si ministër i Punëve të Jashtme.



Shikoni katër tekstet e mësipërme, fshini përkatësinë kombëtare ose përemrin “ne” dhe plotësojini vendet bosh me identitetin tuaj kombëtar. A mund të gjeni elemente të përbashkëta ndërmjet tyre? Bëni një listë me elementet e përbashkëta dhe me ato të ndryshme që do të gjeni.

III-9. Vetidentifikimi i fshatarësisë rumune, jo sipas përkatësisë kombëtare – nga kujtimet e George Jonesku-Gionit (1889)

Të gjithë e mbajnë mend se si deri në vitet e fundit, nëse dikush do të pyeste një fshatar “Çfarë je ti?”, ai do të përgjigjej duke kruajtur kokën dhe duke buzëqeshur: “Zotëri, e çfarë mund të jem tjetër? I krishterë, si gjithë të krishterët e tjerë përpara Zotit!” Duke përdorur po të njëjtën gjuhë, e pyeta: “Mirë, more mik, por pse vetëm i krishterë? I krishterë! Edhe bullgari është i krishterë... Edhe moskoviti është i krishterë... Gjithashtu, edhe greku është i krishterë... Edhe ti qenke i krishterë! Por ti duhet të jesh edhe diçka tjetër, apo jo? A nuk e ndien ti veten rumun, pors paraardhësit e tu, rumun i lashtë si lisi, e me një krah të fortë, që e çan kraharonin e armikut më dysh?”

–“Eh, mor zotëri, - m’u përgjigj fshatari, - ku i di unë këto gjëra; ti flitke si nëpër libra...”

Ionescu-Gion, f. 16-17.



George Jonesku – Gioni (1867-1904) ka bërë mjaft botime si gazetar dhe historian. Pasi studimet i kreu në Paris dhe Bruksel, punoi si mësues i gjuhës frënge dhe i historisë për shkollat e mesme dhe më vonë punoi si inspektor i përgjithshëm për arsimin e mesëm. Paragrafi i mësipërm është shkëputur prej një konference të mbajtur në Athenaeum, në Bukuresht.



Si e paraqet autori ndryshimin midis përkatësisë fetare dhe asaj kombëtare? Sipas pikëpamjes së Jonesku-Gionit, cila është më e rëndësishme? Përsë në fund të shekullit të 19-të përkatësia kombëtare u bë më e rëndësishme se përkatësia fetare? A mund të gjeni se cila ishte lidhja midis kësaj dukurie dhe krijimit të shteteve kombëtare?

III-10. Vetidentifikimi jo sipas përkatësisë kombëtare në Maqedoni – përvoja e H. N. Brailsfordit (1905)

Kujtimet e së shkuarës ishin zhdukur tërësisht dhe asgjë nuk kishte mbetur gjallë, përveçse një traditë disi të turbullt mes fshatarëve, që etërit e tyre dikur na kishin qenë të lirë. Meqenëse doja të zbuloja nivelin e njohurive të tyre tradicionale, unë pyeta disa djem të një fshati të largët pranë Ohrit, ku nuk kishte as mësues dhe as ndonjë prift vendës, dhe ku askush nuk dinte të lexonte. Bashkë me ta, shkova pranë rrënojave të kalasë së carit bullgar, e cila dominon përmbi liqenin dhe rrafshinën aty pranë, që prej majës së një kodre rrumbullake. “Kush e ka ndërtuar këtë vend?”, - pyeta unë. “Njerëzit e lirë”, - që përgjigjja e tyre domethënëse. “Dhe cilët janë ata?” “Stërgjyshërit tanë”. “Po mirë, a ishin ata serbë, bullgarë, grekë apo turq?” “Ata nuk ishin turq, por të krishterë.” Dhe kaq dukej se ishte dhe niveli i njohurive të tyre.

Brailsford, f. 99-100.



Henri Noel Brailsfordi (1873-1958) ka qenë gazetar britanik, që kaloi shumë vite në Ballkan si vullnetar në Legjionin Filohelenik, korrespondent i jashtëm, si dhe drejtues i Misionit Humanitar Britanik në Maqedoni, në vitin 1903. Ishte mbështetës i çështjes maqedonase dhe në vitin 1905 botoi një studim historik kulturor për rajonin.

? Cili është burimi kryesor i vetidentifikimit në përfytyrimin e djemve? Përse e thekson autori faktin se në fshat nuk kishte as shkollë e as prift të përhershëm, dhe se popullsia e saj ishte analfabete? A mendoni se përgjigjet e djemve, në rrethana të tjera, do të kishin qenë ndryshe?

► **Fig. 13. Pavjoni për Bosnjë-Hercegovinën, në Ekspozitën Ndërkombëtare të Parisit (1900)**



Bennett, f. 30.

🔑 Në ekspozitat universale/botërore, secili shtet synon që të paraqitë identitetin dhe individualitetin e tij.

? Cilat janë elementet kryesore të ekspozuara në pavjonin për Bosnjë- Hercegovinën në vitin 1900? Analizoni sfondin (elementet e arkitekturës), veshjet, mobilimin, veprimtaritë dhe qëndrimin e figurave? Mblidhni informacion për ekspozitën më të fundit botërore, si dhe për pjesëmarrjen e vendit tuaj në të. Cilat ishin elementet e veçanta që u përzgjedhën për t'u paraqitur nga shteti juaj?

IIIc. Simbolet kombëtare

III-11. Si i përfytyronte Rigas Velestinlisi flamurin dhe simbolet e Republikës Greke (1797)

Emblema që do të përdoret në flamurët dhe në stemat e Republikës Greke do të jetë topuzi i Herkultit me tri kryqe sipër tij; vetë flamurët dhe stemat do të jenë tringjyrëshe, me të kuqen në krye, të bardhën në mes, dhe të zezën në fund²⁸.

E kuqja përfaqëson ngjyrën perandorake dhe vetëvendosjen e popullit grek; ajo është përdorur prej etërve tanë si rrobë lufte, me qëllim që plagët të mos dukeshin dhe të mos i bënin ushtarët të humbnin guximin.

E bardha përfaqëson pastërtinë e çështjes sonë të drejtë, kundër tiranisë.

E zeza përfaqëson vdekjen për atdheun dhe lirinë. Të gjithë ushtarët grekë, në kokat e tyre do të mbajnë helmata.

Të gjithë ushtarët grekë do të mbajnë në brez bajonetën, ashtu siç mbahet shpata, dhe do t'ia vendosin atë pushkës, sipas nevojës ose gjatë paradave.

Uniforma e ushtarëve grekë do të përbëhet prej kilotave të zeza, këmishës së bardhë dhe çorapeve të kuqe.

Të gjithë grekët, burra e gra, ashtu si dhe të gjithë banorët e kësaj republike duhet të mbajnë në kaskat apo kapelet e tyre emblemën e topuzit, të vizatuar ose të qëndisur në një copë të bardhë apo në bronz; kjo do të jetë shenja dalluese mes demokratëve të lirë dhe vëllezërve të barabartë.

Παρθενων [Parthenon], f. 555-556.

❓ Pas marrjes së pavarësisë, shteti modern grek përvetësoi vetëm një pjesë të vogël të simboleve të propozuara prej Rigasit; Përpiquni që të argumentoni qëndrimin tuaj pro ose kundër përdorimit të elementeve dalluese në veshjet e të gjithë banorëve të të njëjtit shtet. Bëni krahasimin e flamurit të propozuar prej Rigasit, me flamurin e sotëm grek (fig. 17).

► **Fig. 14. Flamuri i ishullit grek të Psaras, gjatë luftës për pavarësi, në të cilin paraqitet motoja “Liri a vdekje”, kryqi, si dhe simbolet e shoqërisë së fshehtë “Filiqi Eteria”**



Simaies, f. 22.

²⁸ Këto tri ngjyra janë përdorur në flamurin e Republikës Franceze, ku bluja është përdorur në vend të ngjyrës së zezë.

► **Fig. 15. Flamuri rumun i Gardës Urbane të Bukureshtit, me mbishkrimin “Bashkimi bën fuqinë” (1867)**



► Dy figurat femërore përfaqësojnë dy principatat rumune të Moldavisë dhe Vllahisë, të cilat u bashkuan në një shtet të vetëm në vitin 1859.

◉ Çqëllim kishte përfshirja e elementeve që i referoheshin posaçërisht një arritjeje kombëtare, në flamurin e përcaktuar për një institucion vendor?

► **Fig. 16. Flamuri dhe stema e Mbretërisë së Serbëve, Kroatëve dhe Sllovenëve / Mbretërisë së Jugosllavisë (që prej vitit 1929)**



Dimić.

► Në flamur dhe në stemë ndërthuren simbolet kombëtare të tri kombeve sunduese të shtetit të parë jugosllav.

◉ Cili është qëllimi i kësaj figure?

III-12. Domethënia e flamurit shqiptar, shprehur gjatë fjalimit të peshkopit Fan Stilian Noli, në varrimin e Faik Konicës (1942)

Më lejoni që të shtoj edhe dy fjalë për flamurin shqiptar. Siç e dini, asnjë prej flamurëve të fqinjëve tanë ballkanas nuk është më i vjetër sesa një shekull e gjysmë. Disa prej tyre nuk e kalojnë as edhe një shekull. Ndërkohë, yni është të paktën 500-vjeçar dhe ndoshta edhe më i vjetër sesa kaq. Ai ka qenë flamuri i Gjergj Kastriotit Skënderbeut, heroit kombëtar shqiptar, i cili luftoi kundër turqve për një çerek shekulli dhe qe luftëtari i fundit i krishterë në Ballkan, i cili u bëri ballë sulltanëve më të mëdhenj të Turqisë. Pas vdekjes së tij, Shqipërisë së braktisur prej fuqive europiane, iu desh që të lëngonte për katër shekuj e gjysmë nën zgjedhën e rëndë turke. Gjatë kësaj periudhe, flamuri i Skënderbeut u harrua – askush nuk pati më dijeni për ekzistencën e tij, derisa një studiues i ri, gjatë kërkimeve në një bibliotekë, e hasi atë në biografinë e Skënderbeut, shkruar prej Barletit në latinisht. Ky studiues ishte Faik Konica dhe flamuri që tashmë mbulon qivurin e tij, flamuri i kuq me shqiponjën e zezë dykrerëshe, është pikërisht flamuri që e rigjeti.

Konica, 2000, f. 174.

► Ky fjalim u mbajt në Shtetet e Bashkuara, në kohën e Luftës II Botërore, kur Shqipëria gjendej nën pushtimin italian. Fan Noli (1882-1965) ka qenë peshkop ortodoks, por edhe kryeministër dhe regjent i Shqipërisë gjatë gjysmës së dytë të vitit 1924. Si kundërshtar i Ahmet Zogut, ai shkoi në mërgim dhe u vendos përfundimisht në Shtetet e Bashkuara, ku u bë edhe figura qendrore e komunitetit shqiptaro-amerikan. Ai botoi shumë libra fetarë, letrarë e historikë, dhe në moshën 63 vjeçare (në vitin 1945) mbrojti doktoraturën në Universitetin e Bostonit, me një temë për Skënderbeun. Pavarësisht se marrëdhëniet e tij vetjake me Faik Konicën (shih II-35) u përkeqësuan gjatë periudhës kur ky i fundit shërbeu si ambasador i Shqipërisë në Uashington

gjatë regjimit të Zogut, ata bashkëpunuan me njëri-tjetrin, sidomos pas pushtimit të Shqipërisë në vitin 1939.

Analizoni tekstet III-11 dhe III-12. A e dini ju domethënien e flamurit tuaj? A lidhet ajo me ndonjë histori apo kuptim të veçantë?

► **Fig. 17. Flamurët e sotëm të shteteve të Europës Juglindore**



Shqipëria, Bosnjë-Hercegovina, Bullgaria, Kroacia, Qiproja, Greqia, Republika e Maqedonisë, Rumania, Sllovenia, Serbia, Turqia dhe Mali i Zi.

Përpiquni që të gjeni simbolikën e këtyre flamurëve. Bëni krahasimin e ngjyrave dhe të mënyrës së paraqitjes së tyre. Krahasojini ato me flamurët e tjerë europianë.

III-13. Himnet kombëtare

A. Himni kombëtar grek (1823)

Të njoh prej kohësh,
O e rikthyera hyjnore,
Të ndrit tehu i shpatës,
Të shkreprijnë sytë.

Nga varret e tanëve,
Merr hov shpirti yt,
Të përshëndesim përsëri,
Rrofsh, Liri!

Gjatë jetove,
Mes njerëzve në zi,
Duke pritur një thirrme,
Të riktheheshe, Liri.

Ah, sa vonoi kjo ditë,
Dhe burrat nuk guxonin,
Se hijet e tiranisë,
Mbi dheun tonë sundonin.

Tani, vështroi bijtë,
Me vrull në shpirt,
Përpara në luftë,
Ja vdekje, ja liri!
Nga varret e tanëve,
Merr shpirti fuqi,
Të përshëndesim përsëri,
Rrofsh, Liri!

Kapsomenos, f. 93-94.



Vargjet e himnit kombëtar janë shkruar nga njëri prej poetëve më të rëndësishëm grekë, Dionisios Solomosi (1798-1857). Poema *Himn për Lirinë*, e përbërë nga 158 strofa, u shkrua në vitin 1823, gjatë Luftës greke për pavarësi. Dy strofat e para të saj, së bashku me muzikën e Nikolaos Mantzarosit, u bënë himni kombëtar i Greqisë në vitin 1864, duke zëvendësuar kështu përkthimin grek të himnit kombëtar bavarez, i cili ishte përdorur deri në atë kohë.

B. Himni kombëtar kroat (1835)

O vendi ynë heroik,
O toka jonë e bukur,
Trashëgimi e lavdisë,
Qofsh gjithmonë i lumtur!

I dashuri dhe i lavdishmi,
I shtrenjti dhe i vetmi,
I dashur kudo shtrihesh,
I dashur kudo ngrihesh.

Rridh lumi Sava, rridh lumi Drava,
As ti Danub mos e zbut vërshimin,
Dhe bashkë me detin blu,
botës tregojini, se kroati e do kombin e vet!

Za Hrvatsku, f. 5.



Vargjet e himnit kroat u shkruan nga Antun Mihanoviçi (1796-1861), dhe u botuan në revistën *Danica* [*Ylli i mëngjesit*] në vitin 1835. Mihanoviçi lindi në Zagreb. Ai qe oficer në ushtrinë habsburgase, dhe më vonë u bë diplomat. Në vitet 1840, vargjet e tij u kënduan me muzikën e kompozuar nga Josif Runjanini (1821-1878) – edhe ky oficer në ushtrinë habsburgase. Kroatët filluan që ta konsideronin atë si himn kombëtar në fillimin e shekullit të 20-të. Në kohën e Jugosllavisë komuniste, ai u njoh si himni i Republikës Federale të Kroacisë, por zyrtarisht mund të ekzekutohej vetëm pas himnit jugosllav (*Hej, Sllavë*). Në bazë të Kushtetutës së vitit 1990, *Atdheu kroat*, përgjithësisht i njohur si *Atdheun ynë i bukur*, është himni kombëtar i Republikës së Kroacisë. Në versionin e parë të tij, fjalët “detin blu” nuk përmendeshin në tekst; ato u shtuan gjatë viteve 90-të.

C. Himni kombëtar shqiptar (1912)

Rreth flamurit të përbashkuar,
Me një dëshirë dhe një qëllim,
Të gjithë Atij duke iu betuar,
Të lidhim besën për shpëtim.
Prej lufte veç ay largohet,
Që është lindur tradhëtor,
Kush është burrë nuk friksohet,
Po vdes, po vdes si një dëshmor.
Në dorë armët do t'i mbajmë,
Të mbrojmë Atdheun në çdo vend,
Të drejtat tona ne s'i ndajmë,
Këtu armiqtë s'kanë vend.
Se Zoti vet e tha me gojë,
Që kombet shuhen përmbi dhé,
Po Shqipëria do të rrojë,
Për të, për të luftojmë ne.

<http://www.albanian.com/information/history/index.html>



Këto vargje janë shkruar nga Aleks Stavre Drenova, [Asdreni] (1872-1947). Ai e kaloi pjesën më të madhe të jetës së tij në Rumani dhe vdiq në Bukuresht. Titulli origjinal i poezisë është *Betimi mi Flamur*, botuar në vitin 1912 nga gazeta shqiptare Liri e Shqipërisë, në Sofje të Bullgarisë. Dy strofat e para, me muzikën e kompozitorit rumun Ciprian Porumbesku (1853-1883), u bënë dhe himni zyrtar i Shqipërisë në vitin 1912.



Ç'dini për himnin kombëtar të vendit tuaj?

► Fig. 18. Ndryshimet që ka pësuar stema bullgare (nga viti 1741 deri në ditët tona)



? Cilat janë elementet e përbashkëta që janë pasqyruar në të gjitha emblemat? Çfarë elementesh janë paraqitur në emblemen e vendit tuaj? Gjeni kuptimin e tyre simbolik?

► Fig. 19. Stema serbe, modeluar nga Pavao Riter Vitezoviçi (1701)



*Signa Crucem, calybelq; rubro fert Serblia campo
Pro Cruce non paucos Serblia palla focus.
Nunc Cruce prostrata, tamen ultro sustinet ictus;
Hinc fato & facto Sevia dicta venit.*

F

SILE-

Davidov, f. 21.

► Fig. 20. Stema e Mbretërisë Serbe (vitet 1880-të)



Ljušić, 2001.

🔑 Në këtë stemë kemi ndërthurjen e shqiponjës mbretërore (bizantine) dykrenare, dhe të shqytit me 4 "S". Ajo u krijua nga historiani dhe politikani Stojan Novakoviç.

? Bëni krahasimin e dy figurave. Analizoni ngjashmëritë dhe ndryshimet midis tyre. Ç'mendim keni për to?

► Fig. 21. Stema e Mbretërisë të Malit të Zi, 1905



? Përse shteti ka nevojë për një stemë dhe çfarë duhet të shprehë ajo? A mund ta konsiderojmë stemën si një element të identitetit kombëtar apo vetëm të identitetit të shtetit? Ç'duhet të shprehë përmes emblemës së tij një shtet shumëkombësh?

► Fig. 22. Monarkia dhe shteti – kartolina rumune në të cilën paraqitet mbreti Karol I (1866-1914)



? Përse u botua kartolina që paraqiste mbretin? Si është paraqitur ai? Ç'ndjenja dhe qëndrime duhet që të transmentonte pamja e tij?

III-14. Përpjekjet për krijimin e një veshjeje kombëtare në Greqi (1843)

Për interesin e ekonomisë dhe të krenarisë kombëtare, si dhe për të shmangur luksin e huaj dhe korrupsionin [që i ka çuar punët në Greqi në këtë pikë], do të ishte mirë [...] që të krijohesh një veshje kombëtare: e lirë, e hijshme, elegante, dhe mundësisht e bërë prej materialesh e prej zanatçinjsh vendas [...], e cila do të identifikonte kombësinë tonë, do ta lidhte gjithsecilin rreth unitetit kombëtar, si dhe do të ndihmonte në formimin e mëtejshëm të kombit. Duke qenë një komb i veçantë, pjesë e Europës dhe e Azisë në të njëjtën kohë, si dhe i respektuar për origjinën e tij të shquar, është e sigurtë që grekët duhet të kenë një veshje, një arsimim, një mënyrë të ushqyeri kombëtare [...]

Politis, f. 124.

? Përpiquni të gjeni arsyet përse autori po mundohet që t'i bindë njerëzit për domosdoshmërinë e një veshjeje kombëtare. A jeni dakord me argumentin e tij? Po ju, a keni në vendin tuaj një "veshje kombëtare"?

► Fig. 23. Një vajzë fshatare serbe me veshjen kombëtare (1865)



Todić, f. 132.

Tabela 3: Festat kombëtare kryesore në shtetet e sotme europiane juglindore

Vendi	Data	Domethënia
Shqipëria	28 Nëntor	Dita e Pavarësisë (1912)
Bosnjë - Hercegovina	1 Mars	Dita e Pavarësisë (1992)
Bullgaria	3 Mars	Dita e Çlirimit (1878)
Kroacia	8 Tetor	Dita e Pavarësisë (1991)
Qiproja	1 Tetor	Dita e Pavarësisë (1960)
Republika e Maqedonisë	8 Shtator	Dita e Pavarësisë (1991)
Greqia	25 Mars	Dita e Pavarësisë (1821)
Rumania	1 Dhjetor	Dita e Bashkimit (1918)
Mali i Zi	13 Korrik	Dita e Shtetësisë (1878)
Serbia	15 Shkurt	Dita e Çlirimit (<i>državnosti</i>) (1804)
Sllovenia	25 Qershor	Dita e Krijimit të Shtetit (1991)
Turqia	29 Tetor	Dita e Republikës (1923)

[www.seeurope.net:http://en.wikipedia.org](http://www.seeurope.net/http://en.wikipedia.org)



Festat kombëtare kremtojnë ato ngjarje që kanë qenë thelbësore për zhvillimin e shtetit kombëtar. Gjatë historisë së shteteve, për shkak të rrethanave politike, festat kombëtare herë-herë janë ndryshuar; gjithsesi, ka patur edhe shtete të cilat gjatë tërë historisë së tyre kanë ruajtur të njëjtën festë kombëtare, si për shembull, Shqipëria. Ndërkohë, shembull tipik i ndryshimit të festave kombëtare është Rumania: festat më të rëndësishme kombëtare, të kremtuara gjatë gjysmës së dytë të shekullit të 19-të dhe gjysmës së parë të shekullit të 20-të, kanë qenë: 10 Maji, me një domethënie të trefishtë: kurorëzimi i Karolit I Hohenzollern si princ i Rumanisë (1866), shpallja e Pavarësisë së Rumanisë (1877), si dhe shpallja e Mbretërisë së Rumanisë (1881); 24 Janari ka qenë dita e bashkimit të Vllahisë me Moldavinë në vitin 1859. Ndërkohë që edhe ditëlindjet e mbretit dhe mbretëreshës kremtoheshin si festa kombëtare. Gjatë regjimit komunist, festa kombëtare ka qenë 23 Gushti (1944), dita kur Rumania u shkëput nga forcat e Boshtit dhe u bashkua me Forcat Aleate, ndërkohë që festat e tjera, si 1 Maji ose 7 Nëntori, kanë patur origjinë ndërkombëtare. Pas rënies së regjimit komunist, 1 Dhjetori (1918) u zgjodh si festë kombëtare, meqenëse përfaqësonte Ditën e Bashkimit të Transilvanisë me Mbretërinë e Rumanisë, pra ditën e krijimit të Rumanisë së Madhe.



Ç'lloje ngjarjesh festohen në shtetet e ndryshme të Europës Juglindore sipas tabelës së mësipërme? Ç'ngjarje të tjera historike festohen në vendin tuaj?

Bëni punë kërkimore vetjake:

Për të mësuar më shumë rreth festave kombëtare të vendit tuaj, si dhe mënyrës sesi njerëzit i kuptojnë ose i përkujtojnë ato.

Këto çështje mund t'i diskutoni me anëtarët e tjerë të familjes suaj, me fqinjët ose me ata njerëz që ju do t'i përzgjidhni si burim informacioni. Pyesni se ç'dinë ata mbi domethënien e festës kombëtare, nëse kanë festuar ata më parë festa të tjera kombëtare, se si festoheshin ato gjatë fëmijërisë ose rinisë së tyre, dhe se si e kalonin ata kohën gjatë këtyre ditëve.

Gjithashtu, përpiquni që të gjeni edhe se sa të rëndësishme janë për komunitetin tuaj festat tradicionale ose ato fetare.

IIId. Mitologjitë kombëtare


► Fig. 24. Paraqitja simbolike e kombit

A. Bullgaria e çliruar – litografi e Georgi Dançovit (1879)



? Si është paraqitur këtu Bullgaria? A keni ju pamje të ngjashme në vendin tuaj?

B. Kartolina franceze të cilat paraqesin Serbinë dhe Malin e Zi (1917)



? Analizoni mënyrën se si janë paraqitur vendet dhe karakteristikat e tyre kombëtare. Vëreni se si janë përfaqësuar këto vende prej figurave femërore.

III-15. Rrënjët historike të kombit maqedonas – Gjorgji Pulevski, *Për maqedonasit* (1879)

Për maqedonasit
 Atdheu ynë është ky vend,
 kaq i dashur për maqedonasit.
 Mbretëri nën Filipin,
 Perandori e carit Aleksandër.
 Cari ynë maqedonas,
 botërisht i njohur si Aleksandri i Madh,
 U la perandorinë në Ballkan,
 Të gjithë malësorëve sllavë.
 [...]

Duhet ta duam atdheun,
 Të përpiqemi që ta kemi,
 E vjetër është Mbretëria jonë Maqedone.
 Le të mblidhemi së bashku,
 Të bëjmë gjithçka për shpëtimin tonë [...]
 Vëllezër maqedonas të besës ortodokse,
 Të bëhemi një dhe trimërisht të luftojmë.
 Si të parët tanë, nën carin Aleksandër,
 Himnet le të na ndjekin,
 Ta ngjallim historinë e vjetër,
 Në mundshim ta bëjmë tani.
 Maqedonët tanë të vjetër,
 na lanë kujtime të mëdha,
 T'i shenjtërojmë eshtrat e tyre,
 Kurora të arta t'i bëjmë ata.
 Ta ngremë flamurin e lashtë luftarak,
 Me fytyrën e Shën Gjergjit në njërën anë,

Dhe atë të Shën Dimitrit në tjetrën,
nën emblemën e shenjtë të luftojmë. [...]
Pulevski, f. 57-58.

Key Gjorgji Pulevski (1838-1895) ka botuar disa fjalorë krahasues, disa gramatika dhe propozime mbi drejtshkrimin e maqedonishtes, si dhe disa përmbledhje të shkurtra historike, gjenealogjike dhe këngësh popullore. Ai ka qenë përfaqësues tipik i romantizmit kombëtar, i cili u përpoq që të vendoste ura lidhjeje në hendekun midis "Periudhës së Ndrithshme" të Maqedonisë së lashtë dhe popullsisë së sotme sllave. Megjithëse nuk ishte një poet i mirëfilltë, ai botoi një libër këngësh maqedonase [*Makedonska Pesnarka*] në vitin 1879, në Sofje.

? Ç'mendim keni për synimet dhe për mesazhin e poemës? Çfarë donte të përçonte autori me anë të saj? Përse ai zgjodhi që të shkruante në vargje?

► **Fig. 25. Heronjtë historikë si modele për të sotmen**

A. Leonidha, mbreti i Spartës së lashtë, u deklaroi persëve se ai nuk do të dorëzohet: "Μολων Λαβει" ("Ejani ta merrni") – figurë në një libër shkollor grek (1901)



Koulouri, f. 72.

? Ç'vlere dhe ç'qëndrime përçohen nga figura dhe nga teksti? Si është paraqitur Leonida në krahasim me figurat e tjera? Si është vendosur ai brenda përmasave hapësinore të pikturës? Përse?

B. Vdekja e Vasa Çarapiçit²⁹ gjatë pushtimit të Kalasë së Beogradit, 1806 – pikturë e Anastas Jovanoviçit (1817-1899)



Muzeu Kombëtar, Beograd.

? Cili është qëllimi i pikturës? Ç'ndjenja dhe ç'qëndrime duhet që të përçojë ajo? Bëni krahasimin e dy figurave.

III-16. Kujtimet e dr. Riza Nurit, mbi ndikimin e tregimeve epike popullore

Isha mësuar t'i lexoja ato plot shije e ngazëllim. Sa më shumë i lexoja, aq më tepër ndjehesha i gatshëm për t'u bërë hero. Tani e kuptoj se këto libra pasqyronin zakonet e lashta heroike të turqve. Më vjen keq që ato tashmë janë lënë pas dore. Është e nevojshme që ato të modernizohen e të rishkruhen [...] Çfarë vlere kanë pasur më parë të tilla krijime?! Nuk e vë në dyshim aspak, se ishte pikërisht 90 përqindëshi i edukimit të marrë prej tyre gjatë fëmijërisë, që **i shndërroi turqit në heronj, si dhe u dha atyre mundësinë që të pushtonin aq shumë vende.** Këto janë veprat e epokës historike të turqve në Islam. Ato duhet të përmirësohen dhe të rishkruhen, sepse do të bëhen mjaft të vlefshme për edukimin kombëtar.

Nur, f. 90-91.

? Cili është mendimi juaj për rolin që luan letërsia në përforcimin e ndjenjës kombëtare dhe/ose identitetit kombëtar? A keni lexuar ndonjë pjesë letrare, e cila ngjall idenë e identiteti tuaj kombëtar?

²⁹ Vasa Çarapiçi ka qenë njëri prej udhëheqësve të kryengritjes së parë serbe 1804-1813.

► **Fig. 26. Pasqyrimi simbolik i ngjarjeve politike**

A. Kryengritja e malazezve – pikturë e Dura Jakshiçit (1832-1878)



Muzeu Kombëtar, Beograd.

? Hartoni dy pyetje mbi këtë pamje. Krahasojini ato me pyetjet e kolegëve tuaj.

B. Bullgaria e bashkuar – pikturë e Nikolai Pavloviçit (1885)



🔑 Kjo pikturë përfaqëson çastin e bashkimit të Bullgarisë me Rumelinë në vitin 1885. Bullgaria luan rolin e nënës, përkundrejt territoreve të reja. Figura vajtuese e paraqitur në sfond nënkupton se bashkimi me Bullgarinë ishte dëshiruar edhe prej territoreve të tjera, por një gjë e tillë nuk u arrit.

? Bëni përshkrimin e pikturës. Shikoni me vëmendje veshjet. Ç'mund të thoni për to? Cilat janë ngjashmëritë dhe ndryshimet midis kësaj pikturë dhe Bullgarisë së çliruar? Cili është roli i këtyre paraqitjeve historike?

III-17. Ligji rumun për kremtimet në kujtim të heroinës së luftës Ekaterina Teodoriu (1921)

LIGJI PËR PËRMENDOREN, SHTËPINË DHE INSTITUTIN E GRAVE "EKATERINA TEODORIU"

Neni 1. – Në nderim të kujtimit të Heroinës Virgjëreshë Ekaterina Teodoriu, e cila ra trimërisht për mëmëdhenë, në qytetin e Targu-Jiut do të ngrihet një shtatore, e cila do të jetë pjesë e përmendores "Fitorja e Jiut", me emrat e të gjithë oficerëve të rënë gjatë betejave fitimtare në luginën e lumit Jiu, duke filluar me emrin e Virgjëreshës, që kishte gradën "Toger i dytë".

Ndërtimi, mirëmbajtja dhe mbikëqyrja e punimeve do të kryhet nga "Shoqëria e varreve të heronjve të rënë gjatë luftës", nën drejtimin e Ministrisë së Luftës. Projekti i ndërtimit do të hartohet nga Ministria e Arteve, përmes një konkursi.

Neni 2. – Trupi i Virgjëreshës do të zhvendoset nga Muncelul, dhe do të varrosset nën përmendore. Veprimtaritë perkujtimore do të zhvillohen në mbretëri çdo vit, në ditën e përcaktuar nga ligji i veçantë mbi kremtimet për heronjtë.

Përveç kësaj, në datën 14 tetor, ditën e fitores së Jiut, në vendlindjen e heroinës, në Vadeni të Gorjit, do të bëhen një shërbesë dhe një kortezh, ndërsa të gjitha shkollat e vendit do të organizojnë konferenca edukative lidhur me këtë temë.

Neni 3. – Shtëpia në fshatin Vadeni në rajonin e Gorjit, në të cilën lindi Virgjëresha, do të riparohet dhe do të mirëmbahet vazhdimisht, së bashku me oborrin e saj, të dyja shpallen vende historike.

[...] Për familjen e heroinës do të ndërtohet një tjetër shtëpi, në të njëjtën komunë, dhe atyre do t'u dhurohen gjashtë akra tokë, së bashku me bagëtinë dhe mjetet e tjera të domosdoshme që i nevojiten një familjeje të thjeshtë fshatare. Dispozitat e këtij ligji nuk e përjashtojnë pensionin që familja merr si ndihmë, për shkak të vdekjes së vëllait të heroinës. [...]

Neni 6. – Ndarja nëpër ministri e fondeve të grumbulluara për përmendoren, shtëpinë dhe për shkollën, do të kryhet prej Këshillit të Ministrave, nën kujdesin e Presidencës së Këshillit.

"Monitorul...", f. 3112.



Ekaterina Teodoriu (mbiemri i vërtetë është Toderoiu) (1894-1917), e bija e një fshatari, në 1916-n punonte si infermiere. E zënë rob prej gjermanëve gjatë luftimeve në Podul Jiu, arriti të shpëtonte dhe vazhdoi të merrte pjesë në luftimet e Valea Jiuluit. E plagosur në të dyja këmbët nga një predhë, u dekorua për Virtutea militara [Merita ushtarake] nga mbreti Ferdinand I (1914-1927) dhe mori gradën "Toger i dytë". Pas shërbimeve në një spital të Jashit, ajo hyri përsëri në trupat luftuese, si komandante toge, dhe gjatë luftimeve të 22-23 gushtit 1917, humbi jetën në betejën e Marasheshtit.



Përse ishte e rëndësishme ngritja e përmendores së Ekaterina Teodoriut? Ç'loj simboli ishte ajo? Çfarë ndjenjash përçoheshin nëpërmjet kujtimit të saj dhe kujt i drejtoheshin ato?

A mendoni se adhurimi ndaj heronjve është një perkujtim për vetë ata, apo mos ndoshta synimet kryesore duhen gjetur brenda sferave edukative dhe atyre politike? Renditni 3 personalitetet që janë edhe simbolet më të njohura kombëtare të vendit tuaj. Cili është raporti ndërmjet burrave, grave dhe fëmijëve? Në ç'loj veprimtarie spikatën ata?

► Fig. 27. Afishe rumune për kremtimin e 70- vjetorit të krijimit të shtetit modern (1929)





Në këtë afishe paraqitet harta e Rumanisë së Madhe, së bashku me portretet e disa figurave historike, si dhe të udhëheqësve politikë. Fotografia qendrore i përket mbretit të ri Mihai I. Figurat e tjera janë të lidhura ose me idenë e bashkimit rumun (Mihai Trimi, princi i Vllahisë 1593-1601, i cili bashkoi për një periudhë të shkurtër Vllahinë, Moldavinë dhe Transilvaninë; Aleksandër Joan Kuza, i cili u zgjodh princ i përbashkët i Moldavisë dhe i Vllahisë më 1859-n; Mihai Kogalniceanu, i cili qe kryeministër gjatë mbretërimit të Kuzas), ose me idenë e monarkisë (mbreti Karoli I dhe mbreti Ferdinand I). Jashtë hartës është paraqitur perandori romak, Trajani dhe mbreti i Dakisë, Decebali, si simbole të origjinës fisnike të rumunëve. Ndërsa data 10 Maj, e paraqitur në krye të afishes, në atë kohë ka qenë edhe Dita Kombëtare e Rumanisë: dita e kurorëzimit të Karolit I si princ i Rumanisë (1866), dita e shpalljes së pavarësisë së Rumanisë (1877), si dhe dita e shpalljes së Mbretërisë Rumune (1881).



A keni dijeni për afishe të ngjashme në vendin tuaj? Po për lloje të tjera afishesh propaganduese? Krahasojeni këtë me fig. 16. Cili ishte qëllimi i botimeve të tilla?

► **Fig. 28. Pullë kroate në të cilën paraqitet basketbollisti i njohur Dražhen Petroviç (1994)**



Pas një karriere të suksesshme, Dražhen Petroviçi humbi jetën tragjikisht gjatë një aksidenti rrugor në vitin 1993. Dražhen Petroviçi është ndoshta një nga kroatët e paktë që është pranuar si hero kombëtar i kohëve moderne.



Përse yjet e sportit nganjëherë mbahen si heronj kombëtarë? Ç'loj heroizmi shfaqin ata? Cila është lidhja me heroizmin e treguar në luftë apo gjatë qëndresave? Përse është paraqitur fotoja e Petroviçit në një pullë?

III-18. Origjina historike e stemës shqiptare, shpjeguar nga një historian bashkëkohor (2000)

Stema e Shqipërisë: Mbi një shqyt të kuq, shqiponja e zezë, dykrenore, flatrashpalosur. Ajo e ka burimin te simboli heraldik i heroit tonë kombëtar, Gjergj Kastrioti Skënderbeu (1405-1468). Stemën e Shqipërisë, si dokument të parë heraldik, e ndeshim në vulën kancelarike të Gjergj Kastriot Skënderbeut. Stema përbëhet nga një shqiponjë dykrenore, krahëhapur. Në ballë të stemës kryeson një yll gjashtëcepësh. Gjurmën e kësaj vule, material dylli të kuq, e ndeshim në dokumente të vitit 1459, kur Papa Piu II (Pikolomini) dhe Kongresi i Mantovës i njohën simbolet e Skënderbeut.

Gjin Varfri, 2000, f. 19.



Përse historiani thekson se stema e shtetit të tij kombëtar është e lashtë dhe e mirënjohur? Po sot, a ka kjo rëndësi të veçantë për ju? Ç'mendoni për rolin e simboleve kombëtare?

KAPITULLI IV: Nacionalizmat në konflikt

Prej shumë kohësh ekziston për Ballkanin paragjykimi që e emërton atë si “fuçi baruti” e Europës. Konfliktet kombëtare ndërmjet shteteve të vogla e lakmitare janë pjesë përbërëse e kësaj tabloje. Ky imazh u krijua gjatë fundit të shekullit të 19-të dhe fillimit të shekullit të 20-të dhe “u vërtetua” nga përvoja e Luftërave Ballkanike, si dhe nga vrasja e Sarajevës, e vitit 1914. Gjithsesi, një imazh i tillë i vrazhdë historik në pjesën më të madhe është i padrejtë. Lufta I Botërore filloi me konfliktin ndërmjet Austro-Hungarisë dhe Serbisë, por sigurisht që nuk u përshkallëzua drejt asaj masakre të njohur tërësore, për shkak të popujve të këtij rajoni. Për më tepër, Europa Juglindore ndodhet në fundin e listës së tmerreve të shkaktuara gjatë shekullit të 20-të. Megjithatë, një gjë e tillë nuk e përjashton nacionalizmin europiano-juglindor nga përgjegjësia për nxitjen e konflikteve të padobishme ose krimeve të tmerrshme.

Qëllimi i këtij *Libri pune* nuk është ilustrimi i tmerreve të shkaktuara prej konflikteve kombëtare në Europën Juglindore. Në të vërtetë, ne jemi munduar që ta mënjanojmë një gjë të tillë dhe të përqendrohemi më shumë në ato argumente dhe ideologji, të cilat në pamje të parë mund të duken të justifikuara, por që, në fund të fundit, i motivuan popujt për të vepruar në mënyrë të dhunshme. Ne mendojmë se një diskutim kritik i burimeve të tilla gjatë orëve të historisë do t’i ndihmojë të rinjtë që të bëhen qytetarë të pjekur e të përgjegjshëm.

Përmes këtij kapitulli, ne gjithashtu duam të tregojmë se konfliktet kombëtare nuk zgjasin përgjithmonë. Në të vërtetë, përvoja historike e Europës Juglindore, madje edhe ajo e rajoneve të tjera europiane, ka treguar mjaft qartë se konfliktet e kanë një fund, se paragjykimet kombëtare dhe urrejtjet mund të zëvendësohen me qëndrime më pozitive, dhe se një botë më e mirë dhe më e sigurtë, mundet, e në të vërtetë po shfaqet. Krijimi i Bashkimit Europian, si dhe rasti i marrëdhënieve franko-gjermane gjatë 5 dhjetëvjeçarëve të fundit, janë shembuj mjaft nxitës. Tashmë, zhvillime të tilla pozitive mund të shihen edhe në Europën Juglindore. Por ato jo domosdoshmërisht tregojnë se shtetet kombëtare nuk do të ekzistojnë më, ose që nuk do të jenë më të rëndësishme. Pavarësisht nga parashikimet mbi fashitjen e shteteve kombëtare, është ende e qartë se edhe për shumë kohë, shtetet kombëtare do të vazhdojnë të jenë aktorët kryesorë të politikës europiane dhe asaj mbarëbotërore. Identifikimi kombëtar do të vazhdojë të ketë rëndësi përgjatë gjithë jetës sonë dhe shteti kombëtar do të vazhdojë të ndikojë në ekzistencën tonë. Prandaj është tepër e rëndësishme të kujdesemi që shtetet tona kombëtare të shërbejnë si një mbështetje pozitive për të ardhmen tonë të përbashkët.


IVa. Ideologjitë e përdorura për nxitjen e konfliktit

IV-1. Paragjykimi kombëtar ndaj gjermanëve në Kroaci (1866)

Kurrë nuk do të dashuroja një gjermane bjonde. Por fatkeqësisht, më rastisi njëherë të takoja një gjermane porsì një engjëll që rrezantonte paqe. Pasi provuam dashurinë e ndërsjelltë, vajza gjermane filloi të luante *Les cloches du monastere* për mua –

gjë që më hapi gojën për gjumë; më pas, ajo filloi të lexonte Berguinen e Mathesonit – e unë fillova të dremisja. Bjondja psherëtinte rreth gjysmë ore çdo ditë, për shtatë ditë me radhë – dhe kur erdhi dita e tetë, unë nuk isha më aty. Kroatet djallëzore, me të cilat duhet të përleshesh, më pëlqejnë më shumë sesa gjermania Lujza, që ishte e plogësht si një limonatë e ngrohtë.

Senoa, f. 164.


 Ç'mendim ka autori për vajzat gjermane? A është e vërtetë kjo gjë?

A keni dëgjuar për paragjykime të tjera ndaj popujve të tjerë? Me cilat kombe ose grupe shoqërore lidhet pjesa më madhe e anekdotave të komunitetit tuaj? Sipas opinionit tuaj, cili është roli i kllisheve dhe i paragjykimeve? A kanë ato ndonjë bazë reale?

IV-2. Kujtimet e dr. Riza Nurit, për refuzimin e martesës me një vajzë të huaj (1910)

Ishte periudha kur merrja pjesë në parlament. Gjatë kësaj kohe më ishin bërë shumë propozime për martesë. Njëra nga kandidatet ishte e pasur dhe e bukur. Ajo vetë kishte mjaft dëshirë dhe po përpiqej shumë. Zemra sa nuk po më çahet për të. **Ajo ishte shqiptare. Vetëm për këtë arsye nuk u martova me të. Gjithmonë thosha: "Unë duhet të lidhem vetëm me një turkeshë"**. Deri më sot, asnjë lloj gjaku tjetër nuk ka hyrë në familjen tonë.


Nur, f. 318.


 Si e shpjegoni qëndrimin e shkrimtarit? Ç'mendim keni, lidhur me vendimin e tij?

IV-3. Mospajtme në lidhje me *Megali Idhenë greke* – diskutimi i profesorit Nikolaos Saripolos me mbretin George I (1877)

[...] një shtet me Kostandinopojën si kryeqytet, i cili, nën skeptrin e Madhërisë Suaj, do të përfshijë gjithashtu edhe Kretën, Thesalinë dhe Epirin, Trakinë, Maqedoninë, Detin e Zi deri afër Trebizondit, Azinë e Vogël, si dhe të gjithë ishujt e Egjeut, duke mos përrjashtuar as vendin tim, Qipron.... "Si shumë po i zgjeroni kufijtë e Greqisë", ndërhyri mbreti.

Politis, f. 63.

 Nikolaos Saripolos (1817-1887), ekspert ligjor, studiues dhe profesor në Universitetin e Athinës, tek "Kujtimet" e tij përshkruan bisedën që bëri me mbretin George I (1863-1913) në vitin 1877, në të cilën i shpjegoi pikëpamjet e tij lidhur me territoret që kërkonte Greqia.


 Përse e ndërpreu bisedën mbreti? Çfarë synonte autori që t'i shpjegonte mbretit?


IV-4. Përkufizimi i hapësirës kombëtare rumune, sipas historianit Aleksandër D. Ksenopoli (1888)

Në krahasim me kombet latine, e meta kryesore e pozicionit tonë gjeografik, që e bën Europën Perëndimore të duket si një kontinent, është se ne, latinët e Lindjes, dukemi si një ishull i humbur, në një oqean popujsh të huaj.

Për këtë arsye, meqenëse fati deshi që ta vendoste popullin rumun në veri të Danubit, ai sot zë një territor hapësinor prej 300 000 km², një territor pothuajse po aq i madh, sa dhe sipërfaqja e tërë Italisë, ose më i madh se gjysma e sipërfaqes së Francës, dhe rrethohet nga tre lumenj, në formën e një trekëndëshi. Këta lumenj janë Danubi në jug, Dnestri në kufirin lindor, si dhe degëzimi i madh i Danubit, lumi Tisa, që formon dhe kufirin perëndimor. Në këtë rajon, përfshirë këtu edhe disa ishuj të tjerë përtej kufijve të lartpërmendur, rumunët përbëjnë - pothuajse kudo - një popull kompakt.

Xenopol, I, p. 43.

 Aleksandër D. Ksenopoli (1847-1920) ka qenë njëri prej studiuesve kryesorë rumunë të shkencave humane gjatë fundit të shekullit të 19-të. Ai ka botuar në fusha të ndryshme, por fitoi famë kombëtare dhe europiane, për shkak të kontributit të tij në historinë rumune, si dhe në teorinë e historisë. Ai është autori i sintezës disavëllimëshe të historisë rumune.


 Në ç'mënyrë është përfaqësuar identiteti dhe hapësira kombëtare rumune? A mendoni se deklarimi i hapësirës kombëtare bëhet për qëllime ideologjike dhe politike? A dini raste të tjera, ku të njëjtat territore janë pretenduar nga disa kombe? Jepni shembuj konkretë.

IV-5. Ndarjet kombëtare në parlamentin osman (1908-1914)

Unionistët [xhonturqit], me sulmet e tyre ndaj nesh, pretendonin se ne ishim bashkuar me elementët e huaj dhe me ata që nuk ishin turq, pra, me tradhtarët e atdheut. Por realiteti ishte krejt ndryshe. Në të vërtetë, opozita kishte turq, arabë, shqiptarë, grekë dhe armenë në radhët e saj, por elementë të tillë ekzistonin edhe midis vetë unionistëve. Në fakt, pavarësisht se pjesa më e madhe e tyre ishin unionistë [...], ekzitonte mundësia për t'i shkëputur përmes një organizimi më të mirë, në një mënyrë të ligjshme. Në atë kohë, arabët donin të krijonin një parti arabe. Për ta frenuar këtë gjë, ishte e rëndësishme që ata të përfshiheshin brenda "Kullës së Babilonit". Kjo nuk ishte një zgjidhje e keqe, sepse edhe unionistët kishin një përbërje të tillë. Në fakt, i gjithë vendi është i tillë. Ç'të bësh? Madje edhe parlamenti po kështu do të jetë. Arabët kanë ide nacionaliste shumë të rrezikshme. Në qoftë se ndodh diçka e tillë, atëherë fundi do të jetë i hidhur. Do të ndodhë e njëjta gjë, po ashtu si dhe me parlamentin e Austrisë. Një ide të tillë e mbështetin edhe grekët, në mos hapur, fshehurazi.[...] Unë për vete jam gati që të vdes për Turqinë, por këtë gjë e mbaj të fshehur si sekret. Për të nuk flas me askënd. Në qoftë se ne e bëjmë një gjë të tillë hapur [të flasim për nacionalizmin turk], atëherë edhe të tjerët do të kenë një arsye të ligjshme për të bërë po ashtu. Kjo do të thotë që vendi do të copëtohet e do të zhduket. Mëmëdheu (vatani) shtrihet që nga Shkodra, deri në Basra e Jemen. Brenda tij gjenden shtatëdhjetë e dy elemente e gjysmë. Kjo gjendje ka qenë pika më e dobët e Turqisë, si dhe rreziku më i madh që i është kanosur asaj. Kjo është arsyeja pse unë i trembesha mendimit për krijimin e partive kombëtare. Në atë kohë, pavarësisht se ai vetë ishte shqiptar, Hysen Xhahidi shkroi disa artikuj mbi "kombin mbizotërues", kundër grekëve tek "Tanin". Është e vërtetë se ai nuk e përmendi Turqinë me emër, por përdorimi i termit "komb mbizotërues" nuk ishte i pranueshëm në një regjim kushtetues. I tërbuar prej qëndrimit të çmendur të këtij njeriu, thoja me vete: - "Ai ose po e bën këtë gjë me qëllim, ose sytë i janë verbuar nga një perde e zezë dhe e trashë paditurie. Ai nuk mund ta kuptojë çfarë dëmi të madh po i krijonte shtetit."

Në të vërtetë, të flisje për një "komb mbizotërues" nuk ishte e drejtë, sepse vendi përbëhej prej shumë kombesh të ndryshme [milet]. Përndryshe, nuk do të kishte pasur kushtetutshmëri. Nëse Turqia do t'i kishte qeverisur këto zona si koloni, përmes ligjeve të veçanta, atëherë kjo do të kishte qenë një tjetër histori. Kështu që ata nuk do të mund të zgjidheshin dot as si deputetë. Megjithatë, Turqia nuk e kishte një pushtet të tillë [...] Grekët u çmendën fare. Ata u ngritën kundër një kombi të tillë mbizotërues. Këta artikuj qenë porsì shkëndijat brenda një kutie baruti. Sa do të doja që ai të kish përdorur fjalën "turk", në vend të kombit mbizotërues. Por ai nuk e tha këtë, ai nuk mundej që ta thoshte këtë [...] Pavarësisht nga kjo, unë u mundova që të mblidhja grupet e opozitës. Pata ca biseda me disa deputetë të rëndësishëm. Arabët nuk donin që të bashkoheshin në një parti të përbashkët. Abdalhamid Zohrai ishte dhe drejtuesi i këtij grupi. Ndërkohë, unë kisha marrëdhënie të mira me Shukri Asalin, deputetin e Damaskut. Ai ishte një njeri naiv. I detë e veta m'i tregonte gjithmonë dhe unë nuk e ndërprisja. Ideja e tij ishte të krijohej një shtet Umajad në Damask [...] Unë për vete i kisha kërcënuar arabët kështu: - "Nëse ju krijoni një parti arabe, atëherë edhe ne do të krijojmë një parti turke dhe do të bashkohemi me unionistët. Pastaj do ta shikoni se kush do ta pësojë humbjen". Atyre u hyri frika dhe e pranuan idenë time. Edhe Partia Popullore nuk deshë të bashkohej, për shkak të mbështetjes së Gumulxhinelit. Duke bërë të pamundurën, ia arrita që t'i bindja.

Nur, f. 328-332.

 Si mund t'i kuptojmë problemet e ngritura në tekst? Si mendoni, cilat ishin ndryshimet ideologjike dhe qëndrimet politike që e shqetësonin autorin?

IV-6. Shpallje të luftës anticoloniale nga qipriotët grekë (1955)

A.

Me ndihmën e Zotit, me besim të plotë në betejën tonë të nderuar, me mbështetjen e të gjithë helenizmit dhe me ndihmën e qipriotëve, KEMI FILLUAR LUFTËN PËR TA FLAKUR TEJ ZGJEDHËN

BRITANIKE, duke përdorur si thirrje të kësaj luftime, atë të cilën prindërit tanë na e kanë lënë si amanet: JA VDEKJE, JA FITORE.

VËLLEZËR QIPRIOTË,

Nga thellësitë e së kaluarës, po na shikojnë pikërisht ata që i kanë dhënë lavdi historisë greke duke mbrojtur lirinë: luftëtarët e Maratonës dhe të Salamisë; të 300-tët e Leonidas dhe luftëtarët e luftës epike shqiptare. Po na shikojnë edhe luftëtarët e 1821-it, të cilët na treguan se çlirimi prej zgjedhës së sundimitarit është arritur gjithmonë përmes Shteteve Kombëtare [...]

I gjithë helenizmi po na vështron dhe po na ndjek me shqetësim, por dhe me krenari kombëtare. Le t'u përgjigjemi atyre me vepra dhe t'u tregojmë se ne jemi të denjë për to.

Ka ardhur koha që t'i tregojmë botës se diplomacia ndërkombëtare është e PADREJTË, dhe në shumë raste FRIKACAKE, dhe që shpirti qipriot është guximtar. Nëse sundimtarët tanë nuk pranojnë që të na kthejnë lirinë, ne jemi të zotët që ta fitojmë atë me DUART dhe me GJAKUN tonë.

Le t'i tregojmë botës dhe njëherë tjetër se grekët e sotëm nuk pranojnë që të rrinë nën zgjedhë. Beteja jonë do të jetë e vështirë. Sundimtari i ka të gjitha mjetet dhe është i madh në numër.

Ne kemi SHPIRTIN. E DREJTA është në anën tonë. Prandaj dhe DOTË FITOJMË. DIPLOMATË TË BOTËS, Hidhuni një sy veprave tuaja. Është për të ardhur keq, që edhe në shekullin e njëzetë, njerëzit ende duhet të derdhin gjak për të fituar lirinë, këtë dhuratë të shenjtë për të cilën ne luftuam krah jush dhe atë për të cilën edhe ju pretendoni, se luftuat kundër nazizmit dhe fashizmit. GREKË,

Kudo që të ndodheni, dëgjojeni thirrjen tonë: PËRPARA! TË GJITHË SË BASHKU PËR LIRINË E QIPROS. [...]

UDHËHEQËSI DIGHENIS

Grivas-Dighenis, f. 34.



Që të dyja thirrjet u lëshuan nga koloneli (gjenerali i mëvonshëm) George Grivasi (1898-1974), i cili, pasi kishte shërbyer në ushtrinë greke, u kthye në Qipro për të drejtuar EOKA-n, duke shpallur dhe lëvizjen guerilase kundër britanikëve, me qëllim që ta çlironte Qipron përfundimisht prej sundimit kolonial dhe ta bashkonte atë me Greqinë. Për rezultatin e kësaj luftime, shikoni tekstin I-39.

B. 1 Prill

“RRITINI FËMIJËT E GREQISË
PËR TË ÇLIRUAR VENDIN”

Një grusht i vogël njerëzish qëndrojnë të armatosur, me SHPIRTIN e tyre të mbushur plot me BESIM, rrethuar nga një Perandori prej 500 milionë banorësh, dhe nuk ndalen përballë Goliatit të fuqishëm, të armatosur gjer në dhëmbë. Kjo është lufta për DREJTËSI, e cila prodhon FUQI MORALE dhe frymëzon ideale fisnike kundër PADREJTËSISË dhe dhunës. [...]

Ne kemi arritur një fitore morale. Një Perandori e tërë është tronditur e turpëruar. Qiproja, e panjohur për shumë njerëz, madje edhe për diplomatët, sot gjendet në pararojë ndërkombëtare, duke u bërë një telash për anglo-amerikanët dhe një sëmundje vdekjeprurëse për anglezët. Gjithë popujt liberalë janë në anën tonë.

[...]

Periudha e nënshtrimit ka marrë fund. Ka ikur koha kur jetohej në kurrizin e më të voglit dhe më të pafuqishmit. Sot duhet që të mbizotërojë DREJTËSIA dhe MORALITETI. Asnjë aleancë e turpshme anglo-amerikane kundër nesh dhe asnjëlloj bashkëpunimi i fshehtë anglo-turk nuk do të arrijë që të na mundë.

Papageorgiou, f. 138-139.



Si e justifikon udhëheqësi i lëvizjes qipriote luftën për çlirim? A keni dijeni për ndonjë lëvizje tjetër antikolonialiste në vitet 1950?



Bëni krahasimin e këtij teksti, me tekstet I-9 dhe I-24. Cili ishte qëllimi i kësaj thirrjeje? Merrni një fletë dhe ndajeni atë në tri kolona. Për secilin tekst, përgjigjuni pyetjeve në vijim, duke pasur parasysh se thirrja përgjithësisht është një akt komunikimi: Cili e shkroi atë? Kujt iu drejtua ajo thirrje? Në ç'kohë dhe në ç'rrethana u krijua ajo? Nxirrni argumentet që janë përdorur për të justifikuar betejën për çlirim? Çfarë vini re? A mendoni se thirrjet duhet të respektojnë disa rregulla retorike për të arritur qëllimin e tyre?

IVb. Konfliktet konkrete

IV-7. Stjepan Radiç, *Ne duam shtetit tonë kroat brenda Bashkimit Jugosllav (1918)*

Ne duam që të kemi me ju [Mbretërinë e Serbisë dhe të Malit të Zi] vetëm një kufi të jashtëm shtetëror ndërkombëtar [...], por përveç kësaj, duam që ta ruajmë kufirin tonë të brendshëm të shtetit kroat, për këto arsye:

Së pari, ne kroatët duam që të sigurohemi se fshatarët tanë do të kenë të drejta të plota, në përputhje me gjendjen dhe nevojat tona të veçanta. [...]

Së dyti, ne kroatët duam që ta organizojmë vendin tonë, Kroacinë, jo vetëm mbi bazën e fshatarësisë, por edhe mbi atë të sllavizmit, duke e zëvendësuar, për shembull, gjuhën gjermane me atë çeke dhe po përpiqemi që t'i kopjojmë dhe t'i zbatojmë të gjitha ato rregulla dhe ligje çeke që janë të përshtatshme për ne; nga ana tjetër, ju po kopjoni rregulla dhe ligje prej të huajve (ndonëse më të përparuar); prandaj nuk do të bëjmë diskutime të pafrytshme me ju, dhe nuk do të mbetemi gjithmonë pakicë në të gjitha çështjet.

Së treti, ne kroatët kemi qëllim që ta organizojmë jetën tonë publike mbi bazën e krishterimit dhe të parimeve njerëzore të Uillonit, duke e lënë mënjanë urrejtjen dhe hakmarrjen, ndërsa ju, vëllezër serbë, përkundrazi, për shkak të vuajtjeve të mëdha, [...] dhe për shkak të heroizmit tuaj, e konsideroni veten si kombin më të mirë, jo vetëm midis sllavëve, por edhe të të gjithë botës. Ne e vlerësojmë këtë heroizëm, por krenaria juaj do ishte një pengesë e madhe për të mësuar prej të tjerëve, sidomos prej kombeve sllave.

Radiç, f. 211.



Stjepan Radiç (1871-1928), udhëheqës politik i Partisë Fshatare Kroate, ka qenë politikani kryesor kroat pas Luftës I Botërore. Ai u vra në parlament, në Beograd, sepse kundërshtoi politikën mbizotëruese serbe. Ai e shkroi këtë artikull menjëherë pas rënies së Austro-Hungarisë, në prag të bashkimit të vendeve sllave të Jugut, në 1918.



Pse e kërkoi Radiç pavarësinë për Kroacinë ("brenda bashkimit juvosllav")? A ishte ai për pavarësinë, pavarësisht nga çmimi i saj? Ç'mendoni për ideologjinë e tij (*Republika e fshatarësisë, Sllavizmi*)? A përbëjnë të tilla ideologji ndonjë interes të madh sot?

IV-8. Deklarata e serbëve, kroatëve dhe boshnjakëve (1943)

Sot kombi i Bosnjë-Hercegovinës, nëpërmjet përfaqësuesit të tij të vetëm politik, Këshillit Shtetëror Antifashist të Bosnjë-Hercegovinës, dëshiron që vendi i tyre, i cili nuk është as serb, as kroat, as mysliman, por serb, kroat dhe mysliman, të jetë Bosnjë-Hercegovina. Ajo duhet të jetë e lirë dhe e bashkuar, ku të garantohet barazia dhe paanshmëria e plotë. Kombet e Bosnjë-Hercegovinës shprehin dëshirën për pjesëmarrje të barabartë, bashkë me kombet e tjera, në ndërtimin e Jugosllavisë federale, demokratike, kombëtare.

Colakovic, f.17.



Cili është opinioni i shprehur në tekst mbi karakterin e shtetit?

IV-8a. Vendimet e Asamblesë së Madhe Kombëtare (Asamblesë së Podgoricës), 13 nëntor 1918

Serbët që jetojnë në Malin e Zi, janë të lidhur me popullin e Serbisë dhe të zonave të tjera me anë të gjakut, të një gjuhe dhe aspirote, një besimi fetar dhe zakoneve të përbashkëta [...]

Në bazë të asaj që u tha më lart, *Asambleja e Madhe e Popullit Serb* në Malin e Zi vendosi që:

1. Mbreti Nikola I Petroviç Njegosh dhe dinastia e tij të largohen nga fronti malazez;
2. Mali i Zi të bashkohet në një shtet të vetëm me Serbinë motër, nën dinastinë *Karagjeorgjeviç* dhe ashtu, të bashkuar, të bëhen pjesë e Atdheut të përbashkët, të kombit të serbëve, kroatëve dhe sllavenëve.

Dimitrije Dimo Vujoviç, f. 226-228

IV-8b. Fjalimi i delegatit malazez, Anto Gvozdenoviç³⁰, në Këshillin e të Dhjetëve të Konferencës së Paqes në Paris, 5 Mars 1919

Ne nuk biem dakord që Mali i Zi të bëhet provincë serbe, dhe të qeveriset nga një sundimtar të cilin nuk e ka zgjedhur vetë dhe që nuk i përket atij. Ne mbështesim idenë e një qëndrese të fortë ndaj çdo aneksimi të mbrapshtë dhe poshtërujes! [...] Ne nuk kundërshtojmë krijimin e një konfederate me shtetet e sllavëve të jugut, në rast se vendet anëtare në të do të ruajnë autonominë e tyre të plotë [...] Ne vetëm po kërkojmë të drejtën që i njihet çdo populli: të drejtën për të vendosur vetë mbi fatin e vet. Që të ushtrojmë këtë të drejtë, duhet që t'i jepet fund sundimit të terrorit dhe despotizmit nën të cilin vendi ynë ka kohë që rënkon me dhimbje. Serbët duhet të largohen menjëherë nga territori i Malit të Zi dhe ky proces të mbikëqyret prej jush [...] Vetëm atëherë Mali i Zi do të jetë në gjendje të shpallë i lirë vullnetin e tij nëpërmjet parlamentit të tij të ligjshëm.

Sherbo Rastoder, f. 84.

IV-9. Deklarata e Asamblesë së Parë Antifashiste për Çlirimin e Popullit Maqedonas [ASNOM] (1944)

Deklarata e ASNOM-it mbi të drejtat themelore të nënshtetasve të Maqedonisë demokratike:

1. Të gjithë qytetarët e Maqedonisë federale demokratike janë të barabartë përpara ligjit, pa dallim kombësie, seksi, race ose besimi fetar.
2. Pakicat kombëtare gëzojnë çdo të drejtë për një jetë kombëtare të lirë.
3. Çdo qytetari i garantohet siguria e personit dhe e pasurisë së tij, e drejta e pronësisë dhe e nismës private në fushën ekonomike.

4. Çdo qytetari i garantohet liria e besimit dhe e ndërgjegjes.

5. Të gjithë qytetarët gëzojnë lirinë e fjalës, të shtypit, të tubimeve dhe të krijimit të shoqatave.

6. Në Maqedoninë demokratike, e drejta për të votuar praktikohet me votë të fshehtë, mbështetur në të drejtën e përgjithshme, të barabartë, të drejtpërdrejtë dhe individuale për të votuar.

7. E drejta për t'u zgjedhur në çfarëdo organi elektoral të pushtetit popullor, i përket çdo shtetasi ose shtetaseje që ka mbushur moshën 18 vjeç, e që nuk ndodhet nën hetim gjyqësor. Për aq kohë sa lufta e popullit për çlirim ende nuk ka përfunduar, me vendim të ASNOM-it, parimi i votimit të fshehtë dhe të drejtpërdrejtë edhe mund të mos zbatohet. Personave me zhvillim të vonuar, sikurse dhe personave të akuzuar si kundërshtarë të interesave të luftës së popullit për çlirim, u mohohen të drejtat e parashtruara në pikat 5 dhe 6 të kësaj deklarate.

8. Për çdo qytetar të aftë, pavarësisht nga kombësia ose besimi i tij, pjesëmarrja si ushtar në radhët e ushtrisë popullore çlirimtare, si dhe në njësitet partizane, është nder dhe detyrë.

9. Ndalohet çdo lloj veprimtarie fashiste dhe profashiste, meqenëse të tilla veprime bien ndesh me lirinë dhe pavarësinë e komunitetit vëllazëror të popujve të Jugosllavisë.

10. Çdo qytetari i garantohet e drejta që t'i apelojë vendimet e organeve shtetërore, sikundër parashikohet edhe në ligj.

11. Çdo qytetar ka të drejtë që të apelojë dhe të ankohet në të gjitha autoritetet shtetërore. Qeveria popullore do të bëjë të gjitha përpjekjet për të zhdukur analfabetizmin, për të përmirësuar kulturën popullore, si dhe për të siguruar arsimin falas.

Mbajtur sot, më datë 2 gusht 1944 (dita e Shën Ilias), në Manastirin e Shën Prohor Pçinskut, në Ilinden.

Makedonium, f. 119-120.

³⁰ Gvozdenoviç Antoja (1854-1935) qe gjeneral në ushtrinë malazeze, franceze dhe atë ruse. Bashkë me mbretin Nikolla I Petroviçi, emigroi në fillim të vitit 1916. Ai qe i pari përfaqësues diplomatik i Malit të Zi në Uashington DC, në vitin 1918. Ai qe gjithashtu kryeministri i fundit i qeverisë malazeze në mërgim, në vitin 1922.

Key Deklarata për të drejtat themelore të qytetarëve të Maqedonisë demokratike u bë nga Asambleja e Parë e ASNOM-it (Asambleja Antifashiste për Çlirimin e Popullit Maqedonas), në 2 gusht të 1944-ës. Kjo asamble, e mbizotëruar prej komunistëve, e cila përbënte dhe organin politik të lëvizjes partizane, dhe që luftonte kundër forcave gjermane dhe bullgare në Maqedoni, përgatiti terrenin për krijimin e njësisë federale autonome maqedonase, brenda kornizës së shtetit të ardhshëm të përbashkët jugosllav të popujve të barabartë. Si e tillë, asambleja shënoi hapin e parë për shpalljen e shtetit të ardhshëm të pavarur maqedonas. Drejtuesit partizanë, jo më kot zgjodhën 2 gushtin, ditën e Shën Ilias, si ditën e shpalljes së shtetit maqedonas, sepse ajo ishte edhe dita e Kryengritjes së Ilindenit, në 1903-in. Në këtë mënyrë u krijua edhe mitologjia e "Ilindenit të Dytë", duke theksuar në këtë mënyrë vazhdimësinë e luftës së armatosur. Pavarësisht nga kjo, shumë prej këtyre neneve demokratike solemne, mbetën thjesht si deklarata, pasi Jugosllavia – e brenda saj edhe Republika Popullore e Maqedonisë – u shndërruan në sisteme politike totalitare të modelit komunist.


IV-10. Vështirësitë e luftës anticoloniale në Qipro (1955-1959), analizuar nga udhëheqësi i EOKA-s, George Grivasi (Digenis)

Ka pasur shumë aktorë të fuqishëm që më kanë penguar gjatë rrugës sime. Ata ishin (a) anglezët, të cilët frikësonin dhe ushtronin masa kufizuese ndaj të rinjve, përmes kontrollit në arsimin fillor; (b) prindërit, të cilët kishin frikë për jetën e fëmijëve të tyre; (c) mësuesit, të cilët kujdeseshin për disiplinën në shkollë dhe për edukimin e studentëve të tyre; (d) komunistët, të cilët donin t'i tërhiqnin të rinjtë në anën e tyre, vetëm për interesat e partisë; (e) persona të veçantë me pushtet, të cilët nuk mund ta kuptonin se sa të rëndësishëm ishin të rinjtë, veçanërisht nxënësit e shkollave për luftën çlirimtare, e cila u kthye në një konflikt të armatosur.

Grivas-Digenis, f. 38-39.

? Analizoni çdo argument që udhëheqësi i luftës anticoloniale e ka identifikuar si pengesë për organizimin e luftës. Cili është qëndrimi i shoqërisë suaj mbi përfshirjen e të rinjve në politikë? (Mendoni për familjen tuaj, për mësuesit, shokët, dhe për shoqërinë në përgjithësi). Deri në ç'masë mendoni se të rinjtë duhet të përfshihen në politikë? Po në konfliktet e armatosura?

► Fig. 29. Thirrja e Qipros drejtuar Kombeve të Bashkuara (vitet 1950)



Karikaturë e Ph. Demetriadesit, te Istorja tis Kyprou, f. 243.



Përkthim: Uashingtoni, Lord Bajroni dhe Zhan d'Arka: "Pra, të gjitha betejat tona shkuan kot?!"

Gjatë luftës antikoloniale, qeveria greke, e cila përfaqësonte komunitetin qipriot grek, u bëri 4 herë thirrje Kombeve të Bashkuara, duke mbrojtur të drejtën e Qipros për vetëvendosje. Në vitin 1958, këto thirrje u shndërruan nga e drejta për vetëvendosje, në të drejtën për "pavarësi".



Pse autori ka përzgjedhur këto tri personalitete? Cilat kombe përfaqësojnë ata? Cilave luftëra u referohen ata?

IV-11. Këndvështrimi i Partisë Qipriote Greke, parti e krahut të majtë (AKEL³¹), 1955

Sipas korrespondentit amerikan që bëri "intervistën", herë pas here, EOKA dhe Digenisi dërdëllisnin gjëra të çuditshme dhe të pakuptimta. Gjithashtu, korrespondenti la të kuptohej se Digenisi ishte stërvitur prej anglezëve për t'u bërë komando. Prandaj, në njoftimin e fundit të EOKA-s, transmetuar prej një stacioni radiojeje të Athinës, Digenisi deklaroi se nëse Kombet e Bashkuara nuk do të praninin të hetonin për çështjen e Qipros, atëherë qipriotët "do ta hidhnin ishullin në erë dhe do të shkaktonin një holokaust, duke djegur veten dhe britanikët. Nëpërmjet kësaj deklarate, EOKA, Digenisi dhe mbështetësit e tyre njohën disa fakte të rëndësishme: Çështja e Qipros ishte në duart e Kombeve të Bashkuara. Pastaj, çfarë kuptimi kishin tërë ato fjalë të ashpra dhe gjithë ajo rrëmujë që u bë për këtë çështje? Por, sikundër e pranojnë edhe vetë, qëllimi i tyre ishte që të mos ua thyenin turinjtë anglezëve.

Meqenëse çështja e Qipros varej prej Kombeve të Bashkuara, përse EOKA e pranon faktin se braktisja e tyre prej athinasve, të cilët u ishin "nënshtruar" të huajve, përbënte një tradhti të hapur dhe të ndyrë? Në OKB, ashtu sikurse ndodhi edhe vitin e kaluar, amerikanët na braktisën dhe na tradhtuan, ndërsa BRSS-ja votoi pro nesh. A nuk është poshtërsi që

ne të heshtim si gur varri, për shkak të atyre që na tradhtojnë dhe na mashtrojnë duke na ofruar baza ushtarake? Meqenëse EOKA e pranon se çështja e Qipros do të zgjidhet nga Kombet e Bashkuara, a nuk është e kuptueshme që mbrojtja më e mirë mund të arrihet përmes bashkimit të të gjithë qipriotëve, të cilën EOKA, në të vërtetë, e kundërshton?

Gjithçka e përmendur më lart tregon se EOKA, edhe sipas skenarit më pozitiv, është keqpërdorur politikisht, e për pasojë po merret me aventura. Ne mendojmë që zgjidhja e çështjes së Qipros, para së gjithash varet nga bashkimi dhe nga lufta e përbashkët e popullit qipriot dhe atij grek. Ky është dhe njëri prej shqetësimeve tona më kryesore, e të tjerat vijnë më pas, me radhë.

Greva politike masive e 2 gushtit në Qipro, e cila qe një shfaqje agresive e popullit të bashkuar, dëshmoi se patriotët janë në rrugën e duhur. Lërimi njerëzit të vazhdojnë me më shumë vendosmëri betejën e tyre për bashkim dhe për të drejta kombëtare. Fitorja do të jetë e tyre, pavarësisht nga pengesat, kundërshtimet dhe përpjekjet për t'i ndarë.

Gazeta Demokriti i ri, 7 gusht 1955, tek Sp.Papageorgiou, AKEL.



EOKA: Ethniki Enois Kyprion Agoniston [Organizata Kombëtare e Luftëtarëve Qipriotë] ka qenë një organizatë e fshehtë e krahut të djathtë, e cila udhëhoqi luftën antikoloniale të Qipros, nga viti 1955 deri në vitin 1959. Qëllimi i EOKA-s ishte bashkimi i Qipros me Greqinë, duke i përjashtuar qipriotët turq, udhëheqësit e të cilëve kishin vendosur që të bashkëpunonin me britanikët. Edhe qipriotët turq krijuan një organizatë të fshehtë, të udhëhequr prej oficerëve të ushtrisë turke – të cilët fillimisht u quajtën Volkan, dhe në 1958-ën "TMT" (Trupat Mbrojtëse Turke) - e cila synonte që të ruante *status quo*-në. Orientimi politik i djathtë i EOKA-s çoi drejt konflikteve me të majtët qipriotë grekë, të cilët ishin kryesisht mbështetës të AKEL-it, parti e cila kishte fituar shumë zgjedhje vendore gjatë dhjetëvjeçarëve të mëparshëm – zgjedhjet e vetme që lejonte administrata britanike.

³¹ AKEL: Anorthotiko Komma Ergazomenou Laou (Partia Përparimtare e Punëtorëve)

IV-12. Qipriotët turq kundër EOKA-s, 1960

LUFTA TERRORISTE E QIPRIOTËVE GREKË VAZHDON Pesë të vdekur brenda dhjetë ditëve! Makariosi duhet t'i dënojë akte të tilla.

EOKA i ka shprehur qartë qëllimet e veta: Popullsia do të terrorizohet dhe fushata e terrorit do të vazhdojë me një furi të plotë. Nuk ka dyshim se kushdo që e planifikon këtë gjë, do të përballet me të njëjtat pasoja.

Gjatë muajve të parë të republikës, organizata terroriste e EOAK-s e rifilloi përsëri fushatën e saj të vrasjeve. Këto akte terroriste u ndërpre në pas marrëveshjeve të Zyrihut dhe të Londrës. Operacioni i luftëtarëve të EOKA-s, të cilët po luftojnë për bashkimin e Qipros me Greqinë, nisi fillimisht me zërat e ashpër për vrasje dhe terror, dhe më pas vijoi shkallë-shkallë drejt *Enosisit* ("Bashkimit"). Për të arritur qëllimet e veta, EOKA e përgatiti mjaft mirë këtë fushatë terroriste, duke e lidhur atë me nevojën për unitet dhe për bashkëpunim ndërmjet qipriotëve grekë. Pa kurrfarë përjashtimi ose ngurrimi, çdo grek që do të kundërshtonte dhe do të tradhtonte EOKA-n, dhe që nuk besonte në synimet e saj të mëdha, do të bëhej shoshë prej plumbave të EOKA-s, dhe ashtu sikurse edhe në të shkuarën, ai do të rrëmbehej, do të torturohej dhe do të digjej.

Komuniteti turk kurrë nuk do t'i harrojë veprimet e drejtuara kundër tij, si dhe aktet terroriste që ka pësuar për shkak të kësaj organizate, e cila kërkonte të arrinte ambicjet e saj të mëdha. Nga kjo pikëpamje, turqit e Qipros e dinë mjaft mirë rëndësinë dhe qëllimin e vërtetë të këtyre veprimeve terroriste.

Qipriotët turq do t'u përgjigjen me pakënaqësinë më të madhe këtyre veprimeve, të cilat nuk përbëjnë një shenjë të mirë për të ardhmen e Republikës së Qipros.

Makariosi³² duhet t'i dënojë veprimet e këtyre terroristëve, të cilët, për të arritur qëllimet e veta, kanë zgjedhur vdekjen dhe frikën. Pozicionet e zaptuara prej tyre e bëjnë mëse të nevojshme një gjë të tillë.

Gazeta *Nacak*³³, 73, 7 tetor 1960.




Në vitin 1958, kohë kur Qiproja ndodhej nën sundimin britanik, shpërtheu për herë të parë dhuna midis dy komuniteteve, e cila çoi në shpërnguljen e një grupi të vogël qipriotësh grekë. Pas këtyre ngjarjeve, nisën negociatat ndërmjet Ankarasë dhe Athinës, të cilat çuan në Marrëveshjet e Zyrihut dhe Londrës të vitit 1959. Në bazë të këtyre marrëveshjeve, në vitin 1960 u vendos krijimi i Republikës së Qipros si shtet i pavarur, nën garancinë e Britanisë, Greqisë dhe Turqisë. Interesat strategjike britanike u siguruan prej dy bazave të pavarura britanike të vendosura në ishull, ndërsa prania e grekëve dhe e turqve u siguruan përmes vendosjes së 950 trupave greke dhe 650 trupave turke. Qipriotët grekë ishin të ndarë në qëndrimet e tyre në lidhje me këto marrëveshje, ndërsa qipriotët turq e mbështetën kushtetutën, e cila gjithsesi nuk iu nënshtrua një referendumi. Të dyja komunitetet akuzonin njëri-tjetrin për mbajtjen e rezervave të armëve dhe për krijimin e bandave të armatosura: në një rast, përpara shpalljes së pavarësisë, britanikët arritën të kapnin një anije, të quajtur "Deniz", duke çuar armë në ishull.

Pas dy vitesh tensioni në rritje, në dhjetor 1963, për shkak të një mosmarrëveshjeje serioze mbi

³² Makariosi III (1913-1977) i kreu studimet në Qipro, Athinë dhe në Boston, dhe më pas, në 1948, u kthye në Qipro. Pas vdekjes së Makariosit II, ai u bë kryepeshkopi më i ri i Qipros, në moshën 37 vjeçare (1950). Ai u dënua prej britanikëve me internim në Seishellet, nga viti 1956 deri në 1957. U zgjodh presidenti i parë i Republikës së Qipros në zgjedhjet e 13 dhjetorit 1959 dhe në vitin 1961, e bëri këtë republikë të re anëtare të Lëvizjes së të Paangazhuarve. Në 15 korrik 1974, për shkak të një grushti shteti të përgatitur prej juntës ushtarake greke, Makariosi u rrëzua nga pushteti dhe u arratis në Londër. Më tej, ngjarjet pasuan me pushtimin turk të 20 korrikut dhe të 15 gushtit, si dhe me ndarjen e ishullit. Makariosi u kthye në Qipro në dhjetor 1974 dhe vdiq në datën 3 gusht 1977.

³³ *Naxhak (Sëpata)* ka qenë një gazetë e përjavshme që u botua nga viti 1959 deri në vitin 1963. Ajo botohej prej Raouf Denktashit, politikan nacionalist ambicioz që prej viteve 1950, i cili mbështeste "turqësinë" e qipriotëve turq. Duke e kundërshtuar politikën më të moderuar të zëvendëspresidentit të parë të Republikës së Qipros, Fazil Kuçukut, ai u zgjodh president i Dhomës Komunale të Turqisë në 1960-n. Gjatë periudhës së përplasjeve midis komuniteteve, u arratis në Turqi (1963/4-1967). Që prej 1968-ës e në vijim, qe përfaqësuesi i qipriotëve turq gjatë diskutimeve ndërkomunitare të zhvilluara me mbështetjen e OKB-së. U bë udhëheqësi i qipriotëve turq dhe qëndroi si i tillë deri në 2003-in, vit në të cilin luajti rolin kryesor në kundërshtimin e versionit të tretë të Planit të Ananit.

kushtetutën, u krijua një atmosferë shpërthyes, e cila kulmoi me përplasjet midis qipriotëve grekë dhe atyre turq. Pas kësaj, në janar të vitit 1964 u vendos një vijë ndarëse, e njohur si *Vija e gjelbër*, e cila kalonte përmes Nikozias. Gjatë viteve 1963-64, një numër i madh qipriotësh turq u detyruan të largohen nga vendi. Gjithsesi, rreth 50% e qipriotëve turq vazhduan të jetojnë së bashku me qipriotët grekë deri në korrik 1974, kur, pas grushtit ushtarak grek kundër qeverisë që kishte njohje ndërkombëtare dhe pas ndërhyrjes ushtarake turke që pasoi, 165 000 qipriotë grekë humbën shtëpitë e tyre. Humbja e jetëve ishte gjithashtu shumë më e madhe se më parë. Në vitin 1975, qeveria britanike lejoi që 8 000 qipriotë turq, të cilët ishin strehuar në bazat e pavarura britanike, të vendoseshin në zonën e kontrolluar nga turqit. Kjo gjë e bëri edhe më të qartë ndarjen fizike ndërmjet komuniteteve të cilat deri në vitin 1958 ishin integruar me njëri-tjetrin në përqindje afërsisht të barabarta në të gjithë ishullin. Qipriotët grekë dhe qipriotët turq u ndanë nga njëri-tjetri dhe shumë individë nga secili komunitet u kthyen në njerëz të shpërngulur në tokën e tyre.

 Krahasoni tekstet IV-10, IV-11 dhe IV-12 dhe përpuni të kuptoni tri qëndrimet e ndryshme që janë paraqitur aty. Gjithashtu referohuni edhe teksteve I-44 dhe IV-6.

IV-13. Qëllimet e “Pranverës kroate” në fillim të viteve 1970-të, sipas shkrimtarit Vlado Gutovac

Kushdo që hyn në burg si i pafajshëm, nuk mund të shpresojë në asgjë. Ai thjesht duhet të presë [...] Unë kam përfaqësuar ëndrrën e shtetit kroat; kjo ëndërr duhet përmbushur me qëllim që ta lëmë atë mënjane, dhe të vazhdojmë më tej krahas popujve të tjerë të botës. Shteti për mua nuk është gjë tjetër, veçse një e keqe e pamënjueshme. Edhe në rastin e Kroacisë është e njëjta gjë. Por kjo duhet zgjidhur si një çështje e brendshme! Vetëm atëherë, kjo dëshirë e tejzgjatur do të mund të përfundojë [...] dhe ne do të fillojmë që të shohim një ëndërr tjetër – ëndërr kundër tij [shtetit].

Gotovac, p.129, 159.



Në fund të viteve 1960, Kroacia drejtohej prej administratorëve komunistë, relativisht të rinj në moshë, Savka Dabcevic- Kucar dhe Miko Tripalo. Ata u përpoqën që të arrinin një nivel më të lartë pavarësie për Kroacinë, brenda Jugosllavisë. Gjithashtu, ata shpallën disa liri demokratike, por brenda suazës së qeverisë komuniste ekzistuese. Kjo lëvizje u njoh me emrin “Pranvera kroate”, ndërsa “Lëvizja e masave” ishte më pak e njohur. Ajo pati shumë përkrahës, veçanërisht studentë. Kësaj lëvizjeje iu dha fund në fillim të viteve 1970, kur Savka Dabcevic-Kucari dhe Tripalosi u hoqën me vendim të Titos. Mjaft njerëz të cilët e kishin mbështetur këtë lëvizje, sidomos ata që ishin intelektualë, u burgosën. Njëri prej këtyre të burgosurve ishte dhe shkrimtari Vlado Gotovac, i cili vuajti katër vjet heqje lirie në burgun famëkeq të Stara Gradishkas.



Çfarë nënkupton autori me fjalët “shteti për mua nuk është gjë tjetër, veçse një e keqe e pamënjueshme”? Ç’mendoni për paradoksin, se armiku i çfarëdolloj shteti u burgos, sepse kishte luftuar për shtetin kroat? A përbëjnë shtetet kombëtare një hap të nevojshëm për heqjen e shtetit në përgjithësi?

IV-14. Memorandumi i Akademisë Serbe të Artit dhe Shkencës (SANU) (1986)

Në Jugosllavi ekziston një shqetësim i madh në lidhje me ritmet e ulëta të zhvillimit shoqëror, vështirësitë ekonomike, tensionet shoqërore gjithnjë e në rritje, si dhe konfliktet e hapura ndëretnike. Një krizë e rëndë ka pushtuar jo vetëm fushën ekonomike dhe politike, por edhe tërë sistemin ligjor dhe rendin në Jugosllavi. Dembelizmi dhe papërgjegjshmëria në punë, korrupsioni dhe nepotizmi, mungesa e besimit dhe mosrespektimi i ligjit, kokëfortësia burokratike, rritja e mosbesimit mes individëve dhe egoizmi gjithmonë e më arrogant i individëve dhe i grupeve janë kthyer në dukuri të përditshme. Dëmi që u është shkaktuar vlerave morale dhe reputacionit të institucioneve më të larta publike, si dhe mungesa e besimit tek aftësitë e vendimmarrësve kanë shkaktuar plogështi dhe zemërim tek publiku dhe i kanë tjetërsuar shtyllat dhe simbolet e rendit dhe të

ligjit. Shqyrtimi objektiv i realitetit jugosllav tregon se kriza e tanishme mund të përfundojë në një traumë shoqërore me pasoja të paparashikueshme, siç mund të jetë edhe copëtimi shkatërrimtar i shtetit jugosllav. Askush nuk mund të mbyllë sytë përpara asaj që po ndodh ose që mund të ndodhë.

[...] [Në Jugosllavinë komuniste] zgjidhja e çështjes kombëtare u hartua dhe u zhvillua teorikisht prej Speransit (Kardelit³⁴), në librin e tij "Razvoj slovenskoga narodnoga vprsanja" [Zhvillimi i çështjes kombëtare sllovene], i cili në përgjithësi shërbeu si një model ideologjik për zhvillimin e Jugosllavisë, si një konfederatë republikash sovraane dhe rajonesh autonome, që përfundimisht u arrit me Kushtetutën e vitit 1974.

Dy republikat më të zhvilluara³⁵, të cilat arritën që t'i përmbushnin programet e tyre kombëtare përmes kësaj kushtetute, janë sot mbështetëset më të flakta të sistemit ekzistues. Në sajë të pozitës së udhëheqësve të tyre në qendrat e pushtetit politik, ato kanë qenë edhe nismëtarët e të gjitha çështjeve me ndikim në sistemin ekonomik dhe politik (përpara dhe pas viteve vendimtare 1960). Ata e formësuan strukturën ekonomike dhe shoqërore të Jugosllavisë, në përputhje me dëshirat dhe nevojat e tyre.

[...] Duke pasur parasysh format ekzistuese të diskriminimit kombëtar, Jugosllavia e sotme nuk mund të konsiderohet si një shtet demokratik. [...] Jugosllavia shihet më pak si një komunitet qytetarësh, kombesh dhe kombësish, të gjithë të barabartë përpara ligjit, dhe më shumë si një komunitet prej tetë territoresh të barabarta. Por edhe ky lloj barazimi nuk vlen për Serbinë, për shkak të pozicionit të saj të veçantë ligjor dhe politik, i cili pasqyron prirjen për ta mbajtur kombin serb nën mbikëqyrje të vazhdueshme. Parimi kryesor prapa kësaj politike ka qenë ai i "një Serbie të dobët dhe i një Jugosllavie të fortë", çka është kthyer në një mendësi mbizotëruese. Në qoftë se serbëve, të cilët janë dhe kombi më i madh, do t'u lejohej një rritje ekonomike e shpejtë, atëherë një gjë e tillë do përbente rrezik për kombet e tjera të Jugosllavisë.

Për këtë arsye shfrytëzohen gjithë mundësitë e nxjerrjes së pengesave më të mëdha, për të ngadalësuar zhvillimin ekonomik dhe konsolidimin politik të Serbisë. Njëra prej pengesave të tilla më të rënda është dhe pozita e tanishme e papërcaktuar kushtetuese e Serbisë, me kaq shumë konflikte të brendshme.

[...] Marrëdhëniet ndërmjet Serbisë dhe krahinave³⁶ nuk mund të reduktohen vetëm në një interpretim ligjor formal të dy kushtetutave³⁷. Kjo është kryesisht një çështje ndërmjet kombit serb dhe shtetit të tyre. Këtij kombi, i cili e ka rifituar shtetësinë pas një lufte të gjatë dhe të përgjakshme, që e ka arritur demokracinë qytetare dhe që ka humbur dy milionë e gjysmë njerëz në dy luftëra botërore³⁸, iu desh që të provonte se si, pas katër dhjetëvjeçarësh, brenda Jugosllavisë së re, ai do të ishte i vetmi që do të dënohej prej një komisioni partiak burokratik, për të mos pasur shtetin e vet. Një humbje më e hidhur historike në kohë paqeje nuk mundet që të imagjinohet.

[...] Çështjes së pozicionit të popullit serb i është kushtuar një vëmendje e veçantë, nisur nga fakti se një numër i madh serbësh jetonin jashtë saj, pra Serbisë së vërtetë, dhe ngaqë numri i tyre është më i madh sesa numri tërësor i popullsisë së disa kombeve të tjera. Sipas regjistrimit të popullsisë të vitit 1981, 24% e popullit serb (1 958 000) jetonin jashtë Republikës Socialiste të Serbisë, që në të vërtetë përbën një numër më të madh sesa ai i sllovenëve, shqiptarëve dhe maqedonasve, dhe pothuajse i barabartë me atë të myslimanëve.

[...] Është e drejta historike dhe demografike e popullit serb që të gëzojë një integritet të plotë kombëtar dhe kulturor, pavarësisht nga republika ose krahina në të cilën ata mund të jetojnë.

[...] Për të përmbushur interesat legjitime të Serbisë, rishikimi i Kushtetutës është diçka e pashmagshme. Krahinat autonome duhet të bëhen një pjesë integrale e vërtetë e Republikës së Serbisë, duke iu siguruar atyre atë nivel autonomie, i cili nuk do ta shkatërronte integritetin e republikës dhe që do të bënte të mundur të veprohej për interesat

³⁴ Eduard Kardeli (1910-1979), slloven, ka qenë mësues; ai hyri në lëvizjen komuniste dhe u bë njëri prej pushtetarëve kryesorë të Jugosllavisë Komuniste. Ai ishte ideologu kryesor i titizmit, dhe u përpoq që të forconte federalizmin jugosllav.

³⁵ Sllovenia dhe Kroacia

³⁶ Kosova dhe Vojvodina

³⁷ Kushtetuta e Jugosllavisë Federale dhe ajo e Republikës së Serbisë.

³⁸ Shifra e të varërve serbë gjatë dy Luftërave Botërore është mjaft e diskutueshme.

e përbashkëta të komunitetit më të gjerë. Çështja problematike e shtetit serb nuk është problemi i vetëm që duhet të rregullohet me anë të amendamenteve kushtetuese. Kushtetuta e vitit 1974 e shndërroi Jugosllavinë në një komunitet në gjendje shumë të paqëndrueshme, të gatshëm për të shqyrtuar çdo alternativë, përveçse asaj jugosllave, sikurse është bërë e qartë edhe nga pohimet e fundit të bëra prej figurave publike të Sllovenisë, si dhe nga qëndrimet e mëparshme të mbajtura prej politikanëve maqedonas. Këto pikëpamje dhe copëzime çojnë drejt idesë se Jugosllavia rrezikohet nga një kalbëzim i mëtejshëm. Kombi serb nuk mund të vazhdojë ta presë të ardhmen në një situatë të tillë pasigurie. Prandaj, të gjitha kombeve të Jugosllavisë u duhet dhënë mundësia të shprehin dëshirat dhe qëllimet e tyre. Atëherë, Serbia do të mund të deklaronte dhe të përcaktonte interesat e saj kombëtarë.

[...] Nëse kombi serb brenda Serbisë nuk merr pjesë njëlloj si shtetet e tjera gjatë gjithë procesit të vendimmarrjes dhe zbatueshmërisë, atëherë Jugosllavia nuk mund të jetë e fortë – dhe vetë ekzistenca e saj si një komunitet shoqëror dhe demokratik do të vihet në pikëpyetje.

Gjithë kjo periudhë zhvillimi e komunitetit jugosllav dhe e Sebisë ka përfunduar në një ideologji të sflitur historike, në amulli tërësore, dhe madje në një kthim mbrapa që më shumë vihet re në sferën ekonomike, politike, morale dhe kulturore. Një situatë e tillë kërkon në mënyrë të ngutshme një reformë të thellë dhe të mirëmenduar, të arsyetuar drejt dhe të zbatuar me vendosmëri nga të gjitha strukturat qeveritare, si dhe organizatat shoqërore të komunitetit jugosllav të kombeve; po ashtu, edhe një integrim të shpejtë dhe pozitiv në botën moderne, përmes një demokracie shoqërore [...]

<http://www.haverford.edu/relg/sells/reports/memorandumSANU.htm>



Memorandumi i SANU-t është kritikuar (veçanërisht jashtë Serbisë) si një platformë politike për nacionalizmin serb dhe si një program që paraqet idenë për krijimin e Serbisë së Madhe; në këtë mënyrë, ai ka shërbyer si bazë ideologjike për politikën e mëvonshme të Slobodan Millosheviçit dhe për luftërat e viteve 1990.



Mundohuni të kuptoni përse teksti pretendon se Titoja kishte bërë përpjekje për ta kufizuar ndikimin e Serbisë në Jugosllavinë komuniste? A mos ishte ky rezultat i përvojës së mëparshme, kur politikat panserbe qenë shkaktaret e tensioneve në periudhën midis luftërave? A ishte i drejtë zemërimi i anëtarëve të Akademisë Serbe? Sipas njohurive tuaja, po përfaqësuesit e republikave të tjera jugosllave, a kishin të njëjtin mendim me ta?

IV-15. Qëndrimi i një slloveni mbi çështjen e gjuhës në Jugosllavinë komuniste (1987)

Me siguri, marrëdhëniet në Jugosllavi do të kishin qenë ideale në rast se sllovenët do të dinin serbo-kroatishten, ndoshta edhe serbishten ose kroatishten veç e veç, ose të paktën maqedonishten; nëse serbët dhe kroatët do të dinin sllovenishten dhe maqedonishten; dhe në rast se maqedonasit do të dinin një ose dy gjuhë të tjera përveç të vetës. Në të vërtetë, sllovenët përpiqen që ta ruajnë marrëdhënie të tillë. Kështu për shembull, fëmijët sllovenë e mësojnë gjuhën serbo-kroate nëpër shkollat fillore, si lëndë të detyrueshme. Mirëpo, serbët dhe kroatët zakonisht nuk e mësojnë gjuhën sllovene nëpër shkollat e tyre fillore. Kjo do të thotë se, në mënyrë të pandërgjegjshme, e zbatojmë parimin [e barazisë gjuhësore] në mënyrë të njëanshme. Sllovenishtja është gjuhë e klasit të dytë në Jugosllavi, fakt që është vërtetuar nëpërmjet një vëzhgimi sipërfaqësor të situatës dhe për të cilën ka me mijëra anekdota. Serbët dhe kroatët e dinë mirë se njohuritë mbi gjuhën sllovene nuk janë domosdoshmëri e madhe për ta. Kontaktet e tyre me sllovenët kanë dëshmuar se sllovenët janë të gatshëm që t'u drejtohen atyre në gjuhën e vet, në shumicën e rasteve. Mendoj se kur një kroat ose serb përballet me mendimin se ai duhet të mësojë sllovenisht, i bën vetes një pyetje logjike: "Përse duhet të mësoj sllovenisht, kur unë mund ta shpenzoj këtë kohë për të mësuar një gjuhë që mund të më hyjë në punë për diçka më të ngutshme që më shqetëson në jetën e përditshme dhe nga e cila varet mirëqenia dhe zhvillimi im?" Shumë sllovenë, veçanërisht ata që kanë punësime federal, mendojnë se njohja e serbo-kroatishtes

është një detyrim moral, duke shpresuar që shembulli i tyre do t'i bindë qytetarët e tjerë, se dhe ata duhet të mësojnë sllovenisht. Unë mendoj se një pikëpamje e tillë është e gabuar, sepse, në fund të fundit, janë sllovenët ata që duhet t'i bëjnë vetes së tyre pyetjen, sikurse dhe të tjerët: "Përse duhet të mësoj serbo- kroatisht, kur këtë kohë mund ta shpenzoj për të mësuar një gjuhë më të rëndësishme? Përse sllovenët të mos mësojnë anglisht, gjermanisht, rusisht, në vend të serbo-kroatishtes?"

Përgjigjja qëndron tek frika, e cila ka qenë karakteristikë e sllovenëve për një mijë vjet. Imagjinojeni një slloven që ndodhet jashtë shtetit, në një delegacion diplomatik ose në ushtri. Papritur ai zbulon që është fare i vetëm, brenda një mbledhjeje me përfaqësues të vendit, të cilët flasin serbo-kroatisht. Përfundimi i vetëm është se ai po qëndron përpara [përfaqësuesve të] një vendi që flet serbo-kroatisht, dhe jo përpara përfaqësuesve individualë të kombit serb ose kroat. Çështja e gjuhës kthehet në një çështje patriotizmi dhe madje, në fund të fundit, në një çështje tradhtie. [...]

Por tashmë shtrohet një tjetër pyetje e rëndësishme: Si është e mundur që të flasim ballë për ballë me shtetin, nëse jemi të pushtuar nga frika? Gjithkush ka kaluar përvoja të tilla. Kur gjendesh përpara komandantit, qeveritarit ose mësuesit të rreptë – herët a vonë do të të mbahet goja. Sllovenëve u mbahet goja kur flasin në gjuhën jugosllave. Vetëm në shtëpi, me familjen dhe në institucionet e veta ata mund të flasin rrjedhshëm.

Pra, parimi sipas të cilit njerëzit e shteteve multifunksionale bëhen të barabartë, në qoftë se ata njohin dy ose më tepër gjuhë, është i diskutueshëm. Ai mund të zbatohet në mënyrë të njëanshme; madje, edhe ky respektim i njëanshëm i këtij parimi, nuk shpëton prej kontradiktave të brendshme. Njëkohësisht, përmes kësaj ne pohojmë se Jugosllavia nuk është një vend me kombe dhe gjuhë të barabarta dhe duke pasur parasysh elementet praktike, nuk mund të bëhet një vend i tillë.

Problemi i gjuhës [...] nuk do të thotë se shtrimi i çështjes kombëtare sllovene fillon me problemin e gjuhës.

Stokes, f. 283-284.



Ç'mendoni për pakënaqësinë e sllovenëve në lidhje me marrëdhëniet asimetrike mes republikave të Jugosllavisë Federale, në dukje të barabarta? A mund të gjendej ndonjë zgjidhje më praktike për këtë çështje?

IV-16. Deklarata e Majit e Shoqatës Demokratike Sllovene (1989)

Nënshkruesit e kësaj deklarate parashetrojnë kërkesat e mëposhtme:

1. Ne duam të jetojmë në një shtet sovran të kombit slloven.
2. Si shtet sovran, ne duam që të vendosim vetë për çdo lloj bashkimi me sllavët e Jugut, ose me kombet e tjera të Europës së reformuar.

Në mbështetje të synimeve e dëshirave historike për pavarësi politike të kombit slloven, shteti slloven do të bazohet në:

- Respektimin e të drejtave dhe lirive të njeriut;
- Demokracinë, e cila përfshin pluralizmin politik;
- Rendin shoqëror, i cili do të garantojë mirëqenien shpirtërore dhe materiale, në përputhje me situatën e tanishme dhe me burimet njerëzore të shtetasve të Sllovenisë.

Repe, f. 198.



Deklarata e Majit 1989 u shpall në datën 8 maj 1989, nga partia e parë opozitare, "Slovenska demokratična sveza" [Lidhja Demokratike Sllovene], e cila i fitoi zgjedhjet në vitin 1990, si rezultat i bashkimit të saj me partitë e tjera të opozitës, brenda koalicionit "Demos". Gjithashtu, *Deklarata e Majit* u firmos edhe nga disa parti dhe grupe të opozitës.




Analizoni tekstin.


IV-17. Futbolli dhe nacionalizmi – një tifoz kroat kujton udhëtimin e tij për ndeshjen midis *Partizanit të Beogradit* dhe *Dinamos së Zagrebit* (1989)

Flitet se ata kanë përgatitur sanduiçë të nxehtë për ne në Beograd. Ata nuk duhet të shqetësoheshin. Atmosfera po nxehej, ndërkohë që uiski dhe konjaku po mbaronte dhe ne po e humbnim

durimin. Vagoni ishte tërësisht i ekspozuar ndaj terrorit dëgjimor: “Tërë grupi nga Zagrebi, gjaku i tyre bardhë e blu!”; përveç kësaj dëgjoheshin edhe disa këngë kombëtare, sepse, në fund të fundit, po shkonim në Beograd dhe në të tilla kohë të trazuara, prania e dy policëve tolerantë, nuk na pengonte të këndonim një këngë, e cila deri pak kohë më parë as mendohej se mund të këndohej në publik: “Do vdes për ty, Dinamo, siç vdiq Stjepan Radiçi për kroatët!”. Atmosfera ishte e ngarkuar me ngjyrat kombëtare dhe çdo gjë kishte lidhje me Dinamon, Zagrebin dhe Kroacinë. Po të pyesnit një student ekonomik 22 vjeçar, i cili vinte nga një familje e pasur, se përse po shkonte në Beograd në një ditë të tillë të rrezikshme, në një kohë kur i kishin thënë të mos lëvizte, ekonomisti i ardhshëm do të përgjigjej: “Ne udhëtojmë, sepse e duam klubin tonë të vërtetë të Zagrebit, kjo është kënaqësi për ne [...]”. Gjendeshim pranë stadiumit, dëgjoheshin brohoritje, katedralja e madhe e tempullit të Shën Savës shkëlqente përmbi majat e kolosit të Partizanit. Pjesa jugore ishte mbushur me “varrmihës, sipërmarrës ose çfarëdo tjetër qofshin ata, të cilët mbanin flamurë dhe ishin në delir të plotë. Një pjesë ishte ruajtur bosh për mysafirët nga Zagrebi, pa asnjë mundësi kontakti. Nga *Partizani* vinin brohoritjet: “Partizani, Partizani, është skuadra e vërtetë, Slobodan Millosheviçi është krenar për të!”. Por sharjet nuk ishin të asaj mase që ne ishim mësuar të dëgjonim gjatë viteve të fundit.

www.badblueboys.hr


 Shpeshherë, identitetet shprehen përmes mbështetjes së skuadrave të caktuara sportive. Në ato shoqëri ku ndalohet shfaqja e hapur e ndjenjave kombëtare, siç ishte rasti i Jugosllavisë komuniste, besnikëria ndaj klubeve të caktuara të futbollit ishte një mënyrë shprehjeje e identitetit kombëtar. Dy prej katër klubeve më të forta të futbollit në Jugosllavi ishin nga Kroacia dhe dy nga Serbia. “Djemtë e këqij blu” mbështesnin *Dinamon e Zagrebit*, “Torcidat” ishin tifozët e *Hajdukut* (Split), “Delijet” [“Guximtarët”] ishin tifozat e *Yllit të Kuq* (Beograd), dhe “Grobari” [“Varmihësat”] ishin tifozët e *Partizanit* (Beograd). Gjatë rënies së Jugosllavisë, përplasjet midis tifozëve të futbollit u bënë gjithnjë e më të ashpra, dhe arritën kulmin në vitin 1990, gjatë një ndeshjeje midis *Dinamos së Zagrebit* dhe *Yllit të Kuq të Beogradit*.


 Si mendoni, përse u bë kaq i rëndësishëm futbollit, si mënyrë e shprehjes së identitetit kombëtar? Pse tifozët u referoheshin Stjepan Radiçi dhe Slobodan Millosheviçi? Përshkruani konfliktet kombëtare gjatë kampionateve të fundit të futbollit. A mendoni se klubet e futbollit mund të shprehin identitete të tjera, përveç atyre kombëtare, p.sh: identitete lokale, të cilat mund të jenë një lloj të papajtueshme? A mund të sillni shembuj nga vendi juaj?

IV-18. Shkrimtarja Dubravka Ugresiçi shpreh keqardhje për ndarjet dhe luftërat e viteve 1990-të

A e kam pyetur veten ndonjëherë se deri në ç’pikë jam fryt i punës së gjatë nën sistemin që kam jetuar, dhe deri në ç’masë jam fryt i vetes sime? Dhe tashmë, jam ASKUSHI, thjesht një numër pa identitet, një copë mish njeriu në duart e komandantëve të luftës, apo jo? Dhe kjo, sepse këta zotër të luftës vendosin në emrin tim, pa më pyetur fare se në cilin shtet do të jetoj, se në cilën gjuhë do të shkruaj, se cilës kulturë do t’i përkas; pikërisht ata vendosin nëse do t’u japin ose do t’u marrin jetën njerëzve të mi të afërt ose shokëve të mi; nëse do ta shkatërrojnë ose jo qytetin tim; nëse do ta ndryshojnë apo jo emrin e rrugës sime. Ata po fshijnë të kaluarën time dhe po përcaktojnë të ardhmen time [...]

Ugresic, f. 121.

 Dubravka Ugresiçi (lindi në vitin 1949) është shkrimtare e njohur romanesh, e cila u largua nga Kroacia në vitin 1993, për shkak të disa mosmarrëveshjeve me opinionin publik, lidhur me çështjen e luftës dhe të bashkimit kombëtar.

 Ç’ndjenja shpreh autori? Si kanë ndikuar ndryshimet politike në jetën e njerëzve të thjeshtë? A mendonin politikanët për mënyrën se si vendimet e tyre mund të ndikonin në jetën e njerëzve? Brenda këtij konteksti, a mund të jetë propaganda politike një prej mënyrave që politikanët përdorin për të bindur njerëzit e thjeshtë se politikat e tyre janë të drejta?

IV-19. Marrëdhëniet ndërmjet gjuhës kroate dhe asaj serbe – opinioni i gjuhëtarit kroat, Stjepan Babiç (2003)

Kur analizojmë standardin e gjuhës kroate dhe asaj serbe, mund t'i përcaktojmë shumë lehtë ndryshimet mes tyre. Mbi këto ndryshime mund të ngremë shumë teorira, por më mirë t'i përmbahemi kësaj pike. Le të marrim një shembull të qartë: Kur ndryshojmë stacionet e radios, dëgjojmë gjuhë të ndryshme dhe mund t'i dallojmë ato nga njëra-tjetra, nëse i njohim. Në këtë mënyrë mund të dallojmë italishten, frëngjishten, spanjishten ose rusishten [...] Po kështu arrijmë të dallojmë edhe ndryshimet ndërmjet gjuhës kroate dhe asaj serbe. Nëse në stacionin e radios A, dëgjojmë këtë shprehje: (...) *"Danas je 30. kolovoza. Meteoroloji najavljuju lijepo i vedro vrijeme"* [Sot është 30 gusht. Meteorologët parashikojnë një mot të bukur dhe me diell.], e kuptojmë që kjo është kroatisht, dhe kur në stacionin e radios B dëgjojmë: (...) *"Danas je 30. avgusta. Meteoroloji najavljuju lepo i vedro vreme"*, atëherë e kuptojmë që kjo është në serbisht.

www.fokus-tjednik.hr



Në shekullin e 19-të, gjuhët "kombëtare" letrare standarde u krijuan mbi bazën e dialekteve të ndryshme, të cilat fliteshin në rajone dhe zona të ndryshme. Përsa u përket kroatëve, gjuhëtarët e shekullit të 19-të zgjodhën dialektin shtokavian, midis tri dialekteve kryesore – shtokavian, kajkavian dhe čakavian – si bazën e gjuhës së përbashkët standarde. Ky dialekt ishte më i afërti me serbishten, dhe, në të vërtetë, është edhe baza e gjuhës standarde serbe. Gjatë periudhës së Jugosllavisë komuniste (1945-1991), gjuha standarde quhej edhe serbo-kroatisht (ose kroato-serbe), dhe shpeshherë debatohej, se në të vërtetë, serbët dhe kroatët kanë të njëjtën gjuhë, por vetëm se përdorin alfabetet e ndryshme. Gjatë rënies së Jugosllavisë dhe krijimit të shteteve të reja kombëtare, mbizotëroi ideja sipas së cilës kroatishtja dhe serbishtja ishin dy gjuhë krejt të ndryshme, madje disa njerëz e identifikuan edhe gjuhën boshnjake si të veçantë.



Cili është opinioni i vërtetë i gjuhëtarit Babiç, lidhur me debatin mbi gjuhën kroato-serbe? Shikojini me kujdes dy citimet e përmendura më lart. Ç'mendim keni për ndryshimet konkrete të të dyja fjalive? A e justifikojnë ato pohimin që kemi të bëjmë me dy gjuhë të ndryshme?

IV-20. Reagimet në Kroaci ndaj shfaqjes së një filmi serb me titra kroatë (1999)

"Vezite se, polecemo" [Lidhni rripat, avioni po niset], flet heroji nga ekrani, dhe poshtë është shkruar: "Vezite se, polijecemo". Pikërisht kështu. Më pas, ekrani shfaq në alfabetin latin "Beograd, jesen 1991" [Beograd, vjeshta e vitit 1991] dhe poshtë saj shpjegohet me titra me shkronja latine: "Beograd, jesen 1991". Çmenduri në kinema. Të qeshura, lot gëzimi dhe përplasje entuziaste të duarve përmbi gjunjë, në një kohë që ende nuk kishte kaluar as minuta e parë e filmit. Pa dyshim, ky është veprimi më i çmendur në historinë e kinemasë; ndoshta mund të krahasohet me fillimet e komedive amerikane pa zë. Sigurisht, ky ishte filmi "Plagë dhe titra", filmi i parë serb që u shfaq nga qendra shtetërore kinematografike e pavarur kroate. [...] pjesa tjetër, tashmë është veçse një legjendë.

Jurak.



Ç'përfundim mund të nxirrni në lidhje me çështjen e gjuhës serbo-kroate? Pse është e rëndësishme ajo për identitetin kombëtar? A përbën çështja gjuhësore një shqetësim vetëm për gjuhëtarët, apo dhe të tjerët kanë të drejtë që të merren me të? Pse çështja e gjuhës serbo-kroate çoi në situata qesharake?

IV-21. Identiteti i dyfishtë i një gruaje të re në Kroaci

Nuk më pëlqejnë dështakët. Të huajt. Njerëzit që duhet të qeshin. Dhe që duhet të jenë të sjellshëm. Nuk i pëlqej as serbët në Kroaci. Kur ata thonë fjalën "babiç", gjithmonë shtojnë pas asaj "nga Korcula". Dhe ata nuk janë nga Korcula. Por nga Dalmatinska Zagora. Nga ato vende, ku *babiç* është diçka tjetër.

OK. Ka edhe kroatët *babiç*, gjithashtu. Por kroatët *babiç* nuk japin shpjegime. Ata kurrë nuk shtojnë “nga Korcula”. [...]

Por ka edhe njerëz që janë serbë dhe që ndihen si të tillë. Ata mendojnë se të jesh serb është normale. A e dini?! Nënati i kanë serbe, baballarët u janë varrosur në varrezat serbe të Benkovacit, ku mes barit të gjatë, gurët e varreve janë të shkruajtur në alfabetin cirilik, ata festojnë ditën e Shenjtit në familjet e tyre, priftërinjtë e tyre mbajnë mjekër të gjatë dhe lejohen të martohen... Kur lind një djalë i vogël, atij i vihet emri Alimpije, Sava ose Tanasije.

Dhe ky djalë i vogël si dhe vajza e vogël me emrin Lepasava, e dinë që janë serbë qysh në çastin kur lindin. Për ta, çdo gjë është e qartë. Ndonjëherë ata mund të thonë se janë “nga Korcula”, por në të vërtetë, e dinë që nuk janë prej andej. A e kuptoni? Ndërsa unë. Rasti im. Ky është problem. Unë nuk jam serbe. Dhe më duhet që të shtoj “nga Korcula”. Unë nuk jam serbe! Pikërisht tani, në këtë çast, me shumë gëzim do të ngrihesha në këmbë dhe do të thërrisja në errësirë: “Unë nuk jam serbe”.

Rudan, f. 14-15.



Ky tekst është një fragment i shkëputur nga romani “Veshi, fyti, thika” i Vedrana Rudanit (lindur në 1949) – shkrimtare, gazetare dhe agjente pasurish të patundshme. Personazhi kryesor është Tonka Babiçi, fëmija i një nëne kroate dhe i një babai serb.



Përshkruani problemet e identitetit të Tonka Babiçit. Cilat janë ndjenjat kombëtare të Tonkës? Si e shpjegoni ju idenë se “kroati *babiç*” nuk ka nevojë që ta shpjegojë origjinën e tij, kurse “serbi *babiç*” po? Në vendin tuaj, a keni dëgjuar ndonjëherë për situata të ngjashme që kanë të bëjnë me identitetin kombëtar të dyfishtë?

IV-22. Mirko Kovaçi flet mbi nacionalizmin, 2011

Besoje se u bëra i ndërgjegjshëm për kombin dhe çështjet që lidhen me të, vetëm kur nisa të ndiej një lloj turpi. Vrasjet, përdhunimet dhe shfarosjet në masë në emër të kombit janë të mjaftueshme për këdo që të refuzojë përkatësinë e tij në një kombësi, gjë për të cilën ai nuk ka qenë përgjegjës që në fillim, sepse askush nuk bëhet pjesëtar i një kombi ashtu siç futet në një parti. Pra, as vullneti i tij nuk ndikon në këtë proces. Duke patur këtë gjë parasysh, bëra ç’ishte e mundur që të distancohesha nga një përkatësi e tillë. Identiteti mund të jetë i ndryshëm, mund të pranohet, mund të jetë i shumëfishtë, mund të jetë i ndërthurur... Për mua është më i rëndësishëm morali sesa kombi... . . . shekulli i njëzetë ishte një shekull i çmendur. Dhe të gjithë popujt tanë të vegjël luajtën rol të rëndësishëm në këtë çmenduri. Kam frikë se kjo “energji patologjike” nuk ka ndryshuar... Ajo duhet të kontrollohet edhe pse unë e di që është e vështirë, por këtu hyn në punë politika, intelijenca dhe programet e ndryshme që kanë si qëllim ta përmbajnë këtë energji brenda kufijve të pranueshëm.

<http://www.portalanalitika.me/drustvo/tema/32789-ovdje-jo-ima-patoloke-energije-.html>



Mirko Kovaçi (lindur në Petroviç të Nikshiqit, në Mal të Zi, 1938) është shkrimtar malazez, serb dhe kroat. Ai është një ndër shkrimtarët më të njohur dhe më me ndikim në territoret e ish-Jugosllavisë. Ai njihet për pikëpamjet e tij kundër luftërave dhe nacionalizmit.

IVc. Kapërcimi i nacionalizmit?

IV-22. Kuadri i përgjithshëm ligjor i Marrëveshjes për Paqen në Bosnjë- Hercegovinë (1995)

Republika e Bosnjë-Hercegovinës, Republika e Kroacisë dhe Republika Federale Jugosllave (“Palët”), **Njohin** nevojën për një marrëveshje gjithëpërfshirëse

për t’u dhënë fund konflikteve tragjike në rajon. **Dëshirojnë** që të japin ndihmesën e tyre në përbushjen e këtij qëllimi, për vendosjen e një paqeje dhe stabiliteti të qëndrueshëm. **Konfirmojnë** përkushtimin e tyre për të respektuar *Parimet e Miratuara Themeltare*, të vendosura më 8 shtator

1995, *Parimet e Miratuara Themeltare Shtesë*, të vendosura në 26 shtator 1995, si dhe *Marrëveshjet e armëpushimit* të 14 shtatorit dhe të 5 tetorit të vitit 1995.

Njohin Marrëveshjen e 29 gushtit 1995, e cila autorizon delegacionin e Republikës Federale të Jugosllavisë që të firmosë në emër të Republikës Serbska, ato pjesë të planit të paqes që lidhen me të, me detyrimin për ta zbatuar pikë për pikë marrëveshjen e arritur, e për pasojë,

Janë marrë vesh si vijon:

Neni 1

Palët do t'i vendosin marrëdhëniet e tyre në përputhje me parimet e përcaktuara në Kartën e Kombeve të Bashkuara, si dhe në Aktin Final të Helsinkit, dhe në dokumente të tjera të Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Europë. Në mënyrë të veçantë, Palët do të respektojnë plotësisht barazinë sovranë të njëri-tjetrit, do t'i zgjidhin mosmarrëveshjet me mënyra paqësore, dhe nuk do të ndërmarrin asnjë lloj veprimi me kërcënime, përdorim force ose ndonjë mënyrë tjetër kundër integritetit territorial ose pavarësisë politike të Bosnjë-Hercegovinës, ose të ndonjë shteti tjetër.

Neni II

Palët i mirëpresin dhe i mbështesin masat e marra, që kanë të bëjnë me aspektet ushake për vendosjen e paqes dhe stabilitetit të rajonit, sikundër është përcaktuar në Marrëveshjet e Shtojcat 1-A dhe 1-B. Palët duhet të respektojnë plotësisht dhe të nxisin përmbushjen e angazhimeve të bëra në Shtojcën 1-A, dhe do t'u përmbahen plotësisht parimeve të përcaktuara në Shtojcën 1-B.

Neni III

Palët mirëpresin dhe mbështesin masat e marra në lidhje me caktimin e kufijve midis dy Njësisë, Federatës së Bosnjë-Hercegovinës, si dhe Republikës Serbska, sikundër është përcaktuar edhe në Marrëveshje, në Shtojcën 2. Palët do të respektojnë plotësisht dhe do të nxisin përmbushjen e angazhimeve të marra.

Neni IV

Palët mirëpresin dhe mbështesin programin elektoral për Bosnjë-Hercegovinën, sikurse është përcaktuar edhe në Shtojcën 3. Palët do të respektojnë plotësisht dhe do të nxisin përmbushjen e këtij programi.

Neni V

Palët mirëpresin dhe mbështesin masat e marra, lidhur me Kushtetutën e Bosnjë-Hercegovinës, sikurse është përcaktuar në Shtojcën 4. Palët do të respektojnë plotësisht dhe do të nxisin përmbushjen e angazhimeve të marra.

Neni VI

Palët mirëpresin dhe mbështesin masat e marra, lidhur me krijimin e një *gjykate arbitrimi, një komisioni për të drejtat e njeriut, një komisioni për refugjatët dhe personat e dëbuar, një komisioni për ruajtjen e monumenteve kombëtare*, si dhe të një *koorperate publike* të Bosnjë-Hercegovinës, sikurse është përcaktuar edhe në Marrëveshje, në Shtojcat 5-9. Palët do të respektojnë plotësisht dhe do të nxisin përmbushjen e angazhimeve të marra.

Neni VII

Duke njohur faktin se nevoja e respektimit të të drejtave të njeriut dhe mbrojtja e refugjatëve dhe e personave të dëbuar, ka rëndësi jetike për arritjen e një paqeje të qëndrueshme, Palët bien në një mendje që t'u përmbahen dispozitave mbi të drejtat e njeriut, sikurse janë përcaktuar në Kapitullin e Parë të Marrëveshjes, në Shtojcën 6, ashtu si edhe atyre dispozitave që kanë të bëjnë me refugjatët dhe personat e dëbuar, sikurse përcaktohen në Kapitullin I të Marrëveshjes, në Shtojcën 7.

Neni VIII

Palët mirëpresin dhe mbështesin masat e marra, lidhur me zbatimin e kësaj marrëveshjeje për paqe, duke përfshirë sidomos ato elemente që i përkasin aspektit civil (joushtarak), sikurse është përcaktuar edhe në Marrëveshje, në Shtojcën 10, si dhe lidhur me task *forcën* policore ndërkombëtare, sikurse është përcaktuar edhe në Marrëveshje, në Shtojcën 11. Palët do të respektojnë plotësisht dhe do të nxisin përmbushjen e angazhimeve të marra.

Neni IX

Palët do të bashkëpunojnë plotësisht, me të gjitha entitetet e përfshira në zbatimin e kësaj marrëveshjeje për paqe, sikurse është përcaktuar edhe në Shtojcat e kësaj Marrëveshjeje, ose që janë të autorizuara nga Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara, duke zbatuar detyrimin e të gjitha Palëve për bashkëpunim, lidhur me hetimin dhe dënimin e krimeve të luftës dhe shkeljeve të tjera të së drejtës humanitare ndërkombëtare.

Neni X

Republika Federale e Jugosllavisë dhe Republika e Bosnjë-Hercegovinës e njohin njëra-tjetrën si shtete të pavaruara sovraane, me kufijtë e tyre ndërkombëtarë. Aspekte të tjera të njohjeve të ndërsjellta do t'u nënshtrohen diskutimeve vijuese.

Neni XI

Kjo marrëveshje hyn në fuqi pas nënshkrimit. HARTUAR në Paris, më 14 dhjetor 1995, në gjuhën boshnjake, kroate, angleze dhe serbe, ku secili tekst është autentik.

http://www.ohr.int/dpa/default.asp?content_id=379



Marrëveshja e Paqes, e cila i dha fund Luftës së Bosnjës të viteve 1992-1995, u negociua në Dejton (SHBA), por akti i fundit u firmos në Paris, në praninë e negociatorit të posaçëm të Bashkimit Europian, si dhe përfaqësuesve të Francës, Gjermanisë, Rusisë, Mbretërisë së Bashkuar dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës si dëshmitarë. Shumica e dispozitave konkrete të marrëveshjes janë të detajuara në 12 shtojca.

IV-23. Traktati i Mirëkuptimit, Bashkëpunimit dhe Fqinjësisë së Mirë ndërmjet Republikës së Hungarisë dhe Rumanisë (1996)

Neni 1

(1) Republika e Hungarisë dhe e Rumanisë (që më poshtë quhen "Palët kontraktuese"), do t'i bazojnë marrëdhëniet e tyre në besimin, bashkëpunimin dhe respektin e ndërsjellë.

[...]

Neni 3

(1) *Palët kontraktuese* pohojnë se gjatë marrëdhënieve të tyre të ndërsjellta, nuk do të përdorin ose nuk do të kërcënojnë se do të përdorin forcën kundër integritetit territorial ose pavarësisë politike të *Palës tjetër kontraktuese*, ashtu si dhe çdo lloj veprimi tjetër, i cili bie në kundërshtim me parimet e Kombeve të Bashkuara dhe me Aktin Final të Helsinkit. Gjithashtu, nuk do të mbështesin akte të tilla dhe nuk do të lejojnë që territori i tyre të përdoret nga ndonjë palë e tretë, për kryerjen e këtyre akteve, kundër *Palës tjetër kontraktuese*.

(2) *Palët kontraktuese* do ta zgjidhin çdo lloj mosmarrëveshjeje që lind midis tyre vetëm me mjete paqësore.

Neni 4

Palët kontraktuese konfirmojnë se, në përputhje me parimet dhe normat e të drejtës ndërkombëtare, si dhe me parimet e Aktit Final të Helsinkit, do të respektojnë paprekshmërinë e kufirit të tyre të përbashkët dhe integritetin territorial të *Palës tjetër*. Gjithashtu, konfirmojnë se nuk kanë mëtime territoriale ndaj njëra-tjetrës dhe se nuk do të ngrenë mëtime të tilla as në të ardhmen.

Neni 5

(1) *Palët kontraktuese*, për të përmbushur qëllimet e këtij Traktati, do të krijojnë një kuadër të përshtatshëm për bashkëpunim në të gjitha fushat e interesit të ndërsjellë. [...]

Neni 7

(1) *Palët kontraktuese* do të zhvillojnë edhe më gjerë marrëdhëniet dhe bashkëpunimin brenda organizatave ndërkombëtare, përfshirë këtu edhe organizatat rajonale dhe nënrajonale. Ato, në mënyrë të ndërsjellë, do të mbështesin përpjekjet e njëra-tjetrës drejt integritetit në Bashkimin Europian, në NATO, si dhe në Bashkimin Europian Perëndimor. [...]

Neni 14

Palët kontraktuese do të nxisin klimën e tolerancës dhe të mirëkuptimit ndërmjet qytetarëve me origjinë të ndryshme etnike, fetare, kulturore dhe gjuhësore. Ato dënojnë ksenofobinë, si dhe të gjitha llojet e tjera të shfaqjeve, të cilat bazohen në urrejtjen racore, etnike ose fetare, në diskriminime e paragjykime, dhe do të marrin masa të efektshme për parandalimin e shfaqjeve të tilla.

Neni 15

(1) a) Për të rregulluar të drejtat dhe detyrimet e personave që u përkasin pakicave kombëtare, të cilat jetojnë në territorin e tyre, *Palët kontraktuese* marrin përsipër që të zbatojnë *Konventën Kuadër të Këshillit të Europës mbi mbrojtjen e pakicave kombëtare*, në rast se në legjislacionin vendas nuk ekzistojnë dispozita më të përshtatshme, lidhur me të drejtat e personave që u përkasin pakicave kombëtare.

b) Duke mos e paragjykuar përmbajtjen e paragrafit të mësipërm, *Palët kontraktuese*, me synimin për të mbrojtur dhe për të forcuar identitetin etnik, kulturor, gjuhësor dhe fetar të pakicave hungareze në Rumani, dhe të pakicave rumune në Hungari, do t'i zbatojnë si detyrime ligjore të gjitha ato dispozita që përcaktojnë të drejtat e personave, të cilët u përkasin këtyre pakicave kombëtare, sikurse përcaktohet edhe në dokumentet e Kombeve të Bashkuara, të Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Europë dhe Këshillit të Europës, të përmendura në Shtojcën e këtij Traktati.

[...]

Neni 19

(1) *Palët kontraktuese* do t'i mbështesin dhe do t'i lehtësojnë kontaktet e drejtpërdrejta ndërmjet qytetarëve të tyre.

(2) *Palët kontraktuese* do t'i zgjerojnë marrëdhëniet e tyre konsullore dhe do të lehtësojnë kalimin kufitar dhe kontrollin doganor, duke përfshirë këtu hapjen e pikave të reja të kalimit kufitar, si dhe zgjerimin e pikave ekzistuese sipas mundësive përkatëse, për të lehtësuar lëvizjen e personave dhe të mallrave. Ato do të hartojnë edhe marrëveshjet e duhura për këtë qëllim.

<http://www.htmh.hu/dokumentumok/asz-ro-e.htm>

? Përmendni dispozitat kryesore, lidhur me sigurinë dhe çështjet e "politikës së lartë", të *Traktatit rumuno-hungarez* të vitit 1996. A përfshinte ai klauzola të veçanta, lidhur me jetesën e njerëzve të thjeshtë? Si mendoni për klauzolat e mëvonshme? A qenë ato të justifikuara?

IV-24. Vlerësim, bazuar në përvojat vetjake, lidhur me marrëdhëniet ndërmjet Rumanisë dhe Hungarisë në zonat me popullsi të përzier (2001)

	Prani konfliktesh	Prani bashkëpunimi	Çështje pa rëndësi ose pa përgjigje
Rumunët etnikë (në tërësi)	3%	20%	77%
Rumunët etnikë që jetojnë në Transilvani	5%	46%	49%
Hungarezët etnikë	6%	70%	24%

http://www.intercultural.ro/carti/interculturalitate_detaliu_capitol2-1.htm#mirceakivu

? Ç'përfundime mund të nxjerrim nga rezultati i këtij anketimi? Ç'mendim keni për faktin që njerëzit të cilët jetojnë në zonat me popullsi të përzier të Transilvanisë, mendojnë, shumë më tepër sesa mesatarja e tërë vendit, se marrëdhëniet ndërmjet rumunëve dhe hungarezëve kanë qenë të mira? (Shumë prej këtyre njerëzve jetonin në zonat e thella të Rumanisë)

IV-25. Pikat e Marrëveshjes së Ohrit e cila i dha fund konfliktit të armatosur në Republikën e Maqedonisë (2001)

Pikat e Marrëveshjes

13.08.2001

Pikat e mëposhtme përbëjnë marrëveshjen për të cilën u ra dakord për të siguruar të ardhmen e demokracisë së Maqedonisë dhe për të lejuar zhvillimin e marrëdhënieve më të ngushta dhe

më të integruara midis Republikës së Maqedonisë dhe komunitetit euro-atlantik. Kjo marrëveshje do të nxisë zhvillimin paqësor dhe harmonik të shoqërisë civile, ndërkohë që do të respektohen edhe identitetet etnike dhe interesat e të gjithë qytetarëve maqedonas.

Parimet bazë

1.1. Përdorimi i dhunës për të arritur qëllime politike hidhet poshtë plotësisht dhe në mënyrë të pakushtëzuar. Vetëm zgjidhjet politike paqësore mund të sigurojnë një të ardhme të qëndrueshme dhe demokratike për Maqedoninë.

1.2. Sovraniteti dhe integriteti territorial i Maqedonisë, dhe karakteri i veçantë i shtetit janë të padhunueshëm dhe duhet të ruhen. Nuk do të ketë zgjidhje territoriale për çështjet etnike.

1.3. Karakteri multietnik i shoqërisë maqedonase duhet të ruhet dhe të pasqyrohet në jetën publike.

1.4. Në rrjedhën e tij natyrale të zhvillimit dhe maturimit, një shtet modern demokratik duhet të sigurojë vazhdimisht që Kushtetuta e tij t’u përgjigjet plotësisht nevojave të të gjithë qytetarëve dhe të përputhet me standardet më të larta ndërkombëtare, të cilat edhe vetë vazhdojnë të evoluojnë.

1.5. Zhvillimi i vetëqeverisjes vendore është thelbësor për nxitjen e pjesëmarrjes së qytetarëve në jetën demokratike dhe për nxitjen e respektimit të identitetit të komuniteteve.

http://faq.macedonia.org/politics/framework_agreement.pdf

Key Njëpërmjet ndërmjetësimit ndërkombëtar, marrëveshja i dha fund konfliktit të armatosur në Republikën e Maqedonisë. E nënshkruar nga presidenti maqedonas dhe nga udhëheqësit e partive më të mëdha politike, në marrëveshje u parashikua shtimi i një sërë amendamentesh kushtetuese dhe ndryshimesh konkrete legjislativë, në mënyrë që të mbroheshin të drejtat e shqiptarëve dhe pakicave të tjera. Si rezultat i Marrëveshjes, vendi ka ecur përpara duke u bërë shtet i të gjithë qytetarëve dhe duke nxjerrë në pah karakterin e tij multietnik dhe multikulturor.

IV-26. Sportet, si një mënyrë e kapërcimit të nacionalizmit. Qipriotët grekë, duke mbështetur skuadrën vendase qipriote turke të futbollit (2003)

Duhet të them edhe diçka tjetër për Afanian³⁹. Ky fshat ka një skuadër futbollit, e cila luan në kategorinë e parë të Veriut, dhe që është në një pozicion të rrezikshëm, në fund të tabelës së klasifikimit dhe mund të bjerë në kategorinë e dytë vitin që vjen. Pas pak ditësh, unë do të luaj një ndeshje mjaft të rëndësishme, nga e cila do të përcaktohet nëse kjo skuadër do të qëndrojë në kategorinë e parë ose jo. Shumë qipriotë grekë të Afanias, refugjatë prej 29 vjetësh, kanë vendosur që të shkojnë dhe të mbështesin bashkëfshatarët e tyre gjatë kësaj ndeshjeje të rëndësishme. Madje, ata kanë nxjerrë edhe një lajmërim në shtypin qipriot grek, për të nxitur çdo qipriot grek të Afanias që të shkojë...

Report, 46, f. 27.

► **Fig. 30. Vija ndarëse (“Vija e gjelbër”), e cila ndante Nikozinë (2003)**



³⁹ Afania është një fshat nga i cili popullsia qipriote greke u largua në vitin 1974, dhe që tani banohet vetëm prej qipriotëve turq.

IV-27. Dy opinione, lidhur me heqjen e Vijës së gjelbër ndërmjet pjesës turke dhe asaj greke të Qipros (23 prill 2003)

A. Vlerësim nga Nikos Anastasiu, publikuar në internet

Asgjë nuk do të jetë si më parë, duke filluar që nga dita e djeshme. Më shumë se 2 000 qipriotë turq, dhe më shumë se 1 000 qipriotë grekë kaluan nga njëra anë në tjetrën, ndërkohë që politikanë të shumtë veçse shikonin, të paaftë për të përpunuar brenda “universit” të tyre të ngushtë, madhëstinë e asaj që po ndodhte. Që prej vitit 1974, ndodhte për herë të parë, që po të njëjtët njerëz të cilët na i kishin vendosur këto kufizime, tashmë kishin filluar që t’i hiqnin. Qipriotët grekë dhe ata turq lëviznin nga njëra anë në tjetrën, kudo që të dëshironin, duke vizituar qytetet dhe fshatrat e tyre, duke gjetur shokët e tyre të dashur që i kishin humbur prej shumë kohësh, pa praninë e policisë që i ndiqte ose u bënte pyetje. Në çdo vend që shkonin, kishte gëzim dhe mikpritje, hare dhe lot gëzimi. Po, po, në çdo vend! Qytetarët janë me të vërtetë më përpara sesa politikanët. Sigurisht, ajo që po ndodh nuk është zgjidhja politike e përhershme që duhet bërë. Por ajo është një katalizator i fuqishëm për një zgjidhje.

Report, 46, f. 26.

B. Një mësues turk nga Famagusta përshkruan vizitën e tij në një familje qipriote greke (2003)

Sot patëm një çift mysafirësh të krahut tjetër. Duke se, si shumë grekë dhe turq të tjerë [nga Qiproja], ata dëshironin të përfitonin nga kjo mundësi për të vizituar vendet ku kishin lindur dhe ku kishin kaluar një pjesë të jetës së tyre. Ata donin të shijonin kënaqësinë e pranisë në një ishull të pandarë, dhe të përjetonin emocionet që kishin mbetur gjithmonë gjallë në zemrat e tyre.

Ata nuk erdhën në shtëpinë tonë, por makina e tyre ndaloi aty pranë dhe na u duk sikur kërkonin adresën

e një rruge, e cila mbante një emër tjetër prej shumë kohësh. Por banorëve të lagjes iu kujtua menjëherë emri i vjetër, “Rruga e Moxartit”. Unë dhe ime shoqe rastisëm aty, pranë portës [...]. Zonja Eleni, emrin e së cilës e mësuam më vonë, na u drejtua: “Gjyshja ime ka jetuar më parë në një shtëpizë këtu afër; thjesht do të doja që ta shikoja njëherë. Ajo shtëpizë është ende e gjallë në mendjen time. Gjyshja më sillte shpeshherë këndeje dhe unë luaja poshtë pemëve. Më parë këtu kishte dy palma”. [...] Vitet kishin qenë të pamëshirshme, shtëpia ishte shkatërruar nga mungesa e kujdesit. Por palmat ishin akoma aty. [...] I ftuam ata në shtëpinë tonë. [...] Si qipriotë që jemi, nuk na u desh më shumë se një minutë për t’u njohur me njëri-tjetrin.

Më pas Eleni na tregoi historinë e saj. [...] “Dëgjova lajmet në radio. Barrikatat do të hiqeshin. Zemra më thoshte që të vija dhe të shikoja shtëpinë e gjyshes sime. Kam shumë kujtime të bukura për të. Lu mora leje doktorëve të mi që të vizitoja shtëpinë e gjyshes. [...]”

Ai (Nikolasi) shpjegoi: “Pashë demonstratat tuaja. Zërat dhe thirrjet e njerëzve, “Irimi”, “Paqe për të gjithë qipriotët”, “Qiproja është atdheu i grekëve dhe i turqve”, ende më buçasin në veshë. Ai vazhdoi: “As unë nuk mund t’i fshihja dot më ndjenjat e mia. Qava. Qava për të gjithë ne. Qava dhe i mallkova të gjithë ata që i ndanë qipriotët. Ne nuk e meritonim një gjë të tillë”.

Fjalët e tij të fundit do të më djegin gjithmonë si zjarr në zemër.

Report, 46, f. 25.

❓ Ç’ndjenja të njerëzve të thjeshtë ndaj politikës dhe politikanëve reflektohen në këto tekste? Komentoni fjalët e Nikolasit: “Ne nuk e meritonim këtë gjë”. A mund të luajnë njerëzit e thjeshtë ndonjë rol për kapërcimin e nacionalizmit? Në ç’mënyrë? A keni dijeni për shembuj të tjerë shtetesh ose qytetesh të ndara në Europën e shekullit të 20-të?

❓ Pyetje përmbledhëse:

Nëse në të shkuarën nacionalizmi përforcohej përmes mjeteve arsimore, a dini ndonjë mënyrë për t’i lehtësuar tensionet kombëtare në të ardhmen?

Bibliografia

- ACIME = Arhiva concursului ISTORIA MEA-EUSTOR [Arkivi i konkursit për hulumtimin historik HISTORIA IME – EUSTORY].
- Ahmed S. Aličić, *Pokret za autonomiju Bosne od 1831 do 1832* [Lëvizja për autonominë e Bosnjës në vitet 1831-1832], Sarajevë, 1996.
- *Atatürk'un Soylev ve Demecleri* [Përmbledhje e fjalimeve të Atatürkut], Stamboll, 1945-1952.
- Jim Bennett, Robert Brain, Simon Schaffer, Heinz Otto Sibum, Ruchard Staley, 1900: *The New Age. A guide to the Exhibition* [1900: Epoka e re. Guidë për ekspozitën], Cambridge, 1994.
- Dimitrie Bolintineanu, *Opere alese* [Vepra të zgjedhura], Bukuresht, 1961.
- Hristo Botev, *Complete Works* [Vepra të plotë] Sofje, 1986.
- Mahmud Esad Bozkurt, *Atatürk İhtilali* [Revolucioni i Atatürkut], Stamboll, 1967.
- Razi Brahimi, *Kënga Popullore e Rilindjes Kombëtare*, Shtëpia Botuese „Naim Frasheri“, Tiranë, 1979.
- H. N. Brailsford, *Macedonia. Its Races and their Future* [Maqedonia. Sfidat dhe e ardhmja e saj], New York, 1971.
- [C. I. Bratianu], *Missiunea Căilor Fearte Române. Studii politice, economice, sociale și tehnice*, Paris, 1870.
- *Cemal Paşa Hatıralar* [Kujtimet e Xhemal pashës], Stamboll, 1959.
- Ion Codru-Drăgușanu, *Peregrinul transilvan*, Bukuresht, [1956].
- Rodoljub Čolaković, *AVNOJ i narodno-oslobodolicka borba u Bosni i Hercegovini (1942-1943)* [AVNOJ dhe lufta për çlirim kom- bëtar në Bosnjë dhe Hercegovinë (1942-1943)], Beograd, 1974.
- *Constitutille române. Texte, note, prezentare comparativă* (red.), Mona-Lisa Puchianu, Corneliu Lungu, Gheorghe Iancu, Ioan Muraru), Bukuresht, 1993.
- *Христоматия по история на България. Българско Възраждане. Втората и третата четвър на 19 век* [Krestomaci për historinë bullgare. Rilindja bullgare. Çerekshekulli i dytë dhe i tretë i shekullit të 19- të], Sofje, 1996.
- *Crnogorski zakonici. Pravni izvori i politički akti od značaja za istoriju državnosti Crne Gore* [Kodet e ligjeve malazeze. Burime ligjore dhe dokumente politike të rëndësishme për historinë e shtetformimit të Malit të Zi] (ed. dr Branko Pavićević, dr Radoslav Raspopović), Podgoricë, 1998.
- Dinko Davidov, *Stematografija. Izobraženije oružij iliričkih. Izrezal u bakru Hristofor Žefarović i Toma Mesmer* [Heraldika. Paraqitje e stemave ilire. Të prera në bakër nga Hristofor Žefarović dhe Toma Mesmer], Novi Sad, 1972.
- *Държавен вестник* [Gazeta shtetërore].
- K.Th. Dimaras, *Κοράις κα η εποχή του* [Korais dhe periudha e tij], Athinë, 1953.
- Ljubodrag Dimić, *Istorija srpske državnosti, Knjiga III. Srbija u Jugoslaviji* [Historia e shtetformimit serb. Libri III. Serbia në Jugosllavi], Novi Sad, 2001.
- *Документи за българската история* [Dokumente për historinë e Bullgarisë], Sofje, 1931, t. 1.
- Edith M. Durham, *Albania and the Albanians, Selected articles and letters, 1903-1944*, Centre for Albanian Studies, [Shqipëria dhe shqiptarët. Artikuj dhe dorëshkrime të zgjedhura, 1903-1944] Centre for Albanian Studies, Londër, 2001.
- Sir Henry Eliot, *Some Revolutions and Other Diplomatic Experiences*, [Disa revolucione dhe përvoja të tjera diplomatike], Londër, 1922.

- Ρήγας Βελεστινλής, *Ανέκδοτα έγγραφα. Νέα στοιχεία* [Rigas Velestinlisi. Vepraf], vëll. V, redaktuar nga Paschalis M. Kitromilides, Athinë, 2000.
- Bernd J. Fischer, *Albanian Nationalism in the Twentieth Century*, in Peter F. Sugar (red.), *Eastern European Nationalism in the Twentieth Century* [Nacionalizmi shqiptar në shekullin e 20-të, te Peter F. Sugar (red.), *Nacionalizmi evropiano-lindor në shekullin e 20-të*], Washington, 1995.
- Dionyssi Fotopoulos, *Athenian Fashions at the turn of the 19th century*, [Moda athinase në fund të shekullit të 19-të], Athinë, 1999.
- Ziya Gökalp, *Turkculugun Esaslari*, [Parimet e turkizmës], Ankara, [1923].
- Vlado Gotovac, *Zvezdana kuga*, [Murtaja e yllit], Zagreb, 1995.
- Στρατηγού Γεωργίου Γρίβα-Διγενή Απομνημονεύματα Αγώνος, *EOKA 1955–1959* [Kujtimet e gjeneralit Grivas Digenis nga lufta e EOKA-s, 1955-1959], Athinë, 1961.
- Josip Horvat, *Politička povijest Hrvatske* [Historia politike e Kroacisë], vëll. I-II, Zagreb, 1990.
- Ferid Hudri, *Albania and the Albanians in world art*, [Shqipëria dhe shqiptarët në artin botëror], përkthyer nga Zef Simoni dhe Pavli Qesku, Athinë, 1990.
- Θέματα Νεότερης και Σύγχρονης Ιστορίας από υς πηγές [Çështje të historisë moderne dhe bashkëkohore nga burimet], Athinë, 2003.
- IEE, [Historia e kombit grek], vëll. 12.
- D. Ionescu, *Albina. Revista populara*, I, no. 35, 31 maj, 1898.
- George Ionescu-Gion, *Stiul istorei naționale în școalele noastre* [Mësimi i historisë kombëtare në shkollat tona], Bukuresht, 1889.
- Ιστορία της Κύπρου Μεσαιωνική-Νεότερη (1192-1974) [Historia mesjetare dhe moderne e Qipros], Nikozia, Ministria e arsimit dhe kulturës, 2001.
- Konstantin Jireček, *Български дневник* [Ditari bullgar], vëll. 1 (1879-1881), Sofje, 1995.
- Miodrag Jovičić (red.), *Ustavi Kneževine i Kraljevine Srbije* [Kushtetutat e Principatës dhe Mbretërisë Serbe], Beograd, 1988.
- Ivan Frano Jukić, *Putopisi i istoriko-etnografski radovi* [Shënime udhëtimi dhe punime historiko-etnografike], Sarajevë, 1953.
- Dragan Jurak, kolumna Film&Video, "Feral Tribune", Nr 707, 5 prill, 1999.
- E. Kapsomenos, *Διονύσιος Σολωμός. Ανθολόγιο θεμάτων της Σολωμικής Ποίησης* [Dionisios Solomos. Antologji e temave të poezisë së Solomos], Athinë 1998; përkthimi anglisht: Prof. Nina Gatzoulis, *Një portret i Dionisios Solomos dhe dy prej poezive të tij*, <http://www.helleniccomserve.com/solomos.html>.
- Vuk Stefanović Karadžić, *Prepiska IV* [Korrespondenca IV] (1829-1832), Beograd, 1988.
- Lyuben Karavelov, *Любен Каравелов. Събрани съчинения* [Veprat e plotë], vëll. 7, Sofje, 1985.
- Dimitrios Katartzis, „Συμβουλή στους νέους πως να ωφελιούωται και να μη βλάπτουμαι απτά βιβλία τα φράγκικα και τα τούπικα, και ποια 'ναι η καθ' αυτό τους οπουδή“ [Këshillim për të rinjtë se si të përfitojnë dhe të mos dëmtohen nga librat frëng dhe turq dhe çfarë duhet të studiojnë], (red. C.Th. Dimaras), Athinë, 1970.
- Καθημερινή – Επτά ημέρες [Tirar i veçantë: lamtumirë dhrahmi], 30/12/01, f. 4.
- Paschalis M. Kitromilides, *Ιώσηπος Μοισιόδαξ Οι συντεταγμένες βαλκαμικής σκέψης τον 18°* [Josip Mesidaks. Koordinatat e Ballkanit që mendoheshin në shekullin e 18-të], Athinë, 2004.
- Ahmed Kondo, *Jeronim de Rada. Flamuri i Arbrit*, Tiranë, 1967.
- Faik Konitza, *Selected Correspondence 1896-1942* [Korrespondencë e përzgjedhur] 1896-1942, Londër, 2000.

- *Конституция на Българското кнџество* [Kushtetuta e Principatës Bullgare], Sofje, 1879.
- Konstantin Konstantinov, *Път през бековите* [Një udhë nëpër shekuj], Sofje, 1997.
- Christina Koulouri, *Исторία και γεωγραφία στα ελληνικά σχολεία (1834–1914). Γμςστικό αντικείμενο και ιδεολογικές προεκτάσεις. Ανθολόγιο κειμένων. Βιβλιογραφία σχολικών εγχειριδίων* [Historia dhe gjeografia në shkollat greke (1834-1914). Përmbajtja dhe ndërlikimet ideologjike. Antologji tekstesh. Bibliografi e teksteve shkollore], Athinë, 1988.
- Emilij Laszowsky, *Stari i novi Zagreb* [Zagrebi i vjetër dhe i ri], Zagreb, 1994.
- Bernard Lewis, *The emergence of modern Turkey* [Ngritja e Turqisë moderne], Oxford, 1968.
- Radoš Ljušić, *Knjiga o načertaniju* [Libri i Naçertanjes], Beograd, 1993.
- Radoš Ljušić, *Istorija srpske državnosti. Kniga II. Srbija i Crna Gora – novovekovne srpske države* [Historia e shtetformimit serb. Libri II. Serbia dhe Mali i Zi – shteti serb i kohëve moderne], Novi Sad, 2001.
- Lina Louvi, *Περιγέλωτος Βασιλείου, Οι σατυρικές εφημερίδες και το εθνικό ζήτημα, (1875-1886)* [Perigelotos Vassilion; Gazetat satirike dhe çështja kombëtare (1875-1886)], Athinë, Hestia, 2002.
- Corneliu Mihai Lungu (koord.), *De la Pronun-ciament la Memorandum 1868 -1892. Mişkarea memorandistă, expresie a luptei naționale a românilor* [Nga shpallja tek memorandumit. Lëvizja memorandiste, shprehje e luftës kombëtare të rumunëve], Bukuresht, 1993.
- Titu Maiorescu, *Opere* [Vepra] (red. Georgeta Rădulescu-Dulgheru, Domnica Filimon), Bukuresht, 1978.
- Makedonium, *Antologija na makedonskata nacionalno-politichka misla* [Makedonium, Antologji e mendimit politik kombëtar maqedo- nas], Shkup, 2003.
- Sp. Markenzis, *Πολιτική ιστορία της Νεωτέρης Ελλάδος* [Historia politike e Greqisë moderne], Vëll. B, Athinë, 1966.
- P. Matalas, *Έθνος και ορθοδοξία. Οι περιπέτειες μιας σχέσης. Από το „Ελλαδικό“ στο Βουλγαρικό σχίσμα* [Kombi dhe ortodoksia. Aventurat e një marrëdhënieje. Prej skizmës “greke” tek ajo bullgare], Herakleion, 2002.
- *Мемоару протме Матеје Ненадовића* [Kujtimet e priftit Mateja Nenadoviç], Beograd, 1867.
- “Monitorul Oficial”, [Monitori zyrtar], 19 korrik 1921.
- Bogdan Murgescu (koord.), *Istoria României în texte*, [Historia rumune në tekste], Bukuresht, 2001
- Hysni Myzyri, *Shkollat e Para Kombëtare Shqipe*, Tirana, 1978.
- Gazeta Nacak, 73, 7 tetor 1960.
- Riza Nur, *Hayat ve Hatiratim I* [Jeta dhe kujtimet e mia I], Stamboll, 1992.
- *Odbrani tekstovi za istorijata na makedonskiot narod*, II del, [Tekste të zgjedhura për historinë e popullit maqedonas], pjesa II, Shkup, 1976.
- Konstantinos Oikonomos, *Επίκρισις εις την περί Νεοελληνικής Εκκλησίας σύντομον απάντησιν του σοφού διδσκάλου Κ. Νεόφυτου Βάμβα* [Koment për përgjigjen e shkurtër të mësuesit të shkolluar Z. Neofitos Vamvas rreth Kishës Moderne Greke], Athinë, 1839.
- K. Ozturk, *Ataturku*, Istanbul, n.d.
- Paisiy Hilendarski, *Slavonic-Bulgarian History* [Historia sllavo-bullgare] V. Tërnovë, 1992.
- Spyros Papageorgiou, (red.), *Αρχείον των παρανόμων εγγράφων του Κυπριακού Αγώνος 1955-1959* [Arkivat e luftës ilegale qipriote], Nikosia, 1984.

- Spyros Papageorgiou, AKEL: *To άλλο ΚΚΕ [AKEL, Partia tjetër komuniste greke]*, Athinë, 1984.
- Παρθενών [Parthenon], dhjetor 1871.
- Nikola Pašić, *Sloga Srbo-Hrvata [Uniteti serbo-kroaf]*, Beograd, 1995.
- Branko Petranović, Momčilo Zečević, (red.), *Jugoslavija 1918-1988. Zbirka dokumenta. [Jugosllavia 1918-1988. Përmbledhje dokumentesh]*, botimi i II, Beograd, 1988.
- A. Politis, *Ρομαντικά χρόνια. Ιδεολογίες και ωοτροπίες στην Ελλάδα του 1830–1880 [Vitet romantike. Ideologjitë dhe mendësitë në Greqi, 1830-1880]*, Athinë, 1993.
- Aurel C. Popovici, *Stat și Națiune. Statele- Unite ale Austriei Mari. Studii politice în vederea rezolvării problemei naționale și a crizelor con-tstituționale din Austro-Ungaria [Shteti dhe kombi. Shtetet e Bashkuara të Austrisë së Madhe. Studime politike për zgjidhjen e problemit kombëtar dhe krizave kushtetuese në Austro-Hungari]*, (red. Petre Pandrea dhe Constantin Schifinet,), Bukuresht, 1997.
- David Prodan, *Supplex Libellus Valachorum or the Political Struggle of the Romanians in Transylvania during the 18th century [Supplex Libellus Valachorum ose Lufta politike e rumunëve në Transilvani gjatë shekullit të 18-të]*, Bukuresht, 1971.
- Janko Prunk, *Slovenski narodni vzpon [Ngritja kombëtare sllovene]*, Lubjanë, 1992.
- M. Psalidopoulos, (yr.), *Κείμενα για την ελληνική βιομηχανία 19^ο αιώνα. Φυσική εξέλιξη ή προστασία [Dokumente për industrinë greke në shekullin e 19-të. Zhvillim i natyrshëm apo mbrojtje?]*, Athinë, 1994.
- Gjorgji Pulevski, *Izbrani tekstovi [Tekste të zgjedhura]*, Shkup, 1985.
- Stjepan Radić, *Izabrani politički spisi, [Shkrime të zgjedhura politike]*, Opatija, 1995.
- Božo Repe, *Viri o demokratizaciji in osamosvojitvi Slovenije (I del: Opozicija in oblast) [Burime rreth demokratizimit dhe pavarësisë së Sllovenisë (pjesa I, Opozitë dhe autoritet)]*, Lubjanë, 2002.
- “Raport. Miqtë e Qipros”, nr. 46, vjeshtë 2003.
- Ρήγα Βελεστινλή *Απαντα τα σςζόμενα [Veprat e plota të Rigas Velestinlisit]*, vëll. V (red. Paschalis M. Kitromilides), Athinë, 2000.
- *România în chipuri și vederi [Rumania në pamje dhe kartolina]*, Bukuresht, 1926.
- Vedrana Rudan, *Uho, grlo, nož [Veshi, fyti, thika]*, Zagreb, 2002.
- August Šenoa, *Zagrebulje [Shkrimet e Zagrebit]*, Zagreb, 1980.
- Σημαίεις ελευθερίας. Συλλογή του Εθνικού Ιστορικού Μουσείου [Flamujt e lirisë. Përmbledhje e Muzeut Historik Kombëtar], parathënia-tekstet nga I.K. Mazarakis-Ainian, Athinë, 1996.
- *Slovenska kronika 19 stoletja 1861-1883 [Kronika sllovene e shekullit të 19-të] 1861-1883*, Nova rivja, Lubjanë, 2003.
- *Srpska čitanka za niže gimnazije i realke [Tekstet serbe për gjimnazin dhe klasat e ulëta]* (red. nga Stojan Novaković), Beograd, 1870.
- Христо Стамболски, *Автобиография, дневници, спомени [Hristo Stambolski Autobiografi, Ditare, Kujtime]*, Sofje, 1927, t. 2.
- Gale Stokes, (red.), *From Stalinism to Pluralism. A Documentary history of Eastern Europe since 1945 [Nga stalinizmi deri te pluralizmi. Histori dokumentare e Europës Juglindore që nga 1945]*, botimi II, New York, 1996.
- Dubravka Ugrešić, *Američki fikcionar [Trillet amerikane]*, Zagreb/Beograd, 2002.

- E. Vakalopoulos, *Επίλεκτες βασικές ιστορικές πηγές της ελληνικής επανάστασης* [*Burime historike bazë të përzgjedhura për revolucionin grek*], Selanik, Vanias, 1990.
- Pashko Vasa, *The truth on Albania and the Albanians, historical and critical essays* [*E vërteta mbi Shqipërinë dhe shqiptarët, ese kritike dhe historike*] Londër, 1999.
- Gjijn Varfri, *Heraldika Shqiptare*, Tiranë, 2000.
- Evgenios Voulgaris, *Στοχασμοί εις τους παρόντας κρίσιμους καιρούς του Οθωμανικού Κράτους* [*Reflektime mbi të tashmen kritike të shtetit osman*], Korfuz, 1851.
- Wayne S. Vučinić, *The Ottoman Empire: its record and legacy* [*Perandoria Osmane: Kujtimi dhe trashëgimia e saj*], New Jersey, 1965.
- Martin Wein, *Dodjoh, vidjeh, zapisah* [*Unë erdha, vështrova, mora shënime*], Zagreb, 1966.
- A.D. Xenopol, *Istoria românilor din Dacia Traiană* [*Historia e rumunëve nga Dakia e Trajanit*], botimi IV (red. V. Mihăescu-Bîrliba, Al. Zub), Bukuresht, 1985.
- Šarl Iriar, *Putopis po Bosni 1875-1876* [*Çarles Yriarte, Shënime udhëtimi nga Bosnja 1875-1876*], Sarajevë, 1981.
- *Za Hrvatsku*, [*Për Kroacinë*], Zagreb, 1992.
- Иван Вазов. Аз съм българче. Стихотворения за деца [*Unë jam bullgar. Poezi për fëmijë*]. Plovdiv, 2005.
- Andrijašević Živko, *Crnogorska crkva 1852-1918 (Kisha malaze 1852-1918)*, Nikshiq, 2008.
- *Besjede i proglasi kralja Nikole (Fjalime dhe deklarata të mbretit Nikolla)*, Cetinë, 2010.
- Đorđević Vladan, *Crna Gora i Austrija u XVIII veku (Mali i Zi dhe Austria në shekullin e 18^{te})*, Beograd, 1912.
- Pavićević Branko, Raspopović Radoslav, *Crnogorski zakonici, tom IV (Ligjet e Malit të Zi, Vëllimi IV)*, Podgoricë, 1998.
- P.P. Petrović Njegoš, *Izabrana pisma (Letra të zgjedhura)*, Beograd, 1984.
- Petranović Branko, Zečević Momčilo, *Istorija Jugoslavije 1918-1988 (Historia e Jugosllavisë 1918-1988)*, Beograd, 1988.
- Stefanaq Pollo dhe Selami Pulaha, *Akte të Rilindjes Kombëtare Shqiptare (1878-1912)*, Tiranë, 1978.
- Rastoder Šerbo, *Crna Gora u egzilu, II (Diaspora e Malit të Zi, II)*, Podgoricë, 2004.
- Vujović Dimitrije-Dimo, *Podgorička skupština 1918 (Asambleja e Podgoricës 1918)*, Zagreb, 1989.
- <http://www.portalanalitika.me/drustvo/tema/32789-ovdje-jo-ima-patoloke-energije-.html>
- <http://ebookbrowse.com/kanuni-i-lek-dukagjinit-pdf-d238875778>
- <http://plisi.al/skedat/bp-1036281933-sp.pdf>

Hartat

Harta 1: Denis P. Hupchik, Harold E. Cox, *The Palgrave Concise Historical Atlas of the Balkans* [Atlas i përmbledhur historik i Ballkanit nga Palgrave], New York, 2001, harta 25.

Harta 2: *Ibid.*, harta 28.

Harta 3: *Ibid.*, harta 35.

Harta 4: Patrick K. O' Brien (red.), *Phillip's Atlas of World History*, [Atlas i historisë botërore nga Phillip], Londër: George Philip, 1999, f. 220.

JEPNI VLERËSIMIN TUAJ PËR KËTË LIBËR!

Mendimi juaj si lexues është me shumë rëndësi për ne, në mënyrë që të vlerësojmë punën e bërë dhe të planifikojmë nismat tona të ardhshme. Qendra për Demokraci dhe Pajtim në Europën Juglindore (CDRSEE), së bashku me një numër kolegësh dhe bashkëpunëtorësh kanë kryer një punë të madhe dhe kanë shfrytëzuar burime të çmuara për projektin “Mësimdhënia e Historisë Moderne të Europës Juglindore”, rezultat i të cilit është ky libër që keni në duar. Në mënyrë që të vlerësojmë frytshmërinë e metodës së përdorur, dobinë e kësaj sipërmarrjeje dhe vlerën e punës sonë, do të dëshironim që të jepnit vlerësimin tuaj për këtë projekt. Ju lutemi, na jepni opinionin tuaj të sinqertë, duke na kushtuar pak kohë dhe kujdes nga ana juaj.

Pasi ta lexoni këtë libër ose ta keni përdorur në klasë, ju lutemi, shkoni në faqen tonë të internetit, dhe tek seksioni “Librat e Punës të Historisë” plotësoni një formular vlerësimi. Formularin e vlerësimit mund ta gjeni në adresën: <http://www.cdsee.org/jhp/index.html>

Nëse dëshironi, mund të na shkruani në adresën elektronike: info@cdrsee.org dhe komentet tuaja do t’i dërgohen drejtpërsëdrejti njërit prej koordinatorëve të PHP-së.

Gjithashtu, mund të na shkruani edhe në adresën postare:

Center for Democracy and Reconciliation in Southeast Europe (CDRSEE)
Krispou 9, Ano Poli, 54634 Thessaloniki, Greece

